

VLERAT KOMBËTARE SHQIPTARE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Elira LULI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Marrëdhënie Ndërkombëtare për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Klodiana Beshku (PhD)

Numri i fjalëve: 73.757

Vendi, muaji viti i dorëzimit
Datë: 14 Dhjetor 2017, Shkollës Doktorale UET
Tiranë

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se kjo tezë doktrature është punimi im origjinal dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre që ndodhen të cituara gjatë punimit.

Të gjitha të dhënat, citimet në tekst të cilat egzistojnë në këtë punim si të riprodhuara nga ndonjë burim tjetër, duke përfshirë dokumenta, libra, artikuj, apo internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Kjo deklaratë ka fuqi kontraktuale, dhe jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve dhe çdo akt plagjiature i cilësuar i tillë nga Komisioni Vlerësues i Punimit çon deri në heqjen e të drejtës së studentit për të ridorëzuar punimin në një moment të mëvonshëm.

ABSTRAKTI

Vlerat kombëtare janë tiparet, që e dallojnë një komb nga një komb tjetër dhe që përbëjnë shtyllën kurrizore të një populli. Vlerat kombëtare zbërthehen dhe shpalosen nga identiteti i një kombi. Trashëgimia kombëtare etno-kulturore dhe vlerat e një kombi mund të konsiderohen si elementë tregues në lidhje me atë se çfarë mundësish ka një vend për të hedhur themelet e zhvillimit dhe çfarë mundësish ka për t'u integruar në BE, si në rastin e Shqipërisë e cila aspiron të integrohet në familjen e kombeve të Bashkimit European.

Kombi Shqipta përveç vlerave të veçanta etno-kulturore, shënjuese të shpirti kombëtar shqiptar, dallohet edhe për vlera liberale dhe demokratike ende jo shumë të zhvilluara në krahasim me po të njëjtat vlera të BE-së.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë vlerat, duke i rënditur në dy sisteme përkatëse, atë kombëtar dhe atë European (BE) në mënyrë që të dekonstruktohen me qëllim për të parë fushat e përputhshmërisë dhe të përplasjes, ndërveprimin që këto sisteme mund të kenë me njëri-tjetrin si dhe mundësitë për të rindërtuar apo influencuar njëri-tjetrin.

Në mënyrë që të shihet se si këto dy rrafshë përshtaten, konstruktojnë apo kanë mundësi të influencojnë njëri-tjetrin është dashur të analizohen dimensionet kulturore dhe politike-normative të të dyja këyre sistemeve.

Në ndihmë të shtjellimit të tezës, si bosht teorik do të përdoret qasja konstruktiviste në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, për të parë gjerësisht mënyrën dhe mundësitë e ndërveprimit dhe rindërtimit të dy rrafshëve të lartpërmendura, nëpërmjet metodologjisë dekonstruktiviste, tipike e kësaj qasje, e cila do të ndihmojë më gjerësisht për të bërë një zbërthim më të detajuar të vlerave të të dy sistemeve.

Qëllimi i fundëm është për të sjellë një qartësi më të perceptueshme në lidhje me kategorinë e vlerave kombëtare të cilat krijojnë përputhshmëri dhe të atyre që krijojnë ende mospërputhje me ato europiane të BE-së .

Së pari ky punim do të shtjellojë sistemin vleror të BE-së, pra BE me kategorinë e vlerave kulturore, qasjet e saj rreth identitetit, si qasja esencialiste në një anë

dhe qasja multi-kulturore në rrjedhën e sotme globale, e cila dominon dhe kategorinë e vlerave dhe normave të fuqisë normative, cilat norma aplikon nëpërmjet saj dhe rëndësia e tyre.

Së dyti do të shtjellojë: sistemin vleror shqiptar me kategorinë e tij të vlerave etno-kulturore tradicionale që lidhen me identitetin kombëtar si, traditat kulturore, bashkëjetesa apo tolerance fetare dhe gjuha, të cilat mund të gjejnë hapësirë për t'u shpalosur dhe të zhvillohen më tutje nën rrjedhën e multikulturalizmit. Ndërsa për kategorinë e vlerave liberale politike do të përfshihen vlerat thelbësore dhe normat e reja nga fuqia normative e BE-së dhe ato do të krahasohen me ato kombëtare në këtë nivel nëpërmjet: **1.** Vlerave liberale dhe si janë ato në raport me normat e reja që aplikon BE-ja, **2.** Si është implementuar deri tani aspekti normativ i BE-së në vend; ku dhe në çfarë fushash vendi mbetet mbrapa në përmbushjen e reformave.

Përfundimet do të paraqesin më së shumti rekomandimet që lidhen me ruajtjen e vlerave etno-kulturore (të cilat kanë një fokus të veçantë në këtë tezë), si duhet të zhvillohen ato me qëllimin për ti promovuar më pas në një familje të madhe kombesh multi-kulturore si BE.

Si mund të vijë në ndihmë diplomacia publike në promovimin e imazhit të një vendi dhe mënyrat dhe mekanizmat për të promovuar vlerat kulturore kombëtare në një epokë marrëdhëniesh multi-kulturore, gjatë procesit të integrimit në BE.

Gjithashtu ky studim do përpiqet të hartojë edhe një bazë të të kuptuarit të kategorisë vlerore politike normative, e cila vazhdon të krijojë mospërputhje me normat post-demokratike të BE-së dhe vonon për këtë arsye, sipas këndvështrimit të kësaj teze, integrimin e Shqipërisë atje.

ABSTRACT

National values are features that distinguish one nation from another. They constitute the backbone of a nation and decode national identity. National ethno-cultural heritage and values of a nation are indicative elements that show what opportunities a country possesses to set the development foundations, ways to promote them in the frames of a global multi cultural climate and what are the perspectives to integrate in the EU, where, in addition to many cultural values Albania possesses, it is still characterized by underdeveloped democracy and liberal values comparing to EU.

The aim of this paper is to analyze these values by ranking them in two relevant systems: national and European Union (EU) one, so that the deconstruction process can be more explicit, in order to understand the areas of compliance and collision, the interaction that these systems may have with one another and the ability they have to construct by influencing each-other.

In order to view how these contexts construct and influence each other, it is important to analyze the normative and cultural aspects on both sides.

In support of the thesis elaboration, as a theoretical axis will be used the International Relations constructivist approach, in order to give a broader view on the ways, opportunities and prospects that the above mentioned plans have to construct each other. The deconstruction methodology, which is a typical methodology of the constructivist approach, will serve to provide a wide detailed deconstruction of the values that this thesis aims to highlight and analyze on both systems. The main purpose is to bring a better understanding or to shed light on the categories of national values that complement each other and those who still create discrepancies with those of the European Union.

This paper will first elaborate the EU value system, namely, the category of EU cultural values and approaches regarding EU identity, such as the essentialist approach in one hand and the constructivist approach that prevails in the era of globalism on the other hand. Furthermore it will elaborate the category of

normative power values, what applies through its norms and their importance to EU.

Second it will elaborate: Albanian system of values, namely, its category of ethno-cultural values related to national identity such as cultural traditions, religious tolerance, and language, in the frames of a multicultural (not only European) global flow. While, for the category of political liberal values, will be elaborated national liberal values in comparison to minor norms and fundamental values applied by EU, to understand to what degree and in what domains the country is still lagging behind in reform implementation.

Conclusions will submit mostly recommendations related to ethno-cultural values (which have a special focus in this thesis), how should they be preserved in order to be later promoted in a large family of multi-cultural nations. How Public Diplomacy may be of great help regarding national image promotion, since it possesses practices and mechanisms to promote national and cultural values in the era of multicultural relations.

Finally, this thesis, will try to develop and submit a basic understanding of national normative political category, which continues to create discrepancies with EU fundamental values and post-democratic norms and therefore, in the view of this thesis, delaying the EU integration process of Albania.

DEDIKIMI

Ja dedikoj këtë punim prindërve të mi që më kanë mbështetur me një vendosmëri të madhe në këtë rrugëtim. Babait, i cili ka qenë një mentor shpirtëror dhe frymëzues i imi në lidhje me vlerat kombëtare, dhe nënës sime që më më ka shtyrë gjithmonë drejt arsimimit dhe formimit të mëtejshëm....Dhe në fund, por jo nga rëndësia, Udhëheqëses sime, Dr. Klodiana Beshku, e cila me ka drejtuar, mbështetur dhe udhëzuar në çdo hap me urtësinë, potencialin akademik dhe vlerat e mëdha morale që e karakterizojnë. Ishte ndihmesa e saj e çmuar, që ky punim mori drejtim dhe formë, siç e kisha dëshiruar.

“VLERAT KOMBËTARE SHQIPTARE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN”

Falenderime

Përmbajtja e Lëndës

Lista e Ilustrimeve dhe e Fjalorit

Kapitulli I

Hyrje.....	faqja 13
1.1 Ideja kryesore dhe objekti kërkimor studimor.....	faqja 16
1.2 Terminologjia e përdorur në studim.....	faqja 19
1.3 Pyetja kërkimore shkencore e studimit.....	faqja 20
1.4 Nënçështjet teorike.....	faqja 21
1.5 Arsyet e kryerjes së këtij studimi.....	faqja 22
1.6 Përmbledhja e literaturës dhe përse u përzgjedhën këto të dhëna cilësore.....	faqja 25
1.7 Hipoteza e studimit.	faqja 30
1.8 Variablat e Studimit.....	faqja 31
1.9 Përse konstruktivizmi për këtë studim.....	faqja 32
1.10 Metodologjia e kërkimit shkencor.....	faqja 35

1.11 Kufizimet teorike	faqja 41
------------------------------	----------

Kapitulli II

Modeli Teorik/Shtjellimi i Literaturës

2.1 Korniza teorike dhe veprat që ndihmuan në përcaktimin e saj.....	faqja 43
2.2 Diskutim i shkollave të ndryshme teorike ekzistuese.....	faqja 45
2.3 Çfarë synon të evidentojë ky studim?.....	faqja 51
2.4 Konceptet e përdorura në studim.....	faqja 54
2.4.1 Përpunimi i këtyre koncepteve në përputhje me metodën dekonstruktiviste.....	faqja 57

Kapitulli III

Analizë rreth qasjeve për identitetin europian dhe identitetin kombëtar shqiptar si dhe kategoria kulturore e vlerave për të dy sistemet.

3. 1 Qasja esencialiste për vlerat Europiane. Çfarë kuptohet me identitet Europian sipas kësaj qasje.....	faqja 59
3.2 Vlerat europiane në periudhat e lulëzimit të themeleve kulturore europiane.....	faqja 63
3.2.1 Europa, nga civilizimi i hershëm në kohët e sotme.....	faqja 65
3.3 Feja/Religjioni	faqja 69
3.4 Rëndësia e gjuhëve europiane për trashëgiminë kulturore dhe pasurimin e saj.....	faqja 74
3.5 Qytetaria europiane.....	faqja 78
3.5.1 BE nën dy trendet kundërshtarë përbrenda saj: Tendencës për një identitet të unifikuar universal apo tendencës për bashkëjetesë tolerante	

ndërmjet identiteteve të ndryshme.....	faqja 82
3.5.2 Përfundime për rastin e identiteteve të ndryshme në BE, për të shkuar tek rasti i identitetit shqiptar.....	faqja 91
3.6 Identiteti kombëtar shqiptar.....	faqja 92
3.7 Gjuha si vlerë dhe shprehëse e identitetit kombëtar.....	faqja 96
3.7.1 Rëndësia dhe veçantia e gjuhës shqipe.....	faqja 97
3.8 Bashkëjetesa fetare.....	faqja 102
3.8.1 Kritikë dhe vlerat në lidhje me bashkëjetesën fetare në Shqipëri.....	faqja 106
3.9 Traditat kulturore shqiptare në themel të vlerave kombëtare.....	faqja 113
3.9.1 Mikpritja.....	faqja 116
3.9.2 Besa.....	faqja 117
3.9.3 Kanunet shqiptare.....	faqja 117
3.9.4 Lindja, martesat dhe vdekja.....	faqja 120
3.9.5 Folklori Shqiptar.....	faqja 122

Kapitulli IV

Vlerat thelbësore dhe normat e reja të BE-së, rëndësia e tyre për BE-në dhe si shfaqen ato në realitetin shqiptar

4.1 Si do të zhvillohet dekonstruktimi i kategorisë së vlerave politike-normative për secilin sistem.....	faqja 123
4.2 BE si fuqi normative.....	faqja 125
4.2.1 Normat dhe vlerat që ekzistojnë në themel të BE-së.....	faqja 129

4.3 Dekonstruktimi i vlerave liberale në kontekstin kombëtar, duke u bazuar mbi vlerat thelbësore dhe normat e reja post-demokratike të BE-së.....	faqja 141
4.3.1 Identiteti kombëtar shqiptar në periudha të ndryshme historike¹.....	faqja 142
4.4 Vlerat thelbësore dhe normat e reja në nivel kombëtar shqiptar..	faqja 151
4.4.1 Progresi social.....	faqja 153
4.5 Rastet e diskriminimit në Shqipëri.....	faqja 156
4.6 Qeverisja shqiptare.....	faqja 159
4.7 Marrëdhëniet Shqipëri-BE, Pësia e lidërshimit politik dhe aktualiteti Normativ.....	faqja 169

Kapitull V

Përfundime dhe rekomandime

• Rrafshi mbikombëtar (BE).....	faqja 174
• Rrafshi kombëtar.....	faqja 176
• Perfundime dhe rekomandime në lidhje me vlerat etno-kulturore (Gjuha).....	faqja 179
(Toleranca fetare).....	faqja 181
(Traditat etno-kulturore).....	faqja 184
• Rekomandime	
(Vlerat liberale, reformat dhe imazhi).....	faqja 185
(Roli i diplomacisë publike në përmirësimin e imazhit.....	
kombëtar.....	faqja 191
Multikulturalizmi.....	faqja 199

¹ Pikërisht në këtë kapitull, dhe jo në atë që zbërthen kategorinë e vlerave kulturore, analizohet rrugëtimi historik i identitetit shqiptar për të evidentuar vështirësitë dhe vonesat në shtetformim, politikbërje dhe në qeverisjen shqiptare.

Shtojca (Intervista)

Bibliografia/Referencat.....faqja204

Kapitulli I

1. Hyrje

Vlerat kombëtare janë tiparet që e dallojnë një komb nga një komb tjetër dhe që përbëjnë shtyllën kurrizore të një populli. Ato zbërthejnë identitetin e një kombi.

Trashëgimia dhe vlerat etno-kulturore kombëtare, normat dhe vlerat demokratike të një kombi janë element tregues se çfarë mundësish ka një vend për t'u integruar, si në rastin e Shqipërisë e cila aspiron të integrohet në BE.

Ky studim do të analizojë, vlerat etno-kulturore si shënjestra të identitetit shqiptar ndër shekuj, vlerat liberale shqiptare dhe “normat sociale”(Durkheim 2004; 16) si janë ato në raport me vlerat thelbësore dhe normat post-demokratike të BE-së.

Pra normat si “trashëgimi ose rregulla” (Durkheim 2004; 16) në tërësi, duke i përfshirë këto si nivele analize në një “sistem vleror” të përgjithshëm (Inglehart-Baker 2000;49)².

Për të analizuar këtë “sistem vleror” shqiptar është e nevojshme të analizohen disa nivele të ngjashme në kuadrin e BE-së, të cilat gjithashtu do të përfshihen në një “sistem vleror” (Inglehart-Baker 2000;49) dhe do dekonstruktohen gjatë analizimit të tyre në mënyrë që të bëhet “një skicim i profilit vleror” (Kocani 2013; 13) i të dy rrafshëve; atij kombëtar dhe atij mbikombëtar.

Secili prej këtyre sistemeve është i ndarë në **nivel tradicional vlerash** që formojnë si identitetin kulturor kombëtar nga njëra anë ashtu edhe atë europian multi-kulturor nga ana tjetër. Gjithashtu është i ndarë dhe në **nivel bashkëkohor (te ri, post modern)** që përbën në nivel kombëtar konsolidimin e demokracisë, ndërsa në atë mbikombëtar rolin normativ të BE-se nga që rrjedh nga fuqia normative e saj.

Strategjia e sigurisë kombëtare në vetvete, një dokument me karakter kombëtar, lind dhe përcaktohet nga vetëvlersimi që një popull ka për këto vlera kombëtare dhe për institucionet shtetërore, pasi jo vetëm “mbrojtja dhe konsolidimi i sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së R.SH-së, rendit kushtetues

² Një sqarim i mëtejshëm rreth konceptit të sistemeve vlerore do të jepet në pjesën që sqaron metodologjinë e punimit.

demokratik, zhvillimi i të drejtave dhe lirive themelore”(SSK 2014;4) përbën rëndësi strategjike për vendin tonë, por për më tepër, “ruajtja e identitetit dhe e vlerave kombëtare, si dhe rritja e mirëqenies së shoqërisë është interesi jetik kombëtar” (*ibid*) Ruajtja dhe promovimi i vlerave kombëtare, në rastin e Shqipërisë, si një vend që nuk njihet aq sa duhet ose flitet për të në mënyrë të përgjithësuar, do të shërbente jo vetëm për të përmirësuar imazhin dhe për të ndërtuar në vazhdimësi harmoni, stabilitet dhe mirëqenie të brendshme, por edhe për të ndërtuar hallka të sigurta në marrëdhënie me fqinjët dhe me familjen e madhe të BE-së ku synohet të integrohet. Mbi interesin kombëtar duhet të ndërtohet politika e jashtme e një vendi, pasi “politika e jashtme përfaqëson, mbron dhe zhvillon interesat kombëtare të R.SH-së” (SSK 2014;13) dhe gjithashtu kjo politikë “karakterizohet nga vijueshmëria dhe qëndrueshmëria e prioriteteve.”(*ibid*) Në rast të mos përmbushjes të këtyre prioriteteve, si mund të arrihet efektiviteti i mbrojtjes së interesave dhe vlerave kombëtare në shtrirje kohore dhe në vështirimin perspektiv duke garantuar kështu sigurinë, integritetin dhe fuqizimin e vendit?

Në këtë mënyrë, identifikimi i këtyre vlerave në një kontekst apo realitet ku shoqëritë ndërveprojnë, përshtaten dhe konstruktohen si dhe dekonstruktimi i tyre sipas këtij konteksti është me interes për kontributin që mund të kenë ato, jo vetëm për interesin kombëtar por edhe për familjen e kombeve të qytetëruara të BE-së, pasi edhe BE është e bazuar në një sistem vleror i cili “përsa i përket teksteve intelektuale ku ideja e Evropës artikulohet sipas qasjeve konstruktiviste, nuk është e vërtetë se e shkuara nuk përfillet, përkundrazi historia e qytetërimit evropian theksohet, por pa përjashtuar shndërrimet, kthesat, rëniet dhe ngritjet e saj (Sulstarova 2011;217)”³Në këtë këndvështrim, e shkuara si dhe kthesat apo momentet e vështira të historisë shqiptare, do të analizoheshin sipas metodës dekonstruktiviste për të parë vështirësitë që ka hasur esenca e shpirtit apo e identitetit kombëtar, duke ruajtur gjithsesi disa vlera thelbësore, karakteristike të

³Enis Sulstarova 2011, Jam Evropë, Ligjërimi i intelektualëve për Evropën në Shqipërinë e tranzicionit. (Politikja, nr.1:217)

identitetit kombëtar të cilat mund të promovohen sot nën qasjen konstruktiviste dhe asaj të multikulturalizmit, por këto vonesa kanë sjellë vonesa në shtetformim dhe të meta në politik-bërje dhe qeverisje.

Vlerat kulturore si “fakte sociale” (Durkheim 2008:76) shoqëria shqiptare në mënyrë të natyrshme i ka përcjellë që nga lashtësia, brez pas brezi. Këto vlera etno-kulturore të spikatura do kishin një bazë më solide nëse edhe realiteti kulturor-liberal dhe ai normativ që aplikon BE, do të ishte më i konsoliduar në vend. Me rrugën drejt aderimit në BE, shoqërisë shqiptare do t'i duhet të përshtatet me një realitet të ndryshëm normativ, nga një komunitet që tashmë ka formën e “një shoqërie të dhënë”⁴, në një realitet të dhënë, me “fakte të tjera sociale”(Durkheim: 2008; 76), pra me vlera në të cilat beson dhe promovon.

Kjo tezë kërkon të hulumtojë procesin e mundshëm të përshtatjes të sistemit vleror të Shqipërisë dhe mundësitë për ndryshim të disa hallkave të këtij sistemi të kategorive vlerore të cilat nuk përputhen, dhe të zhvillimit dhe promovimit të kategorive vlerore që përputhen. Si pikënisje studimi ka ngritur këto pikëpyetje si: A është patjetër i domosdoshëm një adaptim tërësor i sistemit vleror? Cila është rëndësia e promovimit të imazhit nëpërmjet zbërthimit të këtyre vlerave? Cilat janë ato fakte sociale me “detyrim të jashtëm” (Durkheim 2008:76) që na imponon komuniteti i BE-së dhe sa i është përshtatur Shqipëria deri tani? Cilat janë disa veprimtari në kuadër të diplomacisë publike që duhet të zhvillojë Shqipëria mbi bazën e këtyre vlerave që ka, në epokën e multi-kulturalizmit?

Sot, në kohën e globalizimit, interesat e një kombi janë të lidhura ngushtë me ato të fqinjëve të tij dhe me ato të komunitetit ndërkombëtar gjithashtu. Prandaj duhen shfrytëzuar asetet dhe kapacitetet e vendit nëse duhet të ndërtohet paqe e vazhdueshme, progres dhe prosperitet kombëtar. Mungesa e mospërshtatjes me një realitet normativ si ai i BE-së, e mos-shfrytëzimit, e mos-zhvillimit dhe e mos-

⁴Sipas Durkheim, “Një fakt social është çdo mënyrë veprimi, e fiksuar apo jo, që është në gjendje të ushtrojë mbi individin një detyrim të jashtëm; për më tepër që është e përgjithshme në tërësinë e një shoqërie të dhënë, ndërkohë që ka një egzistencë të sajën të pavarur nga manifestimet e saj individuale.(Durkheim, 1895/1982:13)” (Durkheim 2008:76)

promovimit të këtyre vlerave, mund të çojnë në një komb dhe shoqëri pa themele, të paaftë për të promovuar vetveten brenda dhe jashtë kufijve, gjithashtu të paaftë për të ndërtuar interesin kombëtar si dhe për ta implementuar atë.

1.1 Ideja dhe objekti i kërkimit studimor

Ideja e këtij punimi shkencor do të bazohet mbi rëndësinë e vlerave etno-kulturore shqiptare, shënjtuese të identitetit kombëtar, si pasuritë më të çmuara, shprehëse jo vetëm të identitetit por edhe të orientimit që ka një komb dhe interesin që mund të përbëjnë për kombin këto vlera, përgjatë promovimit të tyre në kuadër të përmirësimit të imazhit të këtij kombi. Ky studim, është produkt i shumë kërkimeve dhe hulumtimeve të bazuara në autorë të ndryshëm që kanë shkruar dhe analizuar çështjet e identitetit shqiptar dhe atij evropian, vlera të spikatura që përcaktojnë identitetin, normat politike, realitetin politik, imazhin, diplomacinë publike dhe multikulturalizmin.

Duke ju referuar të dhënave nga libra, artikuj shkencorë, gazeta, informacionit në media dhe faqeve të internetit, janë përzgjedhur në mënyrë selektive këto të dhëna për të ardhur në ndihmesë të ideve kryesore dhe objekteve të kërkimit të këtij punimi. Pra, duke u bazuar në të dhënat e përzgjedhura, nëpërmjet këtij studimi cilësor tipik për shkencat sociale, do shihet se si janë shtjelluar disa prej ideve dhe objektit të kërkimit që ky punim trajton nga autorët e përzgjedhur, si janë shtjelluar vlerat etno-kulturore shqiptare, si konceptohet çështja e identitetit evropian në BE dhe vlerat thelbësore që qëndrojnë në themel të BE-së, dhe njëkohësisht si rendin shtetet e BE-së pas identitetit dhe interesit individual.

Cilat janë benefitet që sjell promovimi i vlerave sot për shtetin dhe në mënyrë reciproke për shtetet?

Vlerat si “fakte sociale (Durkheim 2004: 56) të cilat kanë ndihmuar për të organizuar jetën kolektive të shoqërisë shqiptare do të analizohen dhe zbërthehen (dekonstruktohen) si “forma të të shprehurit, besimesh dhe tendencash të marra

kolektivisht, pra ato që kanë arritur me anë të vlerës së përsëritjes një lloj qëndrueshmërie” (po aty: 59) në kohë si për shembull traditat kulturore.

Si objekt kërkimor në këtë studim do të shërbejnë për analizim: Identiteti evropian si një entitet i përbërë prej identiteteve multi-kulturore të shteteve përbërëse brenda këtij entiteti dhe identiteti i veçantë etnik shqiptar, me vlerat e mbijetesës të cilat janë transmetuar brez pas brezi në shoqërinë tonë si fenomene të pajisura me veçantinë dhe autoritetin e tyre. Gjithashtu një kategori tjetër e objektit shkencor do të jenë vlerat liberale demokratike, si në sistemin e vlerave kombëtare shqiptare ashtu edhe në atë evropian, për kategorinë e vlerave politike normative. Gjatë gjithë analizës, do të kryeht një ballafaqim mes vlerave kombëtare dhe atyre evropiane përgjatë dy niveleve të mësipërme të objektit të analizës.

Duke qenë se Shqipëria është vend kandidat për të aderuar në BE, duke pasur parasysh marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në kanë filluar që në vitin 1991⁵, kur flitet për mundësitë e adoptimit duhet patur parasysh se çfarë standardizon dhe konsideron BE-ja si vlera dhe norma. Për shembull, nëse u referohemi traktateve, BE mbështetet "mbi parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe sundimin e ligjit" (EurActiv 2001), ndërkohë identiteti evropian kulturor mbart gjithashtu në themel të tij një grup vlerash si “arti evropian, kultura, shtetësia, edukimi i përbashkët për të gjithë anëtarët e BE-së, etj” (Patrutiou- Baltes; 2013).

Ky punim, duke vënë theksin mbi vlerat kombëtare, do të rreket të nxjerrë në pah rëndësinë për promovimin dhe zhvillimin e tyre jo vetëm në shoqërinë shqiptare, por edhe në shoqëritë e tjera të vendeve të cilat aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së. Ndërkohë, duke evidentuar mangësitë në realitetin politik-demokratikshqiptar, mund të shihet se cilat janë mundësitë e konstruktimit të vlerave liberale, të reja për Shqipërinë, sipas fuqisë normative që aplikon BE-ja. Ky studimka si objekt

⁵ Shqipëria vendosi marrëdhënie diplomatike me BE-në në vitin 1991, ndërsa në 1992 nënshkroi marrëveshjen për tregëti dhe bashkëpunim. Në vitin 1999 u përfshi në procesin e SA dhe e nënshkroi MSA-në në 2006.

kërkimor vlerat për secilin sistem, atë kombëtar dhe atë të BE-së dhe ballafaqimin mes tyre, për të nxjerrë në pah ndryshimet apo kundërshtitë në kategoritë e vlerave që ndodh mospërputhja dhe njëkohësisht përshtatjene kategorive të vlerave kulturore kombëtare/europiane duke marrë parasysh një realitet europian gjithnjë e më shumë multikulturor.

Rasti i identitetit shqiptar dhe i zbërthimit të mëtejshëm të vlerave përbërëse të këtij identiteti do të analizohen gjatë punimit për të parë ku ndodhen këto vlera të transmetuara brez pas brezi si fakte sociale, në raport me BE-në, dhe realitetin e saj plot diversitet kulturor dhe sa e rëndësishme është të zgjerohen apo ngrihen këto vlera në nivele kontribuese për procesin e integritetit. Sot, në epokën e globalizimit, dhe në kuadrin e politikave “të një zgjerimi të mëtejshëm të BE-së” (Habermas 2006: 50), vetë kombet e BE-së dhe popujt e tyre duhet “të ngrenë identitetet e tyre kombëtare dhe t’i zgjerojnë ata tutje, më tej në përmasa europiane” (Habermas 2006: 50). Ky proces mund të vlejë edhe për rastin e Shqipërisë, kur flitet për përshtatje me një realitet të ri, si ai i BE-së por edhe për zgjerim apo ruajtje të disa prej këtyre vlerave kombëtare, si themele për promovimin dhe përmirësimin imazhit të vendit.

Siç u shpjegua, janë dy nivele studimi siç u pa dhe më lart, niveli kombëtar i Shqipërisë dhe ai europian ose mbikombëtar i BE-së, duke pasur si bazë normat që aplikon BE-ja, nëpërmjet fuqisë së saj normative, qasjet për identitetin europian me gjithë kritikën që ekzistojnë për një mungesë të një identiteti Europian të përbashkët për të cilin Jurgen Habermas shprehet se “ne evropianët jemi kthyer kah vetja”.

Duke analizuar kontekstin vleror të BE-së si në aspektin normativ ashtu edhe në atë të identitetit kulturor, do mundet të bëhet një lloj zbërthimi dhe ballafaqimi për të aplikuar teorinë konstruktiviste në këtë lloj raporti të BE-së dhe Shqipërisë. Ballafaqimi do të konsistojë konkretisht në zbërthimin e vlerave kombëtare shqiptare dhe atyre të BE-së si fakte sociale që mbartin kuptime dhe kanë drejtuar sjelljen njerëzore (Sorokin 2005:274) kolektive në të dy nivelet. Njëkohësisht aplikimi i qasjes konstruktiviste të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe i

metodologjisë së saj dekonstruktiviste, do të rreket te paraqesë se çfarë ndërveprimi do të mund të kenë me njëri- tjetrin këto dy rrafshe gjatë procesit të integritit të vendit në BE dhe cilat janë bazat që duhen rindërtuar.

1.2 Terminologjia e përdorur në punim

Duke u nisur nga vetë titulli i tezës, gjatë punimit do të zbërthehet (dekonstruktohet) termi “vlera kombëtare” shqiptare, si dhe si e kanë shënjuar ato identitetin kombëtar ndër vite dhe periudha të ndryshme historike. Sikurse ky punim ka synim të shtjellojë vlerat kombëtare në dy rrafshe, atë kombëtar dhe atë mbikombëtar (duke marrë në konsideratë faktin që Shqipëria synon aderimin në BE), do të shtjellohen gjithashtu edhe vlerat kulturore të BE-së, vlerat që qëndrojnë në themel të fuqisë normative të BE-së nga njëra anë, dhe vlerat kombëtare nga ana tjetër si karakteristika që qëndrojnë brenda “strukturës “sonë “sociale” (Durkheim 2008: 76) që karakterizohen në “vlera kulturore”(Durkheim 2008:76) dhe politike.

Ato do të permblidhen ose grupohen për të evidentuar “karakterin e tyre unik”(Durkheim 2008:76) kur flitet për ato kulturore dhe karakterin e ndryshueshëm kur flitet për ato liberale-politike. Përpos këtyre do të shihet dhe zbërthehet termi “qeverisje e mirë”, “fuqi normative” dhe “norma të reja ” të aplikuar nga BE ose vlera liberale sipas kontekstit kombëtar në Shqipëri, si dhe ‘identitet europian’, “qasje esencialiste dhe “qasje konstruktiviste” të cilat do dalin në pah kur të shtjellohet identiteti europian. ‘Orient’, ‘Perëndim’ “fuqi e butë”, “fuqi normative” “konstrukt social” ose “rindërtim” .

Pas shtjellimeve dhe dekonstruktimit të kësaj terminologjie gjatë analizës, dhe perspektivës që ajo ofron, do të shihet marrëdhënia Shqipëri-BE në kuadrin e bashkëveprimit, formësimit, hapësirave, ku mund të influencohet, reformat, pritshmërive dhe mangësive, në të ashtëquajturin “kuadër i reformave.”

Gjithashtu, do të vërehet se si nga termi “identitet” mund të zbërthehen disa vlera të përbashkëta dhe anasjelltas. Në këtë punim do të përdoren edhe një mori termash që derivojnë nga vlerat kombëtare, siç janë “gjuha”, “marrëdhënia me

fenë”, “traditat kulturore”, si dhe ajo lloj sjellje dhe praktikë kolektive që ka krijuar sjelljet, normat dhe identitetin shqiptar. Këto terma do të zbërthehen sipas pohimeve dhe interpretimeve të autorëve vendas dhe të huaj duke bërë dhe një lloj difference të perceptimeve apo imazheve që janë krijuar për Shqipërinë dhe Shqiptarët jashtë vendit. Zbërthimi i termave gjatë punimit bëhet me qëllimin për t’i parë ose për t’i lokalizuar ato në një kontekst të ri, siç është në këtë rast ndërveprimi i këtyre vlerave si forca sociale ose praktika sociale (Durkheim 2008:95), gjatë ndërveprimit që do të mund të kenë në të ardhmen me BE-në.

“Multikulturalizëm”, “diversiteti” dhe “diplomaci publike” janë të tjera terma që do të përdoren gjatë këtij studimi, si trende mjaft të rëndësishëm që kanë hyrë tashmë në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Hyrja dhe zhvillimi i “diplomacisë publike” përfaqëson një sfidë konkrete për fushën e diplomacisë klasike dhe boshllëkun që është krijuar ndërmjet veprimtarisë që ka luajtur diplomacia klasike në krijimin e perceptimeve dhe të imazheve dhe veprimtarisë që duhet të luajë dhe të kryej sot gjithnjë e më shumë diplomacia publike si një diplomaci mjaft aktive që ka në shenjestër “publikun e huaj dhe vendas” (Fitzpatrick 2011; 13) Në kuadër të kësaj risie, do të analizohen gjithashtu termat: “diplomaci kulturore” “imazh kombëtar” (Riordan 2005:186), sidomos në fazën e rekomandimeve dhe konkluzioneve, çfarë shprehin këto terma, çfarë nënkuptojnë kur vihen në jetë apo në veprimtari aktive në kuadër të diplomacisë publike, roli që luajnë dhe ndikimi i tyre pozitiv ndërveprues? Gjatë punimit, këto terminologji do të bëhen më lehtësisht të kuptueshme kur të shtjellohen si rekomandime.

1.3 Pyetja kërkimore shkencore të studimit.

Pas shtrirjes së përgjithshme të kuadrit teorik të studimit, hulumtimit në literaturën ekzistuese dhe objektivave të studimit, u hartua dhe pyetja kërkimore shkencore fillestare e cila është:

Cili është raporti i vlerave kombëtare shqiptare me procesin e integritetit europian dhe si e ndikojnë anasjelltas këto dy variabla njëri-tjetrin?

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, ky studim ka për qëllim të shtjellojë:

Vlerat kombëtare shqiptare në sistemin vleror shqiptar, ato të cilat kanë shënjuar identitetin kulturor dhe atë politik, nuk mund të studiohen më vehte pa marrë parasysh vlerat kulturore europiane, vlerat thelbësore liberale të shënuara në traktatet e BE-së dhe normat e reja që u riformuluan pas 90-tës sipas nevojave të zgjerimit, pasi në këtë mënyrë shfaqet më i qartë raporti i variablave me njëri-tjetrin nga të dy sistemet.

Duke pasur parasysh pyetjen bazë kërkimore, studimi do të shqyrtojë:

1. Çfarë ndërveprimi mund të arrihet nga raporti konstruktiv mes dy sistemeve, cilat janë mundësitë e përshtatjes të sistemit vleror kombëtar shqiptar (me ato vlera kulturore që mbart, me një realitet normativ dhe klimë politike shqiptare në kushtet që do të analizohen në vijim) me atë mbikombëtar, pra atë të BE-së?
2. Në cilat hallka të sistemeve vlerore mund të arrihet kjo përshtatje (gjithmonë duke vrojtuar lidhjen dhe ndërveprimin e variablave për të parë ku dhe si mund të ndodhë ndryshimi)?
3. Cilat janë disa prej vlerave kombëtare të cilat nuk kanë nevojë për t'u përshtatur, por duhen ruajtur e promovuar?
4. Si mund të ndihmojnë vlerat e përcuara nga BE-ja në konsolidimin e demokracisë në vend nëpërmjet rolit normativ të këtij entiteti?
5. Çfarë roli mund të luajë diplomacia publike në promovimin e vlerave.

Ky studim, përgjatë kapitujve të tij, do të rreket t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve dytësore, në funksion të pyetje bazë kërkimore shkencore.

1.4 Nënçështje teorike

Disa prej nënçështjeve teorike që dalin në pah e që duhen sqaruar në mënyrë që tu jepet përgjigje pyetjeve të mësipërme janë:

- a) Cilat janë elementët mbi të cilat bazohet identiteti evropian dhe cilat janë qasjet që ekzistojnë brenda BE-së në lidhje me këtë identitet?
- b) Çfarë është fuqia normative e BE-së dhe vlerat apo normat që qëndrojnë në themel të kësaj fuqie?

- c) Si ndikojnë, si mund të ndërveprojnë dhe të konstruktohen këto vlera për secilin rrafsh në mënyrë të ndërsjellë duke marrë dhe duke shkëmbyer nga njëri-tjetri vlera të ngajshme me qëllim që të ruhen interesat kombëtare në mënyrë të ndërsjellë, duke patur parasysh trendet e sotme globale (adaptimi dhe konservimi si procese).

Këto nënçështje do të shtjellohen në funksion të objektivit kryesor të kësaj teze: Ballafaqimin vleror kombëtar me atë mbi-kombëtar me qëllimin e bashëkpunimit më të frytshëm mes dy sistemeve vlerore (kombëtar, mbikombëtar) në funksion të integritetit europian të një vendi aspirant në BE dhe njëkohësisht ruajtjes së identitetit të tij kombëtar.

1.5 Arsyet e këtij studimi dhe cila ishte nevoja për të kryer këtë studim

Rëndësia e këtij studimi qëndron jo vetëm në identifikimin e vlerave kombëtare, por edhe në paraqitjen e opsioneve për zhvillimi, përshtatje, pse jo, edhe ruajtjen e tyre. Studimi shtjellon disa nga vlerat e përbashkëta që rrjedhin nga identiteti i përbashkët, si elementë që kanë përcaktuar sjelljen shoqërore të kombit shqiptar dhe trashëgiminë e tyre deri në ditët e sotme. Vlera e këtij studimi qëndron në faktin se kërkon t'i largohet debatit të përhershëm nëse ka Shqipëria ose jo një identitet europian, duke i parë vlerat e këtij identiteti në një perspektivë tjetër, sipas qasjes konstruktiviste dhe multikulturore.

Pra vlerat do të dekonstruktohen si hallka të një sistemi, ku përveç atyre kulturore, bëjnë pjesë edhe vlerat normative dhe demokratike, të cilat do të shihen në një proces ndërveprimi dhe konstruktimi me vlerat e sistemit të BE-së.

Aplikimi i qasjes konstruktiviste, e cila është dhe baza e këtij studimi dhe do të ndërtojë boshtin e këtij studimi jep mundësi për t'i parë sistemet e analizës jo vetëm si të pavarura dhe të ndërtuara shoqërisht brenda vetes, por edhe si gjeneruese të mundësisë së ndërveprimit të elementëve apo të hallkave të tyre përkatëse ndërmjet njëra-tjetrës. Zbërthimi i këtyre vlerave (kombëtare/mbikombëtare) dhe ballafaqimi i sistemeve vlerore (kombëtare/mbikombëtare) gjithashtu rrit vëmendjen ndaj mundësive për

rindërtim të vlerave të demokracisë në rrafsh kombëtar dhe ndërgjegjësimin e duhur për ruajtjen e vlerave të cilat krijojnë përputhshmëri.

Studimi është nisur nga ideja bazë se, vlerat kombëtare duhet të jenë gjithmonë pjesë e agjendës akademike, politike dhe shoqërore të një vendi, pasi ato janë thelbi për zhvillimin e këtij të fundit.

Në rastin konkret të Shqipërisë, lind nevoja për të shqyrtuar procesin e përshtatjes të vlerave gjatë shkëmbimit që ka Shqipëria me BE-në në procesin e integritetit në dy kategori vlerore atë politike-normative dhe atë kulturore.

1. Shqipëri-BE si fuqi normative dhe ndryshimet pozitive që mund të sjellë kjo marrëdhënie në aspektin politik, institucional dhe ekonomik duke e pasuruar realitetin shqiptar me vlera që rrjedhin nga thelbi i fuqisë normative të BE-së.

2. Shqipëri-komunitet i BE-së si komunitet multikulturor ku të gjithë popujt e kombeve të BE-së shkëmbejnë vlerat e tyre në mënyrë të ndërsjellë dhe adoptojnë çfarë është më e mira për t'u adoptuar duke ruajtur veçantitë dhe karakteristikat e tyre për ta pasuruar dhe për ta bërë më të mirë një realitet multikulturor në favor të bashkjetesës dhe dialogut ndër-kulturor.

Ky studim, duke analizuar në proces ndërveprimi rastin e BE-së me rastin e Shqipërisë, bën të mundur në këtë mënyrë evidentimin e dallimeve dhe të të përbashkëtave ndërmjet sistemeve vlerore të secilit prej tyre, mundësitë e ndërtimit, elementët apo vlerat që vlejnë të përcillen në atë kontekst mbikombëtar dhe zhvillimet që sjell konstruktimi i ndërsjellë i elementëve të identiteteve kombëtare në vazhdim.

Një ndërtim dhe implementim afatgjatë i interesit kombëtar, që është në shërbim edhe të interesave të kombeve të tjera, realizohet duke përqafuar vlerat e solidaritetit, qytetërimit, klimës demokratike dhe drejtësisë dhe vetëm atëherë mundet që interesi kombëtar i një vendi të përkojë me interesat njerëzore, dhe të zhvillojë me ritme më të shpejta mekanizmat për promovimin e vetes në arenën ndërkombëtare. Për të arritur tek vlerat e solidaritetit, qytetërimit, klimës demokratike dhe institucionale, Shqipërisë i shërben një marrëdhënie e vazhdueshme me BE-në, ku në këtë marrëdhënie të mund të zbërthejë edhe vlerat që burojnë nga një themel kulturor që konsiston në “tërësinë e kuptimeve,

normave dhe vlerave” (Sorokin 2005:276) të zotëruara nga një shoqëri si p.sh më konkretisht: Traditat kulturore, marrëdhëniet ndër-fetare, zakonet kulturore dhe gjuha, pa të cilën përcjellja e këtyre vlerave dhe shprehja e vetvetes do të ishte e pamundur. Ideja e interesit kombëtar është e lidhur ngushtë me ekzistencën e kombit. Një komb mbështetet mbi vlerat e përbashkëta që rrjedhin nga identiteti kombëtar dhe nga një themel kulturor i përbashkët: Traditat, zakonet e trashëguara brez pas brezi si trashëgimi e përbashkët zakonore, kulturore dhe gjuha e tij. Autori Elwell citon nga autori Durkheim, se me humbjen apo zbehjen e këtyre vlerave të përbashkëta ndodh ajo çfarë Durkheim e quan “humbje të komunitetit” ose “humbje të identitetit grupor” (Elwell 2013) në veprën e tij “Anomie, An Absence of Norms”.

Pra, është pikërisht vlerësimi i këtyre vlerave si fakte shoqërore dhe afeksioni ndaj tyre që sjell përcjelljen e tyre si vlera në shoqëri të caktuara. Mendohet, pra, se studime të tilla janë me rëndësi të madhe për institucionet që merren me politikën e jashtme, fushën akademike dhe shoqërinë shqiptare. Edhe studiues të huaj janë marrë me studimin e historisë dhe vlerave shqiptare. Në studimet për Ballkanin është e pamundur të anashkalohet historia e lashtësisë shqiptare. “Gjithçka që ka ndodhur në Ballkan prej kohës së mesme e këndeje, në një farë mënyre është ndërtuar mbi atë shtresë së mesme që ne e quajmë Ilirë” (Stipcevic 1985)⁶konstaton studiuesi Stipcevic dhe ‘çdo tregim për Ballkanin fillon me Ilirët’ (ibid 1985) Gjithashtu edhe studimi i gjuhës ka çuar në përfundime shumë të rëndësishme për çështjen kombëtare shqiptare, analizë e cila do vijojë më poshtë kur të trajtohen vlerat e mbijetesës.

Në këtë kontekst është i rëndësishëm zbërthimi apo dekonstruktimi i vlerave kombëtare për të parë rëndësinë e tyre për promovimin e imazhit të vendit dhe përmirësimin e këtij imazhi nëpërmjet diplomacisë publike në kuadër të promovimit të vendit në BE e më gjerë. Vendosje e vlerave kombëtare dhe mbikombëtare në mënyrë të dekonstruktuar për të sjellur një lloj ballafaqimi, është me rëndësi pasi sjell një qartësim përse i përket vlerave të kategorisë

⁶Stipcevic A. 1985“Çdo tregim për Ballkanin fillon me Ilirët”, Bota e Re, Prishtinë, i cituar tek libri: Identiteti Imazhi Diplomacia, i autorit Lisen Bashkurti, 2004, fq 64.

kulturore të cilat duhen promovuar në arenën ndërkombëtare dhe vlerave të kategorisë politike normative kombëtare të cilat paraqesin nevojën për zhvillim dhe konsolidim duke marrë parasysh vlerat thelbësore demokratike të BE-së. Në këtë mënyrë ky studim i shmanget pyetjes së vjetër nëse Shqipëria ka një identitet europian ose jo, e cila është shumë e përgjithësuar, pasi identiteti përbëhet nga vlera me karakter etno-kulturore, politike, demokratike dhe normative të cilat duhen parë në sisteme përkatëse tradicionale. Këtu mendohet se qëndron dhe rëndësia e këtij studimi, në evidentimin e gjithë këtyre elementeve dhe paraqitjen e mundësive për ruajtjen, konsolidimin, promovimin dhe shfaqjen e rëndësisë së tyre për proceset integruese të vendit tonë.

1.6 Përmbledhja e literaturës dhe përse u përzgjedhën këta autorë dhe të dhëna cilësore.

Korniza teorike e këtij punimi bazohet në qasjen konstruktiviste të Aleksandër Wend, sipas librit të tij *Social Theories of International Relations* (1999), i cili jep mundësinë, nëpërmjet metodologjisë dekonstruktiviste, për t'i parë marrëdhëniet ndërkombëtare ndërmjet kombeve duke vënë në rend të parë kulturën e shteteve.

Sipas këtij autori dhe kësaj vepre, konstrukti social dhe ndërveprimi social janë të vazhdueshëm. Ata sjellin ndryshime në ide, në marrëdhënie në ndërveprim, duke ndryshuar vetë marrëdhënien ndërmjet kombeve apo marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo kornizë teorike e ndihmon këtë punim jo vetëm për të evidentuar normat, idetë dhe vlerat, por edhe për të parë se si ato formësojnë sjelljet e shteteve të cilat ndodhen në ndërveprim. Për Wend-in realitetet shoqërore kanë më shumë rëndësi se vlerat materiale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në marrëdhënie të ndërsjella njohuria që shkëmbehet përcakton rolin e secilit nga aktorët dhe tendencat që ka. Martha Finnemore (1996) me “National Interest in International society” do shërbejë si referencë në kuadër të kornizes konstruktiviste. Gjithashtu dhe Holsti K. J. (1997) “America meets the ‘english school” dhe Hopf T. (1998) “The promise of Constructivism in International Relations”. Një tjetër punim me rëndësi është ai i autorit Enis Sulstarova me

artikullin e tij “Jam Evropë! Ligjërimi i Intelektualëve për Evropën në Shqipërinë e tranzicionit, në Revista “Politikja”(2011). Ky punim do të përdoret disa herë si referencë në mbështetje të qasjes konstruktiviste dhe multikulturalizmit që vepron sot në Europë si në mënyrë të pavarur, pasi autori propozon alternativën konstruktiviste që mendimi intelektual dhe debati publik të orientohet në rrjedhat e shkencës dhe mendimit bashkëkohor evropian. Në të njëjtën revistë (2012) autorët Fjoralba Caka, Iva Zajmi dhe Albert Bishaj me artikullin “Aderimi i vendeve të Ballkanit përëndimor në Bashkimin Evropian: Një vështrim i shkurtër krahasues i kriterëve të zgjerimit sjell një vështrim analitik mbi kriteret e vendosura përgjatë periudhave të zgjerimit të BE-së dhe si ndryshoi në traktatet pasardhëse kushti i të pasurit “identitet evropian” për të qënë pjesë e BE-së. Për sa i përket interpretimit të vlerave do të ndihmojnë teoritë post pozitiviste, si marksizmi, post-strukturalizmi dhe feminizmi. Kjo literaturë e këtyre qasjeve jep mundësi gjatë zbërthimit të vlerave dhe normave të bëhet dhe interpretimi i tyre. Teoria e marksizmit kritik nga Mark Rupert (2010) do të ndihmojë në paraqitjen e organizimit të jetës shoqërore shqiptare në periudha të ndryshme historike dhe çfarë impaktesh ka dhenë ky organizim. Teoria e feminizmit nga J. Ann Tickner dhe Laura Sjoberg (2011) do të ndihmojë në paraqitjen e aspektit ndërkombëtar si konstrukt shoqëror ku “agjentët dhe strukturat janë pjesë të një njësie të vetme të bashkpërbërë” (Tickner & Sjoberg 2010; 249). Teoria poststrukturaliste e David Cambell do të ndihmojë për të pasqyruar identitetin, çfarë zbërthehet nga identiteti dhe roli e vlerat e tij për afirmimin e një kombi. Gjithashtu imazhi që është krijuar nga veprimet politike, nga mungesa e reformave në praktikë të shtetit shqiptar. Ashtu si “bota nuk paraqet një fytyrë të qartë dhe të lexueshme; na le thjesht ta deshifrojmë” (Fuko 1984; 127)⁷pavarësisht tablove të qarta që mund të egzistojnë, interpretimi është i pashmangshëm dhe nga interpretimi e pasqyrimi i ngjarjeve krijohen perceptimet dhe imazhi. Interpretimi theksohet gjithashtu nga Max Weber me termin “verstehen” që në gjuhën gjermane do të thotë “të dëgjosh qartë” “të kuptosh, të rrokësh interpretimin apo sensin/natyrën e diçkaje” “të

⁷Fuko M. 1984; 127, I cituar nga David Cambell, në Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, disiplina dhe shumëllojshmëria, KurKI & Dunne & Smith, (2010) UET press

kuptosh diçka”⁸, dhe në konceptin Weberian përfaqëson një term i cili rreket të kuptojë “qëllimin dhe kontekstin e veprimit të njeriut” (Elwell 1996) apo qenieve njerëzore të cilat janë të lidhura ngushtë dhe prodhojnë “veprimet dhe ndërveprimet e tyre brenda konteksteve të veçanta sociale”(Elwell 1996)⁹. Në këtë mënyrë procesi i të kuptuarit është i lidhur ngushtë me interpretimin nga këndvështrimi i atij që vëzhgon apo mundohet të kuptojë së jashtmi këto akte, ndërveprime sociale dhe kontekste. Në këtë këndvështrim do të trajtohet dhe çështja e imazhit kombëtar shqiptar në rajonin e Ballkanit, BE dhe më gjerë, se si ka qenë realiteti në kontekstin kombëtar dhe rajonal dhe si është perceptuar dhe interpretuar së jashtmi. Për një informacion më të gjerë në lidhje se çfarë ofrojnë këto teori për parashkrimin e këtij punimi, janë konsultuar edhe tre libra të teorive të Marrëdhënieve Ndërkombëtare si: “Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare” të autorëve Timm Dunne, Milja Kurki dhe Steve Smith (2010), Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e Karen Mingst (2008) dhe Burchill S., Linklater A., Devetak R., Donnelly J., Paterson M., Reus-Smit C., True J. 2012; Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, AIIS press. Për çështjen e identitetit evropian një libër me rëndësi në këtë punim është “Europe, a heritage, a challenge, a promise” i autorit Jan Berting (2006) ku bëhet një pasqyrim i qartë i Europës sot, si një terren mozaik, i përbërë nga “një diversitet kulturash kombëtare dhe rajonale” (Berting 2006;1) i cili shtrihet tezen për “krijimin e përfaqësive kolektive” të asaj forme që të mundësoheshin në këtë mënyrë “veprimet e orientuara drejt të ardhmes” (ibid) duke vënë në dukje dhe “analizuar specificitetin ose identitetin evropian, trashëgiminë e përbashkët dhe diversitetin” (Berting 2006; 1) që egziston në këtë realitet. Ajo çka thekson autori, është se Europa jeton në një epokë globale dhe duhet të “merret me globalizimin” (ibid) me “ideologjinë” e këtij fenomeni për të kuptuar si qëndron Europa në marrëdhënie me identitetet që e përfaqësojnë dhe “në marrëdhënie me botën që e rrethon” (Berting 2006;2) Pra rëndësia themelore e këtij botimi është për të kuptuar se çfarë perspektivash duhet

8 Parë tek fjalori online Duden:

<http://www.duden.de/rechtschreibung/verstehen#Bedeutung1>

9 Verstehen: The Sociology of Max Weber by Frank Elwell, Rogers State University
 Shih: <http://www.faculty.rsu.edu/users/f/felwell/www/Theorists/Weber/Whome2.htm>

të ndërtohen nga BE, ku “specifikat kulturore sociale dhe diversiteti të luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e një shoqërie të re”(Ibid;15) të adoptueshme për zhvillimet politike, ekonomike sociale që sot po ndodhin në botë dhe jo vetëm kaq, por edhe bashkëpunuese dhe paqësore. Gjithashtu një aspekt shumë i rëndësishëm në librin e autorit Berting, është koncepti shtetësisë/qytetarisë europiane, mënyra si e trajton dhe kritikën që vijnë në këtë aspekt nga autori, si një proces që ecën tepër avash, dhe ka “shumë rrugë përpara” (ibid; 15) që koncepti i qytetarit european të institucionalizohet dhe të pasurohet me vlerat që i takojnë, dhe përveç kësaj ai hedh “ftesën për bashkimin e forcave në mënyrë që të ndërtohet ‘Europa e qytetarëve’” (ibid) për të mirën e shoqërisë dhe Europa si një familje pritëse që i jep ose pajis qytetarët e saj metë drejtat që i takojnë dhe që rrjedhin nga kjo qytetari në teori dhe në praktikë. Një artikull i vlefshëm për këtë punim ka qenë dhe ai i autores Loredana Patrutiu Baltës, “Europe and Europeans, Question of Identity” ku trajton qasjen e identiteti european, dhe trendet që egzistojnë në BE rreth çështjes së identitetit, si për shembull kush do të ishte qasja më e përshtatshme, ajo e krijimit të një identiteti european apo ekzistenca multi-kulturore e identiteteve të ndryshme që egzistojnë në BE?Të tjerë autorë janë Delanty G. (1995) Giddens A. (2007) Miall H. (1993) (1994), Fukuyama F. (2012) të cilët hedhin dritë mbi sjelljen dhe perspektivat që duhet të përqafojë BE në kohën e sotme globale, dhe ku qëndrojnë sfidat për krijimin e një identiteti të vetëm european. Një tjetër autor me rëndësi që shkruan rreth orientalizmit dhe qasjes së Perëndimit ndaj tij është Edward Said (1977). Disa pjesë nga libri i tij do të citohen disa herë për të përshkruar orientalizmin dhe popuj që shpesh herë asociohen me këtë konotacion, që në fakt nuk është një gjë e largët nga perëndimi, por një pjesë e rëndësishme e civilizimit dhe kulturës europiane.Përsa i përket BE-së si një fuqi normative, për aspektin institucional, politik dhe demokratik, dhe çfarë aplikon BE nëpërmjet fuqisë normative, do të analizohet autori Manners, I. 2001, Normative Power Europe: The International Role of the EU si dhe Normative Power Europe, a contradiction in terms (2002), gjithashtu dhe autori Thomas Diez dhe Nielsen, K. 2013, EU Soft power and the capability–expectations gap. Dhe për të bërë një diferencë të soft power/fuqisë së butë dhe

normative power/fuqisë normative, do referohet disa herë Joseph Nye me disa artikuj të cilët janë të listuar tek bibliografia. Për sa i përket identitetit kombëtar shqiptar dhe vlerave të mbijetesës, janë referuar dhe cituar një sërë autorësh si Kristo Frashërimi shkrimet e tij “Identiteti i shqiptarëve dhe të metat e debatit Qose-Kadare” (2006), ku ai i kushton shumë rëndësi njohjes së historisë shqiptare dhe europiane dhe perceptimi i qartë që duhet të kesh për identitetin shqiptar dhe ‘apelativin identitet europian’(Frashëri 2006) për ta analizuar identitetin kombëtar si duhet, duke u nisur nga “çfarë kuptojmë me identitet” dhe “çfarë kuptojmë me identitet shqiptar” dhe me “identitet europian” Nisur nga ky këndvështrim do shihet identiteti kombëtar si përkufizohet nga autori Frashëri, por edhe autorë të tjerë dhe do shihet gjithashtu, si ky identitet kombëtar ka mbijetuar dhe egzistuar në periudha të ndryshme historike. Një tjetër botim në ndihmë të këtij punimi për sa i takon identitetit kombëtar, është “Arratisja nga burgjet e historisë”, nga Pirro Misha (2008), me pyetjen kryesore që ai mundohet të shtjellojë gjatë gjithë veprës së tij, e cila është “Çdo të thotë sot të jesh shqiptar?” Autori Moikom Zeqo, me “Rexhep Qosja dhe çështja kombëtare shqiptare” (1995) flet për vlerat kombëtare dhe ku qëndrojnë sfidat për zhvillimin e mëtejshëm, Nelson Çabej me “Autoktoninë e Shqiptarëve në studimet gjermane” (1995) ku flet se çfarë rëndësie sollën studimet gjermane për gjuhën shqipe, dhe ku evidenton vlerën e kësaj gjuhe. Gaetano Petrotta (2008) sjell gjithashtu një përmbledhje të gjerë me informacione dhe fakte rreth popullit shqiptar, gjuhës dhe lashtësisë së tij. Një studim nga fusha e antropologjisë si ai i Jakov Milajt (1944), “Raca shqiptare” ka gjithashtu shumë fakte rreth dhe hedh shumë dritë mbi identitetin shqiptar. Autori Kulla N. me librin “Neoshqiptarizma” (2002) i referohet disa herë gjatë kapitullit që shqyrton, çështjes së identitetit shqiptar. Gjithashtu edhe studiues si Rustem Gjata (2014), Edit Durham, Kordinjano F. (2008) Puto A. (1999) Milani M. (2003), Elsie R. (2005) të cilët citohen dhe referohen në këtë punim gjithashtu, dhe kanë qenë një literaturë shumë e vlefshme dhe një kontribut në shumë peshë për të shtjelluar çështjet kryesore të këtij punimi. Për sa i përket diplomacisë Publike janë parë disa autorë me rëndësi si, Melissen J. “Beyond the new public diplomacy” (2011) ku jep përkufizime të qarta për këtë koncept të shfaqur në

dekadat e fundit dhe rëndësinë që ka marrë në politikën e jashtme kjo praktikë. Autori Mark S. “A greater role of public diplomacy” (2009), Cull J.N (2009) Public Diplomacy and track two diplomacy. Përveç disa autorëve të tjerë që janë referuar për diplomacinë publike, është zhvilluar dhe një intervistë e cila ka ndihmuar në kuptimin dhe rolin e saj për rastin e Shqipërisë.

1.7 Hipoteza e studimit.

Vlerat kombëtare si në kategorine kulturore ashtu edhe në atë politike janë hallkat ose elementët lidhëse më të rëndësishme për formimin e interesit kombëtar, imazhin dhe zhvillimin vendit në të gjithë sektorët. Gjithashtu ndërtimi, zhvillimi dhe promovimi i vlerave kombëtare me hapa më të shpejtë e sjell shtetin shqiptar më shpejt dhe më afër drejt BE-së. Gjatë zbërthimit që i bëhet dy sistemeve të dy rrafsheve atij kombëtar dhe të BE-së, del në pah që BE është një fuqi normative dhe Shqipëria ka zgjedhur të përshtasë aspektin politko-demokratik dhe normativ sipas kësaj fuqie. Vlerat kulturore kombëtare, shprehëse të identiteti kombëtar janë veçori që mund të mos përputhen me ato europiane, duke qenë se rrjedha globale po sjell gjithmonë e më shumë një ambjent global multikulturor, ku çdo shtet ka mundësinë të shprehë vetveten, të afirmojë, si dhe të promovojë kulturën kombëtare. Megjithatë, në aspektin e vetëshprehjes së vlerave etno-kulturore, Shqipëria paraqet përputhshmëri të kategorisë së vlerave kulturore me kategorinë e vlerave kulturore të BE-së. Për më tepër, në kuadrin e rekomandimeve që do të shtjellohen gjatë përmbylljes së këtij studimi, ajo ka më tepër nevojë për diplomaci publike për promovimin e këtyre vlerave. Nga këto konstatime (të cilat do të shtjellohen gjatë analizës që vijon më poshtë) që janë nxjerrë nga dekonstruktimi i sistemit vleror kombëtar dhe atij të BE-së, ky studimdoktorature ka në qender të tij hipotezën si më poshtë:

- *Vlerat etno-kulturore kombëtare gjejnë përputhshmëri me vlerat tradicionale dhe parimin multi-kulturor të BE-së, ndërkohë që vlerat liberale në nivel kombëtar vazhdojnë të krijojnë tension me vlerat*

normative që transmeton BE-ja drejt vendeve që aspirojnë të anëtarësohen në të.

1.8 Variablat e studimit:

Në mënyrë që të vërtetohet kjo hipotezë, punimi do të ketë variabla të varura dhe të pavarura. **Si variabla të pavarura** në këtë punim do të trajtohen sistemi vlerave kombëtare shqiptare në nivel makro dhe çfarë nënkuptohet me të ose përmbajtja e këtij sistemi, si dhe sistemi i vlerave europiane gjithashtu në nivel makro dhe çfarë përmban ky sistem nga ana tjetër.¹⁰

Variablat e varur do të jenë vlerat e veçanta për secilin nga këto dy sisteme vlerash si për shembull: Për BE-në vlerat kulturore në kuadër të qasjes konstruktiviste si gjuhët e shumta që fliten në BE, feja ose religjioni, qytetaria europiane, për kategorinë e vlerave politike, paqja, demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut. Teksa për rrafshin kombëtar shqiptar do të analizohen vlerat e mbijetuara të identitetit kombëtar (etno-kulturore), ndërsa në kontekstin e kategorisë së vlerave politike liberale do të analizohen identiteti shqiptar në këndvështrim historik, vlerat thelbore, qeverisja, progresi social dhe diskriminimi.

Më gjerësisht, në rastin e sistemit të vlerave të BE-së do të analizohen, si përqaset esenca e këtij civilizimi në realitetin e sotëm European duke shkuar drejt kontekstit dhe realitetit të sotëm që është BE-ja, me popujt e saj, me gjuhët europiane të ndryshme, me kulturat e saj karakteristike të shumëllojshme, religjionin dhe qytetarinë europiane, ndërkohë në rastin e Shqipërisë do të analizohen gjuha shqiptare, bashkjetesa fetare dhe traditat kulturore pa përjashtuar këtu dhe klimën politike, demokratike dhe institucionale në vend, të cilat do të zbërthehen gjatë shtjellimit të vlerave liberale.

¹⁰ Sistemet makro për secin rrafsh, shërbejnë për të treguar si është formuar identiteti kombëtar shqiptar dhe ai i BE-së në nivel tradicional vlerash dhe në nivel bashkohor (të ri post-modern), që përbën në nivel kombëtar konsolidimin e demokracisë, ndërsa në atë mbikombëtar rolin normativ të BE-së.

Në varësi të analizës do shihet përshtatja ose jo e këtyre variablave të varura dhe nëse medoemos ka rëndësi përshtatja ose jonë aspektin e vlerave kulturore. Në nivel normativ do shihet ku qëndron rëndësia e përshtatjes, të mirat që sjell kjo qasje. Ky studim do të rreket ta paraqesë këtë, nëpërmjet theksimit të rëndësisë që ka marrëdhënia bashkëpunuese dhe konstruktive me BE-në në fushën e reformave dhe në aplikimin e normave.

1.9 Përse konstruktivizmi për këtë studim?

Ky studim do të ndalet gjerësisht në teorinë e konstruktivizmit, sepse është një qasje që strukturën shoqërore e sheh në ndërtim të vazhdueshëm, dhe kjo tezë ka pikërisht qëllimin të shohë marrëdhëniet Shqipëri-BE në këtë këndvështrim në nivel makro të studimit duke shkuar në dekonstrukcion në nivel mikro. Një rol me rëndësi në këtë punim në nivel mikro, përsa i përket zbërthimit dhe interpretimit do të luajnë edhe teoritë kritike që u gjallëruan dhe u pasuruan pas viteve 70-80, si marksizmi perëndimor, feminizmi, pos-strukturalizmi, teoria e gjelbër dhe postkolonializmi për aftësitë e tyre të pasqyrimin të marrëdhënieve, elementëve, roleve, ngjarjeve dhe veprimeve të shoqërisë dhe politikës ose bashkëveprimit të ndërsjellë të këtyre të dyjave të para nga kënde të ndryshme, në rrafsh kombëtar dhe në atëndërkombëtar.

Ato do të mund të ofrojnë një logjikë kritike për dekonstruktimin e vlerave që ky punim ka për qëllim të analizojë, si edhe rolin e kuptimit të tyre për shoqërinë në dy nivelet e sipërpërmendura. Konstruktivizmi është një lajmërim për një kthim të vëmendjes drejt formave më sociologjike e historike në praktikën e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, ku identitetet dhe interesat e aktorëve të ndryshëm ndërkombëtarë marrin rëndësi për shpjegimin e sjelljeve dhe ndërveprimit që kanë këto aktorë me njëri-tjetrin. Alexander Wend dhe Martha Finnemore janë dy nga autorët me mjaft influencë të kësaj rryme.

Alexander Wend në punimin e tij “Social Theory of International Politics” zhvillon një “teori të sistemit të Marrëdhënieve ndërkombëtare si një ndërtim social” (Wend 1999; 1) Ai, nisur nga vërtetimet nga studentët të politikës

ndërkombëtare të cilët kanë pranuar rolin e “ideve të përbashkëta” (Wend 1999; 1)për të përcaktuar “strukturën e shoqërisë njerëzore” (Wend 1999;1)dhe se “identitetet dhe interesat”(Ibid) e aktorëve të shoqërisë konstruktohen nga “idetë e përbashkëta” më shumë se “forcat materiale” (Ibid)Duke analizuar kontekstin ndërkombëtar, ai vë re se “sistemi ndërkombëtar nuk është një ambjent shumë social”(ibid), ku vërehet egoizmi i aktorëve të ndryshëm dhe rendja pas interesit vetjak shtetëror. Nëpërmjet kësaj analize do të shihet si qasen shtetet e BE-së me njëri-tjetrin, dhe si nuk kanë arritur të ndërtojnë një identitet të përbashkët, përtej egoizmit kombëtar.

Nërkohë nga pikpamja konstruktive “varësia e individëve në shoqëri” krijohet nga vetë shoqëria, ndërsa “aktorët primarë në marrëdhëniet ndërkombëtare, shtetet, janë shumë më autonome se sistemi shoqëror ku ato janë ngulitur) (Wend 1999; 2) Duke qenë shtete autonome, “sjellja e politikës së tyre të jashtme”(ibid; 2) është e fokusuar më shumë në “politikat e brendshme” se sa nisur nga “shoqëria ndërkombëtare”(ibid) Në analizën në pjesën më poshtë, del qartëse si Shqipëria sipas këtij këndvështrimimundohet “të zhvillojë një qasje sistematike për të kuptuar interesat shtetërore” dhe sjellja e saj shtetërore duhet të orientohet jo drejt pushtetit vetjak,por drejt“domethënies se saj dhe vlerave shoqërore” (Finnemore 1996:2) në një kontekst ndërkombëtar.

Konstruktivistët ofruan një alternativë tjetër në këndvështrimin e strukturës së mardhënieve ndërkombëtare duke u fokusuar mbi identitetet më shumë se sa në vlerat materiale dhe në këndvështrimin e qenieve njërzore si shoqërisht komunikuese, të ndikuara kulturalisht. Për shpjegimin e këtyre aspekteve të politikës ndërkombëtare ato përdorën analiza interpretuese, racionale historike dhe ontologji alternative, duke mundësuar në këtë mënyrë avancimin e studimeve empirike që ishin kryer deri në atë moment. Avancimi i konstruktivizmit, bëri që këto studiues të rinj të përqafonin metodat moderne në shpjegimin e çështjeve me kompleksitet të gjërë, sistemeve të ideve, besimeve, vlerave dhe rolit të tyre.

Besimet dhe vlerat shoqërore kanë tipare strukturore dhe ushtrojnë ndikim të madh në veprimin shoqëror dhe politik. Ato i japin rëndësi të madhe strukturave

normative dhe ideuese, sepse ato ndikojnë shumë në formimin e identitetit shoqëror të aktorve politikë dhe pikërisht rreth kësaj teze do të zhvillohet ky studim kur studiohen marrëdhëniet dhe procesi bashkëpunues Shqipëri-BE.

“Sugjerimi më irëndësishëm teorik, me të cilin bien dakord të gjithë konstruktivistët është se, mënyra e të vepruarit të shtetit formësohet nga bindjet e elitës, identitetet dhe normat shoqërore.” (Mingst 2008:106) si dhe praktikat sociale. Identitetet janë baza e interesave. Aktorët “përcaktojnë interesat e tyre gjatë procesit të situatave që përcaktojnë (Wendt: 1992:398) Pra, identetë, normat, kultura dhe elementët e organizimit njerëzor, si identiteti komunitar dhe shoqëror, roli i etnisë apo i gjinisë, janë të gjitha të ndryshueshmenë thelb. Shumë konstruktivistë nuk e mendojnë “konstruktivizmin si një teori, por më shumë një kuadër analitik” (Reus-Smit 2012:246), me përjashtim të Wendt-it, i cili në librin e tij „Social Theory of International Politics“(1999), arriti të theksojë rëndësinë e “rolit të ideve dhe normave të përbashkëta në formësimin e sjelljes shtetërore” (Ikenberry 1999).

Thellimi i konstruktivistëve në çështjet e interesit, apo në atë që përpiqet të bëjë Martha Finnemore në kërkimin e “njohurive në strukturën ndërkombëtare sociale” (1996) ku identitetet me veçantitë kulturore, normat, praktikën dhe përvojën mbizotërojnë, solli risi dhe korrektime në teoritë që kishin sunduar deri në atë kohë debatin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Duke ju rikthyer studimit të Martha Finnemore “*National Interests in International Society*” /”*Interesi Kombëtar në Shoqërinë Ndërkombëtare*” një pikë fokale ku mbështet analiza e studimit është: “*Si mundën strukturat e jashtme nga shteti–shoqëria ndërkombëtare, normat dhe vlerat e saj të influencojnë në zhvillimin e interesit shtetëror?*”(Holsti 1997:275)Janë normat ndërkombëtare që ndikojnë në veprimet politike të shteteve, mbajnë “balancën”e “pushtetit, marrëdhënien e identitetit me interesin, elaborimin e fuqisë” (Hopf 1998:172),dhe si identetë dhe vlerat arrijnë të ndikojnë në sjelljet shtetërore. “Edhe pse konstruktivizmi nuk ofron ndonjë tablo të qartë të asaj se si është bota, ai shtyn për hetim në proceset ku njerëzit ndërtojnë të kuptuarit”. (Buzan 2002) Kultura si një strukturë e gjerë e kuptimeve,

simboleve dhe praktikave i jep shoqërisë një karakter të veçantë i cili kurrësi nuk mund të anashkalohet, prandaj në këtë studim kultura, vlerat, normat sistemet e besimeve dhe të idevedo të shihen nën dritën e konstruktivizmit se, çfarë roli luajnë gjatë bashkëveprimit të ndërsjellë dhe mundësitë e konstruktimit

1.10 Metodologjia e hulumtimit shkencor

Qasja konstruktiviste si bosht teorik i kësaj teze do të realizohet nëpërmjet metodologjisë dekonstruktiviste. Ky studim ka pasur si pikënisje të tij vlerat kulturore shqiptare në raport me integrimin europian, por gjatë studimeve dhe shfrytëzimit të literaturës dhe mbledhjes së të dhënave cilësore u shfaq e nevojshme përfshirja e tyre në një sistem më gjithëpërfshirës duke ndjekur modelin e Inglehart dhe të Aleksandër Koçanit, të cilët janë marrë me studimin e vlerave të caktuara duke i përfshirë ato në sisteme vlerore. Inglehart dhe Baker (2000) në studimin e tyre rreth insistimit, ekzistencës “vazhdimësisë me një lloj këmbënguljeje të vlerave tradicionale” (*ibid*) përdorin termin “sistemi i vlerave tradicionale” (*ibid*) ku shpjegojnë se një shoqëri me tradita të caktuara (dhe japin shembullin e shoqërive me tradita të theksuara, ortodokse, islamike, konfuciane) ngre zona kulturore të caktuara që karakterizohen nga një “sistem vlerash të dallueshme” të cilat janë insistuese ndaj ndryshimeve në kohë si zhvillimi ekonomik apo modernizimi. Këto autorë konstatojnë se zhvillimi ekonomik ka tendencë t’i shtyjë shoqëritë nën një drejtim të përbashkët, por jo në mënyrë konverguese se sa në forma paralele trajektoresh të cilat janë të formësuara nga trashëgimia e përbashkët. Një studim për sistemin e vlerave në Shqipëri e ka bërë dhe autori Kocani, por ky studim ka për qëllim të përfshijë të tjera grup-vlera nga ato që identifikon autori Kocani në librin e tij “Hulumtimi i Sistemit të vlerave në Republikën e Shqipërisë në Periudhën Postkomuniste”. Ky studim kërkon të jetë më gjithëpërfshirës duke përmbajtur kuadrin social-politik-etik-kulturor në sistemet e vlerave, të cilët analizon.

Ndërsa në planin e dekonstruktimit, duke iu referuar autorit Jacques Derrida shumë të njohur për teorinë e dekonstruksionit, megjithëse ai i referohet më shumë dekonstruksionit të strukturës së teksteve, gjuhës dhe shkrimit që përdoret

për të investiguar mbi detajet më të hollësishme në tekste të caktuara, në metodologjinë e këtij studimi shqyrtohen të dhëna cilësore dhe pohime nga autorë që janë marrë me studimin e identiteteve përkatëse të rrafsheve që analizohen, dhe përveç kësaj zbërthehen vlerat për secilin sistem makro, për të përpunuar të dhënat dhe citimet në një tjetër këndvështrim, për të dhënë një perspektivë tjetër në lidhje me raportin BE-Shqipëri dhe ndërveprimet ndërmjet tyre.

Në këtë sistem më gjithpërfshirës u pa e nevojshme të përfshiheshin edhe normat politike të reja pas 90-ës që rikonceptoi BE për vendet që donin të aplikonin modelin europian dhe të antarësoheshin në BE. Pra normat e reja në gjuhën e BE-së, dhe si po aplikohen ato në realitetin e shtetit kombëtar, për të kuptuar më mirë raportin që krijohet me BE-në dhe vlerat që ajo promovon si në aspektin kulturor por sidomos në atë normativ.

Kështu në këtë mënyrë, metodologjia që ndjek ky studim përshkon dhe dekonstrukton sistemet e vlerave e të dy rrafsheve, atij të BE-së dhe atij kombëtar. Alexander Wend, konstaton se: “përpara se të bëhemi konstruktivistë për diçka, duhet “të zgjedhim “njësitë” dhe “nivelet” e analizave, apo “agjentët” dhe “strukturat” (Wend 1999; 7), të cilat do të analizohen sipas konteksteve ku janë të bazuara. Duke u nisur nga kjo perspektive, për të parë mundësitë e konstruktimit, skematikisht do të krijohen dy grupime vlerash për secilin rrafsh, të ndara në dy kategori të ngjashme brenda sistemit. Më qartë, në rrafshin e BE-së, brenda sistemit ndodhet kategoria e vlerave kulturore (tradicionale) dhe kategoria e vlerave politike, demokratike (bashkohore, post-moderne) dhe në rrafshin kombëtar të Shqipërisë, brenda sistemit ndodhen dy kategori të ngjashme për t’u zbërthyer. Vlerat e secilit sistem janë të zbërthyera nga identitetet përkatëse, pra ai kombëtar shqiptar dhe ai europian. Në këtë rast sistemet për secilin rrafsh do të shërbejnë si variabla të pavarur. Ndërsa vlerat që zbërthehen nga këto sisteme makro, të cilat janë kategorizuar në sisteme për secilin rrafsh janë variablat e varur. Arsyeja pse janë vendosur në sisteme përkatëse, është për të dhënë një pamje sa më qartë dhe të kuptueshme se si këto variabla të varur ndërveprojnë me

njëri tjetrin nga sistemi në sistem, si për kategorinë kulturore, ashtu edhe për atë politike-normative.

Për të dyja sistemet ka zberthim të kategorisë së vlerave tradicionale kulturore, ndërsa për kategoritë politike bashkohore vlerat dhe normat e përçuara nga BE nga fuqia normative merren të mirëqena. Ato zberthehen më të tejduara në rrafshin kombëtar, se si janë aplikuar dhe sa janë përshtatur vlerat thelbërore dhe normat e reja në nivel kombëtar. Kështu, shfaqet nevoja për të bërë një dallim ndërmjet vlerave dhe normave, edhe pse një vijë ndarëse vendimtare nuk ka ndërmjet tyre. Normat mund të kthehen në vlera kur ato janë konsoliduar dhe të përbrendësuar nga një shoqëri. Vlerat janë të lidhura me gjendje emocionale dhe vlerësuese. “Vlerat shtrihen në një gamë të gjerë entitetesh si (objekte, veprime, prona, rrethana), ndërsa normat duket sikur mbështeten në mënyrë unike në veprime.”¹¹ Normat janë standarde të cilat rregullojnë sjelljen shoqërore, duke qenë se përfshijnë ose aplikojnë modele direktivash, detyrash, rregulla dhe praktika. “Standardet e sjelljes që mbështeten në norma mundësojnë rregull në marrëdhëniet e ndërveprimit shoqëror”¹² Normat duke pasur një lloj karakteri konstitutiv dhe drejtues kërkojnë një lloj validiteti në kontekstin ku aplikohen, pra duhet të përkojnë me realitetin.

Prandaj, kur flitet për vlera kulturore tradicionale do të shtjellohen ato vlera kulturore që gjatë mbijetesës së tyre janë ruajtur dhe ngulitur, pasi populli ka pasur një lloj afeksioni për ta ose i ka përcjellur dhe vlerësuar si të ‘mira’¹³, i ka përbrendësuar dhe mishëruar. Gjithashtu edhe kur flitet për vlera kulturore në BE do të trajtohen ato vlera me karakter kulturor nga vendet anëtare të BE-së të cilat kanë kontribuar për pasurimin e këtij aspekti dhe po zhvillohen gjithnjë e më shumë nën rrjedhën globale të multikulturalizmit dhe diversitetit. Kur shtjellohen vlerat liberale thelbësore të BE-së nga baza e fuqisë normative dhe norma të reja

¹¹ How to distinguish norms from values, by Davide Fassio, 2013;200.

<http://www.phenomenologyandmind.eu/wp-content/uploads/2013/12/14.DE-FASSIO.pdf>

¹²**Values and Norms of Society: Conformity, Conflict and Deviation in Norms**

<http://www.sociologydiscussion.com/society/values-and-norms-of-society-conformity-conflict-and-deviation-in-norms/2292>

¹³(*ibid*)

do të trajtohen ato vlera të cilat BE i merr si të mirëqena dhe të cilat duhet të zbatohen dhe të respektohen nga të gjitha vëndet anëtare ndërsa për normat e reja që u shfaqën pas 90-tës do të trajtohen ato norma që u riformuluan nga vlerat thelbësore për vëndet e reja që kërkonin të anëtarësoheshin, të cilat duhet të aplikojnë ato norma në nivel kombëtar. **Për rrafshin kombëtar në vlera kulturore do të grupohen:** Gjuha, feja dhe traditat kulturore, ndërsa në vlera thelbësore dhe norma të reja do të grupohen paqja, demokracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut, progresi social, qeverisja, diskriminimi dhe rastet ku shfaqet ai. Nga ana tjetër, **për rrafshin e BE-së, në vlera kulturore do të grupohen** gjuhët në BE (multilinguizmi), feja, qytetaria, dhe diversiteti kulturor¹⁴, ndërsa **si vlera thelbësore dhe norma të reja , do të grupohen:** paqja, demokracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut, progresi social, qeverisja e mirë, anti-diskriminimi. Në këtë mënyrë studimi ofron një panoramë të përgjithshme të grupimeve vlerore për secilin sistem dhe automatikisht analiza do të vijojë në dekonstrukcionin e këtyre vlerave në hollësi për të mundësuar procesin e të kuptuarit dhe raportin që kanë vlerat kombëtare me ato të BE-së dhe anasjelltas në të dyja kategoritë përkatëse si variabla të varur. Një përshkrim i kësaj metodologjie mund të kuptohet më qartë edhe nëpërmjet skemës më poshtë:

¹⁴Diversiteti kulturor do dalë më në pah gjatë zbërthimit që i bëhet qasjes esencialiste përballë qasjes konstruktiviste, duke u referuar për këtë të fundit tek shumë autorë bashkohorë që bëjnë thirrje për një Europë e cila duhet të pranojë diversitetin dhe multikulturalizmin.

Kategoria e vlerave tradicionale kulturore

konstruktivizëm ↔ dekonstruktivizëm

Multilinguizmi	=	Gjuha
Feja/Religjioni	=	Bashkjetesa fetare
Diversiteti kulturor	=	Traditat kulturore kombëtare

Kategoria e vlerave bashkëkohore, të reja (vlerat politike-liberale)**Vlerat thelbësore dhe normat e reja**

*Paqja	≠	*Paqja
*Demokracia, ideja e lirisë dhe e barazisë	≠	*Demokracia
*Sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut	≠	*Sundimi i ligjit
*Progresi social	≠	*Progresi social
*Qeverisja e mirë	≠	*Qeverisja shqiptare
*Anti-diskriminimi	≠	*Rastet e diskriminimit në Shqipëri

Shënim: Shenjat si =dhe ≠ shpjegojnë: =përputhje; ≠mospërputhje

Ky lloj këndvështrimi dhe analizimi mundëson një të kuptuar më të thellë të dy raliteteve dhe rëndësinë që kanë këto vlera për të dy sistemet, por edhe për rëndësinë që marrin në proces ndërveprimi, duke konsideruar përvojën, rrugëtimin dhe ndryshimin në kohë të vlerave, eksperiencën, domethënien që marrin secila nga vlerat për kontekstin ku ndodhen dhe për kontekstin në të cilin do të përshtaten.

Gjatë zbërthimit të vlerave shfaqet qartë se kategoria e vlerave kulturore (tradicionale) nga të dyja sistemet përkon dhe gjen mundësi bashkveprimi. Ndërsa kategoria e vlerave politike ose e normave të reja në rastin Shqiptar nuk përkon me vlerat thelbësore dhe normat e reja post demokratike, të cilat rrjedhin nga baza e fuqisë normative të BE-së, dhe në rastin e BE-së merren si të mirëqena.

Kjo metodologji dekonstruktiviste e të kuptuarit ndihmon për ta parë marrëdhënien Shqipëri-BE nën një këndvështrim të ri, larg tendencave të krahasimit dhe duke ju larguar pikëpyetjeve të mëdha në lidhje me identitetin evropian të Shqiptarëve ose jo, sepse nëpërmjet dekonstruktimit mundohet të japë kuadro të qarta të variablave që tregojnë përplasje gjatë ndërveprimit, bazave që duhet të rindërtohen (si ajo politike-normative) për t'u zhvilluar dhe integruar më shpejt, duke promovuar vlerat kulturore.

Në mbledhjen e të dhënave cilësore për kryerjen e analizës është përdorur një metodologji kualitative për të shkuar nga një arsyetim induktiv drejt atij deduktiv. Edhe pse studimi ka në themel si qasje konstruktivizmin, i cili jep platformën e përshtatshme për hulumtimin shkencor në fjalë dhe jep mundësi për të krijuar modelin e përshtatjes, analiza që do të përshkojë studimin është një analizë e tipit “verstehen” të vlerave që i përkasin të dy sistemeve vlerore nëpërmjet dekonstruksionit të tyre dhe deduksionit nga e përgjithshmja në elementë të veçantë dhe ndërveprues. Ky lloj dekonstruksioni “verstehen” sipas modelit Weber-ian, rreket të shpjegojë veprimet e vlerave nga sistemi në sistem sipas shpjegimit interpretues. Ndonëse Weber-i mundohet ta shpjegojë “veprimin social” nëpërmjet veprimit të individëve dhe humanëve dhe “të kthejë disa kategori të ndërveprimit human në veprime të kuptueshme”¹⁵, ky studim mundohet të bëjë të njëjtën gjë me kategoritë vlerore për secilin sistem, për të kuptuar përputhshmërinë gjatë ndërveprimit të këtyre kategorive ose jo.

Mbledhja e të dhënave cilësore për të kryer këtë studim është bërë duke marrë parasysh strukturën, si është ndarë studimi dhe kategoritë që janë marrë në shqyrtim në këtë studim. 1.Për kornizën teorike janë shqyrtuar libra dhe botime të autorëve që kanë shkruar mbi konstruktivizmin, si dhe sociologë e studiues që

¹⁵Marianne Weber, Max Weber, *Ein Lebenslied* (Tubingen 1926), p.102, as quoted by H.H Gerth and C.Wright Mills, “Introduction: The man and his work”, in *From Max Weber: Essays in Sociology*, translated and edited with an introduction by H.H Gerth & C.Wright Mills (New York, Oxford University press 1946), p.55.

Marrë nga Tucker, William T. “Max Weber's ‘Verstehen.’” *The Sociological Quarterly*, vol. 6, no. 2, 1965, pp. 157–165. www.jstor.org/stable/4105245

janë marrë me studimin e vlerave dhe normave apo sistemeve vlerore, të cilët janë përmendur më sipër. **2.**Për rrafshin kombëtar janë studiuar libra, artikuj shkencorë, nga fusha e politikës, kulturës gjithashtu edhe identitetit dhe fesë. **3.** Për rrafshin e BE-së është ndjekur një procedurë e ngjashme, si me rastin shqiptar duke parë botime dhe autorë të ndryshëm që shkruajnë mbi qasjet që ekzistojnë në BE dhe çfarë perspektive ofron realiteti i sotëm atje për qasjen konstruktiviste, artikuj dhe informacione nga mediat për sa i përket vlerave me karakter kulturor, vlerave thelbësore dhe normave të reja.

Përsa i përket pjesës së konkluzioneve janë shqyrtuar disa autorë që janë marrë me studimin e multikulturalizmit, diplomacisë publike si dhe dokumenta në internet, përsa i përket rekomandimeve që jepen për diplomacinë publike dhe një intervistë në lidhje me këtë temë. Shqyrtimi i të dhënave për të vijuar analizën dekonstruktive ndërmjet vlerave për secilën kategori dhe sistem dhe ndërveprimin e anasjelltë që ata kanë, mundëson një skemë e të kuptuarit ose shfaq bazat për rindërtim të kategorive vlerore që shfaqin një lloj mospërputhjeje apo përplasje gjatë ndërveprimit. Pra vendosja përballë e sistemeve vlerore nëpërmjet analizës “verstehen” bëhet për të kuptuar dhe për të zbërthyer fushat e ndërveprimit të vlerave, të cilat nuk krijojnë përplasje, por përkundrazi shfaqin përputhshmëri, dhe të atyre që krijojnë mospërputhje siç do të shfaqet natyrshëm dhe qartë gjatë dekonstruktimit të kategorisë së vlerave politike-demokratike të dy rrafshëve. Pra gjatë dekonstruktimit të këtyre vlerave vihen në dukje kategoria e vlerave që shfaq nevojën për rindërtim, si në aspektin e vlerave kulturore që krijojnë përputhje dhe pikërisht për këtë duhen promovuar ashtu edhe të vlerave politike që kanë një lloj frakturimi apo shfaqin një lloj rezistence dhe qëndresenë raport me vlerat e thelbësore dhe normat e reja të riformuluara pas 90-ës nga BE, pikërisht për vënde ku bën pjesë dhe Shqipëria.

1.11 Kufizimet e tezës

Meqënëse me lart u bë një sqarim i shkurtë ndërmjet vlerave dhe normave, në studim kjo ka sjellur një lloj kufizimi gjatë shtjellimit, meqënëse ishte vështirë të hiqej një vijë ndarëse e thellë ndërmjet të dyjave. Kjo gjë ka sjellë kufizime për

mënyrën se si do të mund të analizoheshin, deri sa u pa e arsyeshme të grupoheshin në kategori për secilin rrafsh, brenda sistemeve që u përkasin.

Sikurse ky studim nuk ka sondazhe të shumta apo kampione për të matur përceptime në lidhje me vlerat, gjë e cila do ta zgjeronte shumë temën e studimit, u pa e rëndësishme mbështetja tek literatura epërzgjedhur, në mënyrë që studimi të kishte një fokus sa më të matshëm rreth asaj çfarë rreket të kuptohet. Gjithashtu, ky studim si fillim, gjatë shtjellimit ka ngritur shumë pikpyetje dhe pyetje kërkimore meqenëse studiohen dy kategori te ngjashme nga dy sisteme të ndryshme, por me vijimin e punës dhe nga mbledhja e të dhënave u pa e arsyeshme të kishte një fokus sa më të matshëm dhe konkret, dhe kjo gjë u bë edhe si rezultat i rekomandimeve gjatë fazës së mbrojtjes së bardhë.

Pyetja kërkimore u fokusua vetëm tek qëllimi i studimit që ka të bëjë me raportin e vlerave kombëtare me procesin e integritit europian dhe anasjelltas. Duke qenë se BE është një bashkësi e përbërë nga shumë kombe, kjo gjë e vështirëson punimin nëse do të bëhej një analizë krahasuese e mirëfilltë e dy rrafsheve, ndaj dhe ky studim shkon drejt analizës ‘vershtehen’ të sistemit kombëtar me vlerat që mbart dhe të sistemit të BE-së dhe të vlerave që mbart si për kategorinë e vlerave kulturore, ashtu edhe për atë politike-demokratike, për të kuptuar jo vetëm marrëdhëniet e ndërveprimit por edhe hapësirat e përshtatjes si dhe të konsolidimit të vlerave të cilat krijojnë përplasje gjatë ndërveprimit. Kjo analizë e të kuptuarit nuk bëhet për të treguar një domosdoshmëri kombëtare për t’ju bindur normave politike normative që ka vendosur BE, por për të hedhur dritë mbi procesin e përshtatjes, pasi BE është një destinacion që shteti dhe shoqëria shqiptare e ka zgjedhur me dëshirë dhe e sheh si destinacion final.

Për të dalë sërish tek logjika konstruktiviste, “sistemi i vlerave” si në rasisn kombëtar dhe të BE-së, që ky studim do të shtjellojë ka të bëjë më shumë me sferën sociale ku është i ngulitur secili nga sistemet, si shprehje e identitetit, vlerave, ideve dhe e normave për të ndërtuar realitetet sociale të cilat janë të përfaqësuar nga shoqëritë e secilës palë. Wend pranon se: “karakterit i jetës ndërkombëtare përcaktohet nga besimet dhe pritshmëritë që shtetet kanë për

njëri-tjetrin, dhe këto përbëhen kryesisht nga strukturat sociale në vend të atyre materiale” (Wend 1999; 20) Pikërisht ky studim synon të zbërthejë, nisur nga një qasje konstruktiviste karakteristikat vlerore të këtyre sistemeve për të parë mundësitë e ndërveprimit dhe si ndërtohen shoqërisht dhe si mund të ndërtohen kur ka mospërputhje.

KAPITULLI II

Modeli Teorik/Shtjellimi i literaturës

2.1 Korniza teorike dhe veprat që ndihmuan në përcaktimin e saj.

Meqënëse ky punim shkencor ka në thelb të tij vlerat kombëtare dhe vlerat politike ose normat e reja, si të realitetit të BE-së ashtu edhe atij kombëtar, struktura e punimit do të bazohet në metodën konstruktiviste të Aleksandër Wend, sipas librit të tij *Social Theories of International Relations* (1999), si një dritare për t'i parë popujt në marrëdhënie të ndërsjellë kulturore. Marrëdhëniet ndërmjet kombeve kanë mundësi nga ndërvartësia globale të formësojnë njëri-tjetrin për aspekte të ndryshme në fushën sociale, të shkëmbehen kulturalisht dhe të japin e të marrin nga njëri-tjetri, pasi “sistemi ndërkombëtar është një konstrukt social” (Wend 1999) Kjo kornizë e mbështet këtë punim nga fillimi deri në fund, jo vetëm për të evidentuar karakteristikat, vlerat dhe normat të secilit nga kontekstet që do të analizohen, por për të evidentuar se çdo analizë deri në fund të punimit duke u nisur nga aspekti kombëtar tek ai mbikombëtar (BE) dhe anasjelltas, bazohet tek konstruktin social, duke evidentuar, se si “ndërvartësia, fati i përbashkët, homogjenizimi, dhe vetë-përmbajtja” krijojnë marrëdhënie dhe “ndryshim strukturor nga një kulturë në tjetrën” (Wend 1999), duke qenë se ka shkëmbim dhe ndërveprim të ndërsjellë ndërmjet aktorëve në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Martha Finnemore gjithashtu, me librin e saj “*National Interests in International Society*” (1996) sjell një këndvështrim të njëjtë në ndihmë të përcaktimit të kornizës teorike kur investigon “strukturën ndërkombëtare, jo të fuqisë por të

kuptimeve dhe të vlerave sociale” (1996) dhe të rëndësisë që kanë këto të dytat për të kuptuar “çfarë duan shtetet”(1996). “Shtetet janë ngulitur në një rrjet të dendur transnacional dhe ndërkombëtar të marrëdhënieve sociale të cilat formësojnë përceptimet e tyre për botën dhe rolit të tyre në botë” (1996).

Në këtë aspekt Shqipëria, që të hynte në procesin e aderimit në BE, më parë duhej të fillonte procesin e formësimit dhe socializimit, sepse “shtetet duhet të socializohen nga shoqëria ndërkombëtare” më parë, “që të kërkojnë disa gjera” (1996). Kështu, “interesi shtetëror” i brendshëm shqiptar, pavarësisht qëllimeve dhe politikave të brendshme që shpesh devijojnë ose vonojnë në përmbushjen e reformave që kanë të bëjnë me aplikimin e validitetit normativ në kontekstin kombëtar, është e qartë se me panoramën e marrëdhënieve ndërkombëtare sotduhet të “përcaktohet në kontekstin e normave të mbajtura ndërkombëtarisht” (1996) si dhe ndërgjegjësimit dhe “mirëkuptimit se çfarë është e mirë dhe e duhur” për t’u bërë ose arritur.

Për Wend-in “materializmi” dhe “individualizmi” (Wend 1999) zbehen në kuadrin e konstrukteve dhe marrëdhënieve strukturore që hasen sot në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në ndihmesë të kornizës teorike të këtij punimi do të jenë koncepte dhe nga autorë si Holsti K. J. (1997) “America meets the ‘english school”, i cili në këtë artikull bën një rishikim të botimeve të Martha Finnemore, “National interest in International Society (1996) dhe të Rick Fawn e Jeremy Larkins me botimin “International Society after the Cold War”(1996) për të hedhur dritë mbi mundësitë që ofron shkolla angleze dhe konstruktivistët, për të shkuar përtej asaj çfarë ofrojnë neorealizmi dhe neoliberalizmi dhe për të eksploruar çështje që janë “shmangur dhe thjeshtëzuar nga ato” (Holsti 1997: 275). Gjithashtu dhe Hopf T. “The promise of Constructivism in International Relations Theory”(1998).

Autori Enis Sulstarova me artikullin e tij “Jam Evropë! Ligjërimi i Intelektualëve për Evropën në Shqipërinë e tranzicionit, në Revista “Politikja”(2011) sjell një platformë të mirë për të mbështetur punimin sipas qasjes konstruktiviste që mbështetet punimi i tij, por edhe krijon mundësinë për ta zgjeruar qasjen

esencialiste, si dhe si është raporti në BE, sot me të. Përveç kësaj, platforma që ofrona ai dhe analiza që shtrun brenda këtij artikulli përse i përket identitetit kombëtar shqiptar, zgjon kureshtje për të hulumtuar dhe me tej jo drejt analizës se çfarë identiteti ka Shqipëria, medoemos lindor apo oriental apo perëndimor, por për shpalosjen origjinale të këtij identitetit që ka Shqipëria sot, me pasqyrimet apo ngjyrimet që i kanë dhënë autorët e shumtë, drejt sjelljes konstruktiviste, në raport me identitetet e tjera. Gjithashtu njëti autor vjen në ndihmë të këtij punimi edhe me botimin: Arratisje nga Lindja (2006) ku përpiqet të sqarojë çfarë janë në thelb shqiptarët perëndimorë apo lindorë, ku pika finale e kapërcimit të prapambetjeve mendësive dhe zakoneve lindore mbetet Bashkimi Europian, duke u modernizuar dhe demokratizuar sipas rrjedhës integruese europiane. Artikulli tjetër i vlefshëm i tij është: “Moderniteti i Rilindjes Kombëtare” për rëndësinë që ajo pati për të hedhur themele moderne të shtetit shqiptar dhe për pjesën ku përshkruhet si ka rrjedhur ky identitet ndër periudha të ndryshme historike, dhe faktit si ëndrra apo kërkesa europiane është e hershme tek shqiptarët.

Ashtu siç pretendon dhe autori Derrida, në ‘Writing and Difference’, “brenda strukturës nuk ka vetëm formë, lidhje, dhe konfigurim.” (1978) Egziston dhe imagjinata për një strukturë të caktuar dhe “Imagjinata (si fakultet produktiv i njohjes) është një agjent i fuqishëm për krijimin” (1978) Në këtë këndvështrim (por edhe në atë Weberian të përshkruar më lart) do të trajtohet dhe çështja e imazhit kombëtar shqiptar në rajonin e Ballkanit, BE dhe më gjerë, ashtu siç thotë dhe Benedict Anderson “komunitetet dallohen jo nga falsiteti/vërtetësia e tyre, por për stilin në të cilin ata janë imagjinuar” (Anderson 1983-2006; 6), pra konkretisht, si është bërë imagjinimi e më pas interpretimi i Shqipërisë si një strukturë e përbërë nga shumë elementë që ka ecur në peripeci dhe periudha të vështira historike, për të cilat ka krijuar një stil të përceptuar nga jashtë dhe si mund të përmirësohet interpretimi i kësaj strukture nga jashtë.

2.2 Diskutim i shkollave të ndryshme teorike egzistuese

Shumë kohë më parë, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, debati kryesor ka qenë mes formave të realizmit dhe liberalizmit. Gjatë viteve të fundit, ky debat

është zhvilluar,ndërmjet rrymave të reja të Realizmit dhe Liberalizmit të njohura si neorealizëm dhe neoliberalizëm,të cilat megjithë ngjashmëritë në aspektin teorik, kanë shumë ndryshime në trajtimin e tyre. Krahas këtyre dy rrymave kryesore një këndvështrim mjaft ngacmues në fushën ndërkombtare, ka qenë edhe Marksizmi.

Kështu në vitët 80-të të shek.20, flitej kryesisht për këto tre qasje në parashtrimet teorike të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në disiplinën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare gjatë historisë së kësaj discipline janë zhvilluar 4 debate të mëdha; Autorë Kurki dhe Wright shkruajnë se janë pranuar katër debate sipas Waever (Waever 1996), të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm për formësimin e teorive. **Debati i parë** ishte ndërmjet realistëve dhe idealistëve gjatë *“luftës së II-të botërore, kryesisht për rolin e institucioneve ndërkombëtare dhe për mundësinë dhe që shkaqet e luftës të mund që të përcaktoheshin më mirë. Debati i dytë*, lindi në vitet 60 mes tradicionalistëve të përkushtuar për të mbrojtur metodologji humaniste dhe modernistëve që synonin të fushnin në këtë disiplinë një rigorozitet me të madh shkencor. **Debati i tretë**, që lidhet me debatet midis paradigmave që u zhvilluan në vitet 70-80, i cili u zhvillua mes qasjeve realiste, pluraliste dhe atyre Marksiste, ndaj mënyrës më të mirë për të shpjeguar proceset ndërkombëtarë. **Debati i katërt**, ishte i përqendruar rreth mosmarrëveshjeve që kishin të bënin me objektin e disiplinës së Marrëdhënieve Ndërkombtare dhe studimit të saj.(Dunne Kurki Smith 2010:38)

Janë tre pandehma të mëdha që bashkojnë rrymat dhe teoritë me gjithë ndryshimet që egzistojnë ndërmjet tyre: a)Rrymat që u zhvilluan më vonë i kushtojnë vëmendje teorisë dhe rëndësisë së saj në shpjegimin dhe në të kuptuarit e botës. b) Rrymat si p.sh. Feminizmi, “Poststrukturalizmi, Teoria e të gjelbërvë, Postkolonializmi, vijnë nga disiplina të tjera akademike duke marrë parasysh zhvillimet e 50 vitevetë fundit” (Dunne Kurki Smith 2010:27), ndërkohë rrymat e tjera si Neoliberalizmi, Neorealizmi, Konstruktivizmi etj. nuk kanë më shume se 20 vite që kanë filluar të trajtohen. Çdo njëra prej këtyre rrymavë përpiket të lidhë në një farë mënyre teorinë me praktikën me synimin që të shpjegojë botën

përreth, por asnjëra prej tyre nuk mund të jetë e paanshme, pasi të gjitha bëjnë hamendësime për botën, të cilat janë ontologjike¹⁶ dhe epistemologjike¹⁷, dhe metodologjike¹⁸.

“Të gjitha teoritë janë të vendosura në hapësirë, kohë, kulturë dhe në histori” (*Ibid*) dhe të gjitha janë të nevojshme për pasurimin që i sjellin fushës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke tejkaluar pretendimet e Pozitivistëve (Racionalistët dhe Realistët), që vetëm disa prej tyre, janë teori të mirfillta që shpjegojnë Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Teoricienët modern rekomandojnë recetën “përziej e merr” si teorinë më të mirë për të shpjeguar marrëdhëniet Ndërkombëtare (*Ibid:31*), pra teorinë me të afërt e cila mbulon apo trajton tematikën që dikush ka nevojë të shtjellojë psh; kur diskutohen probleme gjinore, mund të zgjidhet “Feminizmi” (*Ibid 31*), kur diskutohet për ndotje mjedisi apo çështje të tjera në lidhje me mjedisin, mund të zgjidhet “Teoria e gjelbërt” (*Ibid:31*), kur diskutohet për çështjelufte dhe konkurrencë mes shtetesh mund të zgjidhet Teoria Realiste/ Neorealiste ose “realizmi kritik” (*Ibid:31*). Në këtë prizëm, kjo tezë prandaj ka zgjedhur konstruktivizmin, për t’i trajtuar vlerat në një mënyrë të re dhe bashkëkohore, nën dritën e një axhende të re që i përshtatet kohës në të cilën jetojnë, ndryshojnë dhe konstruktohen.

Duke përdorur metodën konstruktivite, kjo tezë mundohet t’i shmanget qëndrimeve realiste pasi shtetet në kushtet e ndërvartësisë globale nuk mund të veprojnë vetëm në një sistem ndërkombëtar anarkik për të përmbushur interesat shtetërore ose kombëtare, ku normat për shtetet sipas Hobbes nuk janë gjë tjetër veçse “të mbajnë armët e tyre të drejtuara, dhe sytë të mbërthyer mbi njëri-tjetrin” (Hobbes 1968:13), por mund të krijojnë marrëdhënie bashkëveprimi të ndësjellë, të përçojnë e të marrin vlera nga njëri-tjetri.

¹⁶(teoria e qenies, nga se përbëhet bota, çfarë objektesh studjojmë, cilat tipare kanë nevojë të shpjegohen),

¹⁷(të njohjes, si e fitojmë dijen mbi botën, çfarë shpjegimi mendohet)

¹⁸(teoria e metodave, çfarë metodash përdorim për të nxjerrë faktet dhe provat, mënyra dhe rrugët që ndjek secila teori në ndërtimin e argumentit).

Ky studim i shmanget gjithashtu edhe qëndrimeve neorealiste, pasi shtetet nuk mund të jenë “si gurë bilardo që përplasen” (Reus-Smit 2012, 231) në këtë rast “sikurse në rastin e realizmit klasik”, ku ekuilibri i fuqisë mbetet parim kryesor,” (Mingst 2008:98) i përcaktuar nga “struktura e sistemit” (*ibid*:98). Sipas Neoliberalëve, “kur ndërruesia është e madhe, sip.sh që nga lufta e II-të Botërore shtetet arrijnë të kenë një gamë të gjerë interesash nga administrimi i tregtisë ndërkombëtare tek mbrojtja globale e mjedisit” (*Ibid*), por gjithsesi “bashkpunimi ndërkombëtar mbetet i vështirë për t’u arritur” (*Ibid*), sepse kërkohet nevojat e një autoriteti qendror për marrjen përsipër të detyrimeve të palëve që kishin nevojë për një bashkëpunim të qëndrueshëm.

Në këtë këndvështrim, as qasja neo-liberale nuk do të ishte qasja e duhur, pasi ky studim kërkon të shohë marrëdhëniet Shqipëri-BE në dritën e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit për të arritur konstruktin dhe përshtatjen për integrimin final dhe frytet që mund të sjellë ky bashkëpunim në të gjitha nivelet. Pra në këtë studim, “aktorët politik qofshin individë apo shtete” nuk mund të jenë “egocentrikë dhe racionalë” (Reus Smit 2012: 234) Në ndryshim me liberalët dhe realistët, marksizmi kërkonte të shpjegonte fuqinë ekonomike të palëve, duke nxjerrë në pah pabarazinë në strukturën e sistemit ndërkombëtar, duke analizuar modelet jo vetëm të tregtisë, por edhe “të prodhimit global” (Rupert 2010:201), të investimeve botërore, që krijojnë ndarje mes rajoneve të pasura dhe atyre të varfëra, pra dëshira për të dhënë një “interpretim kritik të kapitalizmit” (*Ibid*:201)

“Prodhimi i politikës globale” (*Ibid*:201), barazia dhe demokracia (*Ibid* 201) lidhet me idenë, si njerëzit do të mundnin ta organizonin “veten në një mënyrë tjetër” (*Ibid* 201), pasi njerëzit me mënyrën e tyre të jetuarit dhe me llojet e marrëdhënieve që krijojnë në shoqëri edhe në perspektivë historike, kanë kapacitete për të ndryshuar të ardhmen e tyre dhe për t’u organizuar ndryshe. Marksist mendonte se janë marrëdhëniet që i bëjnë ata të jenë ato çfarë janë, por jo prirjet e “brendshme” (*Ibid* 201). Jeta shoqërore sipas Marksit, është një “Marrëdhënie në proces” (*Ibid* 2101). Është qasja “dialektike”, pra “bashkëveprimi mes individëve dhe institucioneve që formojnë kornizën për

veprimin e tyre.” (*Ibid* 202-203) Ajo çfarë është e rëndësishme në teorinë marksiste, e parë nga këndvështrimi perëndimor, është se ai vë theksin mbi “praktikat shoqërore” (*Ibid* 209) të cilat çojnë në “pretendimet për njohjen” (*Ibid* 209), pasi “teoritë që pretendojnë të vërtetën objektive janë udhërrëfyese shumë të këqija”.

Qasja marksiste perëndimore nuk është larg objektit studimor që ka zgjedhur kjo tezë në kuadrin e marrëdhënieve të njerëzve, që i shtynë ata drejt procesit apo në kuadrin e bashkëveprimit mes individëve dhe institucioneve që formojnë “praktikat shoqërore”(Ibid 209) por marksizmi vetë si rrymë ka evoluar për shkak të presionit shumë të madh të rrymave të tjera që u shfaqën, për t’u bërë komplementar me rrymat e tjera dhe me kohën në zhvillim. Interesante është se, secila nga qasjet apo teoritë e mësipërme, merr në analizë prioritete të ndryshme nga tjetra, kështu që në këtë këndvështrim ato janë plotësuese dhe japinkontribute për teorinë mbi marrëdhëniet ndërkombtare. Ky debat rreth tematikave të mësipërme, ka çuar në diskutime mbi teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet Racioanalistëve dhe Reflektivistëve.

Teoricienët kritikë si ato që mbrojnë “feminizmin” kërkonin që femrat të kishin një zë dhe një fuqi në disa sektorë të politikave, dhe kërkonin që ata të ishin “subjekte më të dukshme në politikën ndërkombëtare, ekonominë globale” (Sjoberg & Tickner 2010;244) dhe në fushën e sigurisë, pasi edhe gruaja ka një impakt dhe një rol në politikat globale. Politika ndërkombëtare do të dukej ndryshe nëse do të shihet nën një optikë gjinore. Teoricienët e post-kolonializmit merren me rindërtimin e fakteve të historisë mbi popujt e kolonizuar, dhe duke iu kundërvënë paraftyrimit që është krijuar për gratë perëndimore në mënyrë të përgjithësuar, pa marrë parasysh kontekstin, kur në të vërtetë “realitetet e tyre” mbartin elementë që duhen marrë në konsideratë si p.sh “nënshtrimi” i tyre, në kontekstin gjinor, kulturor dhe racor ku ata janë të vendosur.

Poststrukturalizmi ndalet në rolin që ka “abstragimi, përfaqësimi dhe interpretimi” (Campbell 2010;266) për të paraqitur botën. Çështjet e interpretimit kanë shumë rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare ku ngjarjet dhe eventet janë të skicuara,

prandaj poststrukturalizmi si qasje kritike i “kushton vëmendje rëndësisë së paraqitjes, të marrëdhënieve midis fuqisë dhe dijes, si dhe politikës së identitetit në prodhimin dhe në të kuptuarit e çështjeve globale” (Campbell 2010;268) Postrukturalizmi interesohet vazhdimisht për dukjen, nxjerrjen në pah, pasi dukja është ndërtuar nga disa faktorë që krijojnë një fakt të ditur dhe mbi atë fakt linden perceptimet. Edhe kjo tezë interesohet për dukjen e Shqipërisë, tek rekomandimet kur flitet për diplomacinë publike dhe kontributin që mund të japë ajo në ndryshimin e perceptimeve dhe të dukjes, për një imazh më të mirë.

Shpesh ka tendenca për ta etiketuar qasjen poststrukturaliste si postmoderne, por postmodernizmi erdhi si qasje “përzgjedhëse ndaj kontekstit kulturor” (*Ibid*;2010;269) që ishte krijuar nga humbja e modernizmit. Postmodernizmi nuk përdor një “analizë shpjeguese” por është në vetvete një “formësim kulturor, ekonomik, social dhe politik që rezulton nga ndryshimet e marrëdhënieve në hapësirë dhe kohë.” (*Ibid*;269)

Një ndryshim të madh solli edhe teoria kritike e postkolonializmit, e cila hulumton transformimin e vlerave dhe të njerëzve nga “Perëndimi” (Grovoqui 2010;295) në kohën e kolonializmit. Imponimi i Europës si një formë “universaliste” (*ibid*;295) dhe “superiore” (*Ibid*; 295) e cila “ka format më të mprehta, më të stërholluara e më të përsosura të arsyes e të së drejtës” (*Ibid* 295) për të ushtruar fuqi dhe për të “ndrydhur vetvendosjen” (*ibid* 295) e këtyre popujve. Postkolonialistët hedhin dyshime mbi “axhendat europiane të shpëtimit, të emancipimit, të mbrojtjes dhe të modernizimit universal” (*ibid* ;299), pa hedhur poshtë Perëndimin “si furnizues qytetërimi” (*ibid*; 298) Postkolonialistët merren gjithashtu me studimin e detyrës që marrin pësipër “politikanët perëndimorë” (*ibid*; 300) për të shprehur “superioritetin” (*ibid*) e tyre në theksimin e “të drejtave njerëzore” (*ibid*) si vlera të “Qytetërimit Perëndimor” (*ibid*). Në këtë këndvështrim as postkolonializmi nuk do të ishte qasja e duhur, pasi ky studim kërkon t’i shohë marrëdhëniet Shqipëri-BE në raport ndërtimi të vazhdueshëm dhe ndërveprimi, jo ta shohë BE-në në pozita superioriteti vleror, por si një model për t’u konstruktuar.

Drejtësia sociale është një kollonë e “politikës së gjelbër” (Eckersley 2010;318) gjithashtu e cila ka qëndrimin e saj kritik ndaj fenomeneve që lidhen me “përgjegjësinë ekologjike, mospërdorimin e dhunës dhe demokracinë e aplikuar” (Ibid; 318). Teoria e gjelbër ka funksion normativ që lidhet “me çështjet e drejtësisë, të të drejtave, demokracisë, qytetarisë, të shtetit dhe mjedisit dhe një degë të politikës ekonomike” (ibid;319) që bën lidhjet me mjedisin. Drejtësia mjedisore (pavarësisht fokusit ekologjik), i kalon kufinjtë e komunitetit kur është fjala për rreziqet e prekshme ekologjike, dhe mendon “për të gjithë popujt, brezat e ardhshëm, dhe speciet jo njerëzore” (Ibid 321).

Të gjitha teoritë kritike ose metateoritë, që u përmendën më lart kanë rëndësi për trajtimin e disa aspekteve apo problematikave në këtë studim, por qasja më e plotë mbetet konstruktivizmi, si bosht teorik. Më poshtë do të shtjellohet konstruktivizmi si bosht teorik apo si kornizë e këtij studimi. Shumë politologë mendojnë se shumëllojshmëria e teorive dhe e rrymave në fushën e marrëdhënieve ndërkombtare, jo vetëm nuk prishin punë sikurse mendonte Holsti, por e pasurojnë më shumë fushën e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke i trajtuar problematikat në aspekte me të hollësishme sociologjike dhe antropologjike, krahas atyre tradicionaleve në planin politik dhe ekonomik.

Stephen Walt në debatin mbi gjendjen e teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare, argumenton, se ka një qasje të tretë që është një qasje konstruktiviste, e cila në filozofi i jep shumë hapësira teorisë së racionalizmit. Më poshtë do të trajtohet konstruktivizmi si një qasje në të cilën mbështetet ky studim, sepse duke parë ndërtimin e strukturës shoqërore në ndërtim dhe zhvillim të vazhdueshëm të lejon edhe dekonstruktimin e konstruktit të një sistemi vleror shoqëror.

2.3 Çfarë synon të evidentojë ky studim

Punimi do të vijojë në vija të hollësishme në zbërthimin e kontekstit të BE-së, identiteti/identitetet dhe fuqia normative, pastaj kontekstin Shqiptar të vlerave në veçantësi elementë të veçantë kulturor shprehës të identitetit, kuadri normativ dhe kultura politike për të nxjerrë si fillim individualitetin, veçantinë, mundësitë e

ruajtjes të tyre, të përbashkëtat me sistemin vleror europian dhe më pas kontributin që mund të japin ato në një sistem vleror multi-kombëtar. Duke qenë se “format e veçanta kulturore si normat, rregullat, institucionet, konventat, ideologjitë, zakonet dhe ligjet janë të gjitha të përbëra nga “njohuritë e përbashkëta”¹⁹, sipas mënyrës dekonstruktiviste do të zbërthehen disa nga këto elementë që përmenden nga Wendt.

Duke u bazuar sërish në atë çfarë paraqet Dr. Abraham Marslow, si hierarkinë e nevojave humane apo “hirarkinë e vlerave” në librin e tij “Motivation and “Personality” (Marslow 1987; 97), shihet se si vlerat si një sistem, kanë një hirarki të tyre, dhe disa kanë “prioritet më të lartë” ose më të ulët” (*ibid*) Në këtë fazë që ndodhet “**sistemi vleror**” shqiptar sot duke përfshirë vlerat etno-kulturore të identitetit, normat e reja apo vlerat liberale, pra në fazën para aderimit në komunitetin e BE-së, zbërthimi i vlerave të mbijetesës, kontekstit normativ bëhet për të evidentuar rëndësinë dhe prioritetet e tyre dhe çfarë ndryshimesh mund të pësojnë gjatë procesit të ndërveprimit Shqipëri-BE, jo për të ndarë kush janë më pak apo më shumë prioritare, por për t’i parë si “një rend zgjedhjesh apo preferencash” (Marslow 1987; 98) në këndvështrim me sistemin vleror të BE-së.

“Besimet, vlerat dhe identiteti injë personi janë fituar zakonisht në mënyrë të pandërgjegjshme nga eksperiencia personale e të vëzhguarit të eksperiencës së “tjetrit”” (Naagarazan 2006;3) e cila pastaj prodhon dhe sjelljet në përputhje me vlerat dhe eksperiencat e vëzhguara. Pra duke qenë se identiteti shqiptar ka pasur periudhat e veta të shpëputjeve të marrëdhënieve me BE-në në të shkuarën, nga kthesat historike, cilat do të jenë mundësitë e përshtatjessot gjatë këtij procesi, mundësitë e ruajtjes të vlerave kulturore, dhe përsosjes së tyre nëpërmjet modelevetë veprimtarisë së diplomacisë publike (e cila do të jepet si rekomandim në fazën e konkluzioneve) që duhet të ndjekë aktori/shteti shqiptar për të prezantuar vetveten. Promovimi i imazhit dhe e figurës së tij në një komunitet multi-kulturor ku ka mjaft diversitet dhe ndërtimi i diplomacisë publike mbi

¹⁹Shih Lewis (1969), Bach (1975), Bhargava (1992: 143-156), and Denzau dhe North (1994, të cituar tek Wend A. 199, Social Theory of International Politics, fq.160).

bazën e këtyre vlerave është me rëndësi për statusin apo personalitetin që shoqëria ndërkombëtare, në këtë rast BE-ja mund t'i vlersojë dhe njohë shtetit ose kombit shqiptar.

Dekonstruktimi i vlerave në këtë plan, jep mundësi përveç të tjerave, për të parë mbi cilat vlera është ndërtuar identiteti kombëtar, si dhe çfarë interesash ushqen shteti shqiptar si aktor kandidat për aderimin në BE dhe si do mund të artikulojë ai diplomacinë publike në bazë të këtij identiteti. Dhe kjo jo për qëllime konkurrence, por me piksynimin për të ofruar disa vlera në këtë proces ndërveprimi dhe shkëmbimi që Shqipëria tani do të ketë me komunitete të tjera brenda BE-së, jo vetëm në fazën para aderimit, por edhe pas kësaj për t'u rindërtuar në vlerat që krijojnë përplasje dhe për të kapërcyer me sukses sfidat.

Komuniteti i BE-së me shtetet pëfaqësuese sipas qasjes konstruktiviste i ngjan një strukture sociale të hapur, ku aktorët/individët-shtet kanë hapësirë për të shprehur vetveten dhe veprimet e tyre. Pra kanë mundësi për të ndikuar në një kontekst të dhënë si dhe për t'u ndikuar prej tij, pasi “konceptet e normave, vlerave, rregullave sociale janë të shtrira në një proces ndërveprimi social”(Blumer 1969: 19), dhe për të parë procesin e ndërveprimit është e nevojshme të kryhet një lloj zbërthimi, interpretimi dhe pasqyrimi i rolit të tyre në shoqëri. Ky lloj procesi i krijuar nga marrëdhëniet në veprim krijon kushtet jo vetëm “për ndryshimin e tyre”Blumer (1969: 19) por edhe “për mbajtjen e tyre në një formë fikse”(Blumer 1969: 19)²⁰

Zbërthimi, pasqyrimi dhe interpretimi i vlerave jep mundësi për të dhënë sa është e mundur “një përkufizim kulturor” (Wendt 1999; 187) dhe normativ “të situatës” (*ibid*) të shoqërisë Shqiptare dhe të asaj të BE-së, mbi të cilat mund të ndërtohen perceptimet. Procesi i dekonstruktimit të këtyre vlerave do të sjellë njëkohësisht një panoramë për rolin konstruktiv që mund të luajnë këto vlera apo norma në marrëdhënien që tanimë është ndërtuar. Veçanërisht do të zbërthehet dhe shqyrtohet me një analizë të shteruar identiteti, gjuha, toleranca fetare, kultura dhe

²⁰Blumer (1969: 19) është i cituar në Wendt.A, Social Theory of International Politics”, 1999; P.185

traditat kulturore sipas autorëve të ndryshëm. Konteksti normativ në kuadrin e aspektit politik dhe të reformave, si është gjendja dhe çfarë kushtesh ka vendosur BE. Çfarë kanë prodhuar këto për shqiptarët dhe të huajt, dhe cilat janë pritshmëritë për të ardhmen. Pra analizimi në veçanti i këtyre elementëve në bazë të autorëve të ndryshëm, por edhe veprimeve nga ana e Shqiptarëve nuk do të sillte thjesht njohjen e identitetit kombëtar, si e kanë njohur Shqiptarët veten dhe si e kanë njohur të tjerët gjatë periudhave të ndryshme historike, por edhe mundësitë për të rikuperuar në papërputhshmëritë dhe hendekun që janë krijuar qoftë nga kthesat e vështira që ka bërë identiteti kombëtar, qoftë nga veprimtaria e diplomacisë tradicionale, e cila nuk ka mundur të luajë rolin e diplomacisë publike për promovimin e imazhit mbi bazën vlerave që përputhen.

Sikurse Shqipëria ndodhet në një fazë dialogu dhe ndërveprimi me BE-në për procesin e anëtarësimit, mbi bazën e njohjes së këtyre vlerave ky punim synon të nxjerrë mundësitë që identiteti i Shqiptarëve me vlerat që ka të mirëperceptuara ose jo, të evidentohet për të shmangur paqartësitë, për të artikuluar diplomacinë publike dhe atraksionet kulturore me veçantitë e tyre në një komunitet ku ka shkëmbim, ndryshime dhe kontribute të aktorëve të shumfishtë. Në vitin 1849, shkrimtari francez Victor Hugo fliste për ditën kur të gjitha kombet, në kontinentin europian do të bashkoheshin në një unitet, që do përbënte një vëllazëri europiane, duke ruajtur në të njëjtën kohë cilësitë e tyre të veçanta dhe individualitet. (Patrutiu –Baltes 2013) Duke e parë Europën “si një projekt të hapur” (Sulstarova 2011; 216) ky studim pikërisht kërkon të identifikojë vlerat kombëtare dhe identitetin shqiptar në kuadër apo funksion të epokës së multi-kulturalizmit.

2.4 Konceptet e përdorura në studim

Në punim do të përdoren koncepte si p.sh “sistemi vleror” (Kocani 2013; 6)²¹në Shqipëri. Ky studim nuk kërkon të paraqesë teori për vlerat apo për sistemet sesa

²¹Shenim: Ky studim ka për qëllim të përfshijë të tjera grup-vlera nga ato që identifikon Autori Kocani në librin e tij “Hulumtimi i Sistemit të vlerave në Republikën e Shqipërisë në Periudhën Postkomuniste” siç është sqaruar edhe tek pjesa e metodologjisë. Vetë autori Koçani bazohet në studimet vlerore që ka kryer Ronald Inglehart në disa vënde të

të identifikojë apo të grupojë ato “fakte sociale” (Durkheim 2008;76) norma dhe “vlera kulturore” (Durkheim 2008;76) që janë përcjellë brez pas brezi në shoqërinë tonë si elementët përbërës të një “sistemi vleror” (Kocani 2013:6). Si janë konceptuar këto elementë përbërës deri më sot nga autorë të ndryshëm, dhe si dhe të zhvillohen më tej këto elementë. Vetë elementët përbërës të këtij sistemi do të analizohen si fillim si fakte të mirëqena. Elementët përbërës të sistemeve vlerore do të shihet në dy nivele:

1. “Sistemi vleror” i vlerave kombëtare dhe normave sociale politike

2. “Sistemi vleror” i BE-së²², në nivel identiteti si dhe fuqia dhe aspekti normativ Zbërthimi i këtyre koncepteve do të ndihmojë për arritjen e disa konkluzioneve në lidhje me identitetin, veçoritë, trashëgiminë kulturore, aspektin normativ, kulturën politike, dhe orientimin e popullit shqiptar si elementë jo për të treguar në çdo aspekt predispozitën e tij në lidhje me Europën, por për të parë çfarë aktori do jetë apo individualitetin që do të shpalosë në këtë familje të madhe ku Shqipëria synon të aderojë.

Evidentimi dhe zbërthimi i këtyre koncepteve do të ndihmojë në pasqyrimin dhe “ndërtimin e imazhit”(Mor 2007; 661) të Shqipërisë. Imazhi ose “ndërtimi i imazhit” (Ibid; 661) është një tjetër koncept që do të analizohet dhe do të shihen perspektivat e tij në të ardhmen. Si është zhvilluar ky koncept deri më sot, ku ka qëndruar hendeuku në mes tyre, dhe si do të mund të zhvillohet në favor të përafrimit të vendit me BE-në. Cilat janë disa nga politikat e jashtme që duhen

botës, të cilat do t’i shërbejë si “optikë” për të zhvilluar tezën e tij mbi “ecurinë vlerore të shoqërisë shqiptare postkomuniste” (Kocani 2013:14) Ndërkohë që autori Kocani merret me” vlerat shpirtërore “ të “aktorëve socialë”, të cilët kanë “sjellje” dhe “qëndrime” të cilat inspirojnë vlerat e tyre dhe “sistemin vleror ku ato përfshihen” (Kocani 2013;6) ky studim kërkon të merret me vlerat si fakte sociale të shoqërisë sonë të cilat kanë qëndruar mbi një themel kulturor që ka ekzistuar dhe ashtu kanë ardhur brez pas brezi deri në ditët e sotme me një karakter unik dhe një “ekzistencë” të tyre “të pavarur”(Durkheim 2008;76)

²²Në nivel identiteti evropian, një sistem vleror që ka të bëjë me identitetin pëfshin dhe mbartet nga “arti evropian, qytetaria, edukimi i përbashkët nga të gjithë shtetet anëtare” (Patrutiu –Baltes 2013), por “idea e një identiteti të përbashkët u themelua nga projekti politik i Karlomanjos, i njohur si “renovatio imperi”, i cili paraqiste një sintezë të katër vlerave të perceptuara si evropiane”, të cilat ishin “Idealit teutonik (gjermanik) i lirisë, ligji romak, besimi i krishterë, dhe filozofia greke”.(Ibid 2013)

Ndërkohë Bashkimi Evropian (BE), “në bazë të propozimit të Konventës, mbështetet mbi vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Këto vlera, të cilat janë të përcaktuara në nenin I-2, janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare. (The founding principles of the Union; Europa.eu)

Shih: http://europa.eu/scadplus/european_convention/objectives_en.htm#TOP

ndërmarrë për përmirësimin e këtij koncepti në përgjithësi si dhe aplikimin e tij më pas në praktikë. Pas zbërthimit të koncepteve kryesore, ky studim do të merret me konceptet bazë dhe zbërthimin e tyre.

Konceptet bazë të punimit janë vlerat të cilat do të analizohen si të tilla dhe si të mirëqena, si p.sh ‘identitet europian’, ‘identitete europiane’, ‘multi-kulturalizëm’, ‘esencializëm’, “fuqi normative”, ‘gjuha’, “kuadri multi-lingual i BE-së” “feja” “toleranca fetare”, ‘kultura’, ‘zakonet dhe traditat’. Këto do të shihen dhe shtjellohen si krijime sociale të përfaqësuara kolektivisht (Durkheim 2008:99) dhe si elementë që pasqyrojnë identitetin e një kombi. Pra koncepti i identitetit, çfarë nënkuptohet me atë nga autorë të ndryshëm, si është konceptuar identiteti i shqiptarëve, si zbërthehet në vlera dhe cilat janë perspektivat.

Më pas, çfarë kanë konceptuar autorë të ndryshëm në lidhje me “identitet europian” dhe “identitete të ndryshme” që ekzistojnë sot në BE dhe “identitet kombëtar” shqiptar dhe vlera “etno-kulturore” që autorë shqiptarë dhe të huaj i kanë analizuar dhe çfarë do përfaqësojë ky identitet gjatë procesit të integritetit në BE. Cfarë mundësish për zhvillim, adaptim ose shkëmbim ka ky identitet kombëtar shqiptar kur të ballafaqohet me BE-në dhe me vlerat edhe normat që qëndrojnë në themel të BE-së. Për të bërë një lloj ballafaqimi do të shtjellohen edhe elementët kulturorë europian dhe vlerat që qëndrojnë në themel të BE-së.

Ka një ndryshim të madh mes asaj se çfarë mbart kombi shqiptar në një “sistem vleror”, dhe si perceptohet nga të huajt. Për të kuptuar këtë duhet hulumtuar mbi disa nga konceptet bazë të lartpërmendura të cilat janë edhe elementë kryesorë në shprehjen e identitetit kombëtar dhe të promovimit të imazhit. Ky “sistem vleror” mbart vlera pozitive dhe vlera që kanë nevojë për përmirësim, por të gjitha këto do të shqyrtohen duke analizuar këto koncepte bazë. Këto koncepte do të analizohen mbi bazën e asaj çfarë kanë krijuar këto vlera në eksperiencën sociale (Durkheim 2008:99) të shoqërisë dhe të kombit shqiptar dhe çfarë efektesh pritet të krijojnë ose të prodhojnë ndaj ndërveprimit dhe përmirësimit të aspekteve që Shqipëria ka nevojë me BE-në, duke u bazuar në qasjen konstruktiviste dhe në projektin politik “bashkëkohor europian” (Sulstarova 2011, 213)

Cilat janë disa nga politikat e jashtme që do të ndihmonin në promovimin e imazhit tonë kombëtar? Veprimtaritë e ‘diplomacisë publike’ do të trajtohen në këtë rast edhe si koncepte, ne fazën e rekomandimeve. Si mund të evoluojë koncepti i diplomacisë publike në rastin e Shqipërisë. Cilat janë faktet reale deri tani dhe si mund të zhvillohet më tej veprimtaria në favor të përmirësimit të imazhit dhe të konservimit të disa vlerave të veçanta. Koncepti për të shkuarën dhe perspektiva e këtyre vlerave dhe normave për të ardhmen në një realitet plot diversitet dhe kultura të ndryshme. Pavarësisht nëse Shqipëria ka pasur apo jo një

kontribut me shprehjen dhe përfaqësimin në formën e vlerave apo të normave në komunitetin e BE-së apo një sërë faktesh apo praktikash sociale me orientim përfundimor apo jo, diçka që do të dalë dhe do të qartësohet edhe gjatë punimit, do të shihen perspektivat për të ardhmen. Pra këto koncepte bazë do të shihen si koncepte në ndryshim dhe në evolucion si dhe në përshtatje me komunitetin e BE-së, ku Shqipëria synon të bëjë pjesë.

2.4.1 Përpunimi i këtyre koncepteve në përputhje me metodën

dekonstruktiviste

Metoda konstruktiviste në plan të përgjithshëm përfshin në përgjithësi “sistemin vleror” në dy rrafshet që do trajtohen dhe do të analizohen me elementët dhe faktet të cilat do të zgjerohen dhe shtjellohen gjerësisht. Metoda dekonstruktiviste do të shërbejë për të zbërthyer elementët përbërës të ‘sistemit vleror shqiptar’ dhe të BE-së, pra: Vlerat, norma, si fakte sociale për të parë si pikërisht:

1. Kur flitet për përshtatje në kuadër të identitetit me BE-në ajo shfaqet si një proces i vështirë për tu arritur sot në BE, ku sundojnë identitete kombëtare, të individëve të veçantë të grupeve dhe identitetet kolektive. Sistemet vlerore siç do shihet gjatë shtjellimit të studimit kanë komponentë të cilët mund të ndryshohen, përmirësohen dhe përshtaten, por identitetet përmbajnë vlera apo elementë që shprehin “aktivizim të përsëritur” (Melucci 1995; 44) të njerëzve, individëve apo grupeve që i bashkon “një set i dhënë rregullash, praktikash dhe objektivash kulturore” (Melucci 1995; 44). Pra, “identitetet kolektive janë ndërtime kulturore”, Sulstarova 2011; 213), çka i jep kulturës një rol të dorës së parë për “prodhimin e kuptimit në veprim kolektiv” (Melucci 1995; 42)

Në këtë kontekst, që “në shekullin e XX-të, kombet europiane janë bërë shumë të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijësuar për faktin se, një qëndrim kolektiv” (Berting 2007; 71), ndaj të tjerëve apo ndaj pjesës që sot në shekullin e XI-të ndodhet ende jashtë BE-së (për vendet që duan të aderojnë) “nuk qëndron më” ose (nuk mund të mbahet më) (Berting 2006; 71) Pra nuk mund të ketë një qëndrim kolektiv evropian superior si “djepi universalist, humanist, racionalist, individualist” (individualist kur flitet për paraqitimin e Europës që ka për veten) tashmë, ku brenda saj ka mjaft ndarje apo përçarje, kontradita dhe grupime të ndryshme identitetesh. Kur flitet për komponentët e tjerë të sistemit vleror ato do shihen çfarë përmirësimesh apo ndryshimesh mund të pësojnë.

2. Shqipëria ka një identitet të veçantë etniko-kulturor ashtu siç e kanë vendet anëtare të BE-së, por edhe vetë Europa nëse i përmbahet ende qasjes esencialiste

në disa qarqe, ajo shfaqet e vjetëruar për kohën e sotme në të cilën “nuk mund të ketë identitet pa diferencim” (*Ibid*) “Nocioni i identitetit gjithmone i referohet këtyre tre karakteristikave, vazhdimësia e një subjekti mbi dhe përtej variacioneve në kohë dhe adaptimet” (Melucci 1995; 45) e tij me ambjentin ku ndodhet, kufizimet e këtij subjekti në lidhje me të tjerët, aftësia për të njohur dhe për të qenë i njohur” (Melucci 1995; 45) Pra pavarësisht se ruan një strukturë të fortë apo një “krijim autentik e kolektiv” (Sulstarova 2006:79), identiteti adoptohet me ambjentin ku ndodhet cka e ben ate të ndryshueshëm deri në një farë mase, pasi në një komunitet si ai i BE-së kombet japin e marrin me njëri-tjetrin.

3. Gjithashtu duke u ndalur tek autori Sulstarova, ai shprehet se “identiteti duhet parë si dinamik dhe i ndryshueshëm” (Sulstarova 2011; 214) për sa kohë “identitetet dhe interesat sociale janë gjithmonë në proces gjatë ndërveprimit” (Wend 1994; 386) të tyre. Gjatë punimit do të shihet, si mund të ruhet interesi kombëtar në disa aspekte dhe si mund të arrihet dhe shpaloset njohja dhe promovimi i vlerave kombëtare në një realitet supra-nacional me shumë kombe pjesëmarrëse? Çfarë kuptimi ka rendja mbas interesit në atë realitet mbi-kombëtar ku Shqipëria synon të shkojë, nëse interesi rrjedh në mënyrë të ndërsjellë gjatë ndërveprimit të shteteve në komunitetin e BE-së? Si rrjedhojë interesi shqiptar shfaqet natyrshëm kur flitet për bazat që duhen rindërtuar jo vetëm për t’iu bindur Europës, por për të përmbushur interesin në favor të integritetit dhe zhvillimit kombëtar

4. Zbërthimi i vlerave të të dy sistemeve do të kryhet për të dalë tek institucioni dhe komuniteti, pikërisht aty ku Shqipëria synon të shkojë dhe çfarë kërkon BE nga Shqipëria të ndryshojë nga ky ‘sistem vleror’, gjithmonë duke pasur parasysh “modelin civil” (Sulstarova 2011; 214) si një model “përfshirës” (Sulstarova 2011; 214) ku “baza e shoqërisë është kontrata midis anëtarëve të saj” (Sulstarova 2011; 214) dhe bashkëveprimi. Pra modeli përfshirës i BE-së në këtë rast nënkupton një grumbullim kombesh të cilët duhet të prodhojnë “qytetërim ndërkombëtar” ose një unitet kombesh të cilët besojnë dhe zbatojnë normat dhe vlerat që janë themeli i këtij uniteti, duke marrë parasysh që këto kombe janë të karakterizuar nga “kultura” e “gjallë” (Sulstarova 2006; 79) e kombeve që bëjnë pjesë në të.

5. Përpos polemikave për një identitet të paunifikuar në BE nga shtetet anëtare të BE-së, “konstruktivizmi shoqëror” (Sulstarova 2011; 214) në këtë rast “thekson natyrën e larmishme të historisë së Europës dhe ripërcaktimin e vazhdueshëm të atyre që mbahen për vlera evropiane” (*ibid*; 214) Nga kjo pikënisje zbërthimi i vlerave në këtë kuptim nuk bëhet për të parë ‘shpirtin european’ shqiptar, se sa nga synimi për qëllimin e zbërthimit dhe zhvillimin e këtyre vlerave që kanë të

bëjnë me vlerat “organike” (Sulstarova 2006; 79), të cilat autori Sulstarova i quan sipa Herderit “shprehje e shpirtit të çdo populli” (*ibid*) Ideja është se çfarë mund të pëcillet nëpërmjet këtyre vlerave si “krijim autentik e kolektiv” (Sulstarova 2006;79) ose çfarë mesazhesh mund të përcillen nga ato për botën, nëpërmjetdiplomacisë publike dhe të ndërtimit të një imazhi, duke marrë parasysh komponentët e tjerë të sistemit vleror shqiptar shtetëror apo institucional që janë në fazë modernizimi dhe zhvillimi. Duke e parë Europën si një projekt të hapur dhe të vlerave e normave që mbart si themel për antarësimin,do ketë një zbërthim dhe hulumtim të vazhdueshëm të këtyre. Analiza e punimit do mundohet të paraqesë se si këto koncepte, si elementë veprues, marrin dhe japin formë dhe si mund të zhvillohen për interes të ndërtimit të diplomacisë publike në kuadër të përmirësimit të imazhit kombëtar.

Kapitulli III

Përshkrim rreth identitetit europian dhe identitetit kombëtar, si dhe kategoria kulturore për të dy sistemet.

3.1 Qasja esenciale për vlerat Europiane, çfarë kuptohet me identitet Europian sipas kësaj qasjeje.

Për të kuptuar rreth vlerave kulturore europiane dhe vlerave kulturore kombëtare, duhen sqaruar fillimisht dy qasjet që egzistojnë në BE rreth vlerave kulturore europiane. Me zhvillimin dhe evolucionin e BE-së që nga konceptimi i këtij projekti, ka patur si debate ashtu edhe qasje të ndryshme mbi “identitetin europian” “civilizimin europian” , “kulturën evropiane” apo çfarë tiparësh dhe trashëgimie përmbajnë në thelbin e tyre të gjitha këto koncepte në vetvete dhe si duhet të jetë kjo qasje në epokën e globalizmit dhe në kuadrin e multikulturalizmit që egziston sot jo vetëm në BE po edhe në botë. Përpos identitetit që merr BE nga aplikimi dhe interpretimi i fuqisë normative në arenën ndërkombëtare, sido të shikohet gjatë dekonstruktimit të vlerave të fuqisë normative (normat), ka qasje dhe debate të ndryshme mbi “identitetin europian”, ndërkohë që sot flitet shumë për “identitetin kolektiv” apo “identitetet kolektive” që ekzistojnë brenda saj dhe identitetet e tjera që presin apo dëshirojnë të aderojnë në atë komunitet të madh. Kjo çështje ka sjellë pak çoroditje apo ngatërresa, pasi duhet patur parasysh se

brenda BE-së ka identitete të cilat identifikohen me “grupe kombëtare”, “grupe etnike”, “grupe fetare”, “grupe fundamentaliste”, e kështu me radhë.

Koncepti i identiteteve kolektive haset shpesh, sidomos “këto 25 vitet e fundit” (Berting 2006; 27) si koncept që i është mbivendosur koncepteve si: “racë”, “grupe racore” nga “grupe etnike” dhe “etni” (Berting 2006; 27), për të evituar “karakterin e dyshimtë” (Berting 2006; 27) të këtyre të fundit gjatë përdorimit. Duke qenë se identiteti kolektiv “ankorohet në koshiençën e anëtarëve të një grupi” (Berting 2006; 28) dhe një grup i caktuar arrin të bëjë diferencën, por edhe të shohë ngjashmëritë apo të përbashkëtat me një grup tjetër ose grupe të tjera, kjo lloj vetëdije lidhet serish me përkatësinë në “një klasë sociale” “grup religjioz”, “komb” “grup etnik” “grup profesional” (Berting 2006; 28), por duhet patur kujdes “për të mos e zgjatur më tej konceptin” (Berting 2006; 28). Këto dukuri tek identiteti kolektiv si “tjetri”/ “other” dhe “vetja”/ “self” që i referohen shëmbëlltyrave të karakteristikave sociale dhe kulturore, zakoneve dhe aparençës fizike” (Berting 2006; 28) krijojnë ndjesitë dhe vetëdijen se ku bën pjesë sidhe të identifikimit me një grup, por edhe “përfshirjen e atyre që nuk i përkasin” (Berting 2006; 28) atij grupi. Pra kur flitet për ‘identitet europian’, duhet patur parasysh sa i matshëm është ky koncept në qoftë se i referohemi një komuniteti të tërë që jeton atje në nivel kombëtar, por gjithashtu edhe si komunitet në një ‘entitet gjeografik’ gjithëpërfshirës europian.

Gjithashtu elementët identifikues të vetes, duke iu referuar këtu vlerave, normave dhe sjelljes janë të ndryshme nga një grup në tjetrin, nga një komb në tjetrin. Prandaj është e vështirë për të krijuar një panoramë apo pasqyrim gjithëpërfshirës të elementëve që konstruktojnë “një identitet europian” dhe të identiteteve të tjera kolektive që kërkojnë të aderojnë në radhët e BE-s, por shihen si “stereotipe” (Berting 2006; 29) duke u nisur nga “së brendshmi” (Berting 2006; 29). Realiteti ku ndodhet BE sot, ka realitetet e saj kolektive të kombeve përbërese, ku këta kombe kanë në to identitete të tjera që identifikohen si “të tjerët” jo vetëm brenda vetes së tyre, por edhe në një komunitet të madh të BE-së. Në këtë aspekt duket e vështirë për të vënë kufinj apo vija ndarëse ndërmjet karakteristikave apo vlerave të

përbashkëta apo dalluese, përpos atij identiteti normativ dhe standardeve që aplikon BE në kuadrin e projektit politik që qëndron në themel të saj që nga zanafilla e BE-s.

Këto debate shfaqen prej shumë viteshkur studiues të ndryshëm duan t'i referohen më së shumti asaj se, ç' ishte Europa në të shkuarën, ç' është ajo sot dhe ku synon të shkojë Europa kur flitet për integrimin e saj; “Europeanizim” apo “Integrim në BE”, “BE si Europë”, “Perëndimi” apo “BE” si “shprehje institucionale” (Sulstarova 2011;215) e “qytetërimit perëndimor”(Sulstarova 2011; 215) Pra, mënyra se si konceptohet, interpretohet dhe artikullohet BE dhe Europa nga studiues të huaj dhe shqiptar ka sjellur kontradikta dhe mospajtime të shumta në lidhje me “çështjet e identitetit, nëse ka një esencë ose të paktën një terren të përbashkët në Europë dhe se si Bashkimi European lidhet/apo ka të bëjë me atë Europë” (Diez 2004; 320) dhe nëse duhet patjetër që kjo esencë të jetë lokomotiva e integrimit European ndërkohë që BE përbën një bashkësi kombesh. “Europa” sot “nuk është një komb” (Diez 2004; 320) i vetëm “në kuptimin tradicional të termit” (Diez 2004; 320) por një bashkësi kombesh që i japin asaj një “identitet politik” (Ibid; 320).

Përveç këtij konstatimi, nëse popujt, grupet, kombet përbërëse të BE-së janë “konfigurime unike me një shpirt të veçantë” (Berting 2006; 29) atëherë është e vështirë t'i referohesh në këtë këndvështrim një “konfigurimi unik” (Ibid) european në tërësi dhe një “shpirti të veçantë” (Ibid)european , pavarësisht “përzierjes së fakteve, miteve” (Berting 2006;29)e legjendave dhe të përbashkëtave që kanë disa popuj të BE-së në këto referenca. Gjithsesi, për t'i vazhduar më poshtë këto debate, në pjesët në vijim do analizohet qasja esencialiste dhe cilat janë ato vlera apo ajo trashëgimi e përbashkët vlerash të cilat janë quajtur si thelbi i Europës të cilat mund t'i “përkasin vetëm popujve europeanë, edhe pse elementët e tyre mund të përvetësohen prej popujve të tjerë jashtë Europës” (Sulstarova 2011; 213)

Autorja Dr. Loredana Patritiu Baltes identifikon disa vlera “ku mbështetet identiteti european”, dhe siç janë përmendur dhe më lart ata janë: “arti european,

kultura, qytetaria europiane, edukimi i përbashkët për të gjithë anëtarët e BE-së” dhe e zgjeron më tej këtë koncept duke përmendur “projektin e Karlomanjos” të quajtur “Renovatio Imperi” i cili ishte i pari projekt ku hidhte idenë e identitetit europian të mbështetur në këto 4 vlera të tjera në atë kohë “Ideali Teutonik i lirisë, ligji romak, besimi kristian dhe filozofia greke”. Pavarësisht se këto vlera duken si trarët mbajtës të thelbit dhe të një esence të identitetit europian, duhet patur parasysh që kohët kanë evoluar drejt një realiteti multi-kulturor. Kur kërkon për kulturën europiane në shumë raste rezulton se ajo “i ka rrënjët në art, arkitekturë, muzikë, letërsi dhe filozofi që e kanë zanafillën nga rajoni kulturor europian. Kultura europiane është e rrënjësuar në masë të madhe në atë që është përmendur shpesh si “trashëgimi i përbashkët kulturorë e saj”²³. Ku bëjmë edhe ne. Ndërkohë në raste të tjera kur kërkon për vlerat europiane tradicionale rezulton se në BE në konceptin “vlera” futen edhe “familja, puna, shoqëria, politika dhe religjioni”²⁴ por edhe gjuhët e shumta që fliten sot në BE. “Varieteti i gjuhëve europiane”(Stickel 2006) është “vlerë kulturore” (Stickel 2006) për Europën sot.

“Evropa nuk është veçanërisht e pasur me burime minerale. Pasuria e saj e vërtetë qëndron në shumëllojshmërinë e saj kulturore. Dhe kjo qëndron në thelb në varietetin e saj linguistik. Arritjet e tyre shkencore, kulturore, në dije dhe traditat e europianëve janë të ruajtura në gjuhët e tyre.”(Stickel 2006)

Në këtë kontekst do të ishte e pamundur të studioje vlerat e tjera pa u ndalur tek gjuhët dhe vlera e tyre sot për BE-në. Kultura apo tradita kulturore europiane mund të shtjellohet nga këndvështrime të ndryshme, pasi është e vështirë të gjesh elementë të veçantë që mund të përcaktojnë në mënyrë të pajtuar universale esencën, trashëgiminë apo qytetërimin europian, pasi “të pranoje vlera që mund të

²³Shih: Culture of Europe, http://www.revolvy.com/main/index.php?s=Culture%20of%20Europe&item_type=topic , parë më 21 Qershor 2016

²⁴Për më shumë informacion shih: Communicating research and Innovation on Mission in Europe <http://europeanmission.redcliffe.org/vista-communicating-research-and-innovation/the-values-of-europe-family-work-society-politics-and-religion/>, parë më 25 Qershor 2016

konsideroheshin”²⁵ si tipike “karakteristike europiane”²⁶, do të thoshte që çdo tendencë apo mënyrë për të unifikuar vlerat karakteristike europiane do të ishte një mënyrë për të ringjallur teoritë që kanë të bëjnë me “nacionalizmat dhe rajonalizmat, të cilat përcaktojnë identitetet e tyre mbi dhe kundër Europës”²⁷ prandaj në analizën e sistemit vleror europian do të trajtohen vlerat diverse, ajo që është ndryshe brendësinë e një realiteti multi-kulturomë BE.

Më poshtë do të analizohen ato vlera të cilat janë pranuar përgjithësisht nga disa autorë që përbëjnë sot trashëgiminë kulturore të civilizimit europian, por edhe vlera të tjera që janë në kuadër të diversitetit kulturor që ekziston sot në BE.

3.2 Vlerat europiane në periudhat e lulëzimit të themeleve kulturore

europiane.

Arti, arkitektura, muzika, feja, politika, principet filozofike janë dhe përbëjnë edhe disa nga grup-vlerat e kulturës perëndimore të cilat e dallojnë atë nga kulturat dhe civilizimet e tjera²⁸, si ai aziatik apo i orientit, megjithëse “orientalizmi nuk është kurrë aq larg nga ajo çfarë Denis Hoy e quan “ideja e Europës” (Said 1978;) Më shumë ai lind si nevojë të shfaqet si “një koncept kolektiv për të identifikuar “veten” europiane si kundra gjithë “atyre” jo europianëve.” (Said 1978; 8) Gjithsesi ato, që mbahen si vlera të identitetit europian për të ardhur deri në ditët e sotme, kanë kaluar në disa faza të rëndësishme të zhvillimit të qytetërimit europian. Megjithë elementët dhe vlerat e shumta që egzistojnë dhe periudhat e ndryshme vendimtare të historisë së evolimit perëndimor ka periudha dhe “*elemente thelbësore për të cilët është rënë dakord në përgjithësi që formojnë themelin kulturor të Evropës moderne*”. Fazat

²⁵Për më shumë lexo: Communicating research and Innovation on Mission in Europe
<http://europeanmission.redcliffe.org/vista-communicating-research-and-innovation/the-values-of-europe-family-work-society-politics-and-religion/>

²⁶(*ibid*)

²⁷(*ibid*)

²⁸Për më tepër informacion shih: ndarjen në periudha të kulturës dhe vlerave europiane tek Culture of Europe

http://www.revolvy.com/main/index.php?s=Culture%20of%20Europe&item_type=topic

vendimtare dhe “një listë e këtyre elementeve të dhënë nga K. Bochmann përfshin:

- *Një trashëgimi të përbashkët kulturore dhe shpirtërore që rrjedh nga antikiteti greko-romak, Krishtërimi, Rilindja dhe humanizmi i tij, mendimi politik i Rilindjes, dhe Revolucioni Francez, dhe zhvillimet e modernitetit, duke përfshirë të gjitha llojet e socializmit*
- *Një kulturë e pasur dhe dinamike materiale që është shtrirë në kontinentet e tjera, si rezultat i industrializimit dhe kolonializmit gjatë periudhës së "Divergjencës së Madhe";*
- *Një konceptim i veçantë i individit, i shprehur nga vetë ekzistenca e tij dhe respekti për ligjshmërinë, e cila garanton të drejtat e njeriut dhe lirinë e individit;*
- *Një shumicë e shteteve me rende të ndryshme politike, të cilat janë të disiplinuar për të jetuar së bashku në një mënyrë ose në një tjetër; Respektimi i popujve, shteteve dhe kombeve jashtë Evropës.²⁹*

Këto elemente thelbësore të listuara si pjesë e trashëgimisë kulturore europiane tregojnë se ajo ka kaluar në periudha shumë të rëndësishme të zhvillimit dhe evolimit të Europës që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme. Dhe sipas pikave më lart ky qytetërim është shpërndarë në kontinente të tjera perëndimore nga industrializmi dhe kolonializmi. Kjo paketë apo set vlerash në këto periudha përkojnë me “realizimet më pozitive të Europës” (Berting 2006;51) të cilat lidhen me ato çfarë quhen ndryshe “Bota Perëndimore”³⁰ apo “Kanuni Perëndimor/Western Canon”.² John Searle e lidh kanunin perëndimor “me veprat e mëdha” të “një traditë të caktuar perëndimore intelektuale që shkojnë, le të themi nga Sokrates tek Wittgenstein në filozofi, dhe nga Homeri tek James Joyce në

²⁹Shih: Culture of Europe,

http://www.revolvy.com/main/index.php?s=Culture%20of%20Europe&item_type=topic

Ose K. Bochmann (1990) *L'idée d'Europe jusqu'au XX^e siècle* “No two lists of the main constituents of European civilization would ever coincide. But many items have always featured prominently: from the roots of the Christian world in Greece, Rome and Judaism to modern phenomena such as the Enlightenment, modernization, romanticism, nationalism, liberalism, imperialism, totalitarianism.”

³⁰(*ibid*)

letërsi.”(Searle 1990) Pra ky “kanun” fillon dhe përmban një përmbledhje realizimesh nga antikiteti greko-romak deri në kohët moderne. Ashtu siç përmend edhe Dr.Loredana Patrîtiu Baltes dhe çfarë rezulton për vlera nga kërkimet në këtë fushë, në vijim do të analizohen disa nga ato.

3.2.1 Europa nga civilizimi i hershëm deri në kohët e sotme

(Nga legjenda në realitet)

Kur kërkon për kulturën europiane rezultatet tregojnë se “Europa” është vatër e shumë kulturave tani. Periudhat e rëndësishme në të cilat civilizimi dhe kulturat e saj janë zhvilluar si p.sh periudha greko-romake, humanizmi dhe Rilindja e më pas zhvillimet që solli periudha e modernitetit janë përcjellur edhe në vende të tjera të botës, jashtë kufinjve të Europës. Nëse i referohemi konceptit “Europë”, të dhënat të çojnë shumë pas në kohë. Një periudhë që mbahet si shumë “emblematiske për Europën”³¹ është ajo e “Mesjetës së hershme”³². Pikërisht, është në këtë “periudhë në histori që ideja e Europës u shfaq, së pari siç e njohim ne sot.”³³ Një periudhë në të cilën ka lulëzuar civilizimi europian është periudha greko-romake. Megjithatë shumë merita i atribuohen krishtërimit për lulëzimin e këtij civilizimi. Ka autorë si Pannenberg që mendojnë se përvç krishtërimit “*një rëndësi e ngjashme duhet t’i jepet antikitetit klasik, i përbërë nga arti greko-romak, letërsia, filozofia, si dhe ligji romak.* (Pannenberg 1994)

Romakët “ndanin një nivel të lart afërsie me Grekërit e lashtë”(Coffin, Cole, Stacy, Symes; 2011) duke e dalluar atë më pas nga të tjerët, ama “ndikimi i Grekëve në këtë nuk ka mohim” (Ibid; 2011) Grekët dhe Latinët njihen për “shkrimet e tyre historike” (Fornara 1983; 1), të cilat si literaturëpërmbledhin në vetvete “zhanre të ndryshëm”(Fornara 1983;1) të saj. Disa nga këto zhanre janë “gjenealogjia ose mitologjia, etnografia, historia, horigrafia ose historia lokale”

³¹Për më shumë informacion shih: Cradles of European Culture – Francia Media
<http://www.romanika.net/about-the-projects/cradles-of-european-culture-francia-media/>, parë më 2 Qershor 2016

³²Për më tepër informacion shih: <http://www.romanika.net/about-the-projects/cradles-of-european-culture-francia-media/>

³³(*ibid*)

(Ibid;1) Gjenealogjia apo mitologjia e cila merret me “traditat heroike dhe kërkon të sjellë koherencë ndaj të dhënave nganjëherë kontradiktore të mitit, legjendës dhe etiologjisë” (Ibid; 1) ishte forma më e hershme e prozës letrare që u tentua nga grekët”(Ibid;4) si fillim. Kultura Greko-Romane ishte si fillim e besimit politeist, çka bënte që “njerëzit të besonin në një larmi të madhe perëndish dhe perëndeshash, secili subjekt i një grupi të tërë tregimesh dhe ritesh, të adhuruara në nivele të ndryshme.”³⁴ E tillë është dhe “Legjenda për rrëmbimin e Europës” me personazhe të shumtë të tillë”, të cilët duken sikur ndërthuren në një skemë ‘matrix’ për kohën që flitet.

“Legjenda thotë se Europa, një princeshë fenikase, bija e Agnorit, mbretit të Tiros, duke ecur përgjatë bregut të detit vihet re nga Zeusi. I ndezur dhe i magjepsur nga bukuria e saj, Perëndia transformon veten në një dem të bardhë dhe ulet në këmbët e vajzës së re. Princesha e frikësuar në fillim, bëhet më e guximshme, e ledhaton kafshën dhe ulet në shpinën e tij. Menjëherë demi ngrihet dhe nxiton në drejtim të detit. Pavarësisht nga klithmat e Europës-s, e cila mbeti e lidhur tek briri i tij, demi u largua në valët e detit. Ata arritën në Kretë, ku Zeusi rishfaqti pamjen e tij njerëzore dhe u çiftua me Europën. Nga kjo dashuri, lindën tre djem: Minos, Radamantus dhe Sarpedon. Legjenda vazhdon me kërkimin që bëjnë vëllezërit e princeshës. Mbreti Agnor urdhëroi djalin e tij Kadmus/Kadmit për të shkuar në kërkim të motrës së tij, me një kusht, që të mos kthehej në Tiro, pa e gjetur atë. Nëna e Kadmus/Kadmit, Telefasa, dhe dy vëllezërit e tij, Tasos dhe Kiliks, e shoqëruan atë në kërkimin e tij, dhe vetëm Feniksi mbeti në vend me babain e tij, mbretin. Kërkimi i Europës rezultoi i pasuksesshëm, dhe tre vëllezërit dhe e jëma nuk u kthyen kurrë në shtëpi sipas legjendës. Telefasa vdiq nga hidhërimi. Tasos u vendos në ishujt e Trakisë. Kiliks u vendos në Kiliki. Sa për Kadmus/Kadmit ai zbarkoi në Greqi ku pyeti Orakullin e Delfit, i cili e këshilloi atë që ta udhëhiqte një mëshqerrë, me të cilën la tempullin për të gjetur një qytet ku mund të flinte dhe të pushonte nga lodhja. Kadmus shkoi me kafshën deri tek

³⁴(ibid) The Polytheistic World
<http://www.earlychristianhistory.info/grec-ro-rel.html>

vendi i Tebës/Thelbës dhe aty ndërtoi kështjellën Kadmea. Duke shpresuar për të gjetur motrën e tij, Kadmus/Kadmi i ofron Grekëve alfabetin e shpikur nga fenikasit për të marrë informacione rreth Europës ³⁵

Një pjesë të legjendës e ka përmendur edhe autori Tajar Zavalani kur flet mbi Kadmin dhe Hermoninë, ku do të shpjegojë mbi Ilirët dhe prejardhjen e tyre. Ai shprehet kështu:

“Iliri ishte i biri i Kadmit dhe Harmonisë, të cilët u dëbuen prej Thelbës në Greqi dhe shkuen me jetue në viset që morën ma vonë emnin e Ilirit. Nji shpjegim tjetër që transmeton historiani latin Appian thotë se Iliri ishte i biri i qikllopit, Polifem me gruen e tij Gallatea. Nga kjo martesë lindën, përveç Ilirit edhe dy djem të tjerë, të cilët u quejtën Kelt dhe Gallat. Kta të tre emigruen prej Siçiljes dhe u dhanë emnin tre popujve parahistorik, që ishin Ilirët, Keltët dhe Gallatët. Iliri vet pat gjashtë djem të cilët u banë themeluesit e gjashtë fiseve iliriane: domethanë Taulantët, Enkelët, Autariatët, Dasaretët, Dardhanët dhe Parthenët. Farlati, prifti i Venedikut që ka shkruajtë “Illyricum Sacrum”, në shekullin e XVIII, kallzon se mbreti i parë i Iliris ishte Ylli, i cili jetoi në shekullin e VII para Jezu Krishtit. Pasardhësi i tij Kliniku, mbretnoi në luftën e Trojës dhe iu ndihmoi Grekve me 72 anije detare.”(Zavalani 1998; 17)

“Historia e popujve të Europës”(Zavalani; 1998; 17) fillimisht u shkrua nga historianë “grekë dhe latin”(Zavalani; 1998;17) dhe “kallzimet e tyre janë përzie me legjendat e mitologjisë greke” (Zavalani 1998; 17) Kjo legjendë ka rëndësi pasi në vetvete “përmbledh, realitete historike ekonomike dhe kulturore që duhet të korrespondojnë me lëvizjet e qytetërimeve”³⁶, nga vende të cilët e identifikojnë

³⁵Për më shumë lexo: “The legend of the abduction of Europa”, për të cilën ka shumë variante on line. Përkthimi dhe disa shkurtime janë të bëra nga unë. Një version të plotë të legjendës e gjeni tek:

The legend of the abduction of Europa

<http://www.pheniciens.com/persos/europe.php?lang=en>

³⁶(*ibid*): The legend of the abduction of Europe

<http://www.pheniciens.com/persos/europe.php?lang=en>

dhe lidhin elementë apo personazhe të vetes me këtë legjendë të cilat mund të jenë që “nga Lindja e Mesme deri në rajonet Perëndimore, të cilat atëherë janë quajtur “Evropa”³⁷ “Schopflin mbron idenë se njeriu ka nevojë të besojë, se pa besimin në disa simbole të përbashkëta” (Lubonja 1999;3) ku bëjnë pjesë dhe mitet dhe legjendat etj etj, nuk mund të ketë komunitet” (Lubonja 1999;3) “Besimi dhe mbështetja tek miti nuk është ndonjë lloj relikeje pre-moderne, ajo ekziston në mënyrë universale, me të njëjtën strukturë” (Schopflin 1999; 9) si ‘aspekt i rëndësishëm i përvojës kolektive” (Schopflin 1999; 9)

Nga të dhënat e kërkimit për artin europian në përgjithësi kërkimet tregojnë gjithashtu se duke qenë dhe ai një komponent i rëndësishëm në trashëgiminë e civilizimit të Europës, është gjithashtu edhe një pjesë e pandarë e tij. Rrjedhimisht ai do të trajtohet këtu si pjesë e kësaj trashëgimie europiane. Nëse lexon për artin europian që në fillesat e tij, pjesa më e rëndësishme është “Arti Prehistorik” i cili lidhet direkt me “Rock Art” dhe cilësohet si “një nga përpjekjet më të vjetëra të njerëzimit për të zotëruar simboliken e peizazhit, dhe kjo gjendet, për herë të parë në botë, në Evropë.” Ky art ka rëndësi të veçantë pasi mendohet se “qëndron si një shembull i diversitetit të kujtimeve kulturore të territoreve europiane, por edhe dëshmitar i një prirje të përbashkët, një uniteti radikal, në shfaqjen e sjelljes simbolike.”³⁸

Pra, që me këtë qëndrim për rëndësinë e këtij arti vërehet rëndësia që mbart ai për të treguar shprehje të përbashkëta të unitetit europian që në kohët e lashta. Arti klasik i arkitekturës dhe skulpturës ka gjurmë të forta gjithashtu në periudhën e antikitetit , megjithatë “shekulli i ynë i ka tronditur me vendosmëri pretendimet normative të arkitekturës klasike dhe skulpturës”(Pannenberg 1994). Gjithsesi, “Ndikimi klasik ka qenë shumë i varur nga krishtërimi.”(Pannenberg 1994) Në

³⁷(*ibid*)The legend of the abduction of Europe

³⁸Të dhënat e marra për artin Pre Historik të cilat janë të gjitha të vendosura në thonjza janë marrë tek sit-i : EuroPreArt Project. European Prehistoric Signs. Past signs and Present Memories
Për më shumë informacion vizito: <http://www.europreart.net/prese.htm>

pjesën që vijon do të analizohet krishtërimi si besim që ka pasur shumë ndikim në civilizimin Europian dhe si u zhvillua ai.

3.3 Feja/Religjioni

Për të kaluar tek feja, duhet thënë se pas periudhës së “Politeizmit”, “Krishtërimi” nuk e goditi Perandorinë Romake si stuhi.”³⁹ Ai erdhi gradualisht në shekullin e I-rë para erës sonë deri në tolerimin që i bëri Kostandini dhe më pas Teodosi që e lejoi si besim së bashku me besimet politieste; “shpallja e tolerancës për krishterimin nga Kostandini, pa dashje vuri në qendër të vëmendjes këtë besim”⁴⁰ Perandorët nga koha e Teodosit ishin vetëshpallur të krishterë, dhe ata nganjëherë bënë më shumë për Kishën se peshkopët kryesorë dhe teologët, për të rivendosur paqen dhe të siguronin lulëzimin e bashkësisë së krishterë”(Pannenberg 1994) Duke toleruar këtë besim “Të krishterët bëhen më të zëshëm, jo vetëm në mënyrën se si ato lidhen me të gjithë të tjerët, por në mënyrën se si ata lidhen me njëri-tjetrin”⁴¹, pra arrijnë të krijojnë një lloj uniteti dhe kohezioni brenda besimit të tyre të krishterë. Pra, Krishtërimi me kohën triumfoi mbi politeizmin, jo sepse u “ndalua nga Perandoria Romake, por thjesht u venit me kohën”⁴²

Më vonë ishte” dogmatizimi intolerant”(Pannenberg 1994) ai që errësoi dhe solli paqartësi në “Krishtërimin tradicional”(Ibid) si besim. Kjo lloj intolerance dhe dogmatizimi çoi në ndarjen e Krishtërimin nga “fati i popullit hebre pas shkatërrimit të Jeruzalemit dhe të tempullit të dytë nga Titusi”(Ibid) dhe në të tjera ndarje brenda komunitetit. Megjithatë periudhat e errëta si të ndarjeve dhe si të lulëzimit brenda Krishtërimin, mendohet se ai “ka përmirësuar ndjeshëm botën ndër këto XX shekuj në kaq shumë aspekte të ndryshme të kulturës” (Schmidt; 2004;8), duke marrë në konsideratë që “institucionet e sotme dhe vlerat” (Ibid 2004;8) përfundimisht “reflektojnë origjinën kristiane”(Ibid; 2004;8) Kristianizmit

³⁹Për më shumë info shih: Christianity In The Roman Empire, Part 2: Enter The Christians <http://www.earlychristianhistory.info/ent-chr.html>, parë më 3 Qershor 2016

⁴⁰Për më shumë info shih: Christianity In The Roman Empire, Part 2: Enter The Christians

⁴¹(*ibid*)

⁴²(*ibid*)

i atribuohen nga shumë autorë, liritë dhe të drejtat që sot janë vlerat kryesore ku mbështeten shoqëritë zhvilluara të perëndimit. Një ndër librat e kohëve të fundit që flet mbi rëndësinë e Krishtërit dhe influencën e fuqishme që pati ky besim mbi Civizimin Perëndimor, duke prekur dhe dhënë formë çdo fushe të tij, është ai i Alvin Schmidt, Profesor amerikan i Sociologjisë.

Duke lënë mënjanë ambiguitetin dhe fillesat e fesë së krishterë apo anomalitë që ka hasur ai besim në përgjithësi, ky autor ia atribuon figurës së Jezu Krishtit lartësimin dhe rregullimin e “standarteve të vrashda të moralitetit”, “ndalimin e vrasjeve të femijëve”, “avancimin e jetës njerëzore” në shume aspekte, “emancipin e femrave”, “heqjen e skllavërisë” si dhe ndërtimin e “spitaleve shkollave dhe jetimoreve”(Schmidt 2004;8) Gjithashtu ai mendon se Krishtërimi ka merita të veçanta “në mbajtjen e kulturës klasike gjallë” nëpërmjet “rikopjimeve të dorëshkrimeve, ndërtimit të librarive, moderimin e luftave me ditët e armëpushimit dhe sigurimin e arbitrimin të mosmarrëveshjeve” (Schmidt 2004;8) Faktin e mbajtjes së kulturës klasike gjallë dhe në ngritjen e civilizimit e pranon edhe autori Pannenberg kur thotë që: “Në antikitetin e vonë dhe gjatë periudhës mesjetare, letërsia klasike dhe filozofia janë transmetuar nga murgjit dhe shkollat e krishtera.

Është për t’u dyshuar nëse shumë nga kultura klasike do të kishte mbijetuar sikur të mos ishte përvetësuar nga krishtërimi.”(Pannenberg 1994) Një autor tjetër si Thomas Stearns Eliot flet gjithashtu për peshën dhe rolin e Kristianizmit në zhvillimin e kulturës europiane. Ai mendonte se “traditat e përbashkëta kristiane e kanë bërë Europën atë çfarë është sot” dhe “elementët e përbashkët kulturor” janë sjellë “nga ky krishtërim i përbashkët”(T.S Eliot 1939) Ai e zhvillon këtë koncept duke shtuar se “në krishtërim janë zhvilluar artet” (T.S. Eliot 1939) dhe “në krishtërim janë rrënjësuar ligjet e Europës deri në ditët e sotme” (*ibid*)

Ndërkohë për t’u rikthyer tek projekti i Karlomanjos “Ideali Teutonik i lirisë, ligji romak, besimi kristian dhe filozofia greke” do të shtjellohet si përkojnë këto me atë “sistem vlerash” të listuar nga autori K.Bochman dhe çfarë domethënie përmbajnë. Është një emrues i përbashkët që i lidh këta vlera me njëra-tjetrën dhe

ai është krishtërimi.”Ideali Kristian ka sintetizuar të gjithë tashëgiminë e civilizimit europian duke inkorporuar së brendshmi idealin grek të racionalitetit dhe estetikës, idenë hebraike të drejtësisë, idealin e ligjit dhe rendit romak dhe idealinteutonik/gjermanik të lirisë. (Visser; 2011;44) Sipas W.W. Bryden këto “ideale” janë “unifikuar” nga “shpirti hyjnor i dashurisë për perëndinë dhe humanizmin” që ndodhen “në Krishtërim”(Visser;2011;44) Mirpo autori Pannenberg bën një dallim midis kulturës së krishterë dhe formës kishtare të krishtërimit. Ai thotë kështu: “Një kulturë e krishterë nuk është një alternativë e besueshme e formës kishtare të krishtërimit. Edhe nëse ishte ndonjëherë kështu, nuk është më.”(Pannenberg 1994) Krishtërimi si fe, në ditët e sotme është pjesë e kritikave dhe e debateve të ndryshme.

Pannenberg mendon për “rinovimin e unitetit të krishterë” si diçka “absolutisht të detyrueshme jo vetëm për origjinalitetin e kishave për t’ju bindur vullnetit dhe lutjeve të Zotit të tyre, por edhe për besueshmërinë kulturore të fesë së krishterë” (Pannenberg 1994) ⁴³Ai e sheh këtë “unitet si parakusht për lindjen e rolit të krishtërimit në kulturën publike” (*ibid*) Ai përmend dhe një opsion shumë të diskutueshëm për sa i përket “fesë civile” (*Ibid*) dhe flet për kundërshtitë që ka hasur ky koncept duke e vazhduar kështu mendimin: “*disa kanë sugjeruar se feja civile nuk është një fe në të drejtën e vet, por i referohet një formë të përkushtimit publik që rrjedh nga traditat fetare dhe nga ndërveprimi ndërmjet traditave fetare. Unë besoj se sugjerimi është bindës, por pika ime e menjëhershme është se morali i qëndrueshëm social kërkon një bazë fetare.*”(Pannenberg 1994) Një bazë fetare do ishte “një traditë fetare që, si një çështje e të vetë-kuptuarit të saj dhe si kusht për autenticitetin e vet, kërkon idenë e tolerancës” dhe “institucionalizimin” e saj.”(*Ibid* 1994)

Ka variante të ndryshme që parashtrohen, por ai është për kthimin tek rrënjët e krishtërimit duke e menduar atë si bazë fetare të civilizimit perëndimor dhe duke bërë vazhdimisht thirrje për kthimin e Perëndimit tek rrënjët Jezuite dhe Kristiane

⁴³Ky unitet mendon Pannenberg do t’i shërbente “traditave të liturgjisë, organizimit kishtar dhe shprehjes doktrinare sa kohë ato nuk janë në kundërshtim me njëra-tjetrën” (Pannenberg 1994) Në fund të fundit vetë “ky bollëk i takon besimit dhe jetës së krishterë” (*ibid*)

të besimit të krishterë⁴⁴. Megjithëse Pannenberg është një teolog i shekullit të XX, dhe njihet më shumë për “kritikat moderne të krishtërimit”se nga ata për “doktrinën e krishterë vetë”(Sanders 2014), ai ka lënë një sërë veprash me rëndësi për t’u studiuar dhe referuar. Sot ka një tendencë për kulturat laike dhe pretendime të feve apo besimeve të tjera për dominancë dhe besueshmëri. “Laicizmi dhe pluralizmi” (Schmidt; 8) që ekzistojnë sot po “mjegullon shumë nga këto fakte”(Ibid;8) që i atribuohen krishtërimit për të mirat që solli në “kulturat e njerëzimit”(ibid;8) Sot ka ide dhe tendenca nga disa autorë për t’i shfaqur “shqetësimet e njerëzimit” në një mëyrë të re dhe të pavarur nga “mësimet e Jezusit”, pra laike, megjithatë, autori Schmidt rikujton se, edhe ai “moralitet laik do kishte qenë shumë i vështirë për t’u mundësuar pa etikën paraprake të Hebreo-Krishtërimit”

Sot megjithë meritën që i njihet krishtërimit për formimin e kulturave, shoqërive dhe civilizimit perëndimor pranohet nga autorë të ndryshëm që evidentojnë atributet e Krishtërimit në civilizimin perëndimor që kohët e sotme me rritjen e multikulturalizmit po shfaqen ndryshime edhe në spektrin e besimeve duke sjellur një pluralizëm laik dhe fetar në shoqëritë e sotme. Vetë BE ka në gjirin e saj shtete të ndryshme që kanë marrëdhënie të ndryshme me Krishtërimin. “Statistikat janë dëshpëruese në lidhje me pjesëmarrjen në kisha në Europën Perëndimore dhe në Skandinavi”(Metaxas 2014) Ndërkohë në disa vende të veçanta të Europës lindore vihet re lidhja e ngushtë e tyre me Krishtërimin. “Ndërsa Bashkimi Evropian lë tejet jashtë çdo përmendjeje trashëgiminë e krishterë të Europës në hyrje të kushtetutës së saj (Metaxas 2014), kushtetuta e re e Hungarisë "lidh Krishtërimin me kombësinë hungareze.”(Metaxas 2014) Në fakt Hungaria është një vend i krishterë, që ka jetuar shumë vjet në komunizëm, ku feja ka qenë e ndaluar.

Popujt e pjesës lindore të Europës përgjithësisht fenë e kanë pasur të ndaluar dhe ateizmi ka qenë një fenomen i sforcuar. Të ndodhur në kushtet e lirisë së

⁴⁴“Shoqëritë perëndimore këshillohen që të rigjejnë rrënjët e tyre fetare në një traditë kulturore të formësuar nga besimet hebraike dhe të krishtera”(Pannenberg 1994)

shprehjes dhe të veprimit tani i kushtojnë një rol të veçantë fesë. E njëjta gjë ndodh dhe me Kroacinë. “Kroatët kanë rizbuluar identitetin e tyre të krishterë kryesisht falë rolit që luajti Kisha në luftën për të drejtat e kroatëve gjatë regjimit Jugusllav” (Mazurczak 2014) Kur bëhet fjalë për të drejtat e homoseksualëve në vende të Europës lindore si Kroacia dhe Hungaria, ata kanë votuar pro amendimittë Kushtetutës në favor “të përcaktimit të martesës” (Mazurczak 2014) si një bashkim që ndodh vetëm “ndërmjet një burri dhe një gruaje” (Mazurczak 2014).

BE është sot një realitet që falë Krishtërit ka arritur shumë, sidomos në aspektin e të drejtave të njeriut, të cilat janë jetike dhe përbëjnë një aspekt normativ të cilit BE i mëshon duke i dhënë shumë rëndësi, ama duke qenë në një rrjedhë multikulturore dhe një projektim në kuadrin e globalizmit do ketë edhe qasje fetare të ndryshme brenda saj. Përveç qasjeve të ndryshme fetare janë dhe komunitetet e romëve apo të homoseksualëve në kuadrin e vetë-shprehjes dhe lirive individuale apo të drejtave të njeriut që kërkojnë hapësirat e tyre dhe mundësitë për “shprehje publike” (Mazurczak 2014) Respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe mosdiskriminimi lidhen ngushtë me liritë dhe modernizimin e shoqërive që kanë “vlerat e Krishtërit” (Schmidt 2004; 13) dhe “influncën e Krishtërit” (Schmidt 2004; 13) deri në ditët e sotme. Ky konstatim nuk paraqitet për të vendosur një zot apo një fe mbi të drejtat e njeriut (duke konsideruar debatet e ndryshme që kanë lidhje me këtë temë si nga bota e besimeve ashtu edhe nga kritikë të ndryshëm, si p.sh “A i duhet të drejtave të njeriut një perëndi?” (Elshtain 2003).

Më shumë të drejtat e njeriut paraqiten në këtë kontekst për të shprehur “se konsensusi është rritur” (Stackhouse 2003) në lidhje me pranimin se “të drejtat e njeriut janë universale, të paktën në lidhje me çështjet e racës dhe gjinisë” (Stackhouse 2003) por edhe të fesë, si dhe të pranimin nga feja fenomene gjithnjë e më të dukshme shoqërore që kërkojnë tolerancë mbi bazën e këtyre “të ndryshmeve”. Megjithëse “seksizmi dhe racizmi” (Stackhouse 2003) kanë pasur periudha të errëta në lirishprehje “janë dënuar gjerësisht” (Stackhouse 2003) nga

disa vende duke marrë parasysh edhe nivelin e zhvillimit social-ekonomik të vendeve, apo disa vendeve të tjera që nuk kanë pasur kulturë krishtërimi në formimin e tyre, e megjithatë këto janë fenomene që nuk mund të ndalen më dhe as të vihen nën fre.

Duke qenë se lëvizja e lirë e shtetasve të BE-së, mundëson njerëz me nje fe të caktuar të jetojnë në një vend me fe të ndryshme nga ajo e individit apo qytetarit të BE-së, është e pamundur të vendosësh krishtërimin si referencë jetike fetare për këto qytetarë. Në këtë prizëm do të ishte më e drejtë të thuhej që nuk ‘është një përfundim që ka abandonuar gjerësisht rrënjët fetare’ (Mazurczak 2014) sesa një përfundim që po ecën ose do jetë i detyruar të ecë në rrjedhën globale me uljet-ngritjet e veta, me periudhat e skepticizmit dhe të hapjes e të mbylljes që ka ditur të ecë nën mësimet dhe traditat e Krishtërimin si dhe të implementojë gjerësisht modelin e Krishtërimin për liritë dhe të drejtat themelore dhe të vetëshprehjes së individëve.

3.4 Rëndësia e gjuhëve europiane për trashëgiminë kulturore dhe pasurimin e saj.

Një pjesë e madhe e gjuhëve që fliten sot në BE, rrjedhin nga “familja Indo-Europiane” (Violatti 2015) e gjuhëve, një grup-familje gjuhësh nga e cila rrjedhin gjuhët që “fliten gjerësisht sot në Amerikë, në Azinë perëndimore dhe jugore”(Violatti 2015), dhe jo vetëm në Europë. Këto gjuhë që rrjedhin nga familja Indo-Europiane “besohet se rrjedhin nga një gjuhë hipotetike që njihet si Proto-Indo-Europiane, e cila nuk flitet më,”(Violatti 2015) ose nuk është më fare në përdorim ose e njohur në atë nivel që është latinishtja. Gjuhët indo-europiane kanë një rëndësi të madhe për fushën studimore për të dhënë “ngjashmëritë ndërmjet këtyre gjuhëve” (Watkins 1998; 26) si dhe për t’u përpjekur për të vertetuar se “ato janë vazhdimësia e një gjuhe prehistorike të vetme, e folur ndoshta disa shtatë mijra vjet përpara, e quajtur Indo-Europiane ose Proto-Indo-Europiane” (Watkins 1998;26) Autori Jackson J. Spielvogel thotë se “emri Indo-European i referohet njerëzve që përdornin një gjuhë që rridhte nga një gjuhë e vetme nënë” (Spielvogel, 2011;26)

Duhet patur paraysh që emërtimi Indo-European është “*vendosur për arsye gjeografike për familjen e mirë-përcaktuar dhe të madhe gjenetike, që përfshin shumicën e gjuhëve të Europës, të së kaluarës dhe të tashmes dhe që shtrihet në të gjithë Iranin dhe Afganistanin dhe në gjysmën veriore të nënkontinenti indian*”. (Watkins 1998; 25) Familja Indo-Europiane e gjuhëve ka në përbërje të saj disa degë të tjera të cilat janë: “dega Anatole, indo-iraniane, greke, Italiqe, Kelte, gjermanike, armene, Tocharian, Balto-sllave dhe shqiptare”. (Violatti 2015) Këto degë të ndryshme të së njëjtës familje kanë rëndësinë e tyre për studim jo vetëm për historinë linguistike por edhe për studentë dhe studiues të avancuar të fushave të ndryshme që vazhdojnë të bëjnë kërkime se si “kulturat përdorin gjuhët” (Giacalone Ramat and Ramat: 1998; 527), apo se si transmetohen këto kultura apo tradita kulturore nëpërmjet formave të shkruara apo dhe të folura të gjuhës. Thellimi në ta mundëson një panoramë të përgjithshme të karakteristikave kulturore dhe religjioze të këtyre popujve që flisnin gjuhët indo-europiane, p.sh: “*degët e ndryshme të fesë Indo-Evropiane -gjermanike, kelte, Hindu, etj. - të gjitha kishin disa tipare të përbashkëta thelbësore për shkak të trashëgimisë së tyre nga proto-indo-evropianët. Duke ditur se çfarë ishin këto karakteristika kryesore krijohesh mundësia për të kuptuar, në dritën e këtyre modeleve, disa elemente të fesë gjermanike që përndryshe nuk do të kishin kuptim*”, pa thellimin në këto modele”⁴⁵. “Fjalori i gjuhës nënë i quajtur “Proto-Indo-European” është studiuar për rreth 200 vjet, dhe në këto 200 vjet kanë vazhduar mosmarrëveshje të ashpra për pothuajse në çdo aspekt të fushës së Indo-Europeanishtes” (Anthony 2006: 5), kjo për shkak të misterit që kjo fushë përmban akoma, dhe veçanërisht për shkak të “çështjes së atdheut” (Anthony 2006;6) fillestar të kësaj gjuhe nënë.

⁴⁵Për më shumë informacion shih artikullin: Who were the Indo-Europeans and why do they matter? Shkrim i bazuar në referenca si:

Anthony, David W. 2007. The Horse, the Wheel, and Language: How Bronze Age Riders from the Eurasian Steppes Shaped the Modern World.

Mallory, J.P., and D.Q. Adams. 2006. The Oxford Introduction to Proto-Indo-European and the Proto-Indo-European World. p. 408-409.

Mirëpo, sot, fushat dhe metodat kërkimore kanë evoluuar, dhe ekspertët e fushës së Indo-Europianishtes kanë avancuar në kërkime të mëtejshme duke “rikonstruktuar format dhe kuptimet bazike të mijëra fjalëve nga fjalori Proto-Indo- European” (Ibid;6).Pra, ata mund të japin mundësi se si “këto fjalë mund të analizohen për të përshkruar vlerat, shqetësimet, marrëdhëniet familjare, dhe besimet fetare të popujve që flisnin këto gjuhë”(Ibid;6) Nga kjo pikënisje këto popuj kanë pasur karakteristika, vlera dhe praktika të përbashkëta.

Mbas periudhes romantike/romanticizmit ku gjuhët e hershme ishin fushë studimore për të kërkuar rrënjët dhe “eksperiencat autentike” (Ibid:8) kombëtare, “J.G.Herder propozoi teorinë, më vonë të zhvilluar nga Humboldt dhe të përpunuar në shekullin e njëzetë nga Wittgenstein që gjuha krijon kategoritë dhe dallimet/veçantitë nëpërmjet të cilave njerëzit i japin kuptim botës” (Ibid;8) Gjithashtu, në këndvështrimin Herderian dhe Humboldian gjuha shërbente “si një enë për t’i dhënë formë komuniteteve dhe identiteteve kombëtare” (Ibid: 8) Si rrjedhojë, nëpërmjet kategorive që një gjuhë përmban dhe veçantive të saja, ajo modelon komunitetet dhe identitetet kombëtare si dhe anasjelltas këto komunitete dhe identitete i japin larmishmëri dhe kuptim botës. Në këtë prizëm, që nga kohët e lashta “gjuha mëmë e misterhme Proto-Indo-Europiane u konsiderua jo vetëm si gjuhë, por si një kontener ku civilizimi perëndimor ka pasur fillesat e veta të para”(Stickel 2006), që më vonë ka pasur zhvillime dhe shpërndarje të mëtejshme falë emigrimeve dhe evoluimit njerëzor. Gjithë ky civilizim, “varietet linguistik”(Stickel 2006) dhe “arritje kulturore dhe shkencore” (Ibid 2006) do ishin të pamundura të realizoheshin dhe “do të ishin të gjitha të humbura me një gjuhë të vetme, unitare” (Ibid 2006)

“Fillimi i modernitetit evropian në shkencë, ekonomi dhe kulturë u zhvillua paralelisht me emancipimin e gjuhëve vernakulare të italishtes, spanjishtes, frëngjishtes, anglishtes, gjermanishtes dhe kështu me radhë nga gjuha unitare e elitave mesjetare evropiane, latinishtja. Siç e dimë, shumëllojshmëria e gjuhëve kulturore evropiane që u zhvillua në atë kohë nuk e ka dëmtuar, por për më tepër e ka stimuluar aftësinë krijuese të evropianëve.”(Stickel 2006)

Sot në BE fliten shumë gjuhë të ndryshme. Sipas Komisionit European BE ka 24 gjuhë zyrtare.⁴⁶ Siç ka gjuhët zyrtare, “ka edhe më shumë se 60 gjuhë indigjene rajonale dhe të pakicave, si dhe shumë gjuhë jo-indigjene që fliten nga komunitetet e emigrantëve”.(Nardelli 2014) Ndërkohë ka dhe me mijra emigrantë nga vende të ndryshme të botës “që e quajnë Europënshtëpi dhe bashkë me ta kanë sjellur dhe gjuhët e tyre amtare” (*Ibid*) Kombet që janë sot pjesë përbërëse e BE-së dhe këto komunitete, grupe indigjene rajonale, pakica, etni të ndryshme që përmban gjiri i BE-së sot me gjuhen kanë zhvilluar identitetet e tyre dhe një lloj përkatësie.

Identitetet gjithashtu kanë veçoritë, karakteristikat dhe vlerat e veta. Rëndësia e këtyre gjuhëve është se sjellin pluralitet elementësh në një komunitet të caktuar ku ekzistojnë grupe dhe entitete të ndryshme sociale. “Gjuhët janë çelësi për të njohur njerëz të tjerë”(Komisioni European 1995;67) dhe kultura të tjera, elementë të ndryshëm apo elementë të përbashkë. “Zotërimi i gjuhëve” (*Ibid*; 67) që ekzistojnë sot në Europë “ndihmon për të ndërtuar ndjenjën e të qenurit European, me të gjithë pasurinë kulturore dhe diversitetin” (*Ibid*; 67) që ekziston në Europë sot, si edhe ndihmon në “mirëkuptimin ndërmjet qytetarëve të Europës” (*Ibid*; 67), të çfardo lloj identiteti qofshin ato. Gjuhët ndihmojnë në hyrjen në një kulturë tjetër, “dhe vlerësimin reciprok për diversitetin e kulturave që ekzistojnë”⁴⁷, në këtë mënyrë ruhet “kultura europiane”⁴⁸ dhe jepen “kontribute për trashëgiminë kulturore të përbashkët”⁴⁹, por edhe për pasurimin e saj të mëtejshëm nën dritën e prurjeve të reja në familjen europiane.

⁴⁶Marrë nga: Official languages of the EU

http://ec.europa.eu/languages/policy/linguistic-diversity/official-languages-eu_en.htm

⁴⁷Shih: Konventa kulturore europiane është themeluar për bashkëpunim ndërmjet shteteve anëtare dhe deklaroi si qëllim mes shteteve anëtare:

Zhvillimin e mirëkuptimit të ndërsjellë midis popujve të Evropës dhe vlerësimit reciprok të diversitetit të tyre kulturor, për të mbrojtur kulturën europiane, për të nxitur kontributet kombëtare të trashëgimisë kulturore të përbashkët të Evropës duke respektuar të njëjtat vlera themelore dhe për të inkurajuar në veçanti ruajtjen e gjuhëve, historinë dhe qytetërimin e Palëve të Konventës. Details of treaty N.018

<http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/018> , parë më 29 Prill 2016

⁴⁸ (*ibid*)

⁴⁹(*ibid*)

3.5 Qytetaria Europiane dhe identiteti post-kombëtar.

Qytetaria Europiane është një status i vendosur në “Traktatin mbi funksionimin e BE-së”

Ajo thotë kështu: “Çdo person i cili mban shtetësinë e një vendi të BE-së është automatikisht edhe një shtetas/qytetar i BE-së. Shtetësia e BE-së është një plotësues dhe nuk e zëvendëson shtetësinë kombëtare. I takon çdo vendi të BE-së, të shfaqë apo të vendosë kushtet e veta për fitimin apo humbjen e shtetësisë së atij vendi. Shtetësia e Unionit është dhënë direkt në çdo qytetar të BE-së nga Traktati mbi Funksionimin e BE-së”⁵⁰

Çdo qytetar evropian i BE-së ka disa të drejta dhe vlera që i gëzon automatikisht kur gëzon statusin “Qytetar Evropian i BE-së”. Disa nga këto të drejta të listuara dhe tek traktati i mësipërm janë si më poshtë:

- “Mos-diskriminimi mbi bazën e kombësisë, kur zbatohet Traktati
- Lëvizja dhe banimi i lirë brenda BE-së
- E drejta e votës por edhe e të qëndruarit si kandidat në Parlamentin Evropian dhe në zgjedhjet lokale
- Mbrojtja nga autoritetet diplomatike dhe konsullore të ndonjë vendi tjetër të BE-së
- E drejta për t’i dërguar peticion Parlamentit Evropian dhe e drejta për ankimim tek Avokati i Popullit Evropian
- E drejta për të kontaktuar dhe për të marrë një përgjigje nga të gjitha institucionet e BE-së në njërën nga gjuhët zyrtare të BE-së
- E drejta për të aksesuar në kushte të caktuara dokumenta të Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian

⁵⁰Për me shume informacion ne lidheje me qytetarine Europiane/ të BE shiko EU Citizenship - European Commission . <http://ec.europa.eu/justice/citizen/>, parë më 30 Prill 2016

- *Qytetarët e BE-së gjithashtu kanë të drejtë për qasje të barabartë në shërbimin civil të BE-së.*⁵¹

Sipas autorit Berting, gjithashtu edhe Traktatit të Mاستrihtit, 1 Nëntor 1993 ka një objektiv për projektin e qytetarisë: qytetarinë politike (Berting 2006;191).

Me gjithë vlerat e lartpërmendura që të ofron shtetësia Europiane, koncepti mbi qytetarinë europiane ka qenë gjithashtu mjaft i debatueshëm si për qytetarinë në përgjithësi dhe për atributet dhe të drejtat që i jep individit, ashtu edhe për qytetarinëkur është tendenca ta kufizojnë në sensin politik vetëm. Për qytetarinë në përgjithësi debadi shtrohet sidomos përsa i përket përfaqësimit dhe zërit që të ofron ky status në vendimarrjen e gjerë politike të BE-së. “Vendimarrja politike” (Berting 2006; 190) në një shkallë më të gjerë se kombëtare “ duhet të bazohet mbi një shkallë të gjerë miratimi” (Berting 2006;190) apo konsensusi sidomos nga këto “qytetarë”. Kjo lloj e drejte do t’i jepte qytetarit europian një domethënie më të madhe, një zë të rëndësishëm në përfaqësim, si dhe do të plotësonte më tepër konceptin e Qytetarisë Europiane, duke e shndërruar atë në një vlerë të shtuar në Kuadrin e BE-së.

E meta në këtë drejtim në rrafshin praktik është se “qytetari European aktiv nuk është ende prezent në arenën politike europiane” (Berting 2006; 190), duke e lënë projektimin e këtij koncepti akoma në një fazë fillestare. Nëse një koncept i tillë do të ketë përpunim më të gjerë në të ardhmen, kjo do të ketë impakte pozitive mbi vetë projektin europian dhe mbi qytetarët e këtij komuniteti për të pasur një qasje me konstruktive kundrejt projektit europian. Një fenomen i tillë vazhdon të ndodhë ende kështu, pasi ndoshta vendimarrja politike europiane nuk ka arritur ende të vendosë një vijë ndarëse ndërmjet qytetarisë europiane dhe “Europës” (Delanty; 159) si shfaqje e “idesë kulturore” (Delanty 1995; 159), pra të arrijë atë nivel maturie, sa të mos ta konceptojë konceptin e qytetarisë më si shkrirje të “Europës esencialiste”(Delanty 1995; 159) në mendësi edhe në përdorim, si dhe të arrihet të “thyeret edhe lidhja ndërmjet idesë së europës dhe etno-kulturalizmit në

⁵¹ (ibid)

të cilët është mbështetur deri tani” (Delanty 1995; 159), për të shkuar drejt qasjes konstruktiviste në një realitet multikulturor.

Pra me këto argumentime duket sikur qytetari evropian pavarësisht privilegjeve që gëzon, por edhe attributeve të tjera që mund të gëzonte nëse do të liheshin mënjanë disa mendësi të vjetra në politikë-bërje, paragjykime dhe në nivel vendimarrje Europiane, duket sikur është i zënë kurth brenda kornizës së vet kombëtare.

Duke e përpunuar këtë koncept megjithë kompleksitetin që përmban dhe ofron, mund të arrihej ngritja dhe aplikimi i tij në një shkallë më të avancuar sesa shtet-komb. “Mjetet për të zgjidhur probleme të rëndësishme ekonomike, sociale dhe kulturore të cilat prekin qytetarët evropianë direkt dhe të cilat mund të trajtohen në një mënyrë më efektive në një nivel evropian” (Berting 2006;191), kërkojnë një zgjatje në përfaqësim dhe shtrirje të këtyre të drejtave mbi nivelin kombëtar. Kjo kërkon një “ndërgjegjësim në rritje që duhet të shkojë bashkarisht me mundësitë për influencim direkt mbi politikat kryesore të BE-së, të cilat nënkuptojnë një riorganizim të institucioneve dhe një Kushtetutë Europiane të mirëpërcaktuar” (Berting 2006; 191).

Edhe nëse koncepti i qytetarisë analizohet në kontekstin politik, apo të përmbajtes politike që ofron një shtetësi europiane, ai sërish lë jashtë elementë të rëndësishëm. Pavarësisht tendencës që përmban “për të sjellë institucionet e BE-së brenda arritjes së qytetarëve dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimet politike” (Berting 2006; 191) në mënyrë për “ta bërë Europën më demokratike” (Delanty 2006;191), sërish krijohen kufizime duke vënë kufinj politik mbi këtë koncept. Ai “lë jashtë një aspekt esencial, që është dimension i social” (Bridier 1999; 84-87) Juliette Bridier e vazhdon analizën e saj duke theksuar rëndësinë jo vetëm politike të këtij koncepti, por edhe sociale, pasi vetë qytetaria europiane “i referohet mënyrave në të cilat qytetarët evropianë mund të krijojnë marrëdhëniet e tyre reciproke kulturore dhe sociale” (Ibid; 84-87) me njëri-tjetrin.

Marrëdhëniet e hapura sociale, kulturore dhe mirëkuptimi i ndërsjellë në këto marrëdhënie janë baza për mbarëvajtjen e një shoqërie europiane dhe hapjen ndaj

pranimeve të reja. Reciprokeriteti dhe hapja ndaj njëri-tjetrit mund të bëjë që qytetarët të kapërcejnë kornizat kombëtare “si identitet kombëtare” (Ibid 84-87) dhe të krijojnë një “identitet europian” (po aty) jo esencial, etno-kulturor europian, por “pa paragjykime” (Ibid; 84-87) konstruktiv për pranimin e “tjetrit”. Në këtë prizëm qytetarët dalin përtej egoizmit dhe interesit realist, ashtu sikur shtetet që duhet të lejnë mënjane rendjen mbas interesit dhe qëllimeve në nivelin e shtetit-komb.

Qytetari europian gëzon disa vlera nga kjo qytetari, ama qytetaria e tij merr kuptim kur konstruktohet ‘vetja’/ (self) dhe është në një “reflektim të marrëdhënieve me tjetrin” (Berting 2006; 191) Kjo krijon strukturën e duhur për respektimin dhe pranimin e individëve apo qytetarëve të tjerë, respektimin e “lirive dhe dinjitetit” e tyre. Pra sot BE ka arritur në atë pozitë ku nuk mund të diskutohet qytetaria “në marrëdhënien e individit me etnitetin territorial” (Delanty; 160) ose “shtetësia si kombësi” (Delanty 161) apo qytetari/shtetësi europiane për disa të drejta më tepër që gëzon me këtë status, por një qytetari që kapërcen pengesat kombëtare, dhe në stad, ku të drejtat kushtetuese, civile si edhe detyrimet të mund të përcaktohen në një kushtetutë europiane. Rrjedhimisht një “qytetari post-kombëtare” (Ibid;163) do kishte një impakt të rëndësishëm mbi “çështjen e ligjeve të emigracionit” (Ibid; 163) dhe “të drejtën e autonomise kulturore” (Ibid; 161).

Kjo e fundit ka të bëjë me” hapësirën në të cilën minoritetet mund të përcaktojnë veten në vend që identiteti i tyre të përcaktohet nga ndonjë ideologji dominuese” *Antoni Gidens thotë “nuk mund të bëhen hapa mbrapa mbi pluralizmin” (Gidens 2007; 145), kjo do të thotë që shekulli 21-të na ka sjellur në këtë etapë të cilën BE mundet vetëm ta përmirësojë dhe ta menaxhojë, por jo ta përjashtojë si mundësi nëpërmjet burokracivë të avashta, pretksteve socio-ekonomike apo dyshimeve të euro-skeptikëve. Kur permendet “Multikulturalizmi” duhet pasur parasysh, që termi nënkupton “një politikë ose një grup politikash që njohin vlefshmërinë e mënyrave të ndryshme të të jetuarit brenda një komuniteti shoqëror, duke kërkuar të nxitë veprime të frytshme dhe pozitive midis tyre, por brenda një sistemi të vetëm të përgjithshëm të të drejtave dhe detyrave të*

shtetësisë/qytetarisë.”(Gidens 2007;143) Emigrantët do të vazhdojnë të vijnë në Europë, në mënyrë legale dhe jolegale” (Gidens 2007; 145) ashtu “siç ka dhe një fluks emigrimi në dalje”(Gidens 2007;145).

Çështja është tek pranimi dhe jo marginalizimi i tyre dhe hartimi apo aplikimi i politikave sa me të përshtatshme për pranimin dhe integrimin e tyre në shoqëri dhe komunitet. Identiteti post-kombëtar duket një projekt i së ardhmes, dhe i pjekjeve të disa kushteve që kanë të bëjnë me hapjen dhe pranimin ndaj kulturave të tjera, që mund të mundësohet vetëm nëpërmjet “institucionalizimit të pluralizmit.” (Delanty 163) Problemi i deritanishëm me vendet europiane është se nuk kanë qenë apo “nuk janë mjaftueshëm multikulturale”(Gidens 2007;154) dhe “multikulturalizmi duhet riafirmuar, jo braktisur”(Giddens 2007; 154), jo vetëm për realitetin ekzistues të deritanishëm në BE, por edhe për BE-në si projektin e së ardhmes.

3.5.1 BE nën dy trendet kundërshtarë; tendencës për një identitet të unifikuar “universal” apo tendencës për bashkjetesë tolerante ndërmjet identiteteve të ndryshme

Siç e kam shprehur dhe më parë, në një shkrim në kuadër të kërimit shkencor të kësaj teze doktrale, në kohët e sotme, megjithëse ka një ndërgjegjësim të lartë për diversitetin në mes njerëzve dhe sa afër i ka sjellë globalizmi njerëzit apo fenomene nga të gjitha racat, kulturat apo identitetet e ndryshme, shtetet e Europës shfaqin tendenca për të parë të përbashkëtat e tyre duke u nisur nga një qasje e brendshme ose “e parë së brendshmi” (Berting 2006; 68), pavarësisht se kanë tanimë në gjirin e tyre identitete të ndryshme, gjuhët e ndryshme karakterizuese, “mënyrën e jetesës” dhe “shkallën e mirëqenies ekonomike” (*ibid*) të ndryshme nga njëri shtet në tjetrin dhe kanë në brendësi të tyre një “ndjenjë përkatësie” dhe “një njenje vazhdimësie në kohë” që i bën ata të mendojnë individualisht për fatet e vendeve të tyre dhe për mirëqenien dhe sigurinë e tyre.

Këto ndjenja lidhen më së shumti me “mitet” kur flitet për “origjinën e njerëzve” (*ibid*) dhe lidhen më fort me “shfaqjen e shtetit-komb” (*ibid*). Duke iu referuar mentalitetetve të shekullit të IX dhe fillimit të shekullit XX-të, “disa shtete e

kanë prezantuar veten si bartësit e një procesi të civilizimit ndërkombëtar, dhe diçka më vonë si ekzekutuesit e ndryshimeve historike të paevitueshme të cilat çuan në një rend botëror të ri” (Berting 2006;68), pra sërish duke u nisur nga pikpamja e shtetit-komb, shtete të BE-së e shohin veten si pjesë të një procesi linear të perëndimit, për të cilin kanë dhënë kontribut dhe kanë kryer misionet e tyre, sërish si shtete individuale.

Ndërsa, nisur nga pikpamja e brendshme, të tjerët shpesh karakterizohen si “të ndryshëm” nën përdorimin e një “gjuhë stereotipike”. (*ibid*) Kjo krijon një lloj lidhjeje së brendshmi, e cila krijon njëkohësisht edhe ndarje të mëdha kur flitet për krenari kombëtare, kush ka attribute më shumë e më pak në këtë civilizim etj., etj.

Sidoqoftë shtetet apo “kombet janë të karakterizuar nga identiteti i tyre kolektiv” (*ibid*) gjë që shpie në një identitet me bazë “krejtësisht multidimensional”(*ibid*). Kjo lloj baze e dimensioneve të ndryshme dhe të shumëllojshme ka në brendesi edhe “identitete të tjera kolektive” (*Ibid* 69). Prandaj kur flitet për identitet të unifikuar europian, si “djep i univëralizimit dhe humanizmit”, kjo është më shumë një bindje për të treguar veçanti dhe supremaci “ndaj pjesës tjetër të botës” (Berting 2006; 71) dhe tregon që “europianët kanë identitet kolektiv të dobët European” (Berting 2006;71), ndërkohë që “diferencat e brendshme dhe kundërshtitë” të cilat gëlojnë në realitetin Euopian, e bëjnë të pamundur zhvillimin e një identiteti europian universalist.

Kjo ndodh ndoshta për shkak, se shtetet kombe tashmë janë formuar me kohë në mënyrë indipendente, dhe përpos diferencave që i karakterizojnë të cilat u permenden më lart, për më tepër, kanë qenë dhe në kompeticion ndërmjet njëri-tjetrit. Kombe të afirmuara, që tashmë kanë krijuar imazhin e tyre, vazhdojnë të ndërtojnë dhe të zhvillojnë interesin e tyre kombëtar, pavarësisht se në çfarë bashkësie bëjnë pjesë, siç ndodh edhe në rastin e Bashkimit Europian. Esenca që i lidhte këto shtete me njëri-tjetrin, nga nyja universaliste e pati një zë për t’u shprehur si e tillë deri në BE-në e vitit 1973, kur u zhvillua dhe Samiti i Kopenhagenit. Pastaj, me samitet e tjera dhe me valet e tjera të zgjerimit, u hesht

disi me identitetin European, duke kaluar në kritere politike, ekonomike, si dhe në aftësinë për të përmbushur detyrimet e BE-së.

Kriteret vendosishin sipas specifikave të vendeve me të cilat hapeshin negociatat për aderimin në Union. Por me gjithë kriteret e tjera që vendoseshin në samitet pasaardhëse, kriteri esencial i civilizimit dhe i kulturës europiane ishin indikator të fuqishëm për të ardhmen europiane të atij vendi që aspirojnë BE-në. Pra kjo tregon se në parim, sipas qasjes esencialiste, çështje të tilla si trashëgimia e vlerave europiane kanë bërë bashkë një grup shtetesh për të krijuar Bashkimin European. Me realitetin e sotëm absolutisht është e rëndësishme të kesh një identitet kombëtar dhe një kulturë unifikuese brenda kombit apo shtetit, sepse kjo e bën të suksesshëm një shtet, por në nivel pan-European dhe në kohën e globalizmit rendja më shumë ngase duhet drejt kësaj dhe promovimi i tepërt i disa vlerave specifike të identitetit esencial European, ka çuar në ngadalësim të procesit drejt BE-së. Me një fjalë, vizioni i Karlo Magnjos për vlerat e bashkimit në BE dhe koncepte të këndvështrimeve të vjetra si liberale, neoliberale, nacionaliste etj, që kanë vazhduar deri në shek 20, tashmë janë bërë penguese për një Europë të shekullit të XXI-të. Shtetet duke u tkurrur në interesin kombëtar vetjak, kanë krijuar një hendek në vendimarrje, në ndarje përgjegjësisë dhe vihet re një mungesë solidariteti për të kapërcyer sfida të përbashkëta. Për fat të keq, kjo krizë për mungesën e një identiteti të unifikuar european jo sipas qasjes universaliste, por sipas një qasjeje të hapur dhe pa paragjykime duke njohur meritokracinë e çdo identiteti kombëtar, shoqërohet edhe nga një krizë e vazhdueshme ekonomike, çka shpie në ndarje të mëtejshme në mes vendeve të unionit.

Duket sikur unioni është ndarë në blloqe. Sot përveçse shtohen diversitetet dhe fenomenet e multikulturalizmit, edhe vetë mjedisi global është gjithmonë në ndryshim. Në këtë kontekst nevojitet një BE si fuqi ndërkombëtare dhe si aktor i fortë global, e aftë për të marrë përgjegjësi por edhe për t'u përballur me një mjedis të ri plot pasiguri. Prandaj BE nevojitet të zgjidhë çështjet e identitetit mbi bazat e multikulturalizmit për t'u unifikuar, për t'u shprehur në një zë në arenën globale, për t'u fuqizuar brenda saj, dhe për të zgjuar dhe aftësuar fuqinë e saj

perthithëse edhe për vendet që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj. Janë pikërisht çështjet e përkatësisë dhe të përbashkëtave që fillimisht krijuan lokomotivën e BE-së, por në ditët e sotme, me ritmet që ecën bota drejt unifikimit e globalizmit, identitetet dhe kulturat duhet të zhvillohen e të lulëzojnë në tolerancë dhe diversitet me njëra-tjetrën. Ky do të ishte sistemi që dota çonte përpara Europën, ashtu siç ka çuar përpara dhe SHBA-në.

Bashkimi European kërkon të njihet si aktor i rëndësishëm për politikën e jashtme dhe të sigurisë jo vetëm në rajon, por edhe në arenën globale. Pë këtë aspekt i nevojitet një përputhshmëri e politikave me diskursin dhe veprimet. Deri tani ka qenë e vështirë për të formuluar një qasje të përbashkët të shteteve anëtare për një identitet universal european, për arsye që u trajtuan në pjesët më lart. Pë sa kohë shtetet anëtare do të tkurren nën strehat e tyre, edhe “përpyjekja për të ushqyer apo imponuar disa kultura unifikuese” (Cederman 2001; 38) duken pa vend, ose nuk do të gjejnë terren. BE është komunitet multilingual, dhe gjuhët e ndryshme përcjellin veçanti kulturore dhe kanë kontribuar në pasurimin e kulturave në Europë⁵², ndërkohë “kreativiteti kulturor prodhon diferenca kulturore” (Cederman 2008; 38) Si rezultat i diferencave kulturore që prodhohen, do të ishte shumë e vështirë të projektohej një komunitet diferencash me qasje universale përkundrejt një identiteti të vetëm dhe me një “unitet kulturor” (Cederman 2001;38).

Gjithashtu, edhe traktatet që janë krijuar kanë lënë jashtë aspekte të rëndësishme për sa i përket domethënies të “identitetit europian”, si p.sh “përcaktim të qartë ligjor”(Cederman 2001;2) të popujve apo të vendeve që duhet të përfshihen në BE, duke marrë parasysh “bollëkun e identiteteve konkurrenente”(Cederman 2001;20 që ekzistojnë aty. Megjithëse mbas Traktatit të Amsterdimit në 1997 u hesht me kriterin e identitetit duke i mëshuar kriterëve politike, sërisht është e vështirë për “të përcaktuar se për kë popuj qëndron “Europeanizimi” (Cederman 2001;2) “Duke iu kthyer “Traktatit të Romës”, ku” artikulli 237 specifikon që çdo shtet european është i pranueshëm për antarësim në KE” (Cederman 2001; 2) duket

⁵²Çështja e pluralitetit të gjuhëve është sqaruar më hollësisht në këtë kapitull në pjesën që flet për rëndësinë që kanë gjuhët europiane, për trashëgiminë kulturore europiane dhe pasurimin e saj deri në ditët e sotme

sikur BE ka mbetur ende peng në këtë realitet të shkuar, megjithë ngatërrimin dhe konfuzionin që vjen nga mospërcaktimi i qartë i termit, duke e rrëzuar si koncept. Identiteti European ka në brendësi të vet, siç është cekur dhe më lart, larmishmëri të madhe “identitetesh kombëtare rajonale, religjioze, etnike”(Berting 2006;71) apo “variacione lokale” (Cederman 2001;36) të cilat e bëjnë idenë e një identiteti esencial apo universal european tepër të brishtë apo të paqëndrueshëm krahasimisht me këto identitete të ndryshme e të shumëllojshme brenda BE-së, të cilët kanë konsumuar shumë histori për të ardhur tek realiteti i shtetit-komb të sotëm.

Globalizimi sjell nevojën e kapërcimit të disa kornizave dhe krenarive të shtetit kombëtar, me gjithatë disa vende të BE-së nisen nga niveli shtetëror përta i përket çështjeve të interesit kombëtar dhe të identitetit, dhe kjo duket akoma qartë në disa nga diskursat e tyre politike me euro-skeptikët apo ekstremistët e djathtë. Kriza në nivel të këtij lloji ka cuar në fraksione si ekonomike, ashtu edhe politike brenda BE-së, kjo tregon se BE po pëson përçarje ose disintegrimit dhe janë disa fakte që e demostrojnë këtë si p.sh:

1. Rasti i Greqisë: Diskutimet e shumta rreth faktit çfarë do të bëhej me Greqinë kur populli grek me referendum vendosi *jo* ndaj masave shtrërguese. Më shumë se sa një krizë ekonomike, ajo u duk një krizë në menaxhmentin European dhe kjo tregon, se sa e domosdoshme do të ishte një qeverisje institucionale-federale për Europën.

2. Rasti i Ballkanit: Lenia e Ballkanit në periferi të vëmendjes për shkak të tranzicioneve të brendshme të këtij rajoni, por edhe për shkak të aftësive përthithëse të vetë BE-së, tregon një tjetër sfidë për projektin e hapur European ku tregohen qartë aftësitë e dobëta përthithëse për vende të reja aspirante. Me moton presim vende me demokraci të konsoliduar dhe të fuqishme ekonomikisht, pasi nuk duam andrralla brenda në shtëpi, BE më shumë se sa një projekt i hapur po shkon drejt mbylljes me disa vende elite brenda saj, pasi nëse Greqia rrezikonte daljen, vende të tjera po nga jugu i Europës, do të rrezikonin

gjithashtu.⁵³ “Ngjarja e refugjatëve tregon sesa janë të rëndësishme vendet e Ballkanit Perëndimor për BE-në. Këtu nuk bëhet fjalë për zgjerim, por këtu ka një boshllëk dhe plagë në zemër të Europës, sepse Ballkani Perëndimor nuk është në kufi të Europës, por është i rrethuar nga vende që janë në BE. (D’Alema 2016) BE arriti të zgjerojë kufinjtë dhe të anëtarësojë vendet në periferi të saj, duke lënë një boshllëk mu në zemër të saj dhe akoma jashtë me vonesa të mëtejshme, me politikat e kushtëzimit dhe afatet e papërcaktuara për anëtarësim për vendet e Ballkanit Perëndimor.

3. Rasti i Turqisë: Turqia vazhdon të jetë pre e paragjytimeve për anëtarësimin e saj në BE. Turqia vazhdon të përceptohet nga Blloku i BE-së si një vend shumë i madh, madje deri edhe aty, sa perceptohet si “mysliman”. Ndoshta shumë i madh për aftësitë përthithëse të BE-së. Megjithëse anëtare e forte e NATO-s, Turqia mbetet jashtë BE-së për shumë arsye ose pre e perceptimeve nga brenda BE-së, që janë kultura, traditat, historia, edhe religjioni që duken të ndryshme nga Europa e krishterë në parim. Edhe pse kriza e fundit e emigrantëve duket sikur afroi dy palët në një marrëveshje për liberalizimin e vizave në Turqi, sërish BE paraqet kushtet dhe kriteret që Turqia duhet të plotësojë. “Turqia ka ende edhe 10 pika për të zbatuar nga 72 kriteret e vendosura nga BE për të përfituar liberalizimin e vizave. Marrëveshja më pas duhet të ratifikohet nga Parlamenti Europian dhe shtetet anëtare. Skurse BE duket se po shkon drejt vendimit për liberalizimin e vizave të Turqisë nën rrethanat e krizës që përjetoi nga fluksi i emigrantëve, Turqia duket sikur do ta komplikojë më tej situatën duke paralajmëruar se nuk do t’i përmbahet marrëveshjes për të mbajtur nën kontroll fluksin e emigrantëve nga Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore nëse nuk arrihet marrëveshja për vizat.⁵⁴ Kjo situatë tregon për një BE me dy qëndrime, për sa i përket çështjes së Turqisë. Pra i gjithë diskursi politik i deritanishëm rreth antarësimit të Turqisë në BE, (kuptohet me zëra pro dhe kundër nga BE) duke marrë parasysh, procesin që pas Luftës së

⁵³ Citime nga një artikull i shkruar nga vetë unë, në një punim me titull “European issues in the era of globalisation”, i përgatitur në kuadër të tezës së doktoraturës dhe studimeve doktorale.

⁵⁴ Migrant crisis: EU 'to back' visa-free travel for Turkey, nga <http://kathmandupost.ekantipur.com/http://bit.ly/1VI09H9>, parë më 3 Maj 2016

Ftohtë, duhet të fillonte rivitalizimin tani, pikërisht nën dritën e një krize të cilën diti ta shfrytëzojë më së miri pala Turke.

4. Rasti i largimit të Britanisë nga BE apo “Brexit” siç quhet ndryshe, tregon për një krizë në nivel besimi dhe solidariteti brenda BE-së dhe një tendencë të disa grupeve apo masave në nivel kombëtar, të cilët duke i thënë “po” largimit të Britanisë, shfaqën edhe një herë tendencën për të rendur drejt mentaliteteve të vjetra me karakter nacionalist që krijojnë mure dhe ndarje të mëtejshme. Europa përballët sot nga sfida të mëdha ekonomike dhe sigurie për shkat të ngjarjeve si në Lindjen e Mesme, përplasjeve atje dhe valëve të emigracionit, çka e gjeti të papërgatitur në nivel solidariteti dhe unifikimi për formulimin e politikave dhe qëndrimeve të përbashkëta për t’u përgjigjur ndaj këtyre sfidave. Kjo e vështirëson situatën jo vetëm brenda BE-së, por edhe për popujt që aspirojnë të bëhen pjesë e saj.

Të gjitha këto raste janë indikator për një krizë në nivel identiteti, kulture, vlerash dhe solidariteti brenda BE-së. “Iluzioni i kujt mendon që po të kthehemi në përmasat kombëtare siç ishim më parë, është iluzion pa asnjë bazë e themel, sepse sot vendet e veçanta europiane, përfshi Gjermaninë, përballë kolosëve si SHBA e Kina, nuk do të kishin asnjë peshë e rëndësi” (D’Alema 2016) nëse brenda Europës nuk ndodh ai unifikim dhe kohezion brenda shteteve anëtare. Gjithashtu, këto sfida tregojnë që BE ka nevojë të maturohet në shumë çështje, si dhe të zgjojë aftësitë e saja përthithëse dhe këto aftësi përthithëse realizohen “duke e përforcuar Europën dhe jo duke e dobësuar atë” (D’Alema 2016) Nëse Greqia do të dilte nuk do të ishte e qartë në ç’skenar të mundshëm mund të përfundonte BE? Edhe Brexit ishte një tronditje për themelet e BE-së.

Si mund të transformohet projekti i BE-së në vazhdim nëse nuk ka solidaritet, pranim, multikulturalizëm, dhe vendimarrje të unifikuar; kthim në një Evropë të ndarë në shtete-kombe, zhvillimi i një kështjelle apo fortëse statike Europiane apo zhvillimi i një Europe me të të gjerë në marrëdhënie pozitive me vendet e lindjes, duke përfshirë edhe Rusinë. (shih Miall 1993; Miall 1994b). Pra një Europë me kombe-shtete të mëdha themeluese, dhe shtete të tjera europiane të

vogla, satelitë të këtyre shteteve, apo zona influence të kohës kur Europa funksiononte me blloqe? Apo një Europë pa Britaninë e madhe dhe shtete të tjera të fuqishme që mund të ndjekin shembullin e saj për mungesë solidariteti dhe shprehje tipike të egoizmit kombëtar? Një Europë e luftës, apo një Europë e paqes, model për vendet e rajonet e tjera të botës!? Europa sa më shumë do t'i afrohet qasjes konstruktiviste dhe inkluzive apo pranuese kundrejt diversitetit, aq më shumë do të mund të bëhet një faktor determinant në politiken botërore dhe aq më shpejt mund t'i afrohej edhe Rusia si një aktor konstruktiv, jo me qasje dominante dhe hegjemonie.

Politik-bërësit Europeanë nuk janë përpjekur deri tani të krijojnë një identitet me solidaritet, barazi dhe drejtësi, të cilat do të vlenin si vlerat themelore. Gjithashtu nuk ekziston ndonjë kërcënim madhor që mund të inkurajonte unifikimin e njerëzve të ndryshëm në këtë rajon“ (Svitych 2013) Rasti i Turqisë në fakt dëshmon që, nën dritën e kërcënimit dhe rrezikimit të sigurisë nga kriza e refugjatëve, Turqia dhe BE u ulën dhe shqyrtuan një marrëveshje me njëri-tjetrin. Ndërkohë motoja europiane “të bashkuar në diversitet” dhe aspirimet për një identitet të përbashkët europian, pra supranacional, gjithashtu edhe pritshmëritë që Europa të marrë një rol aktiv global në të ardhmen, mund të realizohen duke marrë parasysh që identitetet janë gjithnjë në bashkëveprim dhe në marrëdhënie konstruktive. Dinamikat që zhvillohen brenda BE-së sot thërrasin për një mision apo projekt politik të përbashkët duke lënë mënjanë çështjet ideologjike, paragjykimet që kanë të bëjnë me interesat e ngushta kombëtare, sovranitetin kombëtar, prosperitetin individual kombëtar që disa shtete anëtare të BE-së janë ende shume të dhënë pas tyre.

Një iniciativë politike e përbashkët kërkon shtrirjen e këtyre identiteteve nga nivele kombëtare në nivele shkëmbyese, kontribuese, përtej gjuhës, traditave apo kulturës kombëtare, duke i pranuar veçantitë kulturore dhe shprehjet e “identiteteve të tjerëve” si shprehje lirie dhe të drejtave themelore, norma që rrjedhin direkt nga fuqia normative e BE-së. Kjo mbi të gjitha kërkon vullnet të madh politik të përbashkët për konstruktimin, apo formimin e ideve, apo planeve

të përbashkëta mbi realitetet kombëtare tashmë të formuara apo të dhëna. Një BE e suksesshme në plan afatgjatë në epokën e globalizmit përvecse duhet të kapërcejë krizat dhe sfidat që kanë në thelb mungesën e identitetit, solidaritetit, reciprocitetit, duhet të jetë e përgatitur edhe për multikulturalizmin, diversitetin e kulturave të ndryshme që ndeshen sot gjithnjë e më shumë, si mundësi për dialog dhe si mundësi pasurimi të ndërsjellë ndërmjet kulturave. Këto qasje janë larg realitetit në të cilin ndodhet BE sot, pasi “Europa e sotme është ajo që po predominohet më shumë nga përjashtimet se sa nga pranimet the Europë (Delanty, 2002), dhe këto janë çështje të cilat kërkojnë një qasje të hapur dhe kapacitet për të ofruar zgjidhje për ndarjet politike dhe shoqërore në atë mënyrë që të arrihet të mbahet uniteti nën diversitetet etnike dhe kombëtare.” *Europa sot kërkon një sens qellimi dhe kuptimi. Në europianët jemi trashëgimtarët e një civilizimi thellësisht të rrënjësuar në fe dhe në vlera qytetare. Civilizimi ynë në ditët e sotme po pasurohet më shumë nga hapja drejt kulturave të tjera. Ajo çfarë na duhet tani është një perspektive humaniste. Përditë dhe në mënyrë sistematike, sistemi ynë ekonomik dhe social duhet të njohin përparësinë e dinjitetit njerëzor. Ai duhet të sigurojë që të gjithë qytetarët tanë të kenë qasje të mirfilltë kundrejt lirisë, komunikimit ndër-personal, kulturës dhe jetës shpirtërore.* (Prodi 2000)

Sot bota ecën në trendet konstruktiviste, si rrjedhojë, kështu që është e pamundur të kthehesh mbrapa në ideologji të vjetëruara, apo të mbash peng një proces siç është ai i BE-së, pikërisht për këto argument, (siç e kam theksuar edhe në artikullin tim “European identity issues in the era of globalisation). Për të evituar konkluzionet, pasi BE vazhdon të jetë një projekt herë në proces e sipër dhe herë nën tkurrje, dhe ndërkohë shfaq dhe prodhon dinamika, sfida, dhe ngjarje, duhet të shihet se si do të reagojë ndaj ndërvartësisë në të ardhmen. Michael Rochard pohonte në vitin 2001, se “ajo çfarë ne po ndërtojmë ka në fytyrën e saj preçedentë të panjohur” më parë, prandaj “le t’i referohemi Europës” duke e parë dhe “duke pritur deri sa të krijohet, para se ta përcaktojmë atë” (Cederman 2001;2) Kanë kaluar dy dekadae më shumë nga kjo kohë kur autori Rochard shprehej kështu, dhe sot ende pritet për Europën që të krijohet, që projekti të

avancojë duke marrë në konsideratë trendet globale që veprojnë në mënyrë të natyrshme dhe të pavarur.

3.5.2 Përfundime për rastin e identitetve të ndryshme në BE, për të shkuar

tek rasti i identiteti shqiptar.

Ky kapitull kishte si qëllim të parashtronte identitetin europian sipas qasjeve që ekzistojnë në BE. Që nga qasja esencialiste, që tashmë po tkurret gjithnjë e më shumë nga trendet globale deri tek qasja e konstruktivizmit, që mbështet multikulturalizmin dhe vlerat multi-kulturore që mbështeten nga kjo qasje dhe se si shtetet mund të kontribojnë për pasurimin e këtyre kulturave për sa kohë janë në marrëdhënie kulturore shkëmbimi dhe ndërveprimi. Jo pa qëllim, u analizuan në këtë kapitull feja në Europë, gjuhët e shumta që kanë kontribuar në përcjelljen dhe pasurimin e kulturave apo traditave kulturore të ndryshme që ekzistojnë në BE, për të dalë tek identitetet kombëtare, si një pluralitet identitetesh dhe kulturash që bashketojnë sot në BE. Pra, u dekonstruktuan nëpërmjet një analize të të kuptuarit disa vlera të qenësishme për identitetet e BE-së, si gjuhët dhe shumëllojshmëria e tyre që fliten sot në BE, feja/religjioni, rëndësia e trashëgimisë shpirtërore dhe vlerore që mbart krishtërimi si fe në Europë, megjithë ndryshimet dhe kritikën që po merr sot nën dritën ekstremizmave dhe shfaqjeve të tendencave që mund të jenë të papranueshme për “Kishën” si institucion.

Gjithashtu s`mund të lihej pa përmendur qytetaria/shtetësia europiane, si një vlerë e shtuar për qytetarët e vendeve anëtare të ndryshme të BE-së, por si një koncept që kërkon një përpunim të përsosur për t'i dhënë gjithnjë e më shumë të drejta politike, sociale dhe kulturore këtij koncepti, përtej nivelit kombëtar. Në fund të kapitullit analizohet gjerësisht qasja multikulturore dhe pluralizmi që ka pllakosur realitetin në BE. Kjo analizë bëhet me qëllim për të treguar që edhe kombe si Shqipëria me veçantitë dhe specifikat që kanë në profilin e tyre vleror (të cilat do të analizohen në kapitullin që shtjellon identitetin shqiptar) mund të bëhen pjesë e kësaj familjeje pa qenë të detyruara të demostrojnë

domosdoshmërisht apo të provojnë identitetin e tyre europian, sidomos kur bëhet fjalë për vlerat kulturore që zbërthehen nga ky identitet.

Pluralizmi ka hasur patjetër pengesat e veta dhe vështirësitë në një hapësirë si BE, çështje të cilat tashmë u shtjelluan më sipër, por nga analiza e të dhënave të nxjerra nga autorë si Giddens, Delanty, Berting e të tjerë të cilët janë cituar po ashtu, rrjedh që pluralizmi dhe multikulturalizmi nuk mund të anashkalohen më, dhe nëse anashkalohet ky fenomen apo shfaqen aksione apo prirje të kundërta kundrejt këtij të fundit, kjo mund të të çojë edhe në kriza që nuk janë në favor të bashkimit, vazhdimësisë, rëndësisë apo përshtatmërisë që nevojitet të ketë BE në kohët e sotme. Në këtë prizëm Shqipëria nevojitet të evidentojë dhe të promovojë vlerat etno-kulturore në kushtet e një atmosfere të lirisë për vetë-shprehjet, të kontributit të këtyre vlerave në një komunitet me përmbajtje të gjerë multi-kulturore dhe për njohje më të gjerë e për një imazh më të mirë jashtë vendit.

3.6 Identiteti kombëtar shqiptar.

Kapitulli paraardhës u mundua të pasqyrojë realitetin e BE-së përsa i përket qasjeve të ndryshme që ekzistojnë brenda atij realiteti, asaj esencialiste dhe konstruktiviste-multikulturaliste, si dhe vlerave kulturore që zbërthehen nga ai realitet i pasuruar nga shumë kultura dhe identitete kombëtare. Sikurse kapitulli më lart u mundua të dekonstruktojë esencën e identiteti europian, si fillim, dhe si ka evoluar situata sot në një Europë të bashkuar, ku ndodhen shumë identitete dhe priten të aderojnë të tjera, pikërisht në këtë kuadër zhvillohet dhe analiza dekonstruktuese, duke shkuar drejt analizimit të rolit të fesë, gjuhëve dhe qytetarisë europiane. Duke qenë se analiza kërkon të nxjerrë në pah dy realitetet kombëtare edhe atë të BE-së për të parë ose ballafaquar fushat e bashkë-veprimit dhe konstruktimit të ndërsjellë, gjithashtu ky kapitull do të pasqyrojë dhe ndërkohë do të zbërdhejë identitetin kombëtar dhe vlerat apo tiparet thelbësorë të këtij identiteti.

Dekonstruktimi i vlerave jep mundësi për të parë si është ndërtuar identiteti kombëtar, dhe anasjelltas si zbërthehet ky identitet në vlera, sipas interpretimeve të autorëve të ndryshëm. Para se të bëhet një zbërthim i vlerave të identitetit apo përpara se të shikohet se si ky identitet zbërthehet në vlera të caktuara është e rëndësishme të jepen disa përkufizime rreth terminologjisë “identitet kombëtar” dhe tërësisë të elementëve apo veçorive që ky koncept përmban. Sipas Fjalorit të Oxford-it identiteti kombëtar është “Një ndjenjë e një kombi si tërësi kohezive, e përfaqësuar nga tradita të dallueshme, kultura dhe gjuha,”⁵⁵ të përcjella brez pas bresi si tipare origjinale ose karakteristike të një kombi të caktuar. Kjo tërësi karakteristikash dhe vlerash janë të trupëzuara në grupe sociale apo pupuj të ndryshëm, të cilët identifikohen nga besimi dhe venia në praktikë e këtyre vlerave apo karakteristikash të cilat i lidhin me një identitet kombëtar të caktuar. Vihet re që autorë të ndryshëm grupojnë pak a shumë elementë të njëjtë në tërësinë dalluese të tipareve apo karakteristikave si p.sh: *“gjeografia, popullsia, historia, ekonomia, politika, kultura materiale dhe shpirtërore, vlerat dhe kontributet e dhëna në dobi të paqes e stabilitetit,”* (Bashkurti 2004; 36) Këto cilësi të brendshme shihen edhe si të përbashkëta dhe afeksioni që ndan popullsia e një kombi të cilët manifestohen në përditshmëri, dhe janë transmetuar nga gjeneratat e kaluara dhe vazhdojnë të ritransmetohen.

Në disa “pika të përbashkëta” (László 2013) të identitetit kombëtar, autori László János përfshin: “Simbolet kombëtare, gjuhën, ngjyrat, historinë kombëtare, lidhjet e gjakut, kulturën, muzikën, gatimin (tradicional), radion dhe televizionin” (László 2013) etj. Duke qenë se një popull apo një kategori sociale identifikohet nëpërmjet identitetit kombëtar dhe ai identitet përmban disa nga vlerat e lartpërmenduar përbashkuese, në këtë mënyrë bëhet edhe kategorizimi i atyre që bëjnë pjesë në këtë grup dhe i atyre që janë jashtë. Identitetet kombëtare janë produkt i kolektivitetit, pasi karakteristikat e identiteteve kolektive janë të aplikueshme për kombet” (Berting 2006; 68) Siç ekziston një identitet kolektiv

⁵⁵Përkufizimi i konceptit “identitet kombëtar” nga Fjalori Oxfordit, online., http://www.oxforddictionaries.com/us/definition/american_english/national-identity, parë më 9.5.2016

kombëtar, bashkëlidhur me atë ekziston edhe “memoria kolektive” (Berting 2006; 68) për sa i përket “të shkuarës së kombit” (*Ibid*;68) e cila “përkujtohet nga festat zyrtare, takimet solemne, statujat e themeluesve të shtetit apo kombit dhe persona të tjerë që luajnë një rol kyç në mitet kombëtare” (*ibid*).

Duke qenë se grupe sociale apo kombëtare janë shumë të lidhura me këto karakteristika të përbashkëta, krijohet ndjenja e përkatësisë për një grup që mund të dallohet me një grup social tjetër apo me një komb tjetër. Ndjenja e përkatësisë, identifikimi me një identitet të caktuar kombëtar rezulton të jetë shprehje shumë e fortë dhe e qëndrueshme sot në realitetet kombëtare. Kjo e bën më të qartë panoramën me identitetet e shumta që ekzistojnë në BE dhe sa shprehje të fortë dhe të qëndrueshme kanë këto identitete nëpërmjet karakteristikave apo vlerave të tyre. Individët dhe “origjina e vendit të tyre, aty ku janë lindur dhe rritur, jep mbi këta një ndjenjë të fuqishme përkatësie” (McCrone & Beschhofer 2015; 6) Madje shumë prej njerëzve “nuk kanë arritur plotësisht ta vlerësojnë se sa shumë domethënie kishte identiteti i tyre kombëtar për ta, deri kur kanë shkuar për të jetuar në një vend tjetër” (*ibid*6-7) Pra lëvizjet e njerëzve, emigrimi (sidomos kur bëhet fjalë për realitetin e BE-së) vetëm i përforcojnë ndjenjat dhe identitetin kombëtar. Duke e parë sërish nga “perspektiva e brendshme” (Berting 2006; 69), shtetet karakterizohen nga identiteti kolektiv, por kjo s’e pengon një identitet kombëtar të jetë edhe “multi-dimensional” (Berting 2006; 69), çka do të thotë se në përbërje mund të ketë edhe “lloje të tjera identitetesh kolektive”(Berting 2006;69) të cilat edhe mund të mos identifikohen me atë identitet kombëtar.

Pra, një popull i caktuar nuk ka detyrime për të shprehur apo mbrojtur të njëjtin identitet kombëtar. Këto janë fenomene të cilat e bëjnë më të ndërlikuar dhe komplekse sot situatën në BE. Gjithashtu, “identiteti kombëtar nuk është një cilësi e lindur” (Anderson 1991; 133) e individit apo e nje popullate të caktuar siç është AND-ja apo përbërja gjenetike e njeriut, por një “akt thelbësisht i ndërtuar shoqërisht.” (Anderson 1991; 133) Duke qenë një akt i ndërtuar shoqërisht, pavarësisht ndjenjës së fortë të përkatësisë që krijon dhe të qëndrueshmërisë, kjo lë hapësirë për konstruktiv shoqëror-social. Pra, shoqëria ndërmjet

bashkëveprimit dhe ndërtimit shoqëror socializohet. “Nëpërmjet socializimit, një sistem besimesh, vlerash, supozimesh dhe pritshmëri transmetohet tek anëtarët e grupit”(Anthony 1991; 8-15) ose individët të cilët e përfshijnë identitetin kombëtar brenda atij individual falë bashkëveprimit në aktin e socializimit.

Ky kapitull nuk ka për synim të shtjellojë të gjitha vlerat apo karakteristikat e identitetit kombëtar, një pjesë e madhe e të cilave u dha në përkufizimet më sipër, por si fillim të zbërthejë identitetin kombëtar shqiptar me ato vlera të cilat mendohet se janë karakteristike për shqiptarët si: Gjuha, jo në kuadrin e një ‘miti’ apo një cilësi superiore, por “si vlerë autoktone dhe autentike e identitetit të shqiptarëve” (Bashkurti 2004; 113) në familjen e madhe të gjuhëve indoeuropiane, bashkëjetesa fetare “si një vlerë e spikatur e identitetit të shqiptarëve” (Bashkurti 2004; 118) dhe traditat kulturore si trashëgimi e etnosit shqiptar “që shtriu linjat e ndikimit në një masë të caktuar deri në ditët tona” (Dervishi 2013; 33) dhe “si një njësi nënkulturore me profile të dallueshme qartë në shumëçka” (Dervishi 2013; 33) Ajo, çfarë është domethënëse dhe lë vend për interpretim, është procesi mbi të cilin njerëzit apo një grup social i caktuar apo populli ndërtojnë identitetin e tyre, dhe mënyra se “si njerëzit bëjnë identitetin e tyre është një proces kompleks” (McCrone & Beschhofer 2015; 4) pra një proces i përbërë dhe jo lehtësisht i përcaktuar. Në këtë aspekt, periudhat historike që ka kaluar populli shqiptar, mund ta dëshmojnë më së mirë këtë proces, por kjo pjesë do të analizohet gjatë zbërthimit të vlerave liberale. Por edhe Europa ka evoluar mjaft nga qasja esencialiste apo ‘Europa e vjetër’. Ajo sot është një komunitet apo bashkësi e cila mbledh në gjirin e saj identitete kombëtare, të cilat përfaqësohen me identitetet përkatëse të cilat shprehen dhe përfaqësohen kulturalisht, të përbëra nga trashëgimia kulturore-historike, “gjuha e banorëve, trashëgimia historike, kultura popullore, mentaliteti shoqëror, mënyra e jetesës, e drejta e pashkruar” (Frashëri 2006) Duke marrë shkas nga të dhënat e autorëve të lartpërmendur rreth vlerave të cilat shprehin identitetin kombëtar, më poshtë do të trajtohen ato vlera të cilat kanë shenjuar karakterin apo profilin kulturor kombëtar shqiptar, për ta zbërthyer këtë identitet kulturor dhe vlerat përbërëse në kuadrin e rrugëtimit që po bën si një “pjesë” që kërkon t’i bashkohet “së tërës” ashtu sikurse kombet

ekzistuese e kanë krijuar atë raport si pjesë përbërëse dhe kontribuese për atë larmishmëri identitetesh.

3.7 Gjuha si vlerë dhe shprehëse e identitetit kombëtar shqiptar

Gjuha është faktori themelor për zhvillimin e formimin e personalitetit, vetëdijes dhe identitetit kulturor e social me të cilin identifikohet. Ajo “është simboli dhe thelbi më i pazëvendësueshëm i kombit” (Zeqo 1995; 106) e cila shpreh dhe sjell fakte nga e kaluara, si dhe “paraqitet si një e ardhme strategjike” (Zeqo 1995; 106) për kombin. Gjuha si mjet komunikimi është “një fenomen i lidhur me mendimin” (Topalli 2013) dhe “një mendim i qartë kërkon një shprehje gjuhësore të qartë.” (Topalli 2013) Kjo nënkupton sa e rëndësishme është gjuha si bartëse dhe shprehëse e mendimit në të gjitha format e tij. Sa më e pasur është gjuha, aq më i saktë dhe i përpunuar shprehet mendimi. Gjuha përveçse është një mjet komunikimi pa të cilin njerëzit dhe popujt nuk mund të kuptohen, “ajo është ngulitur në praktikë sociale” (Rorty; 1976)⁵⁶ prandaj ka dhe fuqinë të përcjellë elementë origjinalë që pasqyrojnë esencën e një kombi nëpërmjet kësaj praktike, dhe krijojnë urat e përcjelljes së këtyre praktikave në popuj të ndryshëm. “Gjuhët natyrore janë produkte të një zhvillimi të gjatë historik (Lafe 2007;11) dhe si një produkt i një zhvillimi të gjatë historik ajo transmetohet brez pas brezi, duke dëshmuar për popullin që e ka folur, për prejardhjen, veçantinë, lashtësinë dhe pasurinë që mbart në vetvete. “Gjuha si komunikim”(Ngugi 1986;16) dhe “si kulturë”(Ngugi 1986;16) janë “produkte të njëra- tjetrës”(Ngugi 1986;16).

Kultura transmetohet, përçohet, shkëmbehet nëpërmjet të folurit, komunikimit, sepse “gjuha mbart kulturën” (Ngugi 1986;16) në vetvete. Nëpërmjet gjuhës krijohet ndërgjegjësimi për veten, pra njihet vetja dhe pjestarët e komunitetit në të cilin bën pjesë. Gjuha jo vetëm shpreh e mbart kulturën, por edhe identitetin e një komunitetit apo kombi të caktuar. Ajo është në këtë mënyrë “e pandashme nga vetja jonë” (Ngugi 1986;16) kur përfaqësojmë “një komunitet të krijesave

⁵⁶Rorty, 1967, cituar tek Postrukturalizmi, David Cambell, fq 271, në Teori të Marrëdhënieve nderkombëtare, UET Press 2010

humane me një formë e karakter specifik, histori specifike dhe marrëdhënie specifike me botën” (Ngugi 1986; 16)

Ajo shërben për promovimin dhe shprehjen e identitetit kulturor kombëtar duke qenë se është e ngulitur në “praktikë sociale” dhe si e tillë ka rol vendimtar gjatë komunikimit ndër-kulturor në kuadrin e shkëmbimeve të identiteteve sociale e multikulturore, pasi me anë të saj mbarten dhe komunikohen traditat kulturore, eksperiencat jetësore, zakonet, vlerat, karakteri kombëtar, mitet, legjendat, individualiteti, si dhe mentaliteti i një kombi. Duke i qëndruar besnike identitetit, ajo shërben për përforcimin e ndjenjës kombëtare, për mbajtjen e shpirtit kombëtar gjallë nga lashtësia deri në ditët e sotme dhe integrimin e mëtejshëm dhe përcjelljen e elementëve kulturor në shoqëri të tjera. Më poshtë do të analizohet gjuha shqipe dhe rëndësia që ka pasur ajo për të përcjellë shpirtin shqiptar, traditat, zakonet, kulturën deri në ditët e sotme që nga lashtësia. Gjithashtu do të pasqyrohet rëndësia që i kanë kushtuar studiues të huaj gjuhës shqiptare, për të zbuluar të vërteta universale përse i përket fushës së linguistikës, historisë dhe shkencës.

3.7.1 Veçantia dhe lashtësia e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe ka ardhur në ditët tona si vijimësi e periudhave të hershme, pavarësisht ndryshimeve apo evolucionin që ka pësuar gjatë kohës. Ajo ka qenë tipari bashkues i shqiptarëve në kohë e rrethana të ndryshme dhe pasqyruese e identitetit të tyre, përveç kësaj ka shërbyes si çelës për zbulimin e gjuhëve të tjera dhe prejardhjen e tyre. *Qiro Truhellkae* identifikoi gjuhën kur shpjegoi lashtësinë e shqiptarëve kështu: “Por prej ilirëve një komb i madh ka durue që tre mijë vjet edhe njer më sot e run gjuhën edhe zakonet e të parëve, prinve të vet” (Karajgdiu 1993; 132-133) dhe “gjuha ilirishte e shqype i ngjajnë shumë njana-tjetres” (Karajgdiu 1993;133). Ai e demonstron këtë fakt me disa emra të vjetër të fiseve ilire, rrënja e të cilëve ekziston në fjalë shqipe. “Ilir, Illyricus, Iliros që d.m.th *I lirë*; Dalmati, Dalmatae, d.m.th djall, djem, djelma; Ardiaei, d.m.th ardhje”(Karajgdiu 1993;133) ose emra qytetesh si “Shkodra, d.m.th. qytet në

kodër; Budva, Butua, d.m.th. i butë; Ulcinum, d.m.th uk-ulk, ulkonjë” (Karajgdiu 1993; 132) etj.

Qiro Truehelka lidh ilirishten me shqipen nëpërmjet rrënjëve të fjalëve, ndërsa emrin e gjuhës “shqipe”, pra gjuha që flet shqiptari mendohet që kjo fjalë “të ketë qenë “qartë, kuptueshëm.” (Omari 2007; 139) Kjo mendohet të përkojë ose të ketë “mbijetuar deri më sot në gjuhën e komunikimit të përditshëm në shprehjet “a ha shqip” “a merr vesh, a kupton”, apo shprehja: shqip po ta them “po ta them qartë, kuptueshëm” (Omari 2007; 139) Edhe emri Shqiptar mendohet se lidhet me “ndajfoljen shqip” (Omari 2007; 139), pra ai që flet gjuhën shqip. Ndërsa Johann Georg von Hahn në veprën e tij “studime Shqiptare”⁵⁷ “emrin shqiptar” (Omari 2007; 139) ai e “nxjerr nga folja shqipoj, shqipëtoj” (*Ibid*), “pjesorja shqipëtuarë” (*Ibid*) që do të thotë “nga ana kuptimore, foljen shqipoj, ai e jep me vështirësi e atëhershëm “kuptoj” që sot ka humbur” (Omari 2007; 139) Autorja Omari, e vazhdon analizën e saj duke shpjeguar që tezën e Hahn-it e mbështeti edhe Gustav Meyer, i cili etimologjikisht e gjen tek “excipio “kuptoj, dëgjoj” (Omari 2007; 140) Një përkufizim tjetër për prejardhjen e emrit shqiptar është ai, që e lidh atë me emrin e shpendit shqipe si emër totemi (M.Lambertz), qysh prej kohës së Skënderbeut. (*Ibid*,140) Këtë tezë si fillim e pranoi dhe E. Çabej me rezerva, dhe më vonë e kritikoi sipas autores, duke qenë se shqip shkruhet me i, dhe emri i shpendit me y ama “në autorë veriorë të mëvonshëm ndeshet dhe trajta y për gjuhën, emrin e banorit dhe vendin; shqyp, shqyptar dhe Shqypni” (*Ibid*).

Interesimi për gjuhën shqiptare nga shkenca europiane filloi relativisht vonë në krahasim me kombet e tjera. Pavarësisht se ata kishin qenë pjesë e qenësishme e dy perandorive, asaj romake e më pas bizantine, më vonë edhe nën perandorinë otomane “Shqipëria kishte mbetur një vend pak i njohur nga Evropa” (Çabej 1990; 7), deri në periudhën e iluminizmit. Një meritë të veçantë “në studimet albanologjike” (*Ibid*: 11) pati historiografia gjermane, duke qenë se ata synonin në shekullin e XVIII që u krijua kjo shkollë të krijonin “një shtet të vetin e të

⁵⁷J.G. von Hahn, Albaneische Studien I, Jena, 1854, f. 229, I cituar tek Omari. A. 2007; 139 Rreth burimit të emrit Shqiptar, Gjuha jonë, Reviste periodike shkencore, shtypur nga Kristalina-Kh,

pacënuar kombëtar” (Çabej 1990; 11) ose “një atdhe” (*Ibid*) siç shkruante J.G. Herderi. Herderi në librin e tij “Ideen zur Geschichte der Menschheit “Ide për historinë e njerëzimit” kur flet për popujt e Europës lindore, ata që u shkrinë, për përzierjet dhe ata që mbijetuan thotë se shqiptarët “nuk janë aspak të huaj, por një popull i lashtë i familjes evropiane” Interesimi mbi gjuhën shqipe filloi “qysh me G.V Lajbnicin dhe J. Tunmanin” (*Ibid*; 13) në një kohë “ kur ende nuk kishte lindur gjuhësia krahasuese” (*Ibid*; 13) e cila shpjegonte “gjuhët e së njëjtës familje” (*Ibid*; 13) nëpërmjet krahasimit të karakteristikave si ”struktura gramatikore, sistemi fonetik, dhe leksiku i gjuhëve” (*Ibid*; 13).

Tunman në veprën e tij “Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore”, 1774, i bënte përshtypje panorama e popujve që shfaqej në Europën Lindore, si një fushë e pagjurmuar dhe e paeksploruar ende si duhej, dhe interesi i tij ishte tek populli shqiptar dhe ai vllëh. Ai i përcakton shqiptarët si “populli i parë që njih historia në këtë vend” (Çabej; 1990; 54), i njih për “ilir, një popull i madh, i shumtë në numër dhe i fuqishëm” (*Ibid*; 54) Gjithashtu thotë se “Vendi që sot quhet Shqipëri ka qenë i banuar nga fise ilire të ndryshme që bënë pjesë që të gjithë në popullin ilir” (Çabej 1990; 55) Pak më vonë në “vitin 1850” (*Ibid*), “me vertetimin e karakterit indoevropian të shqipes nga August Shlajheri dhe të gjuhëve si të keltishtës nga Franc Bopi më 1838, të armenishtes nga Hajnrih Hybshman (1877)” (*Ibid*) “të hitishtes, të tokarishtes e të licianishtes, u krijua tabloja e sotme e gjuhësore evropiane” (Çabej 1990; 14).

Lajbnici arriti të kryej një studim “rreth prejardhjes së gjuhës shqipe”, pasi kishte si qëllim sipas autorit Çabej “për të krijuar një histori universale të botës”, ku gjuhët përbënin elementë thelbësorë për të kuptuar këtë histori. Autori Çabej , vazhdon shpjegimin duke thënë se “Lajbnici ishte i pari që arriti deri në një teori “ilire” të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar” (Çabej 1995; 17) Më vonë Johan Tunman ishte “i pari që u shpreh qartë se huazimet sllave të shqipes lidhen kryesisht me pushtimet bullgare e serbe të trojeve shqiptare gjatë mesjetës” (*Ibid*; 19) me këto studime filloi edhe interesimi i Europës për studime më të tjera, flitet

për kohën e Pashallëqeve nën Perandorinë Osmane siç e shpjegon autori Çabej, kur “Shqipëria po studiohej së brendshmi” (Çabej 1990; 22)

Lashtësinë e Shqiptarëve Hahn-i e sheh tek rrënjët neo-pellazgjike “pasi shqiptarët janë neo-pellazgët, edhe gjuha e tyre është vijimësi e pellazgjishtes” që “i bëri ballë edhe sllavishtes që mori epërsinë në Ilirinë veriore” (Petrota 2008; 40) Ai “nxjerr nga studimi krahasues i zakoneve të tyre të sotme me zakonet e grekëve e të romakëve të lashtë dhe nga studimi i karakterit të shqiptarëve” (*Ibid*; 27) pra me studimet dhe konkluzionet e tij ai “po bënte objekt të historiografisë edhe ilirët” (*Ibid*; 28) krahas grekërve dhe romakëve. Ka shumë autorë që tek gjuha shqipe shohin elementë pellazgjikë, përveç Hahnit, si p.sh: “Imzot Zef Krispi në Përkujtesë mbi gjuhën shqipe të tij thotë se “ gjuha shqipe lidhet me gjuhën frigase dhe me atë pellazge dhe për rrjedhojë edhe me maqedonishten” (Petrota 2008; 40) ndërsa “Vinçenco Dorsa e cilëson si “mbetje e asaj të pellazgëve”(Petrota 2008; 40).

Një tjetër autor si “ D. Pjetër Matranga, prift i ritit grek nga Piana dei Greçi, helenist dhe arkeolog i shquar, shkruar i gjuhës greke në Biblotekën e Vatikanit arrin në përfundimin se “Në gjuhën e re epirote apo shqipe, mbijeton pellazgjishtja e lashtë” (Petrota 2008; 40) Nga një gjuhë neo-pellazgjishte apo me referencë në pellazgjishte, “Barbarih, duke iu referuar saktësisht Majerit, thotë se “Gjuha e sotme shqipe përfaqëson evolucionin e ilirishes së lashtë” (Petrota 2008; 41) dhe “mund të cilësohet si neo-ilire” (Petrota 2008; 41) Studimet që filluan mbi gjuhën shqipe hapën rrugë për studim në fusha të tjera. Studimet dhe interesimi u shpërnda mbi “historinë, e kulturën materiale shpirtërore” (Çabej 1990;33) të shqiptarëve. Franc Bopi “rikonfirmoi përkatësinë indo-europiane të shqipes” (*Ibid*;33) Megjithëse kishte tendenca për ta përafruar ose për të gjetur përkatësinë e gjuhës shqipe në popujt dhe fiset e tjera që ekzistonin në Ballkan e në Europë. Studiuesit sa më shumë e studionin gjuhën tonë, aq më shumë dilnin në përfundimin se ajo nuk mund të varej në asnjë gjuhë tjetër për shkak të tipareve të saj të dallueshme “fonetike, morfologjikedhe leksikore të saj” (Petrota 2008;42)

Çfarë është për t'u vënë re në periudhën e interesimit të shkollës gjermane, është ajo që pas kësaj periudhe, filloi të ngjallte kureshtje edhe historia edhe kultura shqiptare nga mesi i viteve 1800 dhe fillimi i viteve 1900. Teodor Memseni “arriti në përfundimin mbi lidhjet e mesapishtes me ilirishten dhe me shqipen” (Çabej 1990; 34) Pra me tezën se “Shqipja ishte një gjuhë bijë e ilirishtes”, shqipja shihej dhe si çelësi “për zbërthimin e shkrimeve mesape” (*Ibid*; 37). Kur J.F. Falmerajer nxori veprën “Elementi shqiptar në Greqi”, 1857 ai thoshte për shqiptarët se “Albanezët, arbanitët, ose shqiptarët nuk janë një popull me kulturë” (Çabej 1990; 120) në kuptimin që “nuk kanë literaturë kombëtare” (*Ibid*;120) por aimerte parasysh dhe theksonte “Fushën shpirtërore gjatë njëmijëvjeçarit të ekzistencës së vetëdijshme” (*Ibid* 121) të përcjellë nga gjuha dhe fuqia aktive e këtij populli, karakteri luftarak, dhe puna artizanale e tij. Peter Robert Franke, gjithashtu pranon mungesën e fakteve të shkruara për gjuhën ilire duke thënë se “dëshmi mbishkrimore për këtë gjuhë deri sot nuk janë gjetur”, (Çabej 1990; 183) por “kanë mbetur emra njerëzish, vendesh, lumenjsh e malesh”(*Ibid*) dhe “vetëm këto provojnë se ilirishtja bën pjesë në familjen gjuhësore indoevropiane” (Çabej 1990; 183).

Pavarësisht vështirësive në dokumentacion, pra “mungesa e dokumentave gjuhësorë” (Petrota 2008; 43) dhe në analizën që duhet t'i behën “elementëve gjuhësorë të huaj” (Petrota 2008; 43), një pjesë e madhe e studiuesëve që u interesuan nga Europa arritën në përfundime të njëjta “se Shqiptarët janë pasardhës të banorëve të lashtë të Evropës” (Çabej 1990; 124) Pra studimet në fushën albanologjike kanë dëshmuar autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre, prejardhjen indo-evropiane të gjuhës shqipe, karakterin e veçantë etno-kulturor dhe qëndresën deri në ditët e sotme. Këto arritje të kërkimeve shkencore në atë kohë sollën ndërgjegjësim në gjirin e intelektualëve dhe atyre që u morrën me çështjen shqiptare për ta përdorur sa herë kërcënohej identiteti, kombi dhe territoret e tyre nën pushtimet, zgjedhat dhe copëtimet që vijuan në Shqipëri. Sot, “gjuha shqipe (shqip) flitet nga mbi gjashtë milion njerëz në Ballkanin jug-perëndimor, kryesisht nga Republika e Shqipërisë dhe vendet fqinje që dikur ishin pjesë e federatës jugosllave (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbia)” (Elsie)

Duke qenë se është gjuhë, pjesë përbërëse e grupit të familjeve indeo-europiane kjo e bën që të jetë e “lidhur në një shkallë të caktuar me pothuajse me të gjitha gjuhët e tjera të Europës” (Elsie)⁵⁸ Ajo çka e ka lënë gjuhën shqipe pak në hije vjen edhe nga një mungesë përkthimi në gjuhë të huaj të veprave shqipe, duke e krahasuar këto me veprat e popujve të Ballkanit. Për popujt e Ballkanit, ato me origjinë sllave ‘kanë përfituar nga interesi nga adhuruesit dhe ekspertët në studimet sllave’, përse i “përket letërsisë moderne greke, është trajtuar së paku në baza marginale nga akademikët dhe specialistët “Classics”” (Elsie) të veprave klasike dhe “studimeve bizantine” (*Ibid*) dhe përse i përket “letërsisë rumune është përkthyer nga studiues dhe admirues të gjuhëve dhe kulturave të romancës” (Elsie) Shqipëria s’ka pasur interes të tillë, edhe si grup i veçantë nga këto që u përmendën por edhe për shkak të izolimit të gjatë. Duke pasur parasysh aspiratën e Shqipërisë për t’u bërë anëtare e BE-së, veprat letrare mund të bëhen objekt studimi për të huajt, nëse fillon një kontribut në këtë fushë jo vetëm nga të huajt, por edhe nga vetë shqiptarët.

3.8 Bashkëjetesa fetare dhe vlera e saj në shoqërinë Shqiptare.

Feja në shoqëri ka luajtur gjithmonë një rol të mirëfilltë për rregullimin e raporteve shoqërore dhe qëllimi i saj “është të ruajë dhe të përforcojë nevojat e shoqërisë” (Bergson 2002; 10) Kjo dallohet nga shoqëria në shoqëri dhe “ndryshon sipas vendit dhe kohës” (Bergson 2002; 10) Kur flet për besimin fetar në Shqipëri nuk mund të flasësh për një besim të vetëm, dhe nuk të shkon mendja tek fetë apo tek themeluesit apo lajmetarët e parë të këtyre feve, se sa tek toleranca dhe raporti krejt i qetë që kanë shqiptarët me fe dhe besime të ndryshme. Konfliktet fetare për shkak të ideologjive radikale apo synimeve fetare të lidhura me politikën, po kërcënojnë për herë e më shumë sigurinë mbarëbotërore, duke gjetur të papërgatitura shtetet dhe shoqëritë e tyre.

Feja po shfaq trajta të reja dhe ka marrë forma të ndryshme në disa shoqëri të caktuara. Lëvizjet radikale islamiste, por edhe forma të tjera ekstremiste, nuk kanë

⁵⁸Elsie, Robert, mbi gjuhën shqiptare, lexo më shumë në;
<http://www.albanianlanguage.net/>, pare me 10.5.2016

mbetur më në kuadrin dhe kornizat e një besimi të thjeshtë fetar, apo “statik fetar” (Bergson 2002;167), ai lloj raporti “që lidh njeriun me jetën” (Bergson 2002; 167) dhe “individin me shoqërinë” (*Ibid*; 167), por po shtrembërojnë fenë për të justifikuar dhunën (Papa Francesku 2014). Radikalizmi ose ideologjitë radikale ose ekstremiste fetare, që i shërbejnë qëllimeve të caktuara politike, tentojnë të globalizohen, duke vënë si pararojë fenë, kurse bota perëndimore “e krishterë” tenton të globalizohet, duke vënë në pararojë progresin ekonomik-politik dhe vlerat e sistemit të saj liberalo-demokratik. Për të mos hyrë në detaje se çfarë qëndron mbrapa këtyre skenareve, pasi nuk është qëllim i kësaj analize, sot nuk ka vetëm një sfidë me bazë fetare apo religjioze në botë. Kjo s’është as krizë “thjesht ekonomike ose politike, apo edhe një krizë kulturore, si e tillë –jo duke nënkuptuar këtë apo atë lloj të kulturës”(Veilleux OCSO 1976) Ajo, çfarë vërehet sot, është një shfaqje e ndërthurur e të gjitha llojeve të kërcënimeve dhe sfidave dhe një “krizë e antropologjisë” (Veilleux OCSO 1976) ose lindja e një “lloji të ri të njerëzimit”(Veilleux OCSO 1976) apo marrëdhëniesh njerëzore dhe “mënyra të reja të grupimit të njeriut”(Ibid 1976).

Pra nuk është feja, që po shfaq trajta të reja, por grupe të caktuara social-kulturore, po marrin trajta dhe ngjyime të reja, ose të ndryshme nga format tradicionale, në një vorbull interesash e përplasjesh të ndryshme. Në këtë prizëm shoqëria shqiptare ka një raport më të qetë dhe më tolerant me fetë ndaj të cilave, ata, jo se janë treguar indiferentë, por për arsye të mbijetesës dhe të faktorëve historiko-politik, që nuk vareshin prej tyre, kanë vlerësuar disa rrethana, ose faktorë të tjerë më jetikë, të cilët në momente të caktuara ishin prioritarë, si për shembull ruajtja e unitetit etnik, ose ruajtja elementeve të tjerë të identitetit kombëtar, që vireshin në rrezik nga asimilimi kulturor dhe fetar i pushtuesve të shumtë që kanë kaluar në Shqipëri.

Në një kohë kontradiktash dhe ekstremizmi fetar, shqiptarët vazhdojnë bashkjetesën e tyre normale me të gjitha fetë dhe besimet fetare që ekzistojnë në Shqipëri, dhe respektojnë besimet fetare të njëri-tjetrit, pasi feja duket të jetë arsyeja e fundit për të krijuar konflikt ose luftë sipas mendësisë apo mentalitetit

shqiptar. Shumë studiues janë munduar të japin arsye të ndryshme për bashkëjetesën fetare në Shqipëri. Nëse kjo bashkëjetesë funksionon në realitet apo jo. Nëse është një realitet, cilat janë impaktet pozitive dhe negative që ka sjellë ky fenomen që është i dallueshëm në Shqipëri, si në asnjë vend të tjetër Ballkanit dhe në Europë. Në Shqipëri nuk është aspak e rrallë të gjesh në një hapësirë të ngushtë sociale, sikurse është familja, ose fisi dy apo tri fe, të krishterë, muslimanë, bektashi etj, ose edhe raste kur një individ i caktuar mund të mbajë dhe respektojë dy fe njëkohësisht, mund të mbajë dhe dy emra, dhe kryen ritet e festat fetare të të dy apo më shumë besimeve.

Bashkëjetesa fetare ka patur lidhje direkte me mbijetesën. “Ballkani dhe Mesdheu prej lashtësisë deri në kohët moderne kanë patur në bazë të luftrave dhe përjekjeve edhe dallimet konfesionale” (Bashkurti 2004; 120) Gjithashtu dallimet dhe “linjat konfesionale kanë shërbyer edhe si linja ndarëse etnokulturore” (Bashkurti 2004; 120). Është e rrallë, por gjithashtu aspak jo reale, që në shumë treva kufitare të etnosit shqiptar, shqiptarët, për të ruajtur identitetin e tyre të veçantë kombëtar, kanë hequr dorë vullnetarisht nga një pjese e identitetit të tyre fetar, për të shpëtuar atë pjesë që ka lidhje me thelbin e tyre kombëtar. Në Shqipëri që nga lashtësia deri në kohët e sotme besimet fetare kanë bashkëjetuar tek shqiptari për “të plotësuar nevojat shpirtërore dhe të jetesës së tij” (Demi 2011)

Në popullin shqiptar ekzistojnë “katër besime fetare, ndër këto “mysliman, bektashi, ortodoks dhe atij katolik” (Puto 199;32) Krishtërimi në Shqipëri lindi “mbi paganizmin e fuqishëm ilir” (Zeqo 1995; 83) dhe u zhvillua “që në gjymsën e parë të shekullit të I-rë të erës sonë” (Zeqo 1995; 83) Dr. Zef Mirdita shkruan: *“Dijetari gjerman, Gottfried Schram, shpreh mendimin se përhapësit e krishtënizimit ndër shqiptarë janë besët, një fis thrakas që ka jetuar në trekëndëshin e sotëm kufitar: Bullgari, Maqedoni dhe Serbi. Ai e lidh këtë me veprimtarinë misionarike të ipeshkvit Nicetës nga Remesiana (350-420), sot Bela Palanka, në trevën e Nishit. Qëllimi i G. Schramm-it është që përmes besëve, si bartës të krishtënizmit në këto treva, ta shpjegojë jo vetëm krishtënizimin e*

shqiptarëve, por edhe etnogjenezën e tyre.(Zeqo 2016) Shumë studiues të tjerë janë të mendimit se krishtërimi erdhi përpara periudhës që parashtron Schram. “Arkeologjia ka dhënë fakte për krishterimin në Shqipëri shumë më përpara shekullit IV, shumë më përpara Niketës së Remezianës.” dhe “në librin e Dr. Mirditës, kjo çështje sqarohet” (Zeqo 2016) “Shqipëria është nga vendet e para të krishtërimit në Europë të apostoluar nga vetë Shën Pali (Rom. XV 19)” (Zeqo 1995; 83) Shpesh është diskutuar nëse Shqiptarët, kanë qenë vërtetë të krishterë apo jo, dhe si besimtarë apo jo. Autori Jakov Milaj në analizën që shtron për besimin e shqiptarëve mendon se “Shqiptari me të gjitha valët e qytetërimit të huaj që ka kaluar, ka mbetur prapëseprap në funt të shpirtit pagan” (Milaj 1944; 73) Ai “beson më me qejf në çukën e shkëmbenjtë të Tomorrit ose në guvën e thellë të Sarisalltëkut mbi Krujë, se sa në shënjtin më çudi-bërës” (po aty 73) të çfarëdo feje.

Më vonë vija e Teodosit që i ndau ato në mes, shkëputi një pjesë të mirë të popullsisë së krishterë nga Kisha Romake, dhe popullsia e lindjes ra nën ndikimin ortodoks. “Asnjë popull tjetër në Ballkan e më gjerë nuk i mbijetoi “Vijës së Teodosit”, përveç shqiptarëve” (Bashkurti 2004; 120), në kuptimin që nuk arriti të asimilojë karakteristikat e spikatura “të identitetit etnokulturor” (Bashkurti 2004; 120) të tyre. Perandoria Osmane arriti të islamizojë një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare, ama mund të thuhet se ata edhe përfituan nga karakteri administrativ dhe ushtarak i Portës së Lartë për tu mbrojtur, kur fqinjët dhe politikat e tyre sllavizuese kërkonin asimilimin dhe përvetësimin e territoreve të tyre. Gjatë islamizimit të shoqërisë shqiptare vëreheshin këto fenomene në shoqëri “Martesa midis dy feve kanë qenë të zakonshme edhe vazhdojnë edhe sot në disa malësira” (Milaj 1944; 77).

Rastet tregojnë “se muhamedani e pagëzon fshehtazi të birin ose gruan, shkon e falet në kishë, jep ndihmë për mbajtjen e famulltarit, jeton në një strehë me kristjanin që e ka vëlla ose kushëri dhe kur vdes ja le trashëgim manastirit të gjithë pasurinë e tij” (Milaj 1944; 77) Jakov Milaj mundohet në studimin e tij të sqarojë qëndrimin e tij në lidhje me akuzat e Turqizimit të shqiptarëve, duke vënë

re akuzat që haseshin rëndom në këtë drejtim (“Raca shqiptare”) lidhur me Turqizimin e shqiptarëve gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, dhe shkruan kështu: “Myslimanizëm nuk do të thotë turqizim” (Milaj 1944; 72), *“Të besojmë çfarë shkruhet përceptas, pa baza për fene tonë, duhet të ishte njësoj sikur të pohojmë se Gjermanët ndërruan origjinën, sepse braktisën paganizmin dhe përqaftuan krishtërimin, ose se anglezët e sotëm nuk janë më ato të pesqind vjetëve më parë, sepse u ndanë nga kisha Katolike Apostollore Romake”*(ibid). Ai e përforcon qëndrimin lidhur me këtë me argumentin se *“Nëse myslimanizmi do të ishte përhapur me anën e turmave kolone turke të vendosura prej Portës së Lartë, nëpër krahina të ndryshme të Shqipërisë,”* (Ibid; 72) atëherë mund të kishte ndodhur diçka e tillë “Por, një kolonizim të tillë nuk e përmend asnjëherë historia.(Ibid 72.)

Pranimi i pluralizmi fetar është një cilësi e spikatur tashmë tek shqiptarët, ky tipar ekzistonte në AND-n e shqiptarëve edhe para Rilindjes Kombtare, sië është theksuar edhe më sipër, por rilandasit e shndërruan këtë cilësi në një “modusvivendi” të një aspirote të madhe kombëtare, që do të kurorëzohej me krijimin e kombit-shtet, dhe pavarësisht kritikave dhe studimeve që tentojnë të paraqesin anën e kundërt të kësaj medaljeje. *“Shqiptarët e kanë të integruar, tashmë si komb, pluralizmin fetar.....Dhe, ndonëse për këtë duhej paguar me vonesë në formimin kombëtar....produkti final është toleranca si gjendje e lindur brenda kombit dhe mungesa e dimensionit fetar në konfliktet me kombet e tjera”* (Surroi 2003)⁵⁹ Më poshtë do të parashtrohen disa nga kritikrat që i janë drejtuar fenomenit të bashkëjetesës shqiptare në Shqipëri, dhe arsyet përse janë adresuar këto kritika. Rrjedhimisht do të pasqyrohen disa të meta që kanë sjellë disa autorë por edhe disa vlera ose merita që janë bërë karakteristikë e realitetit shqiptar.

3.8.1 Kritikrat dhe vlerat në lidhje me bashkëjetesën fetare në Shqipëri.

Në lidhje me fenë e shqiptarit, “bashkëjetesën fetare”, “mungesën e besimit”, “besimin në kombësi më shumë se në fe” dhe variante të tjera të ngashme si këta,

⁵⁹Veton Surroi 2003, faqe 33 (Fate dhe civilizime në Mileniumin e ri, Rasti i Shqipërisë, Revista diplomacy, ADsh, nr8, i cituar tek Bashkurti L. 2004, Identiteti Imazhi dheDiplomacia.

janë hasur dhe hasen shpesh herë në materialet dhe studimet që i dedikohen kësaj pjese. Shpesh shtrohen pyetje se çfarë lidhje ka shqiptari me fenë, a është ai një popull mysliman, që ka ruajtur tipare lindore, apo “shqiptarizmi” (Puto 1999; 32) ka qenë besimi më i rëndësishëm dhe me vlerë për të? Disa nga këto diskutime dhe debate do të shqyrtohen më poshtë për të parë reagime dhe kundër-reagime që kanë ngjallur këto diskutime apo pikëpyetje ndër autorë të ndryshëm, dhe për të dalë deri diku tek produkti final, ai i bashkjetesës fetare në vend, që duket një mënyrë jetese e pashmangshme dhe karakteristikë e vulosur në kombin shqiptar. Duke qenë se kristianizmi mbahet nga shumë autorë si promovues dhe mbështetës i zhvillimit të kulturave në Europë, pra si një fe që ka qenë e aftë “të ngjallë dhe të kultivojë forcat vetjake dhe tradicionale të kulturës të popujve të veçantë”, (Kordinjano 2008; 15) mendohet se edhe Shqipëria arriti të zhvillojë fetë dhe kulturën e saj, nën dritën e kësaj feje.

Autori Kordinjano beson se, “Lulja e parë e kulturës së mirëfilltë shqiptare çel me lindjen e kristianizmit”, (Kordinjano 2008; 14) duke qenë se kristianizmi frymëzonte lirinë dhe “nacionalizmin e drejtë”, (*Ibid*;14) ndërsa kristianizmi bizantin erdhi si një fe, e cila u bë e pranishme në Shqipëri, kur u vendos “Via e Teodosit” në territorin shqiptar në shekullin e IV, dhe ka mbajtur vazhdimisht nën presion “popullin shqiptar larg kulturës së tij të mirëfilltë, duke penguar zhvillimin e shkollës dhe të gjuhës kombëtare” (*Ibid*;15).

Mendohet se Islamizmi mund të kishte patur efekt asimilues për veçoritë kombëtare të identitetit të shqiptarëve, si gjuha dhe vlerat etno-kulturore, por autori Kordinjano mendon se kjo nuk u krye sepse “pjesa më e madhe e shqiptarëve e ulën kokën me lehtësi ndaj zgjedhës së tij” (Kordinjano 2008; 15) Por rrethanat historike tregojnë se ata nuk ulën kokën, por e pranuan këtë realitet të ri, ashtu siç pranuan edhe realitetet e tjera para këtij dhe duke përfutur nga toleranca e kësaj feje, në filozofinë e saj ndaj feve të tjera, ata u përshtatën, një pjesë e pranoi konvertimin në islam, si një “pragmatizëm shqiptar”, duke ruajtur gjithmonë lidhjet me fisin, krahinën, gjuhën, zakonet, të cilat nuk i tjetërsuan. Përçapjet e para të Rilindjes Kombëtare për mëvehtësi nga Perandoria Osmane

përmbanin dhe përdorimin e miteve, jo pa qëllim. “Miti i shqiptarëve si kombi më i vjetër i Evropës, u shoqërua me kontrastin me turqit si një popull aziatik që nuk ka aftësi të zhvillohet” (Sulstarova 2012; 46)

Një tjetër mit që përdorej në ato fillime ishte “Feja e shqiptarit është Shqiptaria” (Puto 199;32) poemë e Pashko Vasës, që u kthye në slogan të kësaj lëvizjeje. Këto lloj mitesh përdorëshin në qëllim të asaj çfarë donin të arrinin rilindasit me çështjen kombëtare, për të kanalizuar popullin drejt përparimit, për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane, “për të ngjallur dashurinë për atdheun”(Puto 1999;32) dhe fetë të ishin në funksion të bashkimit kombëtar jo të përçarjes. “Fet e besëtë ti kemi/Po të ndarë të mos jemi. (Frashëri 1986; 138)⁶⁰ Duke qenë se Shqipëria ishte e shpërndarë në katër vilajete të ndryshme, dhe sipas pozicionit gjeografik nën influencën e shteteve fqinje që kërkonin përçarje edhe nëpërmjet fesë, rilindasit u kujdesën që të promovonin laicitetin dhe “shqiptarizmin” (Puto po aty) parasëgjithave.

Artan Puto merr në konsideratë edhe terrenin natyror të vështirë në Shqipëri në atë kohë, si një faktor që ka ndikuar në izolimin e tyre dhe “i ka mbajtur ato larg botës përreth” (Puto 1999; 32) Kjo gjë ka ndikuar tek ato që kishin terren më të vështirë malor, të pakapërcyeshëm lehtë, si për shembull: Malësia e dëshmonte këtë fakt në “ruajtjen e institucioneve të vjetra fisnore” (Puto 1999; 32), rrjedhimisht edhe fenë e të parëve e ruante apo e praktikonte ndryshe nga “Shqipëria e jugut dhe ajo e mesme” (*Ibid*; 32) që “ishin gjeografikisht më të hapura” (*Ibid*; 32) dhe “mjedisi fqinj” (*Ibid*; 32) që i njohur për ta.

Duke ruajtur institucionet fisnore, ajo pjesë që jetonte në zona të izoluara malore, i bindej më shumë rregullave fisnore, se sa fetare, domethënë paralelisht me zakonet fisnore ishin edhe ato fetare, por ato fetare nuk luanin absolutisht një rol parësor. Madje institucionet fetare dhe klerikët, u bënë në të shumtën e rasteve, mbrojtësit dhe interpretuesit më fanatik të kodeve zakonore. Në kushtet, kur “shqiptarët nuk kishin një fe kombëtare”, (*Ibid*;32) si fqinjët që arritën ta

⁶⁰Naim Frashëri, 1986, Vepra 2, Prishtinë Rilindja, i cituar tek Dr. Enis Sulstarova, Moderniteti I Rilindjes Kombëtare, Politikja 2012

përdornin fenë për bashkim dhe pavarësi nga turqit para Rilindjes sonë Kombëtare, por edhe më pas Shqiptarët janë komentuar nga studiues të ndryshëm për “mungesën e një besimi të vërtetë” (Demi 2011).

Në fakt “çështja e mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve shfaqet si rebus, gati i padeshifrueshëm në sfondin e dyfishtë të realitetit socio-kulturor mbizotërues të shumë shoqërive të ditëve tona, si dhe të një mjegulle të dendur paragjykimesh që vjen nga jashtë dhe deformon pamjen e vlerave të shoqërisë shqiptare” (Dervishi 2013; 381) Po të fillohet që me krishtërimin, Shqiptarët gjatë shekullit të “XVI dhe XVII tregohen” (Demi 2011) nga studiues “Si shumë të përciptë në kultin e krishterë” (Demi 2011) dhe si të tillë që “Kanë emrin e krishterë, por aspak besimin.” (Demi 2011) Por *“studiuesit më seriozë dhe që e njihnin mirë këtë popull, më i lashti në Ballkan, që kishin ngrënë në sofrën e tij duke shijuar bashkë me ato dhe gjuhën e ëmbël shqipe, edhe rrëfenjat, dhe këngët kreshnike, e shpjegonin këtë dukuri, jo në mungesën e besimit fetar, por në përkushtimin parësor ndaj kombit dhe farës (klanit) së tyre, pastaj ndaj besimit shpirtëror.”*(Demi 2011)

Disa pyetje të tjera që shtron autori Kordinjano janë, si shpjegohet që shqiptari “braktis me kaq lehtësi dhe në masë besimin e të parëve?” (Kordinjano 2008; 19) dhe “Pse nuk është e mundur ta organizojmë në Shqipëri shenjtërinë nga ana shoqërore?” (*Ibid*; 19) pra të arrihen në një farë mënyre të vendosen apo të ndryshohen “kushtet morale dhe fetare të popullit në tërësi” (Po aty) Përsa i përket ndërrimit të fesë apo kthimit të Shqiptarëve në një fe të vetme, ky është një debat i gjatë i cili ka vazhduar me vite. Por në fakt, është për t’u marrë në konsideratë fakti që, Shqiptarët pas paganizmit patën kristianizmin si fe unike, e cila u përça nga konkurenca politike mes Papatit dhe Perandorisë Bizantine, çfarë tregon se fetë kanë ndryshuar shpesh, dhe vinin bashkë me pushtuesit në vend dhe së fundi shqiptarët instiktivisht e dinin mirë, se çfarë ishin ata për njëri-tjetrin dhe se çfarë i bashkonte ata me njëri-tjetrin, në raport me ata që kërkonin t’i ndanin e t’i shkatërronin apo t’i zhduknin.

Mark Milani, një gjeneral i Malit të Zi, me origjinë shqiptare, pranë Knjaz Nikollës, që luftoi kundër shqiptarëve në kohën e Lidhjes Kombtare të Prizrenit, në librin e tij “Jeta dhe Zakonet e Shqiptarëve” shprehet kështu në lidhje me fenë e shqiptarëve: “çdonjeri prej tyre do të kishte dashur që vëllai mos ta ndërronte fenë, por të gjithë ta ruanin fenë e vjetër”, (Milani 2003; 90) duke dhënë të kuptojë, se që atëherë kjo përbënte një lloj problemi sidomos për rikthimin tek feja e të parëve. Procesin e ndërrimit të fesë në kushtet që tashmë ndodheshin apo kthimin tek feja vjetër edhe një herë, Mark Milani e lidh me mungesën e karakterit që do ta shoqëronte individin në këtë veprim dhe e ilustron me pyetjet që do të ngrente shoqëria apo komuniteti në këtë drejtim, si për shembull: “A nuk i mjaftoi njëherë që e uli veten, duke ndërruar fenë” Atij nuk i ka hije të përplasat sa tek njëra fe tek tjetra” (Milani 2003; 90) Kjo tregon predispozitën që njerëzit të mbeteshin në atë fe, sepse njerëzit përreth do të gjykonin edhe do të thonin: “-Ky nuk është i zoti të mbajë asnjë fe” (*Ibid*; 90.)

Në librin e tij ai flet për procesin dhe lidhjen e “vëllamërisë” (Milani 2003; 37) apo vëllazërisë si një lidhje më e shenjtë se feja duke pasur në thelb besën. Shqiptarët shpjegon ai: “ Sa i bashkon gjaku i përbashkët, po aq i ka mësuar dhe nevoja, se feja nuk mund t’i pengojë që ata të jetojnë si vëllezër”, (Milani 2003; 91) pavarësisht tendencën e pashallarëve turq aso kohe, që t’i shtynin shqiptarët “ta lodhnin njëri-tjetrin me grindjet në mes tyre e kështu të dobësoheshin” (Milani 2003; 38) pasi “kërkonin ta bindnin sulltanin se ndryshe Shqipëria nuk mund të zaptohet, nëse nuk nxiteshin shqiptarët ta lodhnin vetveten deri në rraskapitje.” (Milani 2003; 38) Në kushte tepër të vështira dhe kur rrezikohej mbijetesa “shkolla e nevojës u ka mësuar shqiptarëve se: “Kur të kërcënon një rrezik, vdekja është e sigurt nëse nuk e ke ndihmën e vëllait” (Milani 2003; 91) Vëllai këtu nënkuptonte individin me përbërje të njëjtë, race, gjuhe dhe origjine pra përbërje të njëjtë etno-kulturore.

Vështirësia për t’i bashkuar ato gjatë periudhës së Lëvizjes Kombëtare, nuk qëndronte në atë, se ata ishin të shpërndarë në katër vilajete, por edhe shumë të shpërndarë në fise e klane, ku secili nga këto u nënshtrohej rregullave të veta, por

kur vinte puna të rrezikohej mbijetesa e tyre, feja dhe klani kalonte në një rol të dorës së dytë, dhe “mbështetnin përkatësinë në një grup të caktuar etnik” (Puto 1999; 33) si dhe “dalloheshin për ndjenjat e tyre proto-nacionale” (*Ibid*; 33). Domethënë mbijetesa dhe çështja kombëtare si dhe ajo e identitetit arrinte t’i organizonte ata në një farë mënyre për këto kauza. Nën Perandorinë Osmane feja njihësohej me kombësinë, në këtë mënyrë ata shqiptarë me fe të ndryshme sikurse “ata ortodoks” (Puto 1999; 34) trajtoheshin “si pjestarë të kombeve fqinje” (po aty), gjë që e shtonte rrezikun për copëtimin dhe krijimin e shtetit të ri shqiptar.

Në poemat e atyre viteve, jo pa qëllim, ndeshen fjalët: shqiptari, komb, gjak, fis, gjuhë. Pra këto fjalë shërbenin si slogane apo parime unifikuese për shqiptarët nëpërmjet elementëve të përbashkët të tjera nga feja. Më vonë me shpalljen e pavarësisë kombëtare dhe krijimin e shtetit shqiptar “shqiptarizmi” (Puto 1999; 37) me sloganet e veta “doli nga fusha e ideologjisë dhe politikës dhe hyri në atë të kulturës” (Po aty) dhe më vonë kaloi në “neo-shqiptarizëm” (Po aty), rryma e mendimit që lëvrohej deri para ardhjes së komunizmit. Komunizmi e dëmtoi edhe më fort lirinë e besimeve, duke “imponuar monizimin partiak dhe njëkohësisht ateizmin e detyruar shtetëror, madje deri në absurditet, sepse i dekretoi në terma kushtetuese” (Zeqo 1995; 82).

Kështu me kushtetutën e vitit 1976, u legalizua gjithçka që kishte ndodhur në ‘Revolucionin Kulturor’ të vitit 1967 për zhdukjen e fesë në Shqipëri, të klerikëve, të cilët u burgosën dhe u vranë, si dhe të shkatërrimit të institucioneve fetare si (Kisha-Xhamia), që u kthyen në depo, stalla, ose dhe në “vatra kulture” që shërbenin gjoja për emancipimin e zonave rurale dhe përhapjen e mësimave të PPSH-së, dhe të gjitha këto i serverishin popullit shqiptar dhe opinionit të jashtëm, si progres i madh dhe si elemente të ndërtimit të shoqërisë komuniste. Një tjetër autor, Pirro Misha e sheh gjithashtu si “pengesë e mundshme dhe mjaft serioze” (Misha 2008; 74) që pas shpalljes së pavarësisë e më vonë “ndarjen e shqiptarëve në fe të ndryshme” (po aty).

Pengesa qëndron sipas tij, në mungesën në “procesin e kohezionit, të homogjenizimit dhe unitetit kombëtar” (*Ibid*) që mund të ishte arritur nëse shqiptarët do të kishin një fe të përbashkët, apo po të kishin ato “kushtet morale” (Kordinjano; 2008; 21) të duhura, siç e quan autori Kordinjano, për të arritur atë kohezion shoqëror. Procesi i kohezionit apo homogjenizimit ndoshta i ka penalizuar ato në aspektin e tolerancës me njëri tjetrin pasi edhe autor Dervishi konstaton se “përgjithësisht ato janë më pak tolerantë se europianët për shumë çështje të marrëdhënieve me njëri-tjetrin në punën dhe jetën e përditshme” (Dervishi 2013; 382) ama “janë më tolerantë, më të prirur për mirëkuptim me besimtarë që i përkasin feve të tjera” (Dervishi 2013; 383) Në fakt “shoqëria” si një “organizëm që u nënshtrohet ligjeve të domosdoshme, ndryshon nga një shoqëri e përbërë prej vullnetesh të lira” (Bergson 2002; 7-8) Tek Shqipëtarët është vënë re fenomeni i “vullneteve të lira” të shpërndara dhe individualiste ama “terësia e zakoneve të rrënjosura në kohë, të cilave u përgjigjen nevojave të bashkësisë” (Bergson 2002; 8) kanë qenë të diktuar nga qëllimi për “shpëtimin për veten e tyre” (Milani 2003; 91) Pra një lloj homogjenizimi apo uniteti ka dalë në pah, që në kohën e ‘Rilindjes Kombtare’, vetëm për arsye mbijetese kombëtare dhe realizimin e aspiratave kombtare, shtet-kombi Shqiptar është një realitet i ndërtuar mbi konsensusin fetar, prandaj përbën një vlerë të shtuar dhe një shëmbull për t’u ndjekur nga shoqëri dhe grupe etnike që aspirojnë për t’u integruar dhe për t’u bashkuar me njëri-tjetrin në shoqëri të mëdha multi-etnike, multi-religjioze, ose multikulturore siç është BE-ja.

Kur flitet për homogjenizim shoqëror apo ndryshim të kushteve morale shoqërore të fesë në një shoqëri që ka disa besime fetare, mendohet që feja e përbashkët mund të ndihmojë individët të kanalizohen “në një shoqëri ku institucionet, ligjet dhe zakonet” (Bergson 2002; 9) jo vetëm disiplinojnë, por ato “shënojnë pikat më të spikatura” (po aty) të asaj shoqërie. Ose në këtë rast, një moral shoqëror, nën një fe të përbashkët, do të inspironte një solidaritet shoqëror më të madh, se sa në një shoqëri të shpërndarë në disa besime të ndryshme. Ama, shoqëria shqiptare, në këndvështrimin e besimeve fetare, rezulton të ketë respektuar ato rregulla morale që kanë pasur lidhje me mbijetesën ndër shekuj dhe ato vlera që ka

përcaktuar vetë shqoqëria, apo zakone të tyre që disa i quajnë dhe “shembull i zakoneve fisnike” (Milani 2003;35). Domethënë “ky pluralizëm i besimeve fetare i instrumentalizuar nga të huajt”(Zeqo 1995; 83) që nga njëra anë ka qenë “burim i tmerrshëm i përçarjes” (Ibid; 83),nga ana tjetër “solli si një reagim të mençurisë dhe llogjikës kombëtare, tolerancën e pashembullt midis feve” (po aty) duke e kthyer këtë “si një ligj moral” (Zeqo 1995; 83) të vetë shoqërisë shqiptare.

Vetë, Papa Francesku, në vizitën që kreu në Shqipëri, në vitin 2014, përshëndeti shqiptarët duke vlerësuar lart tolerancën fetare në Shqipëri dhe duke e quajtur atë “një shembull frymëzimi” (Papa Francesku 2014), jo vetëm për Europën, por për të gjithë botën. *“Bashkëjetesa paqësore mes besimeve fetare, klima e respekti mes ortodoksëve, katolikëve dhe myslimanëve është një dukuri speciale në kohën e ekstremistëve, në kohën kur besimi po kthehet në faktor përplasjesh dhe dhune”.*(Papa Francesku 2014) Gjatë meshës që mbajti në Sheshin “Nënë Tereza” të Tiranës, ai dha disa mesazhe shumë të rëndësishme për bashkëjetesën fetare dhe një ndër këto që ka lidhje jo vetëm me fenë, por edhe me multikulturalizmin ishte: *“Nuk mund të vlerësosh, nëse nuk nisësh nga identiteti. Pa identitet, nuk ekziston dialog. Me dialog ne ecim përpara, dhe është e bukur.Të mbajmë dhe të zhvillojmë traditën e marrëdhënieve midis komuniteteve fetare që ekzistojnë në Shqipëri.*(Papa Francesku 2014) Pra ky ishte një mesazh që jo vetëm promovon bashkjetesën dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet identiteteve të larmishme dhe dialogun që mund të krijojnë këto identitete ndërmjet njëri-tjetrit, por edhe një mesazh që vendos Shqipërinë si shembull i bashkëjetesës fetare për t’u marrë si shembull nga e gjithë bota, për harmoninë që ekziston ndërmjet besimeve të ndryshme, “krahas vlerës kulturore të besës dhe asaj të kulturës shqiptare” (Dervishi 2013; 379).

3.9 Traditat kulturore shqiptare në themel të vlerave kombëtare.

Ashtu si gjuha dhe bashkëjetesa fetare që janë elementë shumë të spikatur të identitetit shqiptar, ashtu janë edhe traditat kulturore shqiptare. Gjuha si një simbol, e ka bërë dhe ka përcjellë kombin shqiptar ndër vite, brez pas brezi, me gjithë larminë e traditave kulturore, ndërsa toleranca fetare si një specifike e

vulosur nga rrethanat historike, por e pranuar me konsensus dhe tolerancë nga vetë populli, është kthyer jo vetëm në një “ligj moral” (Zeqo 1995; 83) por edhe në një traditë kulturore të shoqërisë shqiptare.

Kur flitet për kulturën në përgjithësi, (përkufizimi i saj do të ceket sërish më poshtë, në pjesën ku shtjellohet kultura politike shqiptare), kuptohet “ e tëra komplekse që përfshin dijen, besimin, artet, moralet, ligjin, traditën, dhe shumë aftësi dhe zakone të tjera të fituara nga njeriu si anëtar i shoqërisë” (Tylor, 1871)⁶¹ Në këtë pjesë nuk do të trajtohen të gjithë elementët përbërës që përbëjnë kulturën si një e tërë, dhe si një koncepti zgjeruar, por traditat kulturore si “modele të sjelljes zakonore”(Linton 1940) si vlera apo elementë të përbashkët të “transmetuar nga anëtarët e një shoqërie të caktuar”(Linton 1940)⁶², në këtë rast, asaj shqiptare gjeneratë pas gjeneratë në mënyrë të natyrshme. Pra, cilat janë ato karakteristika, veçori, modele apo sjellje që kanë formuar një traditë kulturore gjatë transmetimit në breza nëpërmjet gjuhës së përbashkët të shoqërisë shqiptare. Gjuha dhe kultura e një kombi janë të lidhura në mënyra të pashmangshme pasi “kultura varet së tepërmi nga kapaciteti njerëzor për të krijuar gjuhë” (Kessing & Strathern 2007; 48), ndërsa traditat kulturore janë modele të këtij realiteti “të ndërtuara brenda popullatave përgjatë kohrave” (Kessing & Strathern 2007; 61) dhe “të formësuara kulturalisht” (Kessing & Strathern 2007; 61) Traditat kulturore që do trajtohen në këtë pjesë përfshijnë rituale, zakone, folklor, modele sjellje nga kultura si një e tërë, duke u përcjellë dhe trashëguar që nga lashtësia si “vetëdije e kombit” (Zeqo 1995; 125)

Zbërthimi i këtyre traditave kulturore bëhet enkas për të shqyrtuar larminë e taraditave dhe për të përcjellur vlerat e një identiteti kulturor kombëtar. Meqenëse BE nuk ka një identitet kulturor të përcaktuar, por një shumëllojshmëri të “identiteteve kulturore e qytetare të kombeve që jetojnë në gjirin e saj”(Frashëri 2006), atëherë në këtë kuadër edhe Shqipëria ka çfarë të ofrojë dhe të pasurojë në

⁶¹Tylor 1871, i cituar nga Keesing R. & Strathern A. 2007, Antropologji kulturore me perspektivë bashkëkohore, UFO pres fq. 550

⁶²Linton 1940, i cituar nga Keesing R. & Strathern A. 2007, Antropologji kulturore me perspektive bashkëkohore, UFO pres fq. 550

këtë realitet. Ka shumë autorë që janë marrë me studimin e traditave kulturore shqiptare. Mark Milani kur përshkruan tradita dhe zakonet e shqiptarëve shprehet kështu “njerëzit tanë nuk i njohin zakonet e shqiptarëve, edhe pse ata janë fqinjët tanë” (Milani 2003; 35) dhe këtu e ka fjalën më tepër për popujt e ballkanit. “Disave ata u duken shumë më të vrazhdë dhe më të egër se popujt e tjerë, kurse për mua nuk është ashtu” (*Ibid*; 35). Ai nënkupton lashtësinë e tyre, por jo si një punë që do ta evidentojë ai duke shprehur se, këtë punë duhet ta kenë bërë tashmë grekërit e lashtë dhe romakët.

Autori Zeqo i përshkruan shqiptarët “si pasardhës të ilirëve” (Zeqo 1995; 208) të cilët “trashëgojnë jo vetëm elementë të thelbit etnik original, të vijëmisë kohore” (*Ibid*; 208) por edhe “një zhvillim cilësor të ri” (Zeqo 1995; 208) në kohët që pasuan Ajo çka i bën përshtypje autorit Milani, është ajo diçka që ka qenë tek shqiptari “më e qëndrueshme se tek popujt e tjerë” (Milani 2003; 35) dhe si “ky popull nuk e lejoi veten të ndryshonte” (*Ibid*; 35) pas gjithë atyre zgjedhave dhe pushtimeve që kaluan mbi të.

Disa nga traditat që ndryshe mund të quhen edhe vlerat e “mbijetesës” shqiptare dhe “origjinale të identitetit shqiptar” (Bashkurti 2004; 112) (gjithmonë sipas autorëve të ndryshëm), janë: Mikpritja, besa, vëllamëria dhe miqësia, këngët popullore, familja, forklori gojor, legjendat shqiptare, kostumet popullore sipas krahinave, mikpritja, etj.. Autori Robert Elsie, mendon se kultura shqiptare është e pasur me shumë veçori dhe shpreh se “kjo kulturë, pa dijen e së cilës Ballkani kurrsesi nuk ka si të kuptohet” (Elsie 2000) është një terren i pastudiuar nga bota perëndimore. Tek libri “Leksiku i kulturës popullore shqiptare” ai i kushton një rëndësi besimeve në Shqipëri, të të gjitha llojeve. Autori Elsie “*përqendrohet në figurat e mitologjisë shqiptare, të besimeve fetare, të bashkësive, urdhrave dhe sekteve fetare që kanë qenë të pranishme në Shqipëri, të shenjtëve e shenjtoreve, burra e gra, që kanë luajtur rol në besimet e shqiptarëve, të vendeve të shenjta e objekteve të kultit, të festave kalendarike, të ritualeve e të bestytive popullore*” Ato autorë, që kanë shkruar për traditat kulturore shqiptare, udhëtarë, kalimtarë, studiues, albanologë kanë vënë re që kultura shqiptare është e pasur dhe e begatë

me tradita e veçori kulturore si “një muze i gjallë i së kaluarës” (Elsie 2000), biles ai shkon më tej, duke e cilësuar kulturën shqiptare tradicionale si një “minierë ari” (Elsie 200) për “etnografë” dhe studiues “antropologë”(Ibid),por që duhet “të kapërcejë rrethin e mbyllur dhe të hyjë në komunikim më të gjerë” (Jakllari 2002; 16) me botën.

3.9.1 Mikpritja

Autori Elsie përshkruan një sërë traditash, ku një nga këto është mikpritja. Si një traditë e rrallë mikpritja shqiptare e respekton dhe e nderon shumë mikun. Për shqiptarin është “e paimagjinueshme që dikush të mos mikëpritet apo të lihet jashtë pa një strehë, pavarësisht vështirësive të rënda ekonomike në gjithë hapësirën shqiptare” (Elsie 200; 116-117) Një mik i pritur në shtëpi gëzon shumë të drejta të tjera kur pranohet si mik, si mbrojtje, nderim, mbajtje me ushqim “bukë, kripë, dhe zemër” (Elsie 2000; 117) duke e kthyer mikpritjen në një akt “institucional, sa individual aq edhe kolektiv” (Bashkurti 2004; 133) që lidhet me “kuptimin moral dhe shpirtëror” (Bashkurti 2004; 135) të shqiptarit. Mark Milani thotë se mikpritja shqiptare “është diçka e shenjtëruar” (Milani 2003;74). Mikpritja te shqiptarët shfaqet si një virtyt i rrallë, ku mikun nderohet dhe qeraset me çfarë të gjendet në shtëpi dhe e quajnë nder të madh mësymjen në shtëpinë e pritësit. Nuk mund të le pa përmendur shprehjen “Bukë e kripë dhe zemër” . Nga një mikpritje e zakonshme, nga idealizmi që e karakterizon këtë akt, mund të lindë një miqësi e përkohshme dhe mikun “bëhet mik i paharrueshëm” (Milani 2003; 75) për ata dhe anasjelltas mikpritësi për mikun. Kjo traditë ka marrë pamjen e një “ceremoniali” (Bashkurti 2004; 135) për rëndësinë që shfaq si akt. Mikpritja është një vlerë tradicionale e shqiptarëve, ku mikun e respektonte mbi gjithçka, e cila dallohet e njihet dhe nga të huajt që vizitojnë Shqipërinë për arsye të ndryshme.

Në BE dhe më gjerësisht në botë, mikpritja është e lidhur ngusht me industrinë e turizmit, me vizitorët që vizitojnë një vend të huaj, jo vetëm me bashkëjetesën paqësore multikulturore. “Mikpritja do të jetë industria më e madhe në botë deri në vitin 2020, sipas Organizatës Botërore të Udhëtimit” (Indipendent 2011) për të

cilën po vihen në lëvizje shkolla të caktuara dhe po shtohet numri i tyre në botë që i “dedikohen industrisë së turizmit” (Independent 2011) Këto shkolla apo programe shkollore kanë për qëllim të stimulojnë “mendues kritikë”(Independent 2011), menaxhues të zotë“por edhe të diplomuar të cilët tregojnë respekt duke vlerësuar diversitetin e njerëzve”(Ibid), që të japin ide dhe kreativitet në një "atmosferë të njohur" në të cilin studentët dhe stafi mund të bashkëveprojnë”(Ibid). Edhe për rastin e Shqipërisë, mikpritja mund të zhvillohet si vlerë në një kuadër të tillë industrial, duke pasur parasysh Shqipërinë si një vend turistik, por edhe si një vend që ka udhëtues e vizitorë të shumtë që vijnë jo vetëm si turistë, por si biznesmenë, partnerë, të huaj që jetojnë përkohësisht, studentë etj. Etj..

3.9.2 Besa

Besa është një tjetër vlerë, me përmbajtje të lartë morale, që ka shërbyer si institucion në ndërtimin e marrëveshjeve dhe marrëdhënieve njerëzore nëpërmjet fjalës së dhënë. Ashtu si kanunet vepronin nëpërmjet forcës së zakonit si institucion virtual , ku normat kishin fuqi për të vepruar në mënyrë psikologjike tek shqiptarët, edhe besa përbënte “autoritetin e lartë” (Ibrahimi 2010) të popullit shqiptar, që shihej dhe respektohej si një “kod moral e shpirtëror” (Bashkurti 2004; 138) Ky lloj kodi moral e dallon atë nga popujt fqinjë të Ballkanit, por edhe nga popujt e tjerë në botë, si nga kuptimi që mbart si një fjalë me emërtim të caktuar, të veçantë, që zor të gjendet në fjalorët e gjuhëve të botës, por edhe nga rëndësia e madhe që i ka kushtuar populli shqiptar asaj “qysh prej periudhave mitologjike” (Ibrahimi 2010).

Besa lidhet drejtpërsëdrejti me etnosin shqiptar, ku “në kulturën gojore shqiptare ekzistojnë dhjetra legjenda shumë të lashta”(Bashkurti 2004; 139) që evidentojnë rolin dhe rëndësinë e besës në raport individ me individ, familje, fis dhe më gjerë në raporte shoqërore. Një sërë baladash të vjetra lidhen me këtë institucion. Murosja e Rozafës tek ‘Legjenda e vjetër e Kalasë së Shkodrës’, ose “Kostandini dhe Doruntina” e periudhës së Mesjetës së Mesme” (Bashkurti 2004; 139) Në këto legjenda shfaqet sakrificat e njeriut për të ndërtuar një vepër të moralshme me

qëndrueshmëri të gjatë që paguhet dhe me jetë. Sikurse më poshtë do të trajtohen ‘Kanunet Shqiptare’, ato kanë një veçanti shumë thelbësore të përbashkët dhe “pikërisht aspekti ku nuk ndryshojnë është institucioni i besës.” (Bashkurti 2004; 141) Është besa e cila “sanksionohet” “si princip themelor” (Ibid), në detyrimin moral që rrjedh nga kjo e drejtë zakonore shqiptare.

Besa vjen si zakon i respektuar brez pas brezi deri në ditët e vona ku gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndihmuan dhe strehuan Hebrenjtë duke shpalosur njëkohësisht dy akte apo veprime me vlerë si mikpritjen dhe besën. *“Shqipëria ishte i vetmi vend në Europë i cili kishte më shumë hebrenjë në mbarim të luftës se sa në fillim të luftës dhe kjo iu atribua faktit se shqiptarët jo vetëm mbrojtën hebrenjtë që jetonin në Shqipëri, por strehuan edhe të tjerë që po arratiseshin nga vendet e tjera europiane.”* (Shkreli 2015) Akte të tilla që lidheshin me veçori si besa mikëpritja, burrëria dhe nderi, kanë qenë “dëshmi e një superioriteti moral të shqiptarëve” (Shkreli 2015) në kohra dhe situata të ndryshme. Rëndësitë themelore të këtyre veçorive të pajisura me vlera të larta morale qëndronin dhe “shërbenin që të vendoseshin dhe të ruheshin lidhjet dhe miqësitë” (Shkreli 2015) ndërmjet njerëzve dhe popujve “pa marrë parasysh ndryshimet politike, fetare ose krahinore.” (Shkreli 2015) Në një kuadër global ku dallimet kulturore sjellin larmishmëri dhe pasuri, por ndasitë politike, fetare, ose ideologjike tentojnë të ndajnë njerëzit dhe popujt, vlera të tilla të vjetra tradicionale që kanë në thelb marrëdhënien dhe marrëveshjen ndërmjet njerëzve, meritojnë vëmendje dhe mundësi për promovim.

3.9.3 Kanunet shqiptare

Kanë ekzistuar disa kanune në Shqipëri për ligjet sociale dhe të drejtën zakonore. Disa nga këto janë, ‘Kanuni i Lekë Dugagjinit’, ‘Kanuni i Maleve ose i Malësisë së Madhe’, ‘Kanuni i Labërisë’, ‘Kanuni i Skënderbeut’ të cilët zbatoheshin në krahina të caktuara. Ato vepronin si “ligj i përbrendësuar” (Leopold 1978; 64)⁶³ “si dukuri sociale të mirëbrendësuar” (*po aty*) në një

⁶³Leopold P. 1978, fq 64, i cituar tek Bardhoshi N. 2011, fq.44. në botimin me titull “Gurtë e kufinit” Uet press

shumicë njerëzish të cilët i/e konsideronin atë/ato “bindës dhe të dëshirueshëm”(Ibid). Kanunet vepronin si institucione të cilat përfaqësoheshin nga pleqtë apo kryepleqtë të cilët vendosnin rregulla dhe kufizime.

Të gjitha kanunet përmbledhin dhe ushtrojnë “autoritet zakonor” (Bardhoshi 2011; 44) në aspekte të ngajshme që kanë të bëjnë me pronësinë, qeverisjen, familjen, fqinjin, etj. si për shembull: në “Kanunin e Skënderbeut, përmbledhen normativa që kanë të bëjnë me: familjen, shtëpinë, detyrimet, qeverimi, ndëshkimet, fajet e damet dhe kishën”⁶⁴. Këtu nuk do shihet aspekti normativ dhe zakonor për të gjitha kanunet që kanë ekzistuar në Shqipëri, por vlera e tyre, dhe rëndësia për popullin shqiptar. Kanuni përbën vlerë në vetvete, pasi ai *“përbënte bazat juridike dhe etiko-morale të shoqërisë shqiptare, pra përfshin ligjet, rregullat, normat, zakonet, doket, të cilat dhe pse nuk kanë qenë shkruar, kanë mbijetuar me shekuj, sepse janë ruajtur me fanatizëm në kujtesën e të parëve dhe janë transmetuar gojariht nga populli ynë, me të njëjtin mekanizëm si janë ruajtur dhe transmetuar gjuha e bukur shqipe, folklori i pasur, zakonet fisnike dhe historia e jonë e gjatë dhe e lavdishme.”* (Alia 2012) Ka majft autorë të cilët kanë evidentuar “rolin e kanunit në rregullimin e raporteve ekonomike dhe tregtare të shoqërisë shqiptare, përparësitë në disiplinimin e të drejtës së pronës” (Alia 2012) etj.

‘Kanuni i Lekë Dugagjinit’ ka pasqyruar vlera të larta etiko-morale, si një e drejtë apo forcë zakonore me ligje të pashkruara dhe në këtë formë nuk është vetëm “një përpilim i të drejtës zakonore, por deri tani më i mirënjohuri” në këtë fushë dhe “objekt interesimi ndër historianë, ekspertë ligjorë, etnografë, jo vetëm në Shqipëri dhe Kosovë, por edhe jashtë” (Elsie 2001; 148) E drejta zakonore shqiptare, e pasqyruar në kanune ku si më i rëndësishëm nga përpilimi dhe më i plotë njihet ai i ‘Lek Dugagjinit’, për vlerën që pati “në rregullimin e raporteve ekonomike dhe tregtare të shoqërisë shqiptare, përparësitë në disiplinimin e të drejtës së pronës” (Alia 2012) dhe “rregullimin e marrëdhënieve familjare e

⁶⁴Dr. Musa Ahmeti , 2007, Kanuni i Skënderbeut, vepër monumentale e kulturës sonë, <http://www.forumishqiptar.com/threads/91609-Kanuni-i-Sk%C3%ABnderbeut> parë më 16.5.2016

shoqërore”(Alia 2012).Vlerë tjetër që përcolli gjatë periudhës që ishte në përdorim përbënte fakti se në “shtratin historik dhe kulturore” (Alia 2012) të tij, lindi dhe u zbatua e drejta zakonore shqiptare, etika, morali dhe rregulli shoqëror”(Ibid) duke qenë se sa ishte në përdorim“ka drejtuar dhe administruar të gjitha aspektet e jetës të shoqërisë shqiptare”(Alia 2012). Përveç këtyre, e drejta zakonore apo “dokësore” (Bardhoshi 2011; 36) kishte një funksion që ndihmoi shumë “në krijimin, ruajtjen dhe kohezionin social. Përkatesisht në kohezionin etnik” (Bardhoshi 2011; 37) kombëtar shqiptar.

3.9.4 Lindja,martesa dhe vdekja

Pamjen dhe dukjen e cermonialeve e kanë gjithashtu edhe lindjet dhe vdekjet, por edhe dasmat në Shqipëri. Ato “përcillen me pritje shumë të mëdha dhe ceremoniale madhështore” (Bashkurti 2004; 135) Lindja është një ngjarje me rëndësi jo vetëm për çiftin që kanë sjellë në jetë një fëmijë por edhe për familjarët e tjerë, të afërmit, fafëfisnin etj..Dëshira për t`u shtuar me pasardhës apo trashëgimtar “në fakt shfaqet që në ditën e martesës, në ditën e dasmës, kur nusja hyn në oborr e me ç`rast i hidhet mbi kokë grurë e sheqerka.(Dojaka 1978; 132) ku karakteristike e këtyre cermonialeve janë këngët sipas krahinave të ndryshme shqiptare dhe vallet që shoqërojnë ceremoninë, si p.sh në krahinën e veriut në Shkodër, “materiali folklorik”⁶⁵ i kësaj zone, pasqyrohet “me dasmat karakteristike me këngë e jare shkodrane.”⁶⁶ Lindja e një fëmijë shoqërohet gjithashtu nga këngë, hare dhe gëzim. ‘Ninullat’ apo ‘këngët e djepit’ janë këngë karakteristike që shoqërojnë, lindjen dhe rritjen e një fëmije. Ato paraqesin një rëndësi të veçantë si “një pasuri të lirikës gojore” (Hajrullahu 2013) dhe “vlerësohen si pjesë e rëndësishme e krijimtarisë letrare popullore e që në fakt shprehin traditën e fushës së kulturës shpirtërore të trashëguar”(Hajrullahu 2013) ndër vite. “Ninullat janë përqendruar te figurat historike, legjendare” (Hajrullahu 2013) të dikurshme, ku vihet re “që edhe në ditët e sotme nuk janë lënë anash

⁶⁵Rituali i Jetës, gjama, dasma, lindja ngjiten në skenë, marrë nga <http://www.panorama.com.al/%E2%80%99Rituali-i-jetes%E2%80%9D-gjama-dasma-lindja-ngjiten-ne-skene/> pare me 16.6.2016

⁶⁶(ibid)

aspak figurat legjendare, kreshnike, si ato të urtësisë dhe mençurisë. Meqenëse populli shqiptar ka një letërsi të pasur që daton në kohëra të lashta”(po aty) ninullat kanë qenë objekt studimi *‘për studime të shumta nga studiues dhe autorë të njohur vendas dhe të hua,j’*”(po aty) Një tjetër rit që aplikohet në disa krahina, kur kryhen vizita për lindjen e fëmijëve, është edhe sjellja e vezëve si dhuratë, për të lindurit djem, sillen vezë në numër çift dhe për të lindurat vajzë, vezë në numër tek, duke pasur parasysh preferencën e shqiptarit për të lindur djem më shumë se vajza. Vezët, grurët dhe sheqerkat përfaqësojnë dëshirën për vazhdimësinë e jetës nëpërmjet trashëgimtarëve të shumtë.

Edhe vdekja ka ceremonialin e saj në Shqipëri. “Efekti tragjik i konstatimit të dukurisë së vajtimit masiv shumëzërësh, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë përsëri edhe tek mjaft studiues dhe udhëtarë që përshkonin viset tona në kohë dhe vise të ndryshme.” (Tole 2013)“Kur vdes një burrë ceremonia e varrimit është kaq e madhe sa e rrënon familjen. Rrëfimi që bën Herodoti për varrimet e thraksave vlen për malësitë e sotme. Disa fise e kanë thjeshtuar ceremoninë, por asnjë nuk ka hequr dorë” (Durham 1991; 503) Me aktin e vdekjes dhe procesin e varrimit janë të lidhura edhe një sërë bestytish të tjera në popull. Ajo çfarë është karakteristike në vdekje është vaji, ose këngët e vajit, të cilat këndohen nga gratë. Këngët vajtuese mbartin vlera dhe kanë domethënie sepse “paraqesin në radhë të parë ato gjëmë-kuisjet e vajtoreve shqiptare në Jug të Shqipërisë” (Tole 2013).

Në disa rrjeshtime të vajit, mendon autori Tole “futet edhe e qara me bote”, në të cilën ne gjejmë gjenezën e lindjes së iso-polifonisë popullore, e shpallur së fundi nga Unesco edhe si "kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit." (Tole 2013) Gjithashtu autori Vasil S. Tole shton se në “studimin e *"Odiseja dhe Sirenat, grishje drejt viseve iso-polifonike të Epirit"* , kemi tërhequr vëmendjen në lidhjen që ekziston mes vajtimit dhe praktikave të varrimit me tuma tek ilirët dhe epirotët, ku mendohet se duhet kërkuar edhe fillesa e poezisë së lashtë gojore. Një skemë e tillë, e mirë strukturuar, që sigurisht tregon nivelin e lartë artistik të perceptimit të jetës dhe të vdekjes nga banorët e atyre anëve. (ibid)

3.9.5 Folklori Shqiptar

Letërsia gojore shqiptare është shumë e pasur me elementë kulturore duke qenë se është e “lidhur ngushtë me jetën, zakonet e besimet e një populli” (Sako 1984; 14) Letësia gojore në çdo formë, si këngë popullore, poezi, legjenda, përralla, tregon shumë për një popull, duke të njohur me të vërtetat e tij. “Folklori është pasqyra e jetës së një populli dhe aspiratave shekullore të tij”(Sako 1984; 15), pasi aty ka shënuar ngjarjet e jetës së tij dhe shërben si “pikënisja e letërsisë artistike” (Sako 1984; 15).

Lirika popullore shqiptare apo vargjet orale, përmbajnë çshtje dhe tematika të ndryshme, të lëvruara në gjini të ndryshme.”Proverbat dhe gjëzat janë të thëna të shkurta ku është fiksuar” (Sako 1984; 43) eksperiencia jetësore e brezave të popullit. “Këngët historike” (Sako 1984; 79) të cilat flasin ngjarje dhe persona historikë konkretë”(Ibid), këngët e dashurisë, të mërgimit etj. Disa nga këto janë “Këngët e Kreshnikëve”, si p.sh “*Cikli kryesor, ai i "Mujo dhe Halilit," ruan shumë nga shija e kulturave të tjera heroike të tilla, si ato të pasqyruara në Iliada e Homerit në greqisht, Beowulf në anglisht, El Cid në spanjisht, Chanson de Roland në frëngjisht, Nibelungenlied gjermane dhe Byliny ruse*”.(Elsie) Kënga popullore Shqiptare, si pjesë edhe e ceremonialeve të lartpërmendura është e pasur me vlera të rralla. “Kënga popullore në mënyrën më besnike e përcjell njeriun gjatë tërë jetës së tij , që nga lindja e deri në vdekje. Në këngët tona popullore , nuk ka shpëtuar as një pjesë e jetës së njeriut, rritja, puna, sukseset, gëzimet, vuajtjet , hidhërimet, luftërat, kurbeti, sëmundjet , vdekjet, vajtimet pa u përfshirë në mënyrën më besnike përmes melodisë, vargjeve dhe këndimit të tyre” (Krasniqi)⁶⁷

Këngë të tjera janë Këngët e ‘Fushë-Betejës së Kosovës’, këngët çame, ato arbëreshe, o e bukura More, legjenda, balada, etj. Mendohet se lirika popullore, vargjet orale dëshmojnë se ato janë kultivime të hershme që kanë ardhë si trashëgimi brez pas brezi duke sjellë vlera dhe dëshmi për jetesën e hershme të

⁶⁷Krasniqi D, Nje jetë e tërë nëpër këngë, www.preshevajone.com,
<http://www.preshevajone.com/nje-jete-e-tere-neper-kenge/> pare me 20.6.2016

ilirëve. “Sipas Hamondit praktika ilire e tumave të ceremonive rituale të varrimit, ka qenë në zanafillë edhe shkaku i lindjes së poezisë orale në Ballkan, bile edhe para Homerit” (Zeqo 1995; 209) Autori Zeqo përmend vargun e njohur të Quint Enit *“Illyrici restant sicas et sibonisque forden”* (*“Ilirët janë të fortë në hanxharë dhe heshta”*), jo vetëm që nga lart i shikon vetitë e të parëve tanë, por në fjalën *‘sica’* ruan në zanafillë formën më të lashtë të shqipes *‘thika’*, në kuptimin e hanxharit. Sica si armë e ilirëve është përhapur në disa gjuhë të Europës së vjetër” (Zeqo 1995; 210).

Kjo nënkupton se nëpërmjet kësaj poezie orale kuptohen shumë detaje në lidhje me lashtësinë dhe gjuhën dhe traditat kulturore të shqiptarëve që në lashtësi, të cilat janë produkte kulturore për t’u promovuar dhe për t’u këmbyer si vlera kulturore dhe si gjuhë e përbashkët për dialog kulturor. “Kjo kulturë, në radhë të parë përbën atë, që ne e quajmë taban kombëtar, dhe foklori me kalimin nga periudha parakombëtare në atë kombëtare, mbetet forma kryesore e kulturës shqiptare, duke lejuar që populli shqiptar të krijojë traditat e veta, t’i shprehë dhe t’i përcjellë nga brezi në brez. Tani me marrëdhëniet e ndërsjella që kanë popujt ndërmjet njëri-tjetrit, foklori shqiptar mund të pasqyrojë fizionominë karakteristike shqiptare të shpirtit, të ideve dhe të kulturës së kultivuar ndër shekuj.

KAPITULLI IV

Vlerat thelbësore dhe normat e reja post/demokratike.

Rëndësia e tyre për BE-në dhe normate reja në realitetin shqiptar.

4.1 Si do zhvillohet dekonstruktimi i kategorisë së vlerave politike-normative për secilin rrafsh

Ky kapitull rreket të paraqesë vlerat thelbësore nga baza e fuqisë normative dhe normat e reja post-demokratike europiane të cilat do të shtjellohen dhe zbërthehen për të kuptuar vlerën që kanë ato për BE-në dhe sa të rëndësishme janë normat e reja që rrjedhin dhe janë riformuluar nga baza e vlerave thelbësore në aplikim (dhe në kthimin e tyre në vlerë të përvetësuar) jo vetëm për vendet anëtare por

edhe për vende si Shqipëria që synojnë të anëtarësohen në BE. Si fillim në këtë kapitull do të shqyrtohet fuqia e butë si koncept dhe çfarë përcillet ose kërkohet të aplikohet nëpërmjet kësaj fuqie, si dhe normat që ekzistojnë në themel të kësaj fuqie. Kjo bëhet për të kuptuar nivelin e përplasjes apo të frakturës që krijohet kur zbërthehen vlerat liberale kombëtare me ato çfarë aplikon BE si norma post-demokratike për vende aspirante ose kandidate për antarësim.

Nëse gjatë zbërthimit më lart të kategorisë kulturore të vlerave nuk ndodh përplasje, duke marrë parasysh diversitetin kulturor në të cilin ndodhet BE sot, përkundrazi Shqipëria e ka një identitet kulturor për ta shpalosur në familjen e madhe të kombeve, krejt ndryshe ndodh në aspektin politik, normativ institucional ku kategoria e vlerave politike-normative kombëtare jo vetëm krijon mospërputhje me vlerat thelbësore dhe normat e marra në mënyrë të mirëqenë, por është dhe pjesë e cila vazhdon ta vonojë anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Në këtë këndvështrim Shqipëria duhet të ndërtojë themelet e saj, të konstruktohet duke implementuar dhe perfeksionuar fushën politike, demokratike dhe institucionale, në mënyrë që të forcojë dhe të zhvillojë vlerat liberale duke u përshtatur me normat e reja bashkohore të BE-së, jo vetëm që të krijojë përputhshmëri me vlerat demokratike europiane, por që të zhvillohet dhe të emancipohet në këtë drejtim së brendshmi, për mirëqenien e saj kombëtare. Jo pa qëllim evidentohet roli politik konstruktiv dhe reformues i BE-së për vëndet si Shqipëria të cilat dëshirojnë të hyjnë në BE.

BE evidentohet si aktori më i rëndësishëm ndërkombëtar në ushtrimin e fuqisë normative jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkan. Pra, roli normativ theksohet për të evidentuar me tej, me detaje se çfarë rëndësie mbart për kulturën politike shqiptare dhe validitetin normativ në Shqipëri fuqia normative e BE-së. Gjithashtu edhe pjesa që flet për sundimin e demokracisë dhe lirisë në BE shtjellohet më poshtë për të parë çfarë të mirash mund të marrë ose të mësojë aktori shqiptar nga këto vlera dhe norma të BE-së. Në një sistem vleror, çdo hallkë ka profilin e saj, që do të thotë se përveç identitetit kulturor Shqipëria ka dhe një identitet politik.

Meqenëse do të zbërthehet fuqia normative dhe vlerat thelbësore e post-demokratike të BE-së, është e rëndësishme për të kuptuar se si është krijuar ky identitet politik-normativ për të prodhuar ato vlera liberale në të cilat ende çalon. Këtë gjë e dëshmojnë më së miri periudhat dhe kthesat e vështira në të cilin ka kaluar kombi shqiptar. Pasi të shtjellohen periudhat historike ku ka kaluar identiteti shqiptar (sidomos ai politik), të cilat kanë lënë gjurmë më shumë në kulturën shtet-formuese dhe politike, më shumë se sa në atë të vlerave kulturore të mbijetesës, do të shtjellohet edhe kultura politike, dhe realiteti normativ me vlerat liberale si pjesë gjithashtu përbërëse e këtij sistemi vleror, në të cilin po jeton Shqipëria në kuadër të integritetit në BE, kushtet dhe mundësitë për adoptim nëpërmjet fuqisë normative që aplikon BE-ja, dhe mundësitë për përmirësimin e imazhit, promovimit të vlerave nëpërmjet diplomacisë publike.

Përfshirja e kategorisë së vlerave post-demokratike të BE-së dhe e vlerave liberale nga ana tjetër të kombit Shqiptar në sistemet vlerore përkatëse për çdo entitet, bëhet për të dhënë një panoramë të qartë të bazave (vlerave) të cilat jo vetëm kanë frakturë por kanë penguar edhe kategorinë e vlerave kulturore për t'u zhvilluar dhe promovuar ashtu sikurse çdo komb promovon vetveten në arenën ndërkombëtare.

4.2 BE si fuqi normative

Për të analizuar BE-në si fuqi e butë dhe më konkretisht qasjen e saj si fuqi me karakter normues apo normativ është rëndësishme të shikohen në përgjithësi karakteristikat e fuqisë së butë dhe fuqisë normative, ngjashmëritë dhe veçantitë me fuqinë e butë (soft power). Të dyja teoritë, (fuqia e butë) dhe (fuqia normative) “merren me politikat e jashtme të fuqive ndërkombëtare.”(Barkl 2013; 3) Edhe pse “të dyja teoritë hipotetizojnë mbi rolin e normave dhe identiteteve ndërkombëtare të cilat kontribuojnë në fuqi, ende kanë mbetur të paprovuara këto supozime/hipoteza” (Ibid 2013;3) Kjo shpjegon faktin që, edhe fuqia e butë si në koncept ashtu edhe në praktikë, ka hasur kritika dhe debate të shumta, por këtu do trajtohet për ato vlera që mban në themel, si i aplikon dhe çfarë kërkon nëpërmjet tyre.

Në “teorinë e fuqisë së butë fokusi bie më pak në atë, se çfarë lloj aktori është një fuqi” (ndërkombëtare) duke u fokusuar “më shumë mbi atë se çfarë mjetesh përdor dhe si i përdor ato” (Li 2009;7) Gjithsesi, meqenëse ky kapitull në pjesën e parë merret kryesisht me BE-në si fuqi normative duhet patur parasysh që “fuqia normative është aftësia për të formësuar dhe ndryshuar atë që kalon për normale në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe që padyshim do të ketë dimensionet utilitare, sociale dhe narrative tek ajo, ashtu siç për të cilën do vihet dhe në dyshim’. (Manners 2001;10) Fuqia normative që ushtron një aktor ndërkombëtar si BE e përfaqëson atë edhe anasjelltas si aktor. BE ka evoluar shumë si një model qeverisjeje dhe si model politik supra-nacional. Ajo sot përfaqëson një bashkësi kombesh që bëjnë pjesë në një projekt politik i cili aplikon një formë të re për mënyrën e të bërit politikë, për arsyen e normave dhe principeve të cilat qëndrojnë në themel të politik-bërjes së saj. Në kuadrin politik, “normat e saj kushtetuese përfaqësojnë faktorë të rëndësishëm themelorë të cilët përcaktojnë identitetin e saj ndërkombëtar. (Manners 2002; 241) Respektimi i këtyre normave dhe principeve janë baza për mbarëvajtjen e marrëdhënieve me shtetet anëtare të Unionit.

Megjithë valët e ndryshme të zgjerimit, traktateve dhe deklaratave që janë zhvilluar gjatë viteve, baza normative ka evoluar me kohën, gjithashtu edhe “ndryshimet procedurale”(Caka, Zajmi, Bishaj 2012;49) nga traktati në traktat, kriteret apo kushtet për anëtarësim kanë pësuar ndryshime dhe kanë pasur specifikat apo karakteristikat e veta në varësi të vendeve që janë antarësuar ose që presin të antarësohen, (si në rastin e Shqipërisë e cila bën pjesë në vendet e Ballkanit perëndimor ku vihet re një “zgjerim i kushtëzimit” (Caka, Zajmi, Bishaj 2012: 57) që do të thotë “shtimi i kriterëve të reja për aderim dhe riinterpretim në mënyrë të zgjeruar të kriterëve të mëparshme” (Ibid 2012; 57) si dhe reforma të tjera në vend.

“Fuqia e Butë (Soft power) ka qëndruar në themel të politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së si një mekanizëm për të promovuar vlerat e fuqisë normative dhe standardet europiane të cilat kanë tërhequr dhe vazhdojnë të tërheqin vendet ose shtetet drejt procesit të integritetit. Sipas autorit Portela, “fuqia e butë nuk ka

qenë një koncept “i bërë me porosi” për BE-në ashtu siç ka qenë p.sh (“fuqia civile”/civilian power) dhe (“fuqia normative”/normative power) (Nielsen 2013, 726)⁶⁸ “Fuqia e butë është aftësia për të ndikuar tek të tjerët për të marrë rezultatet e dëshiruar nëpërmjet tërheqjes/joshjes në vend të shtrëngimeve apo pagesave” (Nye Jr. 2008;94) Megjithatë kur vërehet procesi i antarësimit në BE si i shteteve që janë pjesë e BE-së, ashtu edhe i shteteve që dëshirojnë dhe kërkojnë antarësimin, dallohet që ka aplikim të një lloj fuqie të butë, e cila ushtrohet për të tërhequr shtetet drejt integritit të plotë. Fuqia e butë nuk e kontraston fuqinë normative.

Kur shqyrtohet rasti i Shqipërisë apo i vendeve të Ballkanit në veçanti, theksi bie në "pesë normat themelore të paqes, lirisë, demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtat e njeriut nga baza e fuqisë normative, të përcaktuara nga BE-ja si kriter për anëtarësim "(Barkl 2013, 19); (plus kritereve të tjera të shtuara që kanë të bëjnë me reformat), ja përsendryshimi duhet të specifikohet, pasi ajo çfarë aplikon BE në këtë rast, është më tepër fuqi normative e aplikuar. Për më tepër, "këto norma plotësohen me normat e progresit shoqëror, anti-diskriminimit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë "(Barkl 2013 19). Në të kundërtën, nëse marrim rastin e fuqisë së butë, ato në përgjithësi nuk janë të përcaktuaraq shumë ose aq mirë, si në rastin e fuqisë normative që aplikon BE. "Fuqia e butë është një koncept përshkrues, më tepër se sa normativë/normues. "(Nye 2011 81)⁶⁹

Fuqia normative përputhet shumë me fuqinë e butë kur bëhet fjalë për “ndryshimin e përceptimeve” dhe “ndikimin konceptual” (Barkl 2013; 16) jashtë vendit, pasi pavarësisht se njëra fuqi ka karakter përshkrues dhe tjetra normues,

⁶⁸Megjithatë, “Narrativa historike e integritit paqësor të BE-së ndërmjet shteteve më parë ndërluftuese është tregues i një burimi të rëndësishëm të fuqisë së butë, - për të cilën ajo ka marrë dhe çmimin Nobel për paqen në vitin 2012” (Nielsen 2013; 729)

⁶⁹Këtë pjesë e kam theksuar edhe në një punim timin me titull; “THE WESTERN BALKANS BETWEEN INTERNAL TRANSITIONS AND THE EU INTEGRATION PROCESS” Elira Luli, Europolity, vol.9, nr.2. 2015, në fq 117-118
<http://europolity.eu/wp-content/uploads/2015/12/Vol.-9.-No.-2.-2015.pdf>

kur bëhet fjalë për promovim të vlerave të dyja përputhen në një drejtim në lidhje me promovimin e “normave ndërkombëtare” (Ibid 2013; 17), dhe aplikimi i këtyre normave në realitete kombëtare të pasqyrohet anasjelltas në realitet ndërkombëtar. Pikërisht, duke qenë se Shqipëria ka mbetur pas përse i përket ndryshimit të përceptimeve dhe mos-promovimit siç duhet të vetes për sa i përket këtyre normave ndërkombëtare të cilave i mëshon BE, për këtë arsye edhe kategoria e vlerave kulturore ka mbetur e papromovuar sa duhet dhe e pa vlerësuar sa duhet. BE si aktor normues ka fuqinë për të ndikuar mbi një aktor që është në partneritet me të apo në një marrëdhënie me të, në lidhje me atë se çfarë kalon për normale në marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Teoria e fuqisë normative supozon se një aktor në marrëdhënie”, si në rastin e Shqipërisë që është në marrëdhënie të vazhdueshme me BE-në për procesin e anëtarësimit, “është një aktor më “normal” se një tjetër” (Barkl 2013; 17) sepse i është nënshtruar ndryshimeve me karakter normues duke filluar të pasqyroj validitetin e këtyre normave në realitetin kombëtar të tij. Shqipëria që pas rënies së diktaturës, i është drejtuar BE-së dhe “BE e ka mbështetur rrugën e Shqipërisë për demokraci që nga viti 1991” (Beshku 2013; 46)Që nga periudha e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2006), sa më shumë vonohet Shqipëria në pasqyrimin e validitetit normativ, në zhvillimin e vlerave liberale, dhe në aplikimin e normave dhe reformave,aq më shumë largohet data finale e anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Pavarësisht kritikave, vonesave që vijnë për shkak të procesit të ngadaltë të reformave në Shqipëri dhe euroskeptikëve nga ana e BE-së, BE mbetet aktori më i rëndësishëm i cili “ka kryer më mirë veprimtarinë e tij si një aktor normativ ndërkombëtar dhe, si pasojë dhe për rrjedhojë, si një fuqi e butë e bashkësisë ndërkombëtare” (*ibid*) në Shqipëri dhe në Ballkan.

Më poshtë, kur të trajtohet realiteti i vlerave liberale kombëtare shqiptare, do të shihet pse ka çaluar ose vonuar ky aspekt në realitetin shqiptardhe do të vërehet se sa është përshtatur Shqipëria me këtë realitet që aplikon BE. Më poshtë do të analizohen dhe zbërthehen më gjerësisht cilat janë normat dhe principet kryesore

që qëndrojnë në themel të BE-së dhe çfarë kërkohet më shumë nga BE në kuadrin e reformave që po ndërmerr Shqipëria për antarësimin në BE.

4.2.1 Vlerat dhe normat që ekzistojnë në themel të BE-së.

Për të zbërthyer në mënyrë të detajuar vlerat dhe normat që qëndrojnë në themel të politik-bërjes së BE-së si aktor ndërkombëtar, ky punim do t'i referohet më së shumti autorit Ian Manners, cili e solli konceptin e fuqisë normative në përdorim me punimet e tij dhe më pas vijuan edhe debatet nga kerkues shkencore dhe akademikë të tjerë në lidhje me këtë koncept dhe kontradiktat që mund të mbartë brenda vetes. Gjithashtu do t'i referohet edhe autorit Thomas Diez, i cili e lidh fuqinë normative me identitetet që krijohet nga diskursi normativ.

Duke lënë mënjanë debatet, (për ta lënë atë në fund të shtjellimit të kësaj pjese), si fillim do të shtjellohen principet e normat bazë të fuqisë normative të BE-së, si dhe simbolika dhe domethënia e tyre. Manners përcakton fuqinë normative si një fuqi që “vepron nëpërmjet ideve dhe opinioneve” (Diez 2013; 4) si fuqi “për të rregulluar/modeluar vlerat e të tjerëve” (Diez 2013;4), pra të (aktorëve të tjerë). Manners identifikon “5 norma themelore” (Manners 2001;10) të cilat përfshijnë “*acquis communautaire*” dhe “*acquis politique*”. (Ibid 2001;10) Për t'i renditur për nga rëndësia, duhet filluar me “*rolin qendror të paqes*” që gjendet tek deklarat kyçe simbolike si ajo e “Robert Schuman në 1950”, “Traktati i Çelikut dhe i Qymyrit, 1951” dhe *TEC “Treaty establishing European Communities” , 1957*”⁷⁰(Manners 2001; 10) Pas rolit qendror të paqes vijon “*Ideja e lirisë*” e cila gjendet tek *TEC* dhe Traktati i Bashkimit Europian “*Treaty of European Union*” (*TEU, 1991*)”. (Manners 2001; 10). Pas këtyre të dyjave vijojnë “*demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore*” (Ibid;10) të cilat gjithashtu janë në principet themelore të “TEU, artikulli 11, TEC, artikulli 177, dhe dispozitat e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë të Unionit dhe kriteret e anëtarësimit të adoptuara në Këshillin Europian të Kopenhagenit, 1993.” (Ibid;

⁷⁰TEC- Traktati Themelues i Komuniteteve Europiane, 1957

11) Pra, në përgjithësi ato të cilat vlerësohen si vlera themelore në BE janë, Paqja, respekti për të drejtat e njeriut, liria, demokracia, barazia dhe sundimi i ligjit.

- **Paqja**

Paqja mbetet jo vetëm një vlerë thelbësore për BE, por si një siguri për të kaluarën që konfliktet dhe luftrate së shkuarës të mos përsëriten më. Pra pas luftës së II-të botërore, BE arriti të zhvillohej si një nga projektet më paqësore të para ndonjëherë në histori. Kështu paqja mbetet jo vetëm një vlerë bazë për vendet anëtare të BE-së, por edhe një vlerë me të cilën BE kërkon të promovojë stabilitet, respektimin e lirive dhe të drejtave thelbësore dhe respektimin e ligjit. Këto janë vlera themelore të cilat mbajnë në unitet shtetet anëtare dhe duhet të pranohen dhe të respektohen jo vetëm nga shtetet anëtare por edhe nga shtetet që kërkojnë të anëtarësohen në BE. Pavarësisht euroskepticizmit, partitë e krahut të djathtë, nacionalizmi dhe radikalizmi në rritje dhe sfidate tjera që janë shfaqur në BE si pasojë e emigracionit krizës ekonomike, BE vazhdon të lëshojë mesazhe në favor të bashkimit, paqes, solidaritetit, përmirësimit të politikave të emigracionit, të zhvillimit dhe promovimit të mëtejshëm të këtyre vlerave. Këto vlera janë sanksionuara në traktate dhe një shtet që kërkon të anëtarësohet në BE duhet të respektojë këto vlera. Paqja arrihet dhe promovohet nëpërmjet një bashkëjetese të paqme, që pranon kulturat e ndryshme dhe diversitetin e shumëllojshëm. Duke mbyllur boshllëqet që krijojnë largësi kulturore, politike, ekonomike nëpërmjet dialogut konstruktiv dhe paqësor arrihet bashkpunimi në një ambient miqësor dhe progresi social mund të arrihet me hapa më të shpejta. “Paqja dhe siguria në njërën anë, dhe progresi social e zhvillimi ekonomik, nga ana tjetër, janë të lidhura ngushtë, të ndërvarura dhe ndikojnë njëri-tjetrin”⁷¹ Paqja është çelësi i konsensusit, i dialogut politik, i bashkëpunimit për reforma, pra çelësi për të

⁷¹Declaration on Social Progress and Development,
<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ProgressAndDevelopment.aspx> , parë më 5
12 2016

krijuar klimën e përshtatshme ku mund të ndodhin ndryshime pozitive demokratike.

- **Demokracia**

Demokracia, një tjetër vlerë thelbësore për BE-në, është një koncept që mbështetet në dy trarë të rëndësishëm siç janë *ideja e lirisë* dhe *e barazisë*. Nga koncepti i lirisë rrjedhin dhe janë zhvilluar koncepte të tjera si liria e vetëshprehjes, liria e fjalës, liria e publikut për t'u informuar, e zgjedhjeve të lira, pluralizmi i partive dhe organizatave, liria e shtypit etj. Ndërsa nga koncepti i barazisë rrjedhin të drejtat për barazi dhe shanse të barabarta ndërmjet njerëzve dhe të drejtave të tyre dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë. Në nivel shtetëror dhe institucional një demokraci funksionale karakterizohet nga llogaridhënia dhe përgjegjshmëria për të drejtat që rrjedhin nga liria dhe barazia. Një llogaridhënie dhe përgjegjshmëri e tillë garantohet nga sundimi i ligjit.

BE përbëhet nga vende që në parim kanë arritur të respektojnë standardet dhe normat demokratike, pra përfaqësohet nga vende demokratike. Demokracia në BE përfaqësohet ngamulti- sisteme qeverisjeje dhe është, “në fund të fundit, shprehja e fundit e demokracisë përfaqësuese”⁷². Pra nëse ka pakënaqësi, apo një lloj hendeku apo defiçiti demokratik (sikurse edhe cilësohet shpesh në artikuj të ndryshëm shkencor) brenda gjirit të BE-së, kjo vjen në radhë të parë edhe nga sistemet e qeverisjes dhe elitat që drejtojnë këto sisteme në nivel kombëtar.

Demokracia si vlerë thelbësore është një sistem qeverisjeje që ndihmon shtetin në forcimin e institucioneve, ndihmon dhe aftëson popullin për të kërkuar llogari dhe përgjegjshmëri ndaj institucioneve dhe elitave politike, dhe për të zgjedhur nëpërmjet votës së lirë. Demokracia e vërtetë pjesmarrëse arrin të prodhojë një qeverisje efikase. BE, duke ndryshuar praktikat institucionale dhe duke i kërkuar vendeve që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së që të implementojnë normat dhe

⁷² The rise of democracy in Europe. Mark Leonard. <https://www.aspistrategist.org.au/rise-democracy-europe/>, pare me 24.12.2015

zbatojnë kritere si demokracia, qeverisja e mirë, të drejtat themelore të njeriut, sundimin e ligjit etj, në këtë mënyrë i kërkon atyre të implementojë dhe të përvetësojnë normat e demokracisë. Kështu ajo kërkon të konsolidojë demokracinë në vendet që aspirojnë të bëhen pjesë, për të mundur të veprojnë si një organizëm që bashkohet nga të njëjtat vlera, për të mënjanuar destabilitetet, konfliktet dhe armiqësitat. Pra, vlerat e shumta që rrjedhin nga demokracia, si qeverisja e mirë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe sundimi i ligjit, kërkojnë transparencë, përgjegjshmëri, llogaridhënie, dhe reagim nga shoqëria publike për përmirësim politikash në favor të zhvillimit.

Demokracia dhe qeverisja e mirë janë në harmoni kur institucionet publike nuk zabtohen nga elitat politike për të avancuar interesin vetjak të tyre, kur luftohet korrupsioni, kur nuk abuzohet me postet publike, kur luftohet pabarazia dhe diskriminimi dhe kur ka llogaridhënie dhe vullnet politik për të qeverisur në mënyrën e duhur. Pra avancimi në të gjitha vlerat dhe normat e reja që ka vendosur BE për vende si Shqipëria që kërkojnë të anëtarësohen, kërkon demokraci dhe qeverisje efikase.

- **Sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut**

Sundimi i ligjit në BE është një vlerë bazë, e cila mban themelet e të gjitha vlerave të tjera. Pa sundimin dhe respektimin e ligjit duket sikur humbet rëndësia e të gjitha vlerave të tjera. Sundimi i ligjit vendos para përgjegjësisë dhe llogaridhënies të gjithë njësoj, si pushtetarët ashtu dhe qytetarët, në kuptin që të gjithë janë barabartë para drejtësisë dhe të gjithë duhet t'i binden asaj njësoj. Sikurse BE nuk është një unifikim i vetëm, por funksionon si një sistem qeverisjeje i shumë sistemeve, të cilat ndajnë këto vlera themelore të përbashkëta, ka pasur edhe sfida të ndryshme apo ngjarje të shfaqura nga vendet anëtare të cilat “kanë shfaqur kërcënime sistematike për sundimin e ligjit”⁷³

⁷³ Rule of Law, European Commission, marrë nga: http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/rule-of-law/index_en.htm , parë më 5.12.2016

Për këtë arsye Komisioni European “ka adoptuar një strukturë të re për të adresuar kërcënimet sistematike për sundimin e ligjit në komunikimin e saj të vitit 2014”⁷⁴ për ndonjë nga shtetet anëtare që ka tendencë apo paraqet shkelje në këtë drejtim. Kjo, gjithmonë sipas këtij komunikimi, do të thotë që, nëse një shtet paraqet shkelje të tilla në lidhje me sundimin e ligjit ose në fushën e drejtësisë, të cilat paraqesin rrezikshmëri që çështje të tilla të përshkallëzohen, komisioni merr masa nëpërmjet një procesi që ka në vetvete tre faza: vlerësimet, rekomandimet dhe monitorimet në vijim të rekomandimeve të komisionit.

“Nëse nuk gjendet zgjidhje dhe kompromis brenda kësaj strukture, neni i 7-të i TEU-Traktatit të BE-së, mbetet mjeti i fundit për të zgjidhur një krizë dhe për të siguruar që shteti anëtar është në përputhje me vlerat e BE-së”.⁷⁵ Në këtë aspekt vendeve aspirante, si Shqipëria duhet të përforcojnë sundimin e ligjit, zbatimin e tij dhe të luftojnë korrupsionin për të arritur standardet e duhura në këtë drejtim. Konsolidimi i këtij kriteri të rëndësishëm që pritet të japë rezultate edhe më të dukshme me reformën në drejtësi dhe zbatimin e saj në praktikë janë garancia për BE-në nga njëra anë, si dhe Shqipërinë nga ana tjetër, që mundësia për shkelje të jetë më e pakët kur Shqipëria të jetë anëtare me të drejta të plota, gjithashtu edhe si garanci për integritetin dhe krijimin e një bazë të mirë dhe të fortë për vlerat e tjera thelbësore tek të cilat BE i mbështet dhe i promovon. Kështu BE kërkon vende të cilat adoptojnë këto norma për t’i kthyer më vonë në vlera, që unioni të ketë në gjirin e saj vende me norma ose vlera të konsoliduara, për vetë ligjshmërinë e saj. Sa më koherente dhe sa më efikas të jetë rregulli dhe sundimi i ligjit brenda unionit, aq më e fuqishme dhe serioze do jetë jehona e saj dhe thirrja për promovimin e këtyre vlerave dhe jashtë BE-së.

Sundimi dhe zbatimi i ligjit në BE është i lidhur ngushtë jo vetëm me barazinë si koncept, në kuptimin që të gjithë janë të barabartë para ligjit, por edhe me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, pavarësisht, racës, ngjyrës, fesë, orientimit seksual, kombësisë, aftësive apo veprimtarive të tyre. “Mbrojtja e të drejtave

⁷⁴(*ibid*)

⁷⁵(*ibid*)

themelore është edhe një nga parimet e përgjithshme të ligjit të KE-së” (McCrudden and Prechal 2009; 4)

Pra ligjet e anti-diskriminimit, personat përgjegjës dhe institucionet duhet të bëjnë punën e tyre që këto ligje të zbatohen në praktikë. Pra për BE-në nuk është e rëndësishme vetëm respektimi i ligjit dhe zbatimi i tij, por edhe ndërgjegjësimi dhe informimi i duhur që këto të drejta dhe ligje të njihen në publik të gjerë, të kuptohen drejtë në mënyrë që të rritet konsensusi në kuadër të diversitetit të gjitha llojeve, dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Këto vlera themelore, që u paraqitën më lart, kanë sfidat e tyre brenda BE-së dhe debatet në lidhje me to vazhdojnë për arritjen e përmirësimeve dhe ku nuk ka përmirësime vazhdojnë kritikën. Por, pavarësisht sfidave apo problematikave që mund të shfaqin këto vlera brenda unionit, duke marrë parasysh sfidat që ka BE sot në sektorin ekonomik, social dhe të sigurisë, ato tashmë merren si të mirëqena për shtetet anëtare dhe për shtetet që kërkojnë të antarësohen si vlera që duhen të zbatohen dhe si vlera që përbashkojnë vendet e unionit dhe ata që dëshirojnë të antarësohen. Nëse nuk respektohen ato, atëherë vijohet me pezullime apo vonesa në këtë proces. Në këtë prizëm, në këtë studim, këto vlera merren si të mirëqena përsa kohë BE kërkon për një shtet që të mund të antarësohet, duhet të respektojë dhe të përvehtësojë këto vlera. Shfaqja e **normave të rejaose minore** që nga roli qendror i paqes dhe detyrimet normative të tjera minore (*minor norms*) janë të lidhura ngusht me përmbajtjen apo rrjedhën historike në të cilën është zhvilluar BE. Pra normat e reja thjesht kanë një riformulim duke marrë parasysh zhvillimet e reja pas 90-tës, por bazën e kanë tek normat themelore. Përpos faktit që janë rishfaqur dhe janë theksuar pas vitit 91, sidomos gjatë kriterëve të Kopenhagenit, duke zënë një vend apo duke i aplikuar si normat e reja, duke pasur parasysh valët e zgjerimit dhe vendet me të cilat BE ka ndërvepruar, ato sipas fakteve kanë qenë të pranishme edhe më herët, si në Traktatin themelues të komuniteteve europiane (1957), ashtu edhe në Traktatin e Bashkimit European (1991). Fakti që ato u shfaqën, u zgjeruan dhe morën më tepër rëndësi në kriteret e Kopenhagenit, “për të dalluar Europën përëndimore demokratike nga Europa

lindore komuniste” (*Ibid*; 11) në atë kohë, përcakton edhe arsyen përse theksoheshin më tepër këto norma gjatë marrëdhënieve që krijonin shtetet në procesin e anëtarësimit dhe konstruktimit me BE-në. Normat e *reja/minore* që u përcaktuan në vazhdim kishin gjithashtu një rëndësi të veçantë në lidhje me kontekste të caktuara. Ndër këto janë:

- ***Progresi social***

Norma e **“progresit social”** e cila gjendet gjatë gjithë “*aquis communautaire*” dhe “politique” dhe në hyrje të “TEC dhe TEU, artikulli 2” (*ibid*).

Kjo normë ka lidhje drejtpërsëdrejti me “liberalizimin në Aktin e Vetëm European (Single European Act “SEA”) dhe me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (Economic and Monetary Union “EMU”)(*ibid*:11). BE i kushton shumë rëndësi progresit social dhe zhvillimit ekonomik, të cilat nuk mund të ndahen nga njëra tjetra. Rritja ekonomike, rritja e cilësisë së jetesës për qytetarët e një vendi, duke përmirësuar dhe zhvilluar sektorët si shëndetësia, edukimi, vende të lira pune, të ardhura më të mira, sigurinë etj etj.

- **“Anti-diskriminimi”**

Norma anti-diskriminim u shfaq po gjithashtu si një normë post-demokratike, pas 90-tës si nevojë për të luftuar “racizmin” dhe “persekutimin ndaj minoriteteve” (*ibid*; 11)Ajo gjendet në “artikullin e 13-të të TEC” dhe “Kriteret e Kopenhagenit” (*ibid*). BE i kushton shumë rëndësi kësaj norme, për vendet të cilat janë proces integrimi. Këto vende duhet të përshtasin ligjet e anti-diskriminimit ta aplikojnë mekanizmat e zbatimit që legjislacioni i kësaj fushe të funksionojë si në teori dhe në praktikë, në mënyrë që të luftohet racizmi dhe diskriminimi në çdo fushë.

- **“Zhvillimi i qëndrueshëm”**

Në vitin 1992, kur u zhvillua dhe “Samiti i Tokës” “Earth Summit” nga UN i cili kishte si synim “zhvillimin ekonomik dhe gjetjen e mënyrave për të ndalur

shkatërrimin e burimeve të pazëvendësueshme natyrore dhe ndotjen e planetit”⁷⁶ mori rëndësi dhe norma e “zhvillimit të qëndrueshëm” e cila u “përfshi në traktate nëpërmjet Traktatit të Amsterdimit (Treaty of Amsterdam “TOA”)(Manners 2001; 11) dhe gjendet gjithashtu në “artikullin 2” si tek “TEC” dhe “TEU” dhe “artikullin 6, TEC” (*ibid*). Pastaj, më vonë u zhvillua dhe konferenca e Rio-s, pikërisht mbi temat për varfërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, “Rio-20”. Këtu, “qeveritë vendosën për të zhvilluar objektivat globale të zhvillimit të qëndrueshëm, duke u mbështetur në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, por edhe duke përfshirë çështje të tilla si menaxhimi i burimeve natyrore, konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, institucione efektive, qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe të shoqërive paqësore”⁷⁷. Kjo konferencë i dha rrugë një agjende për zhvillimin e qëndrueshëm e cila synon të përmbushë qëllimet e saja në vitin 2030.

- **“Qeverisja e mirë”**

Në fund është dhe rasti i “Europës Qendrore dhe Lindore” ku merr rëndësi të veçantë norma e **“qeverisjes së mirë/good governance”** (*Ibid*;11) e cila nuk gjendet zyrtarisht e formuluar në ndonjë traktat, por gjendet tek kriteret e Kopenhagenit dhe “dokumentat e fundit të Komisionit” (*ibid*), në lidhje me asistencën e BE-së për zgjedhjet dhe qeverisjen Europiane.⁷⁸

BE kërkon sipas kësaj norme, një qeverisje demokratike në nivel vendor, zgjedhje të lira dhe të ndershme, të përmbushen pritshmëritë e qytetarëve ndaj politikës dhe institucioneve, të ketë transparencë, llogaridhënie, administratë publike eficiente, të sundojë dhe të respektohet ligji, të luftohet korrupsioni në të gjitha nivelet, të punohet për shvillim të qëndrueshëm , të respektohen të drejtat e njeriut dhe të pranohet diversiteti kulturor etj.

⁷⁶UNConference on Environment and Development 1992<http://www.un.org/geninfo/bp/enviro.html>

⁷⁷ The 2030 Agenda for Sustainable Development and the SDGs, http://ec.europa.eu/environment/sustainable-development/SDGs/index_en.htm, parë më 4 dhjetor 2016

⁷⁸ (EU election assistance and observation) (COM 2000 (1991) final) dhe (European Governance (SEC (2000) 157/4 final) (Manners 2001:11)

Më poshtë këto norma vijojnë të paqyruara në një tabelë e cila i paraqet ato në mënyrë më të detajuar.

Baza e Fuqisë Normative të BE-së⁷⁹

Vlerat Themelore	Detyrat & Objektivat	Institucionet e Qendrueshme	Të Drejtat Themelore
- Liria - Demokracia - Respekti për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore - Sundimi Ligjit	- Progresi Social - Anti-Diskriminimi - Zhvillimi I Qëndrueshëm	- Garantimi I Demokracise - Sundimi I Ligjit - Të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale - Mbrojtja e Minoriteteve	- Dinjiteti - Liritë - Barazia - Solidariteti - Shtetësia/Qytetaria - Drejtësia
Traktati – të vendosura në Artikullin/Nenin 6 të Traktatit mbi Bashkimin European	Traktati – Të vendosura në Artikullin/Nenin 2 të “TEC” dhe “TEU”, dhe Artikulli /Neni 6 dhe 13 i TEC	Kriteret e Kopenhagenit – të vendosura në konkluzionet e Këshillit European të Qershorit 1993	Draft Statuti i të Drejtave Themelore të Bashkimit European

Me daljen e një-pasnjëshme të normave të reja në varësi të valëve të zgjerimit apo ngjarjeve të ndryshme në momente të caktuara historike edhe pse ishin të theksuara në traktatet ekzistuese, vërehet sa ka evoluar Europa nga konteksti historik i post Luftës së Dytë Botërore si një organizatë politike, që i ka kaluar përmasat e një qeverisjeje globale vetëm për qëllime ekonomike, por që i ka dhënë identitet të mirëfilltë vetes nëpërmjet këtyre “normave dalluese”(Manners 2001;12) në arenën ndërkombëtare, të cilat tashmë janë të vulosura edhe në traktatet e saj. Shfaqja dhe vendosja e këtyre normave nga traktatet e ekzistuese deri tek ndryshimi në valët e zgjerimit që u rishfaqën normat e reja, kjo gjë ka hasur dhe debate e diskutime të ndryshme siç u cek edhe më lart në lidhje me universalitetin dhe vlefshmërinë e tyre,nëse apo “sikur të gjitha të ishin të mira”(Manners 2001’12) dhe, më së shumti, këto debate ndeshen tek “katër normat minore”, që vijuan më vonë, pasi “normat themelore/kryesore janë në

⁷⁹Manners I. 2001, Normative Power Europe: The International Role of the EU, Figure four, pg.11

përgjithësi universale brenda BE-së” (Manners 2001; 12), pra nga norma, janë kthyer në vlera. *“Fuqia normative - fuqia në përgjithësi – normuese, ekziston në bazë të marrëdhënies të ‘fuqi dhënësit’/’power giver’ që është BE dhe ‘fuqi marrësit’/’power reciever’”(Barkl 2013;22-23), që është aktori që kërkon të hyjë apo t’i nënshtrohet një marrëdhëniejeje konstruktimi me aktorin BE. BE nuk mund të jetë një fuqi normative thjesht vetëm duke u mbështetur në diskursin normativ. Në qoftëse qëllimet dhe mjetet e saja nuk janë normative ose nuk prodhojnë një efekt normativ, atëherë kjo nuk është e përputhshme me fuqinë normative” (ibid)*

Ky përkufizim i autorit Barkl vërehet edhe në rastet që përshkruan Manners kur shpreh rezervat e tij në lidhje me vlefshmërinë e normave minore, si p.sh në rastin e “normës së progresit social që mund të jetë e dobët tek ato shtete anëtare të cilat janë duke pëqafuar filozofitë neo-liberale ekonomike” (Manners 2001;12), pra nuk prodhohet efekti i progresit social i dëshirueshëm nga BE apo “norma e zhvillimit të qëndrueshëm që mund të gjendet vërtetë vetëm në Europën veriore”. (Ibid;12) Ndërkohë që antidiskriminimi është “tipik për pjesën më të madhe të BE-së, për të mos folur për “normën e qeverisjes së mirë, e cila supozohet të jetë e dobët brenda vetë BE-së” (Ibid; 12) Me gjithë këto debate që ka hasur fuqia normative si dhe të metat që ka hasur aplikimi i saj në praktikë, nga shumë faktorë për vendet që janë sot pjesë e BE-së dhe jo vetëm për ata që aspirojnë të antarësohen në BE, ky studim mbështet idenë se pavarësisht faktorëve dhe predispozitave penguese që ekzistojnë në shtete të ndryshme, nga faktorë të ndryshëm, vetë marrëdhënia e konstruktimit që krijohet me shtetin që kërkon të antarësohet është ndihmuese, sidomos për aspektin politik-normativ. Ky konstatim përforëcohet dhe nga ideja e Wend-it kur konstaton që “shtetet ekzistojnë para sistemit shtetëror” (Keohane 2000) në kuptimin që “identiteti i shteteve duket se është krijuar para hyrjes së tyre në sistem”(Williams 2008), pasi hyrja në një sistem ndërshtetëror apo “të shteteve” (ibid) vetëm e rregullon identitetin e një shteti, por nuk e vendos apo e krijon atë” (ibid). Sipas normave dhe kushteve të vendosura nga BE mund të shihet rruga dhe mënyra e përshtatjes, si vijnë këto norma në një realitet shqiptar dhe çfarë kërkohet që Shqipëria të adoptojë me një proces të tillë. Si do ndikojë kjo kulturë ndërshtetërore e BE-së

për të formësuar sjelljen shtetërore të Shqipërisë. Kjo do shihet më poshtë, kur të analizohet konteksti i vlerave liberale kombëtare shqiptare.

Ndërkohë autori Diez shprehet për konceptin e fuqisë Normative të Europës dhe aktorët në marrëdhënie konstruktimi dhe ndërveprimi si “vetja dhe/tjetri” (self/other) (Diez 2013;15) dhe e lidh këtë me identitetet. Ai merret më së shumti me diskursin dhe artikulin e këtij koncepti vetja/tjetri dhe fuqinë e diskursit të “fuqisë normative”. “Identitetet” që konstruktohen apo “kërkojë një tjetër kundër të cilit” të konstruktohen; dhe “një tjetër të cilën ata ndërtojnë në të njëjtën kohë” (Diez 2013;15) Në rastin e vendeve që kërkojnë të antarësohen në BE, Europa/BE paraqitet si vetja/self që prezanton dhe aplikon standardet dhe normat e saj dhe tjetri/other, si në rastin e Shqipërisë e cila duhet të përafrojë, rregullojë dhe të ndërtojë normat dhe standardet e veta për t’u bërë pjesë e BE-së. Nëse merren në analizë kriteret e Kopenhagenit si sundimi ligjit, standartet politike dhe administrative, pikërisht “kapitulli 23 dhe 24 i “BE aquis” që merren më së shumti me kriteret politike”, BE artikulon nëpërmjet këtyre kriterëve atë “çfarë BE-ja është (ose çfarë supozohet të jetë)” dhe si rrjedhim atë se “çfarë duhet të bëhen vendet candidate”(Nicolaïdis & Howes, 2002; 774) në mënyrë që të antarësohen.

Kështu sërish, me gjithë debatet e shumta që ka dhe mund të lindin nga kjo pjesë, nëse merren parasysh kritikët e autorit Manners apo Barkl si më lart në lidhje me atë çfarë efekti është në gjendje të prodhojë BE nëpërmjet këtyre normave apo standardeve tek tjetri, duhet marrë parasysh fakti që vetë brendësia kuptimore apo “përmbajtja e normave është për t’u përshëndetur pasi ata parashikojnë një botë më paqësore” (Diez 2013; 20) duke vendosur kështu një proces normash ndërmjet dy ose më shumë aktorësh nëpërmjet marrëdhënies së konstruktimit. Raporti i normave që vendoset ndihmon në konstruktimin e aktorëve të përfshirë në atë marrëdhënie. “Nëse ndërtimi i një identiteti të veçantë konsiderohet problematik ose jo, kjo varet nga konteksti nga i cili ai është parë – kjo në fund të fundit është politika mbi të gjitha” (Diez 2013; 20), prandaj konsiderohet me rëndësi të veçantë të qenurit “reflektiv ndaj kontekstit të diskursit” (Ibid;20) ku

palët/aktorët marrin pjesë apo angazhohen. Përveçse të qenurit reflektiv ndaj kontekstit të diskursit, nëse dhe vetë “normat janë projektuar pa vetë-reflektim, ndërtimi identitetit (të caktuar) që ata kërkojnë, lejon shkeljen e vazhdueshme të këtyre normave brenda (vetë) BE-së” (Diez 2013; 20.)

Si rrjedhojë këto norma paraqiten si të thuash me një efekt bumerang ndaj projektuesit nëse nuk ndodh mbi/për ta një vetë-reflektim i vazhdueshëm. Roli i normave jo vetëm shpreh politikën nga brenda -jashtë të BE-së duke luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në formësimin, por edhe në artikullimin dhe diskursin politik që rrjedh nga këto norma. “Diskursi mbi fuqinë normative” sipas Diez është ai “që kontribuon në formimin e një identiteti europian”, sidomos përse i përket identitetit normativ, por ai fton (politik-bërësit dhe analistët) për një dekonstruktiv/rindërtim të vazhdueshëm të këtyre normave dhe vlerave/principeve (si në politikë ashtu edhe në analizë) nëpërmjet ekspozimit të kontradiktave brenda këtij diskursi dhe nëpërmjet këtij diskursi dhe praktikave të tjera⁸⁰. Në këtë mënyrë do mund të mënjanoreshin standardet e dyfishta apo të njëanshme ku BE mund të paraqitet me “vetë-të drejtë” të plotë për projektin e saj apo shumë idilik në atë çfarë përcjell nëpërmjet këtyre normave dhe “çfarë i kërkon të tjerëve/others të jenë”(Diez 2013; 25). Ndërsa vendet që kërkojnë të anëtarësohen, i mbetet të shohin anën pozitive në brendësimin e normave post-demokratike si në teori dhe në praktikë, për institucione më të qëndrueshme, qeverisje më të mirë dhe zhvillim kombëtar me hapa më të shpejtë.

Gjithë përshkrimi i mësipërm u paraqit për të bërë një dallim ndërmjet vlerave thelbësore, pra ato që njihen si vlera bazë të sanksionuara në traktate dhe rëndësia e tyre për BE-në, dhe si u shfaqën normat e reja pas 90-tës për vendet e reja të bllokut lindor ish-komunist dhe të Ballkanit që aspironin të anëtarësoheshin në BE. Prandaj, në këtë aspekt, përse i përket rrafshit kombëtar dhe kategorisë së vlerave liberale, më poshtë do të trajtohen pikërisht vlerat thelbësore dhe çështje

⁸⁰Diez sjell në një ekspozim të kontradiktave që vijnë nga debati i këtij diskursi normativ dhe ndërmjet diskursit dhe praktikave që ndiqen sepse në këtë mënyrë mund të arrihej “shpëtimi i fuqisë normative të BE-së” (Diez 2013;25)

që kanë të bëjnë me normat e reja, (që në fakt rrjedhin nga vlerat bazë të fuqisë normative) pra si janë normat e reja në raport me realitetin shqiptar.

4.3 Dekonstruktiv i vlerave liberale në kontekstin kombëtar duke u bazuar mbi vlerat dhe normat e reja post-demokratike të BE-së

Më lart u trajtuan ato vlera të cilat janë kthyer tashmë në vlera për kontekstin e BE-së dhe normat post-demokratike apo normat e reja që u rishfaqën dhe u ritheksoan me zgjerimin e BE-së dhe sipas valëve të zgjerimit që ndodhën sidomos pas viteve 90, pas rënies së Komunizmit në Europën lindore. Këto norma post-demokratike ose të reja (minos norms) të cilat rishfaqen nga traktatet e hershme të BE-së dhe ritheksohen gjatë gjithë kriterëve të Kopenhagenit, janë shumë të rëndësishme për realitetin shqiptar, jo vetëm për vokacionin pro-perëndimor që kombi shqiptar ka, por edhe për një sërë avantazhesh që populli dhe elita politike mendon se mund të përfitojnë nga ky integrim, dhe nga marrëdhënia ekzistuese konstruktive, të cilat mund të jenë; modeli ekonomik apo social, demokracia liberale, sistemi ligjor, zhvillimi i qëndrueshëm politikat e anti-diskriminimit etj.

Pra ideja Europë për shqiptarët ka artikuluar edhe interesin për të shkuar drejt saj pavarësisht rrugëtimit të tyre historik apo duke lënë mënjanë “peripecitë historike” (Sulstarova 2011;216) dhe pavarësisht përplasjeve apo kontraktave që ekzistojnë sot në Europë për Europën “si një proces i hapur” (Sulstarova 2011;216) për vendet Europiane apo “një proces i vulosur nga e shkuara” (*Ibid* 2011;2016) për një kastë të vjetër që sheh rrënjët e saj historike, apo elitat dhe mazhorancat që po rendin drejt dhe vetëm për interesin kombëtar të shteteve.

Pavarësisht qasjeve, në periudhën aktuale shteti shqiptar është në fazën e përmbushjeve të reformave që kanë të bëjnë pikërisht me normat post-demokratike, pra të implementimit të normave liberale dhe kjo duket një rrugë e gjatë dhe me shumë përplasje siç do shihet gjatë shtjellimit të analizës më poshtë. Kjo përplasje ndërmjet vlerave post-demokratike të BE-së dhe vlerave liberale kombëtare nuk është vetëm një frakturë e vazhdueshme që vjen që nga post-vitet

90-të, kur Shqipëria filloi të kishte marrëdhënie me BE-në dhe t'i nënshtrohej procedurave të anëtarësimit, por një hendek që trashëgohet nga e kaluara dhe rrugëtimi i vështirë që ka bërë identiteti kombëtar sidomos ai politik dhe normativ deri në kohët e sotme, pavarësisht ruajtjes së karakteristikave kulturore apo vlerave të mbijetesës.

4.3.1 Identiteti kombëtar shqiptar në periudha të ndryshme historike.

Ka një sërë problematikash që lidhen me identitetin kombëtar shqiptar, që kanë të bëjnë me disa paragjykime dhe kualifikime që vijnë nga vetë periudhat e vështira historike që ka kaluar Shqipëria. Shqipëria ka një pozicion gjeografik shumë të mirë në mesdhe dhe për shkak të shumë rrethanave historike, ajo ka qenë gjithmonë e lakmuar nga fqinjët e saj, dhe kjo nuk parashtrohet këtu për të analizuar këtë pozicion se sa për të treguar problemet që i kanë ardhur nga lakmitë e fuqive të mëdha dhe fqinjëve të saj nga faktorët e mësipërm. Kur përmenden probleme, merren parasysh coptimet territoriale, pushtimet, ndikimi dhe jetesa nën perandori të tjera që nga lashtësia, problemet me shtet-formimin dhe si pasojë çështjet e identitetit shqiptar që kanë qenë të rrezikuara dhe të kërcënuara si pasojë e trysnive të fuqive asimiluese nga pushtuesit e huaj.

Autori Julian Amery, në librin e tij “Bijtë e Shqiponjës”, “Sons of the Eagle” botuar për herë të parë në 1948, shpjegon se “fati i një territori me një rëndësi kaq strategjike” (Amery 2002; 2) si i rastit të Shqipërisë nuk mund të ishte kurrësi “çështje indiference për fuqitë”(Ibid;2). Pozicioni i saj strategjik ka dëshmuar që nga kohët e hershme të ketë qenë “shkak i qëndrueshëm sherri” (Amery 2002; 2) ndërmjet fuqive “në përpjekjet e tyre për të fituar ose për të ruajtur pozitën dominuese në Adriatik ose Mesdheun Lindor” (Amery 2002; 2) Pozita gjeografike ishte tejet e disfavorshme, sepse zgjonte lakmitë e fuqive e në këtë kuptim pengonte vazhdimisht që “kjo popullsi e madhe të homogjenizohej drejt një identiteti të vetëm” (Bashkurti 2004; 62). Në fillim ishte Perandoria Romake, fuqia dhe rritja e saj e madhe për kohën e cila “u përlesh me vendasit e Ilirisë, Dardanisë dhe Epirit dhe i nënshtroi këto mbretëri nën sundimin e saj në mënyrë që të konfirmonte supremacinë e saj në Adriatik” (Amery 2002; 2) Dhe sidomos

pas dyndjeve sllave në shek. VI pas Krishtit, këto treva kaluan një periudhë shumë të vështirë politike-etnike-ekonomike-territoriale.

Kjo bëri që ilirët në veri dhe veri-lindje të pësonin tkurje territoresh dhe ndryshime për sa i përket asimilimit dhe ruajtjes së vlerave të tyre. “Veriu humbi gjuhën dhe vetëdijshmërinë ilire” (Hoch 1995;45) ndërsa ata në jug arritën të ruajnë “identitetin e tyre.” (Hoch 1995; 45)⁸¹ Nën Perandorinë Romake ata gëzonin të drejta dhe role ushtarake dhe politike duke u ngritur gradualisht në nivelet më të larta” (Bashkurti 2004; 66) të kësaj perandorie. Historia dëshmon se “shumë funksionarë të lartë deri në nivele perandorëshdolën nga radhët e fiseve Ilire si Kostandini, Dioklecian, por edhe shumë të tjerë” shtatë ilirë u bënë perandorë dhe udhëhoqën perandorinë”, (Zheliakova 2000;10)⁸². Kjo tregon vlerësimin që vetë Roma kishte për aftësitë qeverisëse dhe ushtarake të kësaj popullsie.

Pas kësaj periudhe, vija e Teodosit pati pasoja negative për integritetin kombëtar, pasi kjo gjë shkatërroi unitetin fetar të popullsisë me origjinë Ilire dhe nxori pa asnjë mbrojtje këtë faktor të rëndësishëm, përpara trysnisë asimiluese etnike dhe fetare sllave duke spostuar rolin e rëndësishëm gjeopolitik të kësaj krahine, duke e shndërruar në një nga periferitë e Perandorisë Bizantine, larg vëmendjes së saj. Kur Perandoria Romake u nda nga ajo Bizantine në shekullin e IV pas Krishtit, ndarja e këtyre dy perandorive nga “Vija e Teodosit” që mori emrin nga perandori Teodosios do të linte shumë gjurmë jo vetëm në integritetin dhe zhvillimin etno-kulturor kombëtar të popullsisë shqiptare për periudhën më pas, por edhe për unitetin kombëtar. Me ndarjen e perandorive u krijua një ndarje e re në dy influenza të tjera të provincave Ilire. Duke u ndarë dy kishat e perandorive në shekullin e XI “Vija e Teodosit vazhdoi të ngelej pika e referencës për çdo proces politik që po ndodhte mbi popullin shqiptar”, (Bashkurti 2004; 69). Për një

⁸¹Hoch E. Geschichte der Balkanländer, 1995, p.45, München, cituar tek: Bashkurti, L. 2004, Identiteti Imazhi dhe Diplomacia, Shqipëria dhe Shqiptarët, Geer

⁸²Zheliakova A. 2000, fq.10 e cituar tek Bashkurti A. 2004, fq.66

pjesë të popullsisë dhe territoreve ilire që ranë nën ndikimin e Bizantit autori K. Maloki shprehet se “Orientalizma shqiptare i ka rrënjët aty nga vitet 740, kur Shqipëria u bë pronë e Bizantit, në Leonin e III-të të quajtur Isaurios” (Kulla 2002; 82). Pra ishte “administrata Bizantine” (Kulla 2002;82) kur shqiptarët ishin të detyruar të braktisnin Kishën Romake për atë Bizantine, sipas K. Maloki, që gdhendi “Orientalizmin shqiptar” (Kulla 2002;82) duke rrënuar “vetitë e larta ndërmjetësuese-kolektiviste, marrëdhëniet e shqiptarit me shqiptarin dhe marrëdhëniet e shqiptarit me shtetin dhe eprorët e tij.”(ibid)

Sikurse mesjeta është një periudhë e ndritur për civilizimin Europian, për Shqipërinë dhe shqiptarët “shënon një periudhë të komplikuar por shumë interesante”, pasi ato vazhdonin të kishin marrëdhënie “etnokulturore nga dy anët e ndarjes së madhe” (*Ibid*; 69). Pra përveçorientalizmit Osman, ishte edhe “Bizantizma historike” (Kulla 2002;82), e cila pati pasoja të rënda për identitetin dhe sjelljen e shqiptarëve. Pjesa e orientalizmës cilësohet këtu për të dhënë të kuptohet që shqiptarët me ardhjen e bizantit, u bënë dy komunitete fetare, dhe feja sjell ritet e kulturën e saj të ndryshme, më vonë me Otomanizmin erdhi dhe islamizmi me ligjin e sheriatit dhe me fraksionim të fesë, nga dy komunitete fetare u bënë tre. Pra ato ndryshuan një rrjedhë të natyrshme shqiptare për vetëvendosje kulturore, sociale dhe politike dhe u munduan të institucionalizojnë “instrumente dhe tipare të dominimit kulturor” (Grovgui 2010; 302) të ndryshëm nga rrjedha normale e tij kombëtare.

Me ardhjen e Otomanizmit, kur shqiptarët ishin në pragun e shthurjes së rendit feudal, turqit e rikthyen mbrapa këtë nismë me feudalizëm shtetëror e me dukuri të tjera shoqërore që ndikuan në mënyrën e jetesës së shqiptarëve. Perandoria Osmane për gati pesë shekuj me radhë kishte Shqipërinë nën sundim, ku “shekulli XVII-të dhe XVIII-të janë periudhat më të errëta”(Bashkurti 2004; 80) Në këtë sundim “familja, fisi dhe zakonet shqiptare shërbyen si institucione alternative paralele me ato të Sulltanit” (Bashkurti 2002; 81) Në këtë kohë ekzistonin dhe shumë krahina që qeveriseshin nga “‘Kodi i Nderit i Lek Dugagjinit’ ose ‘Kanuni i Lek Dugagjinit’, ‘Kodi i Skenderbeut’”etj. (Bashkurti 2004; 81).

Për këto kode ligjore ka disa përshkrime dhe interpretime, por le të sqarohen dy nga këto. Autori Julian Amery shkruan se Kanuni i Lek Dugagjinit “përcaktonte rregullat e gjakmarrjes dhe sjelljet/zakonet e përgjithshme të malësorëve” (Amery 2002; 9) duke ushtruar një ndikim kufizues mbi njerëzit e klanit” dhe “zbutjen e realiteteve të zymta të anarkisë”(Amery 2002; 9), megjithatë vazhdon analizën autori në fjalë, “si kode të tjera të kalorësisë dhe të ligjeve të luftës ai u thye më shumë në shkelje se sa në respektim” (Amery 2002; 9). Ndërsa, autori Bashkurti i përkufizon dy kodet e mësipërme si “dy sisteme legjislative shumë të përafërta” (Bashkurti 2004; 81) të cilët krijuan “një kuadër normash, rregullash, institucionesh vlerash të përbashkëta me dy funksione:1. “rregullimin e jetës së shqiptarëve në marrëdhënie me njëri-tjetrin. 2. ruajtjen e identitetit shpirtëror e zakonor shqiptar nga asimilimi Otoman” (Bashkurti 2004; 81).

Shqiptarët edhe pse “nuk ishin pjesë e atyre kombeve që kontribuan direkt për rilindjen dhe modernizmin European, duke qenë, se ishin nën ndikimin Otoman” (Xholi 1987; 15) dhe të sundimeve apo të ndikimeve të tjera, siç thotë autori Feraj, intelektualët e asaj kohe arritën të “përshtasin iluminizmin për kushtet dhe nevojat e shqiptarëve në gjysmën e dytë të shek. XIX. (Xholi 1987; 15) Projektet e këtyre mendimtarëve apo intelektualëve të kohës ishin për zhvillimin e qyteteve, institucioneve, zhvillim të arsimit, si dhe të funksiononte si duhej “sistemi fiskal, monedha kombëtare me simbolikën kombëtare të shtypur mbi të” (Sulstarova 1012; 46) dhe “decentralizimi i pushtetit” (Ibid), dhe këto projekte po mendoheshin në kuadrin e mos qëndrimit të mëtejshëm nën perandorinë Osmane dhe në kuadrin e mëvehtësisë politike kombëtare. Ata i shihnin turqit si një popull që nuk kishte aftësi të përparonte, sipas linjës që mendonin ata.

Shqiptarët mbeten gjithmonë me fytyrë nga Perëndimi, pavarësisht influencave të momentit politiko-historike që nuk ishin në dorë të tyre. Sakrificat e Gjergj Kastriot Skenderbeut ishin të mëdha në shekullin e XV “për të mbrojtur portat e qytetërimit European” (Zeqo 1995; 34)nga vërshimi Otoman, sakrifica të cilat i njohu dhe Europa e asaj kohe “e humanizmit dhe e artit rilindas” (Zeqo 1995;34) Për të vazhduar me Rilindjen Shqiptare, që kulmon në vitin 1912 “që pikërisht

ringjallje” (Zeqo 1995;35) për kombin shqiptar. Ky “zgjim kombëtar erdhi pikërisht në mënyrë graduale dhe pjesërisht si rrufe dhe tronditje” (Kulla 2002; 77) Ka një problematikë në këtë ngjarje, duke qenë se ‘Rilindjen’ e analizojnë “në aspektin romantik të saj, por kjo do të ishte një tablo e paplotë” (Sulstarova 2012; 44), pa “aspektin iluminist” ”(Sulstarova 2012; 44), duke marrë parasysh angazhimin e rilindasve “për shpëtim dhe modernizim të kombit shqiptar”(Sulstarova 2012; 44).

Një kritikë ose një e metë tjetër në lidhje me këtë zgjim të ngadaltë, por të vrullshëm në pikën finale, lidhet me vonesën e tyre për “të fituar lirinë dhe pavarësinë” (Kulla 2002; 77) ende si një shkak “i prapambetjes kombëtare” (Kulla 2002; 77), të paktën këtë thekson historiani Stavro Skëndi në librin e tij “Historia e Rilindjes Kombëtare”. Si fillim qenë “Fuqitë e mëdha që ndihmuan nacionalistët kristianë të gadishullit” (Kulla 2002; 77) ndërkohë “shqiptarët qëndronin vetëm”, (*Ibid*; 78) duke mos pasur lidhje mbi bazën e trashëgimisë “sllavo-ortodokse”, (*Ibid* 78) si ajo që ekzistonte “ndërmjet sllavëve ballkanas dhe Rusisë” (*Ibid* 78) Ndërsa Autori Hysamedin Feraj e cilëson aktin e pavarësisë si një akt që “u shpall pezull” (Feraj 2012; 69) për arsye se “nuk kishte asnjë mbështetje në territor e në popull”,(Feraj 2012; 69) duke qenë se të dy “ishin nën zotërimin osman, serb, grek, malazes e të tjerë” (Feraj 2012, 69) Në Lidhjen e Prizrenit intelektualët e kohës kishin objektiv “bashkimin e katër vilajeteve” (Sulstarova 2012; 47) mbi “parimin e mbizotërimit etnik” (*Ibid* 47) të bazuar në gjuhën e folur” (*Ibid* 47) Gjuha kishte vlerë të veçantë për periudhën e Rilindjes, pasi përbënte motivin qendror” në objektivat e tyre me idenë se ajo e “zbulon qenien shqiptare si të tillë” (*Ibid* 49)

Arsyeja pse intelektualët e rilindjes kërkonin të adaptonin modelet europiane të modernitetit ishte se ata e shihnin kombin shqiptar “si evropian në zanafillën dhe “indoevropianë” nga “gjuha dhe kultura” (Kulla 2002; 77) dhe për të ardhmen e tij. Parimet si “vetvendosja kombëtare, mbrojtja e të drejtave kombëtare dhe statusi i barabartë i kombeve” (Sulstarova 2012; 51) mendoheshin për perspektivën që do sillnin këto parime në lidhje me afirmimin e kombit shqiptar

përkrah popujve ballkanik, që ishin pavaruar gati një shekull para Shqipërisë dhe marrëdhëniet që Shqipëria mund të krijonte me vendet fqinje si një vend i mëvehtësuar dhe i pavarur. Por fitorja e rilindjes nuk zgjati, pasi “u denatyrua” (Zeqo 1995; 35) me copëtimin e saj në 1913. Autori Moikom Zeqo e cilëson këtë ngjarje si “tragjedi” (Zeqo 1993; 35) me “pasoja katastrofike” (Zeqo 1993; 35) për “historinë e mëpasshme” (*Ibid*). Mbas kësaj periudhe ishte rryma emancipuese e “Neoshqiptarizms” me intelektualët e kohës si Branko Merxhani, Vangjel Koça, Nebil Çika etj. Ajo “solli rrjedhime mjaft pozitive në jetën politike, kulturore, arsimore dhe kombëtare-edukative” (Kulla 2002; 13) si doktrinë që fillesat e veta i kishte “me lëvizjen e Rilindjes Kombëtare” (Kulla 2002; 13) Intelektualët e shkollës së Neoshqiptarizms kërkonin formimin e kulturës së atillë nëpërmjet arsimimit dhe ndërgjegjësimit që të arrihej sa më shpejt rruga drejt perëndimit.

Gjithë vëmendja e tyre ishte tek “bërja e shqiptarëve” krijimi i kohezionit të brendshëm popullor kolektiv nga një kulturë e përshtatshme, pasi ata mendonin se “kultura është çelësi i ndryshimit” (Kulla 2002; 17). Në fakt mendimet e tyre ishin të përparura për errësirën dhe ndasitë e kohës që po përjetonte Shqipëria në atë kohë, dhe mbeten aktuale akoma dhe sot. Kultura si pas tyre kishte rëndësi të veçantë për perspektivën që do të merrte Shqipëria e atyre viteve pasi “kultura është vazhdimisht në lëvizje, edhe kur riprodhon vetveten” (Wend 1999; 188) Pra ajo mund të krijonte atë klimë të favorshme së bashku me edukimin dhe arsimimin për të lartësuar dhe aftësuar ndërgjegjen kombëtare për një Shqipëri dhe shqiptarë të unifikuar drejt perëndimit. Shpërndarja e ideve që kishin të bënin me integritetin kombëtar, filozofinë e lirisë, krijimin e shtetit, modelin evropian dhe një “idealizëm të ri”, për këta kalonin vetëm “nëpërmjet kulturës” (Kulla 2002; 24) Në planin për progres social, politik dhe qeverisje, përpjekjet e klasës së neo-shqiptarizms që pasoi më vonë, orvateshin për të riformuluar ose krijuar interesin shqiptar dhe “formimin e një ndërgjegjeje kombëtare” (*Ibid* 13) në një Shqipëri, ku kishte shumë analfabetizëm, klasë intelektuale jo shumë të aftë për të pëfaqësuar si duhej vendin dhe varfëri, dhe që kishin të freskët në memorie mentalitetin e Orientit. Kësisoj kërkohej më tepër ndërgjegjësim dhe punë për të

shkuar drejt përndimit duke mposhtur atë klimë “transi” (Feraj 2012; 70) ku Shqiptarët kishin “mbetur pezull ndërmjet shtetit dhe kombit” (Feraj 2012; 69) dhe “popullatës që nuk ngrihej në popull” (Ibid; 70) pra i njerëzve apo individëve që nuk arrinin të unifikoreshin në një bashkësi kolektiviste dhe në një zë për të përfaqësuar kombin.

Orvatjet dhe përpjekjet e neo-shqiptarizmit për të krijuar një komb dhe një shtet shqiptar të fortë kulturash dhe politikisht, i shkatërroi komunizmi, i cili i ktheu edhe një herë shqiptarët në “idealet”(Kulla 2002;83) dhe “veset” (Ibid) e vjetra me orientim nga lindja, por jo si këndvështrim gjeografik, por si orientim, ose si rreshtim politiko-ideologjik me gjysmën e botës pas luftës së dytë botërore, që quhesh ‘Kampi Lindor Komunist’. Kjo është periudha, kur identiteti kulturor i shqiptarëve nuk kishte shumë rëndësi, sepse gjithë përpjekjet bëheshin për të krijuar një identitet sa më të spikatur në rrafshin politiko-ideologjik. Madje lidhshipi komunist, i asaj kohe i përfshirë në ethet e kompleksitetit si një vend i vogël i kampit komunisto-socialist, përpigj të identifikohej, si i vetmi vend komunist Marksisto-Leninist në botë, i cili ruante me fanatizëm modelin komunist të inspiruar nga Marksi dhe Engelsi dhe të zbatuar në praktikë në vendin e parë komunist në Bashkimin Sovjetik nga Lenini e Stalini.

Por, ato risi që solli shkolla e Neoshqiptarizmit e viteve 30-të, dhe jo vetëm, por edhe “përpjekjet kolosale” (Kulla 2002; 83) të intelektualëve dhe të klasës politike, sidomos ajo e dalë pas Kongresit të Lushnjës të marra komplet “që nga shpallja e pavarësisë e deri në vitet 1943-44” (Kulla 2002; 83), për një emancipim drejt përndimit “i bllokoi komunizmi” (Ibid;83).Duke marrë parasysh pozitën dhe gjendjen e shoqërisë shqiptare shqiptare në 1944, mund të thuhet me plot gojën se ishte shoqëria më pak e përshtatshme në Europë për të adoptuar marksizmin klasik” (Misha 2008; 98), të implementuar nga klasa komuniste. Më vonë, me këto synime megallomane Shqipëria e vetëquajti veten pas viteve 60-tës si fanar i vetëm i komunizmit marksist-leninist ne Europë dhe në të gjithë botën, ose si një shkëmbgraniti buzë Adriatikut etj.

Kështu Shqipëria pas viteve 60-të u prish me të gjithë aleatët e saj të botës komuniste, u prish me Bashkimin Sovjetik, vendet e Europës lindore komuniste, pastaj u prish edhe me aleatin e saj të fundit komunist Kinën, duke u vetizoluar dhe u zvogluar nga e gjithë bota, në një vetë-harrim më shumë se asnjë herë tjetër në planin ndërkombëtar. Nga ky moment Shqipëria dhe lidhshipi i saj komunist pomponte me një propagandë të ethëshme modelin e saj komunist, godiste majtas e djathtas gjithë modelet e tjera komuniste, si revizioniste, ose si tradhëtare të komunizmit marksist-leninist të vertetë. Gjithashtu, lidhshipi i saj komunist filloi të pompohej, si lidhshipi i vetëm komunist në të gjithë botën.

Në planin e brendshëm ekonomia socialiste e shtetizuar e centralizuar deri në ekstrem në qytet dhe në fshat, sidomos në fshat në fillim të viteve 80-të me tufëzimin e bagëtive dhe me heqjen e oborreve kooperativiste, që deri tani ishin si ekonomi ndihmëse për familjet fshatare në kufinj të mbijetesës, e kaloi ekonominë shqiptare në një gjendje krize pa rrugëdalje, duke eliminuar çdo shpresë për një model të suksesshëm për ata që besonin dhe shpresonin ende në këtë sistem. Në planin kulturor dhe edukativ, përsëri gjithçka planifikohej e realizohej dhe i shërbente forcimit të identitetit komunist të vendit si dhe “propagandës intensive të tyre” (Misha 2008;99). Në planin kulturor dhe artistik që në vitet 50-të, u vu në qendër të tij metoda e realizmit socialist dhe censura komuniste si dhe u kopjuan metodat e ‘Revolucionit Kulturor Kinez’, që godisnin çdo tendencë që devijonte, ose anashkalonte botkuptimin komunist në art, letërsi e kudo nën frymën klasore. Në planin arsimor-edukativ megjithëse me “hapjen e universitetit të parë shqiptar në vitin 1957” (Misha 2008; 98), në vitin 60-të filloi revolucionarizimi i shkollës, i cili në thelb kishte komunistizimin dhe ideologjizimin e shkollës, me ‘Trekëndëshin Revolucionar’ (mësim, punë, kalitje-fiziko-ushtarake). Në planin historik, kulturor e gjuhësor e kombëtar, megjithëse u bënë shumë aktivitete në planin historik, për zbulimet arkeologjike, studimet gjuhësore (Kongresi i Drejtshkrimit), studime folklorike, promovimi i Heroit Kombëtar Gj. Kastrioti, 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe u krijuan shumë institucione kërkimore, që mbështetnin këto aktivitete, fryma klasore-komuniste, metodologjia marksiste-leniniste, si dhe izolimi i vendit nga bota, i

kthenin këto aktivitete më shumë si lustër për rregjimin dhe një propagandë që nxiste një lloj nacionalizmi komunist për konsum të brendshëm. Në planin fetar regjimi komunist në vitet 60-të mbylli institucionet fetare (kishat dhe xhamitë), burgosi dhe pushkatoi, si armiq të klasës priftërije dhe hoxhallarë dhe e ktheu Shqipërinë në të parin vend ateist të botës, ku feja ndalohej me ligj dhe mburrej me këtë identitet të ri, duke e vlerësuar si element të një shoqërie komuniste edhe pse kjo gjë e izoloi jashtëzakonisht më keq Shqipërinë e izoluar. Të gjitha këto fusha tregojnë se, Shqipëria ishte një vend ku “komunizmi mori forma më ekstreme se kudo gjetkë në Europë” (Misha 2008; 95).

Pas rënies së Komunizmit, me ardhjen e demokracisë, pavarësisht dëshirave dhe tendencave të kohës “Shqipëria vazhdonte të mbetej vendi më i varfër i kontinentit” (Misha 2008; 99). Përpjekjet ishin të vështira për “një popullsi krejt të çoroditur nga” izolacioni i gjatë dhe që gjendej në “krizë të rëndë identiteti” (Misha 2008; 99) Në këtë periudhë, ku Shqipëria është një vend i hapur me synimin integrimin në BE, edhe pse nuk ka shumë aktivitete që promovojnë identitetin tonë etnik-kulturor të lashtë evropian dhe kontributin e tij shumë të hershëm, fillojnë të qarkullojnë literatura dhe vepra autorësh të ndaluar para viteve 90-të dhe informacione shkencore në gjuhë shqipe dhe të huaj, që prezantojnë identitetin dhe kulturën shqiptare origjinale. Gjithsesi, “drejtimi nga perëndimi, tani më i konsoliduar si nocion evropian, mbeti gjithmonë udhërrëfyes” (Balla 2012; 493) mbas periudhës post-komuniste si një drejtim që kishte si qëllim integrimin përfundimtar në BE. Ndërkohë një periudhë krize si ajo e 97-98, dhe 21 Janari i vitit 2011 e çuan Shqipërinë prapa në kohë përse i përket rrugës së integritit dhe arritjes finale në komunitetin e BE-së. Marrëdhëniet me BE-në vazhdojnë në kuadër të integritit të Shqipërisë, dhe Shqipëria nuk e ka diskutuar ndonjëherë drejtimin e saj perëndimor dhe integrimin e saj në BE, as nga partitë politike as nga populli, pavarësisht periudhave të krizave dhe ulje-ngritjet e saj si në aspektin politik dhe në konsensusin që duhet arritur ndërmjet forcave politike për këto reforma, ashtu edhe në drejtim të politikave të kushtëzimit si dhe kritereve që i ka vënë BE si kushte normative që duhen arritur dhe plotësuar në kuadër të këtij integriti. Pjesa më poshtë do të përpiqet të analizojë kategorinë e

vlerave thelbësore dhe vlerave post-demokratike, pasi nëpërmjet tyre ato kërkojnë që vende ish-komuniste si ato të vendeve të Europës lindore të përvetësojnë këtë kategori normash dhe të vinë në standartet e vendeve të zhvilluara të BE-së për sa i përket këyre vlerave.

4.4 Vlerat thelbësore dhe normat e reja në nivel kombëtar

Më lart u përmend rrugëtimi dhe kthesat që ka bërë Shqipëria në historinë e saj, pikërisht për të evidentuar brishtësitë e saj dhe ngadalësitë në përshtjen e saj me vlerat thelbësore dhe normat e reja europiane. Vlerat thelbësore të fuqisë normative të BE-së si paqja, demokracia, liria, barazia, sundimi ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut ishin vlera që nuk ishin përbrendësuar në të njëjtin nivel me kombet e tjera të BE-së, kur Shqipëria hyri në marrëdhënie me BE-në e më pas në procesin e integritimit. Kjo siç u sqarua më sipër, sepse në aspektin politik dhe liberal u hap vonë ndaj demokracisë së perëndimit.

- **Paqja**

Paqja e cila rënditet si ndër vlerat e para thelbësore në BE, është një vlerë ende e brishtë në realitetin shqiptar. Paqja sociale çenohet shpesh nga tensionet politike, kultura e dobët politike, mungesa e konsensusit të vazhdueshëm për vendime të rëndësishme në lidhje me vendin, ndërmjet pozitës dhe opozitës, mungesa e tolerancës, dhe shfaqja e konflikteve në mënyrë sistematike.

Tensione dhe problematika shfaqen edhe në komunikimin e përditshëm, në ngjarjet e ditës, në ngjarje që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë, etj. Përveç, këtyre varfëria, dhuna në familje, korrupsioni hapin çështje që e bëjnë gjithmonë e më të vështirë arritjen e paqes sociale në Shqipëri.

- **Demokracia**

Gjithashtu edhe demokracia, ka mbetur një proces në tentativë duke pasur parasysh tranzicionin e gjatë të saj, që pas rrëzimit të komunizmit. Pavarësisht disa arritjeve, ende nuk mund të flitet për një demokraci funksionuese, dhe ky mos-funksionim pasqyrohet në dobësi në shtetin e së drejtës, reforma në drejtësi,

në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar etj.. Të gjitha këto fenomene përbëjnë kërcënim për mirë-funksionimin e demokracisë, duke marrë parasysh edhe problemet sociale të cilat e vështirësojnë akoma më shumë zhvillimin e demokracisë. Gjithashtu edhe mediat nuk kanë bërë shumë progres, në përcjelljen e lajmeve dhe mesazheve në mënyrë paanshme, duke qenë se ndodhen në trysni të vazhdueshme nga politika, ose janë pjesë e klaneve politike.

Lufta për pushtet është një tjetër fenomen, që ka penguar arritjen e kompromiseve politike në të mirë të vendit. Pra, deri tani ka rezultuar një demokraci e brishtë, ku elitat politike të cilat kanë në dorë fatin e vendit, janë fokusuar në interesa afatshkurtra pa pasur ide të qarta dhe plane të përbashkëta konsensuale për luftimin e të gjitha sfidave që pengojnë mirë-funksionimin e demokracisë në vend.

Sundimi i ligjit

Sundimi i ligjit dhe funksionimi i shtetit të së drejtës mbeten kushtë parimore për zhvillim sipas standarteve të shteteve të zhvilluara sociale dhe integrim. Kur flitet për sundimin e ligjit mendohet zbatimi i ligjeve në praktikë dhe barazia e të gjithë qytetarëve para tij. Mirë-funksionimi i shtetit të së drejtës dhe zbatimi i ligjit në praktikë janë kusht për mbarëvajtjen dhe konsolidimin e demokracisë, pasi duke funksionuar ky aspekt, arrihet zhvillimi ekonomik, zbatohen të drejtat shoqërore dhe liritë themelore të njeriut dhe ka një funksionim eficient të institucioneve shoqërore. Në Shqipëri këto kanë çaluar, si rezultat i mos funksionimit të mirë të shtetit të së drejtës dhe zbatimit të ligjeve. Gjyqësori nuk mund të jetë në funksion të politikës. Reforma në drejtësi pritet të sjellë ndryshime pozitive në fushën e sundimit të ligjit, pasi këto të dyja janë lidhura ngushtë dhe vetëm zbatimi i reformës mund të sjellë efektin ose frytet në realitet. Reforma në drejtësi mbetet kriter thelbësor për integrimin e Shqipërisë në BE.

Këto vlera bazë, themelore për BE-në kanë qenë themele jo të forta për të transportuar dhe implementuar normat e reja që BE riformuloi për nevojat e zgjerimit dhe vende që aspironin të integroheshin. Normat e reja apo (minor

norms) si “progresi social”, “anti-diskriminimi”, “zhvillimi i qëndrueshëm” dhe “qeverisja e mirë” dolën në pah si detyra dhe objektiva që rrjedhin nga baza e fuqisë normative të BE-së duke parë ndryshimet e kohës si, rrëzimi i perdes së hekurt të komunizmit që ndante bllokun perëndimor nga ai lindor, dhe me aspirimin e shumë vendeve ish-komuniste për t’u kthyer në familjen europiane dhe nevojën për zgjerim të BE-së drejt këtyre vendeve. Në këtë aspekt nuk mund të lihet pa përmendur trashëgimia që la komunizmi në Shqipëri dhe realiteti i zymtë i asaj kohe, i cili nuk ishte shumë i favorshëm për përvetësimin dhe aplikimin e këtyre vlerave post-demokratike. Pra trashëgimia e hershme që lanë zgjedhat dhe regjimet e mëparshme në nivel politik ishte e pakonsoliduar dhe e aftë të përthithte normat post-demokratike bashkë-kohore. Analizimi i tyre në realitetin shqiptar vijon duke i parë ato një nga një.

4.4.1 Progresi Social në Shqipëri

Lidershipi komunist në Shqipëri ishte si ato “projektet politike radikale” (Misha 2008; 99) që ia kishte mbushur mendjen vetes dhe përpiquej të bindte popullin shumë të varfër shqiptar, se ai duhet të ishte krenar për këtë lidshrip që po e mbronte komunizmin (marksist-leninist) dhe po eksportonte revolucionin në gjithë botën. Në planin ligjor dhe kushtetues, Shqipëria në vitin 1976 promovoi Kushtetutën e RPSSH, një bazament ligjor komplet komunist që sanksiononte triumfin e socializmit në Shqipëri dhe të ideologjisë marksiste-leniniste në të gjitha aspektet, duke u bërë kushtetuta më e politizuar në botë dhe që pasqyronte injorancën dhe fanatizmin e rregjimit të asaj kohe. Përsa i përket gjendjes ekonomike sociale, elita politike komuniste megjithëse predikonte barazinë gjendja ekonomike ishte në nivelet më të ulëta dhe kushtet social-ekonomike ishin shumë të rënda, faktorë të bënë shumë të vështirë rrugën për rimëkëmbje sociale.

Pasi sistemi komunist ra në gjithë lindjen, në vitet 90-të, në Shqipëri lëvizja studentore e cila u bë nismëtarja e pluralizmit dhe e demokratizimit me sloganin “Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa”, solli në Shqipëri tendencën për krijimin e modelit perëndimor european demokratik, pluralist, të hapur, me shtyp të lirë, me ekonomi tregu, zgjedhje të lira etj. Ajo, çfarë la trashëgim komunizmi, ishte gjendja ekonomike shumë e mjeruar, ku kishte mungesa të theksuara në nevojat bazë humane. Gjatë viteve të tranzicionit që pasuan, megjithëse nga të gjitha qeveritë ka pasur përpjekje dhe reforma në fusha si ekonomia, arsimit dhe

shëndetësia, ka dokumente dhe sondazhe që tregojnë se ekzistojnë pabarazi të dallueshme në nivelin e jetesës të zonave të ndryshme, nga një qytet në tjetrin e sidomos në fshat. Pabarazia e ka shoqëruar gjithmonë Shqipërinë edhe më përpara se periudha komunizmit. Edit Durham vërente diferencat ndërmjet njerëzve kështu: “është e çuditshme, po në të gjithë qytetet që pashë, të egrit ishin shumë të egër, ndërsa të qytetëruarit shumë të qytetëruar. Këtu përzihen shumë shekuj bashkë” (Durham 1991; 75) Ajo vërente diferenca të mëdha të shtresave shoqërore, që janë prezente edhe sot në realitetin shoqëror shqiptar, si në realitetin kulturor, ashtu edhe në atë ekonomik.

Niveli i papunësisë ka qenë gjithmonë nga më të lartët në Shqipëri. Ajo çka është karakteristikë e dukshme, është se problemet shoqërore-ekonomike shfaqin pabarazi të dallueshme në drejtime apo fusha të ndryshme nga krahina në krahinë. “Rezultatet e zbërthiera të Treguesit të Zhvillimit Njerëzor në Shqipëri zbulojnë dallime të ndjeshme në nivelin e zhvillimit njerëzor ndërmjet rajoneve të ndryshme të vendit dhe ndërmjet rretheve të ndryshme të po atij rajoni (HDPC, 2002)”. Dukuri të cilat vërehen në këtë fushë janë, mungesa e sigurisë, jo vetëm në nivel personal, por edhe në shumë sektorë të tjerë të sigurisë, për shkak të tranzicionit të gjatë politik, korrupsionit, problemet në sistemin në drejtësi, të cilat po vazhdojnë të mbajnë peng jo vetëm përmbushjen e reformave, por edhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm shoqëror. Prandaj në sektorin ekonomik, Shqipëria duhet “të ndjekë reformat ekonomike që synojnë rritjen e konkurrencës dhe trajtimin e papunësisë së lartë, si dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit” (EC Report 2015; 75). Edhe në progres raportin e 2016 të Komisionit Europian për Shqipërinë, identifikohet papunësia e lartë, sidomos tek të rinjtë dhe çështje të tjera në sektorin bankar si kreditë e këqija, apo reforma në drejtësi që pritet të ketë ndikim në investime private dhe të huaja në rast të përmbushjes së tyre me sukses. Nxitja ekonomike është një çelës për zhvillimin social, por rritja ekonomike nuk mund të përmbushet pa patur progres në kriteret e tjera që ka vendosur BE apo pa një mbarëvajtje paralele të vlerave post-demokratike të BE-së me vlerat liberale kombëtare. Për sa kohë zhvillimi i qëndrueshëm social është i lidhur ngusht me normat e tjera të reja post-demokratike të BE-së, shihet si pozitive marrëdhënia që ka Shqipëria me BE-në në përmbushjen e kriterëve dhe avancimin dhe zbatimin pa ndalesa të reformave, pikërisht për të zhvilluar dhe konsoliduar jo vetëm këto norma por edhe për rritjen e mirëqenies shoqërore në vend. Në qoftë se do të lexohen në progres raportet e njëpasnjëshme ndër vite të Komisionit Europian, vihet se për çdo kriter që BE ka vendosur, si ai politik, ekonomik, qeverisje, shoqëri civile, shpesh fillohet me një fjali hyrëse si : “Disa progresa janë bërë si...”. Kjo është mjaft domethënëse për raportin që është krijuar, edhe pse gjithsesi ritmet janë tepër të ngadalta.

Për sa i përket publikimit të organizatës “Social Progress Imperative”, të 2015, Shqipëria renditet “në listën e vendeve mbi mesataren”, por më poshtë se vendet e tjera të rajonit si Bullgaria, Rumania, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Bosnje Hercegovina. Shqipëria ka ende rrugë të gjatë për të bërë për garantimin e mirëqënies sociale për shtetasit shqiptarë dhe për të arritur standardin e duhur përsa i përket progresit social. Duhet pasur parasysh se vetë populli shqiptar, duke marrë parasysh një studim që ka bërë Fondacioni Friedrich-Ebert, në 2014 “Shqiptarët dhe modeli social-evropian. Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale” në kuadër të asaj se çfarë i duhet Shqipërisë për të arritur standardet minimale për të shkuar drejt (MSE), modelit social European, ka bërë një përcaktim të riskut, duke vendosur papunësinë të parën, si pengesë për zhvillim dhe problem kryesor. Më pas qytetarët rendisin alternativa të tjera si: Varfëria, standardet e ulëta të drejtësisë, standardet e ulëta të shërbimit shëndetësor, krimi dhe dhuna, niveli ulët në edukim, mungesa e rendit publik, shkelja e të drejtave të njeriut, mungesa e solidaritetit social⁸³ etj, janë probleme të mëdha jo vetëm për të arritur progres social, por edhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Gjithashtu edhe pabarazia gjinore e shoqëruar me diskriminim gjinor është e pranishme dhe bëhet mjaft më e vështirë, kushtet ku mungon siguria minimale humane dhe njerëzore dhe nevojat bazë, dhe pjesa që duhet të përballet më shumë me këto vështirësi janë kategoria e femrave, fëmijëve dhe komunitete si ato të romëve apo të shtresave të tjera pa përkrahje.

Përsa i përket zhvillimit të qëndrueshëm ka iniciativa që synojnë mbështetjen dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri. Në samitin e zhvillimit të qëndrueshëm të UN, mbajtur në New Yourk, më 25 Shtator 2015, më shumë se 150 lider të botës, duke përfshirë dhe kryeministrin e Shqipërisë perceptuan “Axhendën e re 20130 për zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë synimet për zhvillim të qëndrueshëm.”⁸⁴ Këto synime kanë për qëllim t’i japin qytetarëve një jetesë më të mirë, me më pak varfëri, të përmirësojnë mundësitë për shanse ë barabarta, të marrin dhe të avancojnë në nisma për mbrojtjen e ambjentit dhe ndryshimet klimaterike, përmirësim në qeverisje, institucione të përgjegjshme, edukim më i mirë dhe shërbim shëndetësor më cilësor. Kjo kërkon vullnetin dhe përkushtimin jo vetëm të politikanëve, por edhe të ndërkombëtarëve, shoqërisë civile dhe një bashkëpunimi të ngushtë të të gjithë këtyre niveleve dhe hallkave përgjegjëse, për të hartuar strategjitë e duhura, të shoqëruara me studimet dhe statistikatat e duhura, qëpolitikat dhe nismat që ndërmerren të jenë të bazuara në tregues të dhe të dhëna të qarta.

⁸³ Për më shumë informacion shiko: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11314.pdf>

⁸⁴ Për më shume info

shiko: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/articles/2015/09/28/the-sustainable-development-goals-launched-in-albania.html> , parë më 15. 07.2016

4.5 Rastet e diskriminimit në Shqipëri

Diskriminimi në Shqipëri shfaqet në forma të ndryshme. Diskriminimi nuk është një fenomen i cili është zhdukur dhe nuk shfaqet në vende të ndryshme botës ku jetojmë. Në fakt për këtë fenomen luftohet shumë sidomos në aspektin e të drejtave gjinore dhe të komuniteteve, si të LGBTI. Në vende të zhvilluara europiane ose perëndimore punohet shumë për shanse të barabarta, për të cilat vihen në punë institucione, ligje, politika, fushata ndërgjegjësimi, programe politike dhe mekanizma të tjerë. Por ndonëse fenomene të tilla ekzistojnë, puna kundër diskriminimit nuk ndalet.

Përsa i përket Shqipërisë, në aspektin e të drejtave të njeriut dhe diskriminimit ajo shfaq fenomene të ndryshme dhe lloje të ndryshme diskriminimi në grupe të ndryshme. Disa nga këto grupe të cilat shfaqen të ekspozuara nga fenomeni i diskriminimit janë femrat, komunitetet romë, fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, njerëz me bindje të ndryshme politike, në vendin e punës, apo njerëz me orientime të ndryshme seksuale etj.

Vihet re një pabarazi e theksuar ndaj burrave dhe grave në Shqipëri, ku gratë mbeten kategoria e dhunuar (kur bëhet fjalë për dhunën në familje, marrëdhënie ose raporte çift etj), e diferencuar e marginalizuar në fusha si shkollim dhe punësim, sidomos në zonat rurale. “Nga Vrojtimi Kombëtar me bazë popullatën, “Dhuna në familje në Shqipëri”, rezulton se 59.4 % e femrave (më shumë se 1 në 2 gra) janë shprehur se kanë pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime “gjatë jetës”, dhe 53.0 % e grave (1 në 2 gra) po përjetonin dhunë në familje “aktualisht”⁸⁵. Përsa i përket marrëdhënieve të punës “në 2013, shkalla e papunësisë sipas gjinisë ka qenë 9.3 % për meshkujt dhe 13.7 % për femrat” ndërsa në vitin 2014 kjo papunësi “për femrat është rritur në masën 15.5%”⁸⁶ pa folur për vende drejtuese në kompani private ose institucione, apo shërbime të tjera publike ku ajo mbetet ende një kategori në pozita më inferiore se sa burrat. Edhe përsa i përket mediave gratë nuk përfaqësohen siç duhet, ku figura e saj shfaqet “pa autoritet, pa pushtet, në një kontekst familjar, e ndërvarur me të tjerë dhe në një punë me status të ulët, madje shpesh e nënshtruar, teksa burrat shfaqen të mbipërfaqësuar, profesionistë me punë të mirë, me autoritet dhe pushtet individual”⁸⁷. Duke qenë në pozita të tilla, si dhe në kushte të mungesave si ekonomike, të sigurisë dhe sociale, pjesëmarrja e gruas apo përfaqësimi i saj ka

⁸⁵Studim mbi situatën e diskriminimit të grave në Shqipëri: Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, <http://kmd.al/skedaret/1448456514-studimi.pdf>, parë më 01. 12 2016

⁸⁶(*ibid*)

⁸⁷Studim: Diskriminimi i grave në Shqipëri, <http://www.botasot.info/shqiperia/457318/studim-diskriminimi-i-grave-ne-shqiperi-video/> parë më 01.12. 2016

qenë i munguar dhe i cunguar në zhvillime të ndryshme sociale, ku mungesa në emancipimin e saj ka shkaktuar dhe për rrjedhojë e këtij trajtimi dhe sjelljeje ndaj saj, ka sjellë gjithashtu mungesa në të gjithë strukturën dhe zhvillimin e shoqërisë.

Pra në këtë aspekt Shqipëria mbetet mbrapa, duke pasur parasysh ritmin e emancipimit të gruas në BE, ku barazia gjinore mbetet një nga vlerat themelore të unionit. Ata shfaqen të barabarta me burrat në shumë sfera të jetës. Ka shumë arritje në këtë këndvështrim në BE, “edhe pse ende ekzistojnë pabarazi, BE-ja ka bërë progres të rëndësishëm gjatë dekadave të fundit në saj në aspekte si: Legjislacioni i trajtimit të barabartë; integrimi gjinor (integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha politikat e tjera); masat specifike për përparimin e grave”⁸⁸.

Ndër format e ndryshme të diskriminimit në Shqipëri është dhe diskriminimi racor. Ato komunitete më të ndjeshme ndaj këtij diskriminimi mbeten ai rom dhe egjiptian. Megjithëse ka përmirësim të politikave dhe legjislacionit për këto komunitete, gjithashtu edhe një plan veprimi kombëtar për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë për vitin 2016-2020, megjithatë këto dy komunitete vazhdojnë të përballen me diskriminime, paragjykime, duke vuajtur dhe jetuar në kushtet minimale të jetesës. Pra kur BE përmend si prioritetet apo kriter bazë për Shqipërinë mbrojtjen e të drëjtave të njeriut, mos-diskriminimin, duhet pasur parasysh që komunitete si ato të romëve dhe egjiptianëve kanë pasur një një përjashtim të gjatë, gjë e cila ka ndikuar në informimin, zhvillimin dhe mungesat në shërbimet sociale dhe administrative që duhet të kenë dhe gëzojnë ata. Ata vuajnë pengesa të mëdha edhe përsa i përket politikave të strehimit, marrëdhënia e tyre me shtetin është e dobët, aksesit në shërbime gjithashtu si pasojë e mos-kuptimit të procedurave dhe arsimimit në nivele të ulëta. Me studime tregohet se komuniteti rom dhe egjiptian vuajnë papunësi dhe nivel varfërie 2 ose 3 herë më shumë se pjesa tjetër e popullit. Mesatarisht romët kanë një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të re sesa popullsia tjetër jo-rome dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore⁸⁹

Kjo është një situatë e cila nuk është në standardin e duhur për sa i përket respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështje për të cilën BE është shumë e mprehtë në qëndrimin e saj. “Drejtues të Bashkimit Evropian për të

⁸⁸Barazia gjinore në BE, Komisioni European <http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/>, parë më 1. 12. 2016

⁸⁹Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, prill 2014, http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf, f. 37, Informacione të marra nga Raporti vjetor 2015, KMD https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/03/Raport-Vjetor-2015_KMD.pdf, parë më 01.12.2016

drejtat e njeriut i kanë rekomanduar Shqipërisë që të ndalë diskriminimin ndaj komunitetit rom, pasi kjo do të pengojë integrimin e vendit në BE.”⁹⁰

Një lloj tjetër diskriminimi është ai që shfaqet tek personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, shumë nga këto persona vuajnë pengesa dhe paragjykime, mospërfshirje dhe mospjesëmarrje në fusha të ndryshme dhe aktivitete. Për ato vazhdon të mungojë infrastruktura dhe trajtimi në institucione të ndryshme. Vazhdojnë të mos jenë pjesë e vendim-marrjes në nivele të duhura. Në vitin 2014, sipas të dhënave “të Minisrisë së Arsimit dhe asaj të Mirëqenies Sociale dhe shifrave zyrtare të INSTAT –it rezulton se 64 përqind fëmijëve me prapambetje mendore dhe fizike të moshës shkollore, nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm.”⁹¹ Për këtë dhe për shumë mospjesëmarrje të tjera në aktivitete shoqërore janë një sërë faktorësh që ndikojnë. Shërbimet dhe infrastruktura e dobët që mund t’u vijë në ndihmë këtyre personave mungojnë, por edhe kostot financiare për trajtimin e tyre janë të larta. Ka një platformë ligjore për këto grupe, por si gjithmonë vërehet mungesa e zbatueshmërisë. “Institucionet e nxitin përjashtimin social përmes mungesës së përgjegjshmërisë, korrupsionit, sjelljes klienteliste, trajtimit të diferencuar dhe moszbatimit të ligjit”(UNDP 2015; 3) Përveç kësaj ato përballen me reagime dhe paragjykime ofenduese të tipit “handikapatë,” “budallenj,” “të çmendur,” “me të meta mendore,” “sakatë,” etj. (ibid 2015; 18). Pra kjo tregon se nuk ka një ndërgjegjësim dhe një funksionim korrekt dhe të përgjegjshëm të instancave përkatëse dhe shoqërisë e cila duhet të dijë si t’ trajtojë këto grupe.

Një grup tjetër që gjithashtu gjendet shpesh pre e diskriminimit është ai i komunitetit LGBTI, pra diskriminim që vjen si rezultat i orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Edhe ky grupim përballlet me ngacmime ofenduese, bulizëm, paragjykime në ambjente pune, shkolle apo ambjente të tjera sociale, mospunësim për shkak të orientimeve seksuale që kanë, mungesë përfitimesh apo aksesit në shërbimet sociale etj. Pjesa që përballlet me më shumë vështirësi ndaj diskriminimit janë adoleshentët dhe të rinjtë sidomos në ambjentet shkollore. Ata, “për shkak të mungesës së politikave të mbrojtjes dhe eliminimit të dhunës në shkollë me bazë homofobinë dhe transfobinë”(Hazizaj, Poni 2015: 76), e kanë shumë të vështirë të mbrohen, të përceptohen si qenie normale humane, dhe të bashketojnë në paqe me identitetet e tyre gjinore ose orientimet seksuale që kanë. Kur themi diskriminim për shkak të gjinisë, rishfaqen gratë të të gjitha

⁹⁰Diskriminimi i romëve, Shqipëria rrezikon integrimin në BE, <http://www.tiranaobserver.al/diskriminimi-i-romeve-shqiperia-rrezikon-integrimin-ne-be/> , parë më 02.12.2016

⁹¹64 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk shkojnë në shkolla. <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=46503> , parë më 03.12.2016

grupimeve që mund të jenë gratë me orientim seksual të ndryshëm, gra nga komunitete rome apo egjiptiane, me bindje politike të ndryshme, të cilat mbeten kategoria më e ekspozuar ndaj dhunës dhe diskriminimit dhe si të thuash të lëna jashtë shoqërisë shqiptare.

Shqipëria ka ende shumë për të përmirësuar në aspektin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të gjitha kategoritë e lartpërmendura, por edhe të tjera që janë pre e diskriminimit. Në këtë aspekt, kanë institucionet një rol, shoqëria civile, mediat me fushata për ndërgjegjësim, si dhe kërkohet më tepër përgjegjshmëri në zbatimin e ligjeve dhe përmirësimin e infrastrukturës përkatëse në këtë aspekt. “Shqipëria renditet në listën e vendeve që kanë shkallën më të lartë të homofobisë, krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Ky konstatim është publikuar në raportin e fundit social dhe ligjor mbi diskriminimin me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, të realizuar nga Këshilli i Europës”⁹². Prandaj të gjitha rastet që u përmenden më sipër sjellin në vëmendje një fushë dhe detyra që kërkojnë mjaft përsheptim dhe rigorazitet për të luftuar diskriminimin e llojeve të ndryshme, në mënyrë që të arrihet një barazi, të rritet shkalla e ndërgjegjësimit, programet shtetërore, që të arrihen parametrat e zhvillimit për një shoqëri të mirë-integruar, ku çdo kategori shoqërore dhe çdo person ka një rol, ka një kontribut shoqëror, është qenie e lirë dhe në fund të fundit gëzon lirinë e vetë-shprehjes dhe mund të përdorë, zhvillojë dhe përmirësojë aftësitë e veta në një klimë shansesh dhe mundësish të barabarta.

4.6 Qeverisja shqiptare

“Pirro i kishte thirrur ata shkipetare, apo Bijtë e Shqiponjës, dhe natyra e tyre lakmitare dhe e ashpër e meritonte emrin plotësisht. Të mprehtë nga syri dhe të ftohtë nga zemra, ata ishin të guximshëm në vendime, por si të gjithë mercenarët, të paparashikueshëm në beteja. Liria dhe hakmarrja ishin pasionet e tyre udhëheqëse; dhe ata jetonin pa gëzim dhe vdisnin me ngurrimin se sa me pendim. Krenar të paudhëheqshëm, ata ishin të paduruar ndaj kufizimeve, krejtësisht të painstruktueshëm, të shurdhër ndaj ankesave, dyshues ndaj synimeve, të vështirë për tu udhëhequr, dhe të pamundur për tu drejtuar; zotërinj të mëdhënj dhe kusarë të mëdhenj, që çmojnë lavdinë më shumë se ndershmërinë, floririn më shumë se këto dy të fundit, dhe fuqinë mbi gjithçka. (Amery 2002; 12)

⁹²<http://www.pinkembassy.al/shqiperia-vendii-me-homofobik-ne-rajon-parë-më-3.12>. 2016

Realiteti në Shqipëri ka qenë në mënyrë të vazhdueshme i zyrtë dhe i vrazhdë, kohë pas kohe me shumë pengesa dhe vonesa në emancipimin dhe afrimin e mentaliteteve tona me ato Europiane, sidomos në aspektin politik dhe të qeverisjes. Shqipëria si një realitet kombëtar dhe politik i krijuar në periudhën e Rilindjes Kombëtare në fund të shek 19 dhe fillim të shek, 20 trashëgoi një prapambetje të theksuar kulturore-arsimore, gjithashtu edhe politike, sepse jo vetëm që ishte shteti i fundit që u krijua pas rënies së Perandorisë Osmane duke trashëguar modelet e saja autoritariste, por edhe për shkakun, se ekperiencat qeverisëse perandorake ishin më mediokret dhe më të prapambeturat në Europë. Në historinë e Shtetit dhe të politikës shqiptare, pas vitit 1912 shteti ekzistonte vetëm formalisht, pasi Shqipëria në vorbullën e luftrave, herë ballkanike, herë botërore, herë zhdukej nga harta dhe herë dilte në sipërfaqe. Vetëm pas Kongresit të Lushnjës, Shqipëria u rikthye në një farë normaliteti shtet-formues, me kufij të përcaktuar, me institucione të një demokracie liberale, me parlamentarizëm, madje edhe me një njohje diplomatike ndërkombëtare, si një anëtare e rregullt e Lidhjes Kombeve(pranuar në vitin1920).

Pas trazirave të brendshme politike në vitin 1920-24, mes pozitës dhe opozitës, që ngjan shumë me luftën për pushtet me politikën aktuale në Shqipëri të ngjarjeve pas viteve 90, Shqipëria rikthehet në instiktet e vjetra të autoritarizmit, të liderit absolut dhe të kultit të njëshit, duke eliminuar opozitën dhe duke krijuar dy forma shtetërore autoritariste; Repulikën Presidenciale(1925-28) të Zogut dhe Monarkinë e Zogut(1928-39). Gjatë kësaj kohe, vendi pati një lloj stabiliteti, krijoi një rritje normale ekonomike, por krijoi një klasë politike servile ndaj lidershipit politik të vendit, ku sovraniteti i vendit gjithnjë e më shumë varej pas interesave të Italisë së Duces, e cila në v.1939 e pushtoi Shqipërinë, duke e kthyer atë në një shtojcë të hapësirave italiane, deri në çlirimin e vendit me 29 Nëntor 1944.

Edhe në drejtimin politik, dhe të qeverisjes, komunizmi la një trashëgimi të keqe duke patur parasyshsistemin në të cilin bazohej si: kultin e njëshit absolut, në moslejimin e asnjë zëri apo fraksioni opozitar që të konkurojë për pushtet, në

zgjedhjet jo të lira e të ndershme, në diktaturën e proletariatit që mbahej nga psikologjia e terrorit dhe frikës nga organet e diktaturës e të policisë sekrete politike, nga një ekonomi e centralizuar dhe e komanduar nga shteti partiak, nga shoqëria e përçarë dhe e ndarë me ligjin e pashkruar dhe më vonë kushtetues të “luftës së klasave” dhe nga një administratë e politizuar në ekstrem, e frikësuar dhe e kontrolluar në çdo aspekt të saj dhe nga një propagandë e shfrenuar dhe e politizuar, e cila kontrollohej në çdo skaj dhe që mbulonte çdo pjesë të vendit deri në rrëzimin e sistemit komunist në vitin 1990-91. Pas viteve 90-të, ku kishte mjaft shpresë për zhvillimin e demokracisë si dhe të shtetit modern dhe të civilizuar, Shqipëria jo vetëm nuk e kapërceu mentalitetin e politikave të vjetëruara, me origjinë nga e kaluara, si p.sh “sundimin politik autoritar në sistemin partiak monoteist” (Fita, Kafia 2011; 209) dhe pothuajse gjithmone rafraktar e konfliktual me mendimin opozitar, por deri në “eliminimin dhe asgjësimin e çdo forme të mendimit ndryshe nga ideologjia e partisë-shtet, “Fita, Kafia 2011; 209” Siç rrodhën ngjarjet vendi u zhyt në një tranzicion të gjatë “që rezultoi më i gjatë dhe më i vështirë nga ç’ ishte parashikuar” (Fita, Kafia 2011; 209).

Shqetësim të madh paraqesin disa shfaqje dhe aspekte të qëndrimeve intolerante si: “Politika e një loje të shumës zero, konflikti politik i përhershëm, mungesa e konsensusit dhe konkurrenca e pandershme në sferat politike, ekonomike dhe shoqërore”, (Rakipi 2012; 6) të cilat më shumë se karakteristika të vetë tranzicionit të ngadaltë dhe të gjatë, ngjajnë me “produkte që kërcënojnë të bëhen tipare të përhershme të peizazhit politikshqiptar” (Rakipi 2012; 6) Këto produkte politike, kanë pasoja të mëdha në dy struktura, shtetin dhe shoqërinë. Sipas Alexander Wend “shtetet janë të lidhura konceptualisht me shoqëritë,” (Wend 1999; 197) pra shtetet nuk janë struktura të ngurta, përkundrazi “në jetën tonë të përditshme qytetarët dhe politikë-bërësit” gjithnjë e më shumë po i “trajtojnë shtetet si të ishin njerëz”. (Wend 1999; 197) Kjo si pasojë e marrëdhënies së ngushtë që ka shteti në lidhje me shoqërinë dhe anasjelltas. Ky lloj ndërveprimi “shtet-shoqëri”, (Wend 1999; 197) ndikon në sjelljen e përditëshme të qytetarëve, në qeverisje dhe në kulturën politike që është krijuar në vend, kulturë e cila në vite, ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë negativisht në këtë marrëdhënie shoqëri-shtet, në Shqipëri, ku

shteti si një institucion lider, nuk ka krijuar modelin dhe klimën për mbarvajtjen shtet-shoqëri dhe të krijojë modelin e qeverisjes së duhur për të përvetësuar modelin europian. Pra, në rastin e Shqipërisë ky raport ka rezultuar kokëfortë dhe rezistent, dhe pa një marrëdhënie të ndërsjellë ndërmjet dy strukturave.

Ndërkohë, në marrëdhëniet “agjent-strukturë”, (Wend 1999;197) është për t’u theksuar dhe roli agjentëve ose “roli kyç qëindividët konkrete (të cilët si agjentë formojnë” qeveritë ”(Wend 1999; 197) luajnë gjithashtu një rol të caktuar në strukturat shtetërore dhe sociale. Kjo sjell vëmendjen tek individët e veçantë në Shqipëri dhe rolin e tyre në prishjen e këtyre strukturave dhe të këtij bashkëveprimi që duhet të funksionojë në mënyrë të sinkronizuar. Megjithatë, në këtë aspekt, duhet patur parasysh që “ka një sistem feedback-u ndërmjet asaj çfarë kultura “di” ose “njeh” dhe asaj çfarë “di” ose “njeh”individit.” (Muller; 2005; 366) Lind pyetja: Po Shqipëria çfarë strukture sociale ka, apo çfarë shteti ka? Në çfarë kulture politike operojnë këto të dyja? A kanë një ndërveprim apo marrëdhënie mbi bazën e të cilës konstruktohen apo bashkveprojnë? Po individët e veçantë ç`rol luajnë? Shumë studiues janë të mendimit që, Shqipërisë i mungon “ritmi i brendshëm” (Kulla 2002;39), pikërisht ajo lloj harmonie shoqërore “që të frymëzojë e të ushqejë një ideal të mbështetur mbi parimin moral, një lëvizje mendore me vlerë të vazhduar”, (Kulla 2002; 93) ose për të mbështetur idenë e autorit Kulla janë “idetë” siç i quan Wend të “njohurive të përbashkëta”. Këto ide “ndërtojnë interesat” (Wend 1999; 189) shoqërore. “Sistemet sociale gjithashtu strukturohen nga “dija”ose njohuria” (Wend 1999; 189) e përbashkët ose e ndërsjellë.

Një tjetër kritikë është se një mungesë e qeverisjes demokratike dhe ky tranzicion i gjatërrjedhin nga mos-veprimi “i faktorëve kompleksë që shoqërojnë një ndryshim rrënjësor të të gjithë godinës shoqërore” (Fita, Kafia 2011; 209) ose e thënë me fjalët e Wend-it, atë të “strukturës shoqërore” Por si mund të ketë njohuri apo dije të përbashkëta. ide, parime ose ideale morale në një shoqëri “ku nuk ka asnjë formë bashkimi” (Kordinjano; 2008;11) Që të ketë një konstrukt social jo vetëm ndërmjet dy ose më shumë shteteve, por edhe ndërmjet shtetit dhe

popullsisë, kombi, fillimisht duhet të “ketë bashkim në terësinë” (Kordinjano 2008; 11) e tij si “popull dhe si komb” (Kordinjano 2008;11).

Kjo prishje e “godinës shoqërore” ka ndodhur për një sërë faktorësh të cilat janë përmendur më lart edhe tek periudhat e vështira që ka kaluar identiteti shqiptar ndër shekuj, si pushtimet e gjata dhe zgjedha, varfëria ekonomike, ndarja në rajone të mëdha të shkëputura pothuajse fare nga njeri-tjetri, mungesa e një tregu unik kombëtar, mungesa e infrastrukturës, rrugëve dhe transportit deri në periudhën e Luftës së parë botërore të cilat e kanë mbajtur popullsinë nëpër krahina të ndryshme të ndara, pasi rrugët kryejnë funksionin e arterieve për qarkullimin e shkëbimin, si të mallrave ashtu edhe të njerëzve. “Pavarësisht nga rrugët e hapura nga austriakët dhe italianët gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, në vend vazhdohej të udhëtohej kryesisht me këmbë ose me kafshë” (Misha 2008; 79), fenomen ky i sjellë edhe nga Edit Durham, në librin “Brenga e Ballkanit” (1991) kur tregon për udhëtimet e saj nëpër Shqipëri.

Në fillimin e shekullit XX, “Kultura si kultivim i shpirtit (cultura animi)⁹³ dhe i mendimit në kuptimin njerëzor, prej të cilës njeriu pasurohet me një thesar njohurish të ndryshme, të cilat shërbejnë për përmbushjen e njeriut dhe shtjellimin e jetës”, (Kordinjano 2008;12) si njohuri që shkëmbehet në mënyrë të

⁹³ ‘Cultura animi’ është një term i përdorur si fillim në antikitetin klasik nga oratori Roman, Cicero. Termi Kulturë më pas u shfaq në kuptimin e saj të tanishëm, në shekullin e XVIII dhe XIV si konotacion i procesit të kultivimit ose i përmirësimit si në fushat e bujqësisë dhe kopshtarisë. Në shekullin e XIV termi u zhvilluapër t’iu referuar së pari përmirësimit ose përpunimit të individit, veçanërisht nëpërmjet edukimit, dhe më pas në përmbushjen e aspiratave apo idealeve kombëtare. Në mesin e shekullit të XVIII-të, disa shkencëtarë e përdorën termin “kulturë” për t’iu referuar një kapaciteti njerëzor universal. Në shekullin e XX-të, “kultura”, u shfaq si një koncept qendror në antropologji, që përfshin gamën e fenomeneve njerëzore që nuk mund t’i atribuohet trashëgimisë gjenetike. Aktualisht bëhen dallime ndërmjet objekteve fizike të krijuara nga një shoqëri, si e ashtëquajtura kulturë materiale dhe çdo gjë tjetër, duke përfshirë edhe asetet e paprekshme ose të patrupëzuara ose jo-materiale të tilla si gjuha, zakonet, etj që janë referenti kryesor i termit “kulturës”. Në këtë pjesë termi kulturë nuk i referohet traditave kulturore që kanë arritur të trashëgojnë shqiptarët, por kultura si kultivim i mendjes dhe i shpirtit prej së cilës njeriu pasurohet dhe sillat sipas njohurive të përbashkëta në çdo fushë të jetës. “Ai cikël i gjerë i shkencës dhe i letërsisë” (Kordinjano 2008;12) por edhe i rregullave, i normave, kultures politike dhe demokratike “që jep një shtysë drejt përmirësimit dhe ngritjes” (Ibid;12) edhe të fushave apo sferave “të ngjashme me këto” (Kordinjano 2008;12)

Një pjesë e shpjegimit të termit “kulturë”, është gjetur tek <https://ëëë.boundless.com/sociology/textbooks/boundless-sociology-textbook/culture-3/culture-and-adaptation-31/the-origins-of-culture-199-3031/>, parë më 14.5.2016

njëtrajtëshme në të gjitha strukturat shoqërore dhe fushat e jetës për unifikimin dhe energjizimin e kombit dhe shoqërisë, mungon akoma në Shqipëri. “Nëse ivlerësojmë kushtet e përgjithshme të popullit në varësi të asaj, që është kultura e vërtetë dhe vetjake” (Kordinjano 2008; 12) atëherë kjo Shqipëri nuk është ende aty ku duhet të jetë. Nëse kushtet e përgjithshme mungojnë për një kulturë sa të vërtetë aq dhe vetjake, atëherë ç`mund të thuhet për kulturën politike në Shqipëri? “Një kulturë politike është produkt si i historisë kolektive të një sistemi politik ashtu edhe i historive jetësore të anëtarëve të atij sistemi, dhe kështu ajo është e rrënjësuar në mënyrë të barabartë, si në ngjarjet publike ashtu dhe përvojat private”⁹⁴ të njerzëve dhe individëve të asaj shoqërie.

Kultura politike në të cilat qeverisin elitat politike është më tepër një shprehje “mbi qëndrimet e mbajtura nga të gjithë anëtarët e një sistemi politik, se sa mbi qëndrimet e mbajtura nga individët apo kategori të veçanta të individëve,” (Pye & Verba 1965; 524) pasi vetë termi “kulturë” në kuptimin e përgjithshëm shpesh i referohet atyre aspekteve të sistemeve të besimit, të cilat janë të përbashkëta nga anëtarët e një shoqërie dhe që janë të veçanta për këtë grup” (Pye & Verba 1965; 524)⁹⁵ Prandaj kultura politike trajtohet edhe si specifike edhe si pjesë e së përgjithshmes. Pra, është e rëndësishme të vëresh se “edhe pse marrëdhënia midis besimeve politike dhe besimeve të përgjithshme në njërin anë dhe sjellja politike nga ana tjetër mund të ndryshojnë” (Pye & Verba 1965; 524) në varësi të rrethanave apo nivelit të ndryshëm që mund të kenë ose jo, “është e qartë se ata nuk janë të parëndësishme për njëri-tjetrin” (Pye & Verba 1965; 524) pra jane nivele, sisteme besimesh apo struktura që kanë lidhje me njëra-tjetrën në një mënyrë apo një tjetër.

⁹⁴Kultura politike sipas Enciklopedise Ndërkombëtare të Shkencave Sociale; 1968; copyright Thomas Gale 2008, Marrë nga http://ëëë.encyclopedia.com/topic/Political_culture.aspx , parë më 16.5.2016

⁹⁵Koncepti i Kulturës nga Clyde Kluckhohn “Concept of Culture në “Culture and behaviour, nga Richard Kluckhohn ed, Neë York , The free press of Glencoe, 1962), I cituar tel Pye and Verba, 1965, Political culture and Political development, fq 525

Megjithatë duhet theksuar se “sfera politike përbën një subkulturë të veçantë me rregullat e veta të sjelljes dhe proceset e saj të dallueshme të socializimit”⁹⁶ Ato elementë të cilët mund të ndihmojnë studiuesit të “ngushtojnë hendekun” ndërmjet kulturave dhe sub-kulturave: mund “të jenë të motivuara nga shqetësimet politike, ekonomike, dhe etike” që transportohen, influencohen ose ndikohen nga një kulturë e përgjithshme në një realitet kulturor politik ose anasjelltas. Në këto aspekt siç u zbërthe edhe më lart, shqetësime ekonomike, etike, ligjore (sundimi i ligjit) dhe me karakter politik ekzistojnë në Shqipëri të cilat e kanë bërë më të vështirë qeverisjen “e mirë” politike institucionale sipas standardeve që kërkon BE.

Në raportin dhe marrëdhëniet që Shqipëria ka me BE-në, aspekti normativ, vlefshmëria ligjore dhe sundimi i ligjit janë disa aspekte tepër të rëndësishme për të sjellur ose arritur “ndryshimin social” (Moore 1973; 719), pasi “ligji është një mjet shumë i rëndësishëm për projektimin social”(Moore1973; 719) Kur thuhet ligj mendohet “një term i shkurtër” (Moore1973; 719) që qëndron “për një bashkimshumë të përbërë të parimeve, normave, ideve, rregullave praktikave dhe aktivitetet e agjensive të legjislacionit, administrimit, gjykimit dhe ekzekutimit, të mbështetura nga pushteti politik dhe legjitimiteti” (Moore 1973;719) Fakti që Shqipëria ndodhet në një tranzicion të gjatë, me karakteristika të këtij tranzicioni që po bëhen permanente, vjen nga faktorë të ndryshëm politiko-social, nga ato regjime dhe periudha historike të vështira të cilat u përmendën më lart. Si për shembull, në trashëgiminë e mangët të traditave dhe të eksperincave shtet-formuese që nga periudha e Skënderbeut e në vazhdim, në mungesat e mëdha të përvojave të frytshme demokratike e liberale pas viteve 1912 e në vazhdim, në mungesat e elitave dhe lidërshipeve politike të emancipuara dhe të përkushtuara ndaj vendit, në regjimin e gjatë komunist që kaloi shteti shqiptar, ku shoqëria funksiononte mbi baza ideologjike të ndarjes, të konfliktit të shoqërisë mbi bazën

⁹⁶Kultura politike sipas Enciklopedise Ndërkombëtare të Shkencave Sociale; 1968; copyright Thomas Gale 2008, Marrë nga http://ëëë.encyclopedia.com/topic/Political_culture.aspx , parë më 16.5.2016

e parimit të luftës së klasave (në miq dhe armiq të pushtetit, e cila zgjati 50 vjet dhe quhej si një modus shumë i nevojshëm që e çonte përpara shoqërinë).

Ky mentalitet i ndarjes së shoqërisë në grupe kundërshtarësh, u transplantua nga ‘klasa politike’ që mori përsipër drejtimin e vendit në periudhën e pluralizmit, ku shoqëria u nda edhe më keq, në parti të ndryshme, ku përsëri njerëzit e shohin veten si kundërshtarë të papajtueshëm me njeri-tjetrin, ose në një ‘luftë klasash’ moderne në kushtet e pluralizmit.

Kur thuhet ka probleme me situatën normative, sundimin e ligjit, me përqafimin dhe përvetësimin e normave, apo vlefshmërinë e këtyre ligjeve në çdo aspekt ose kur përmendet legjitimiteti apo hendeku social, kjo tregon se “ligji dhe konteksti social në të cilin ai operon duhet të inspektohen bashkë” (Moore 1973-719) për shkak të ndërvartësisë që kanë këto dy kontekste me njëra-tjetrën. Zhvillimi i veçorive kulturore në shërbim të përmirësimit të një kulture të përgjithshme, duhet të shërbejë “si parakusht i domosdoshëm” (Fita, Kafia 2011; 214) për përmirësimit të nivelit të qeverisjes, kulturës politike, validitetin normativ, zhvillimin e reformave, zbatimin e ligjit dhe zhvillimin e demokracisë. Pikërisht veçoritë kulturore, si: Kultura qytetare, pjesëmarrja e vazhdueshme politike, qëndrimi mbi çështjet publike, disiplina për rregull dhe punë, respekti për ligjin, respektimi i kundërshtarit, kultura e dialogut (jo vetëm politik), pranimi i diversitetit të cilat janë karakteristika të demokracive të zhvilluara perëndimore me vlera liberale, mungojnë ende në Shqipëri si pasojë e mungesës së kultivimit të një kulture të përgjithshme, e cila pengon kohezionin dhe zhvillimin socialsi dhe marrëdhënien e ndërsjellë shtet- shoqëri.

Janë “elementët e ndryshëm të kulturës, qoftë edhe të kombinuar, të cilët bashketojnë në atë mënyrë të atillë sa të na lejojnë ne të kuptojmë kulturën si një e tërë e unifikuar (Muller;18) Pikërisht këto elementë ose mungojnë ose jetojnë në mënyrë të ndarë edhe “si pasojë e vlerave të trashëguara nga e kaluara dhe e vakumit të vlerave të vërteta demokratike” (Fita, Fakia 2011;213)

Një e metë tjetër në këtë aspekt, është që “klasa politike shqiptare (fenomen që vihet re edhe sot)ka një tendencë të vendosë shenjë barazie midis partisë dhe shtetit” (Fita, Fakia 2011; 213) Pra partia në fuqi “tenton të sillet si rregullator absolut i jetës politike në vend” (*ibid*), ndërkohë që si rregullator do të vlente bashkëveprimi sinkron i shtetit të pavarur me shoqërinë. Dhe kur merren në analizë në këtë mes sjellja e individëve të caktuar qoftë në sistemin politik (p.sh politika e një lideri të caktuar) apo edhe individëve të veçantë në strukturat sociale (individë apo grupe që i shmangen kontekstit të normve dhe ligjeve), është me rëndësi të kuptohet se veprimet “apo aktivitetet e një individi mund të jenë gjithmonë të lidhura me të tërën” ose kulturën si një e tërë. Prandaaj, “bindjet dhe zakonet duhen parë jo në izolim, por në kontekstin e gjerë kulturor” (Muller 2005; 18) të një shoqërie të caktuar.

Një asye tjetër,se përse tranzicioni i gjatë vazhdon dhe reformat ose normat e vendosura nga BE nuk po gjejnë zbatueshmëri në Shqipëri është dhe karakteri klientelist që ka ende Shqipëria. Në fillim të viteve 1900 Edit Durham sërish vëren një tjetër fenomen në Shqipëri: “Fakti kryesor është fisi. Çdo fis ka një legjendë të caktuar për prejardhjen e vet”, e cila “ndiqet rreptësisht sipas vijës së mashkullit dhe tradita është trashëguar nga ati tek i biri përmes kujtesës.”(Durham 1991; 114) Çfarë është për t’u vënë re në këtë mes, është se perëndimi lartëson krishtërimin për vlerat dhe normat e tyre, pra krishtërimi si bazë e moralit. Ndryshe Autori Panneberg thotë se “Pa një besim në origjinën hyjnore të botës, nuk mund të ketë një bazë për rregullin”(Pannenberg 1989;33) shoqëror në përgjithësi. Ndërsa, ajo çka dallohet kur Edit Durham flet për kanunin është se⁹⁷: “shprehja kështu ka thënë Leka” ka më tepër forcë detyruese se sa dhjetë porositë e Biblës” (*Ibid*; 116) dhe kjo nuk vlen vetëm për mësimet e Biblës sipas saj. Gjithashtu edhe “mësimet e islamit, e të Krishtëritit, ligji i Sheriatit dhe i kishës, të gjitha duhet t’i nënshtrohen Kanunit të Lekës” (Durham 1991; 116)

⁹⁷“Malësorët kanë afër pesëmbëdhjetë shekuj që e njohin krishtërimin por zakonet e fisit janë ende më të forta se kanuni i kishës” (Durham 1991; 114) duke dashur të nënkuptojë se disa zakone katolike të këtyre fiseve kanë rëndësi më të madhe nga ato të kishës.

Ky parashtrim për Kanunin u bë pasi Kanuni⁹⁸ dhe forma të tjera zakonore kanë qenë të pranishme dhe vazhdojnë të jenë edhe sot në realitetin social shqiptar. E drejta e huaj, ose ligjet e diktuar nga të huajt zor se kanë zenë vend apo të zbatohen në Shqipëri pikërisht sepse, Shqiptarët kanë repektuar kodet zakonore të veta si mënyrë për të mbajtur “jetën shpirtërore” (Gjata 2014) të tyre të paprekshme. “Edhe në fushën e marrëdhënieve juridike-civile, si në ato familjare, të detyrimeve tregtare, u ruajtën shumë elementë të kësaj të drejte edhe gjatë shekullit të XX-të, ku mbi të gjitha spikat “fjala e dhënë” ose “besa”, terma që krahas kuptimit si institute juridike, ishin po aq dhe morale.” (Gjata 2014)

Me kalimin e kohës, “me konsolidimin e shtetit kjo e drejtë u mënjana gjithnjë e më tepër, por kurrë nuk u fshi plotësisht nga vetëdija e njerëzve” (Gjata 2014) Shqiptarët, duke e ruajtur në vetëdijen e tyre të drejtën dhe kodet zakonore duket sikur me raste vazhdojnë të operojnë në atë mjedis kulturor që kjo e drejtë zbatohet dhe respektohet për të mos iu nënshtuar ligjeve të pushtesve apo zgjedhës së huaj. Gjermania i jep rëndësi të drejtës zakonore për studim për të kuptuar “shprehjen e gjendjeve të mjediseve të ndryshme shoqërore” (Gjata 2014), ndërsa shtete si Anglia “e ka zhvilluar pa ndërprerje deri në ditët e sotme” (Gjata 2014) të drejtën zakonore duke “e ruajtur më tepër në formë”, pasi “përmbajtja i është përshtatur vazhdimisht kërkesave të shoqërisë bashkohore” (Gjata 2014) Fakti se Shqiptarët ruajnë në ndërgjegjen e tyre të drejtën zakonore nuk do të thotë se është një shoqëri e vjetëruar.

Vetë “karakteri i gjerë dhe i përpunuar” i kësaj të drejte tregon se Shqipëria ruante “traditën, marrëdhëniet etiko-morale”, ruante cilësitë “psikologjike dhe etnike” origjinale të popullit, duke “kapërcyer stadin e një rendi primitiv” të shoqërisë, por të gjitha këto ekzistojnë për arsye që t’i shërbenin Shqipëtarëve “sigurimin e autonomisë dhe organizimin vetë-qeverisës” (Gjata 2014) Në mentalitetin e popullit⁹⁹ ende ruhen në një farë mase, ku më shumë e ku më pak, “zakone që

⁹⁸“në psikologjinë e popullit ende ruhen në një farë mase, zakone që janë zbatuar gjatë shekujve (Gjata 2014).

⁹⁹Parimet etike dhe morale si “nderi”, “burrëria”, “liria, barazia ndërmjet njerëzve” “besa”, “mikpritja”, “gjakmarrja” u bënë norma të detyrueshme” (Gjata 2014) për shoqërinë. Pa vënë në dyshim karakterin e këtyre zakoneve që disa prej tyre janë kthyer në norma të detyruara për

janë zbatuar gjatë shekujve” (Gjata 2014) Por ajo çfarë është për t’u diferencuar nga çka u parashtrua dhe realitetit të sotëm, është se Shqipëria nuk është më në kushtet e zgjedhës apo të pushtimit nga një fuqi e huaj, por në marrëdhënie të vazhdueshme me BE-në, të zgjedhur vetë me vetëdije, e cila ushtron fuqinë e butë nëpërmjet fuqisë normative, për t’a përgatitur vendin drejt integritit të plotë. Sot Shqipëria nuk është në një kuadër të tillë, si në të shkuarën ku Shqiptarët duhet t’u binden zgjedhës, por janë në një fazë konstruktimi drejt rrjedhave liberale dhe bashkëkohore. Në këtë kontekst nevojitet një ndërgjegjësim më i shpejtë dhe i përkushtuar me politikat e duhura nga të gjitha instancat për të përgatitur shoqërinë dhe institucionet drejt integritit dhe modeleve bashkëkohore të shoqërive përëndimore. “Strukturat e shoqërisë njerëzore janë kryesisht kulturore”, (Wend 1999; 193) domethënë nisen nga kultura, dhe në këtë kuptim “jo vetëm rregullojnë sjelljen por konstruktojnë identitetet dhe interesat”, kur kanë bashkëveprim kompakt dhe të ndërsjellë, prandaj në këtë aspekt BE shihet si rregullator normativ që e ndihmon Shqipërinë të konstruktohet sipas modelit të dëshiruar european.

4.7 Marrëdhëniet BE-Shqipëri. Pesha e lidërshiptit politik dhe aktualiteti normativ.

Përsa i përket realitet normativ dhe ligjor, qverisjes, klimës apo kulturës së përgjithshme demokratike, Shqipëria mbetet ende mbrapa siç u analizua dhe më sipër kur u prekën normat e reja të BE-së në raport me Shqipërinë, si për një rregullim normativ, ligjor dhe pasqyrimin e këtyre rregullimeve në praktikë, por edhe për përmbushjen e reformave që do të rregullonin dhe favorizonin atë së brendshmi nga njëra anë, dhe nga ana tjetër do të sillnin afrimin e saj në mënyrë më të shpejtë drejt kontekstit normativ dhe vleror përëndimor. Është e qartë që demokracia është një proces i ngadaltëtë dhe tranzicioni i gjatë në Shqipëri ka qenë i lidhur ngusht me një lloj demokracie të mbajtur peng pak nga kultura e

popullin dhe rëndësinë e tyre, analizimi i tyre nuk bëhet për të hedhur dyshime mbi karakterin e këyre të drejtave zakonore dhe vlerën e tyre, por për të vënë në dukje atë çfarë ka mbetur në ndërgjegjen e shqiptarëve.

përgjithshme demokratike dhe politike, dhe pak nga klasa politike, pasi “çelësi i një tranzicioni demokratik sa më të butë dhe me sa më pak kosto për qytetarët e vendeve në tranzicion lidhet ngushtë me politikën që ndjek e gjithë klasa politike” (Zotaj 2014; 142)

Kultura dhe “trashëgimia politike” (Zotaj 2014; 143) janë thelbësore për të kuptuar sjelljen dhe veprimet e një klase politike, pasi “politika ndërtohet mbi bazë principesh, konceptesh dhe vizionesh” (Zotaj 2014; 143) dhe mbi të gjitha “kërkesa për vlera demokratike lidhet ngushtë me përpjekjet e shoqërisë për t’i arritur këto vlera”. (Zotaj 2014; 143) “Në qoftë se i referohemi traditës politike në Shqipëri, ajo ka një mangësi të madhe përse u përket elaborimit të vlerave dhe kulturës demokratike” (Zotaj 2014; 144) dhe në këtë traditë apo kulturë politike “argumentët dhe faktet flasin për një vazhdim të traditës komuniste në zhvillimet politike nga ana e drejtuesve të rinj” (*Ibid*; 144) që ndjekin interesat afatshkurtra apo janë në “ndjekje të interesave të tyre personale” (*Ibid*; 144) Në këtë aspekt vëmendja drejtohet tek klasa politike apo liderët e ndryshëm të cilët kanë vonuar procesin e demokratizimit në Shqipëri. “Ka dy lloj politikanësh shqiptarë: për të cilët konjuktura e brendshme dhe e jashtme është gjithçka dhe politikanë vizionarë, këta të dytët na duhen domosdoshmërisht, se realisht na mungojnë” (Zeqo 1995; 54)

Kur përpjekjet e shoqërisë, kultura e përgjithshme dhe formimi politik i shoqërisë ecën paralel me vullnetin dhe përpjekjen e klasave politike mund të arrihet ajo demokraci që “bazohet në respektimin e qartë të rregullave të saj” (Zotaj 2014; 144). BE për vende si: Shqipëria pjesë e Ballkanit Perëndimor “është bazuar në politikën e kushtëzimit” (Abazi 2011; 80) me të cilën nënkupton dhe aplikon “Kriteret e Kopenhagenit”, të cilat synojnë garantimin dhe qëndrueshmërinë e “institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave” (Abazi 2011; 81), si dhe një ekonomi të qëndrueshme dhe të aftë për të konkurruar në tregjet globale.

Politikat kushtëzuese u panë si stimuluese për vende si Shqipëria edhe pse “kanë provuar të jenë të papërshtatshme për Rajonin e Ballkanit” (Troncota 2015; 166)

duke marrë në konsideratë shumë faktorë specifik të brendshëm, por edhe “rolin dhe impilikimin e ndryshëm të BE-së “ (Troncota 2015; 166) në procesin e reformave dhe të stabilizimit të këtyre vendeve në veçanti. Në fakt, kritikën dhe skepticizmin vijnë nga dy krahët, qoftë nga këndvështrimi i vendeve të Ballkanit për BE-në për sa i përket “kushtëzimit” si politika të pafavorshme që nuk kanë “kapacitetin e nevojshëm për të implementuar ndryshimet e kërkuara” (Troncota 2015; 164) për vende si Shqipëria, ose nga këndvështrimi i BE-se që po i teston si vende që nuk janë ende të aftë “për të adaptuar idetë europiane” (Troncota 2015; 164) pasi këto ide apo norma ende nuk po reflektohen apo nuk po “jehojnë në strukturat e brendshme”(Troncota 2014;164).

Ndërkohë “BE po jeton një krizë të thellë” (D’Alema 2016) me problemet e saj të brendshme si kriza emigrantëve nga Lindja e Mesme, dhe paaftësia e vendeve anëtare të saj për të ndarë barrën e përgjegjësisë për këtë krizë, euroskepticizmi dhe “një krizë udhëheqësish” (D’Alema 2016) vazhdon të mbizotërojë, si dhe kriza ekonomike që e ka shoqëruar për gjatë viteve të fundit, ndërsa Komisioni i ri me Presidentin Jean-Claude Juncker vazhdon të theksojë që “Ballkanit Perëndimor i duhet ta mbajë perspektivën Europiane” (Juncker 2014) por në të njëjtën kohë ai vetë me të marrë detyrën deklaroi se, “BE do të duhet të marrë një pushim nga zgjerimi” (Troncota 2014; 168) pavarësisht se marrëdhëniet dhe bisedimet vazhdojnë, projekti i zgjerimit do jetë “pesë vjet i ngrirë”(Troncota 2015; 169), duke e llogaritur nga koha që ai mori detyrën. Nëse kjo suspansë do të ketë impakte negative apo pozitive në avancimin e reformave për periudhën e ngrirjes kjo mbetet për t’u parë, por kjo nuk duhet të pengojë procesin e reformave për një vend si Shqipëria, të cilës i nevojitet raporti konstruktiv në radhë të parë me veten (pra klasat politike me njëra-tjetrën dhe klasat politike me qytetarët, sepse janë qytetarët pikë së pari, të cilët i kërkojnë më tepër reforma të tilla).

Në dukje, nga klasat politike ose nga diskursi i shumta politikë të palëve duket sikur antarësimin në BE e kanë prioritet, ndërkohë në praktikë vërehet mungesa e një debati konstruktiv, si dhe mungesa e një konsensusi nga ato për t’i

përshpejtuar këto reforma. Në kuadrin e këtyre sfidave ka thirrje dhe kritika të shumta nga studiues të ndryshëm të formës: “BE nuk mund të lërë pas dore Ballkanin Perëndimor” (Abazi 2011), ose “vetëm duke stabilizuar Ballkanin mundet BE të shpresojë që ta bëjë politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë më kredibël” (Vachudova 2003;93)¹⁰⁰në rajonin e Europian e më gjerë, por gjithashtu ka dhe mesazhe të tilla si: BE ka kriza por “s’është një projekt në krizë (D’Alema 2016) dhe gjithashtu është “ një projekt fitimtar që ka garantuar për 60 vjet, paqe, rritje ekonomike, përparim dhe stabilitetin në Europë” (D’Alema 2016)

Këto janë mesazhe stimuluese që vende si Shqipëria të mund të forcojnë kuadrin ereformave në kuadër të bashkëpunimit jo vetëm me rajonin e Ballkanit

(bashkpunimi rajonal i Ballkanit Pererëndimor në kuadër të fqinjësisë së mirë është shumë i rëndësishëm për BE-në) por edhe me BE-në për t’i bërë reformat dhe zhvillimin politik sa më të demonstrueshme dhe të prekshme. Për momentin hapat e Shqipërisë janë ende të ngadaltë dhe i duhet ende përkushtim për të zbatuar prioritetet kyçe që BE ka vendosur si: reforma në drejtësi, dekriminalizimi i partive politike, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, reforma në administratën publike, reforma zgjedhore, sfida këto që akoma pengojnë vendosjen e një date të saktë për hapjen e negociatave.

Korrupsioni ka pasur njëefekt gërryes në të gjithë sektorët shtetëror dhe institucional në Shqipëri "SipasTransparency International, korrupsioni në Shqipëri brenda sektorit publik mbetet një nga sfidat më të mëdha të vendit,veçanërisht në fusha të tilla si partitë politike, shëndetësi, dhesistemet e drejtësisë. Pagat e ulëta, pranimi social i ryshfetitdhe rrjetet e ngushta sociale bëjnë të vështirë detyrën e luftimin të korrupsionit në mesin e policisë, gjykatësve dhe zakoneve të zyrtarëve. Korrupsioni është gjithashtu i ndërlidhur ngushtë me krimin e organizuar me shumë prej zyrtarëve të lartë të shtetit që përfshihen në kontrabandë, evazion fiskal dhe zaptime territoriale”. (Nence 2013)

¹⁰⁰Vachudova M. 2003;93, “Strategies for European Integration and Democratization in the Balkans”Slovak Foreign Policy Affairs’ fq 92-106, e cituar në Troncota M. 2014) The formation of Junker Commission and its impact on the Western Balkans” ,fq. 153-177 Europolity, Continuity and Change in European Governance, Vol.8, nr 2

Edhe pse reforma në drejtësi u miratua në parlamentin shqiptar mbetet për tu parë më pas sundimi i ligjit, performancadhepërgjegjësitëqë kërkohennë institucionet gjyqësore dhe luftimi i korrupsionit në gjyqësor. "Partitë qeverisëse të Shqipërisë dhe Opozita mbetet të ndara mbi ndryshimet e rëndësishme gjyqësore, të cilat kanë si qëllim për të frenuar ndikimin politik mbi gjyqësorin dhe të ndihmojnë vendin për aderimin në BE" (Mejdini 2015)Problemi më i madh në sistemin gjyqësor është përsëri korrupsioni. Në një intervistë për Albanian Daily News, Ambasadori gjerman në Tiranë, Z. Hellmut Hoffmann komenton mbi reformën gjyqësore kështu *"kur shtetet anëtare të Bashkimit Evropian thonë se ka një problem me Korrupsionin në gjyqësor, pika e tyre nuk është aq shumë se nuk janë ligjet e duhura, ose se ligjet nuk janë të përkryera. Shqetësimi i vërtetë është se ligjet ekzistuese nuk zbatohen në mënyrë të drejtë pasi shumë gjygjëtare janë të korruptuar. Ky është thelbi i problemit"* (Hoffman 2015)

Një tjetër çështje e cila nevojitej për tu zgjidhur shumë vite më parësi projekti për hapjen e dosjeve të komunizmit është ende në pritje.Në krahasim me vendet e tjera komuniste të cilët e hoqën këtë çështje disa vjet më parë, Shqipëria vazhdon ta vonojë edhe këtëproces. Përfundimi i këtij projekti do të ndihmonte për të trajtuar problemet e vjetra të trashëguara nga e kaluara, format e vjetërrura të regjimeve politike dhe në fund do të sillte transparencë dhe shpresa se demokracia është një proces që po maturohet.

Tjetër çështje aktuale për tu zgjidhur në Shqipërimbetet informalitetit, qeverisja konfliktuale mes partive politike dhe liria e medias.Informaliteti ka pasur një efekt brejtës në ekonominë e Shqipërisë për shumë vite. Rezultatet e informalitetit për 25 vjetjanë parë në nivelet e papunësisë, rënie ekonomike dhe mungesë e stabilitetit ekonomik. Dialogu politik mbetet endeçështje sfiduese për forcat politike shqiptare. Marrëdhëniet mes forcave politike kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm dhe konsensus në gjetjen e mënyrave më pak konfliktuale për të ecur përpara drejt reformave.

Liria e medias në Shqipëri është gjithashtu ende e karakterizuar nga informaliteti, mungesa e lirisë së mendimit, apo konkurrencësë drejtë në tregun mediatik dhe

dezinformacioni. Këto fusha që u përmendendën tregojnë se fuqia normative e BE-së me vlerat e saj të konsoliduara normative dhe me vlerat post-demokratike ka hasur në terren të vështirë dhe ky terren është i vështirë për arsyet që kanë të bëjnë me kulturën e gjithanshme në përgjithësi, pastaj atë polike siç është përmendur më lart dhe kulturën normative Shqiptare. Në këtë aspekt konstruktiv shfaq hendek midis dy entiteteve sidomos për sa i përket vlerave post-demokratike të BE-së me vlerat liberale kombëtare. Pa diskutim që një raport i vazhdueshëm ndërmjet BE-së dhe dhe Shqipërisë për të ndërtuar këtë aspekt ka pasur dhe do vazhdojë të ketë impakte pozitive, pavarësisht të metave dhe kritikave që shkojnë edhe për BE-në në këtë drejtim.

KAPITULLI V

Përfundime dhe rekomandime

8.1 Përfundime

- **(Rrafshi mbikombëtar (BE))**

Në BE ka pasur shumë diskutime për një identitet të paunifikuar europian përtej antagonizmave shtetërore duke qenë se shtetet kanë pasur tendencë të rendin pas identitetit dhe sovranitetit të tyre në plan kombëtar. Në fakt “vetë projekti europian u ndërtua mbi bazën anti-kombëtare të identitetit” (Fukuyama 2012), ose mbikombëtare. *“Ai kishte për qëllim që të shkonte përtej egoizmit kombëtar dhe antagonizmave që karakterizonin politikën europiane të shekullit të XX. Dhe për këtë arsye ka pasur një besim se do të kishte një identitet të ri universal që do të zëvendësonte identitetet e vjetra europiane, si i të qenurit Italian, gjerman, ose francez”* (Fukuyama 2012) Kur autori Fukuyama flet për sferën politike europiane të shekullit të XX, atëherë kuptohet sa e rëndësishme do të ishte një identitet i unifikuar politik europian në këtë sferë, me qëndrime të njëjta rreth vlerave dhe normave që vetë fuqia normative ka dhe aplikon në themel të saj.

Ky identitet i unifikuar politik dhe normativ, edhe mbi eksperiencat e përbashkëta kolektive, nuk do të zëvendësonte identitetet kombëtare, por do shërbente si një

mbulese unifikuese për qëndrime të njëjta, për kohezion dhe harmoni ndërmjet vëndeve anëtare, në mënyrë që edhe menaxhimi i sfidave të vazhdueshme të bëhej në mënyrë sa më efikase.

Një BE me menaxhment dhe lidërsip të unifikuar dhe më e forte në arenën globale do ishte një model i konsoliduar dhe do të luante një rol akoma më të fuqishëm për vënde si Shqipëria apo vëndet e tjera të Ballkanit që pritshmëritë i kanë shumë të mëdha ndaj BE-së. Për këto vënde si dhe për vende që janë në BE, por akoma çalojnë në sferën politike, kërkohet një Europë e unifikuar në identitet politik në mënyrë që të avancojë zgjerimi dhe të konstruktohen politikisht vëndet që kanë nevojë të konstruktohen në atë fushë.

BE sot ka një krizë në nivel politik, ekonomik, dhe në ndarjen e përgjegjësiave, prandajka dhe sfida të tjera që rrjedhin pikërisht nga këto, por projekti është diçka në proces, që vazhdon, dhe vlerat e BE-së tashmë janë të sanksionuara në traktate. Britania e Madhe shprehu vullnetin e saj me referendum dhe tashmë është jashtë BE-së, çka e ka vënë në sfidë akoma më të madhe BE-në për vetë projektin europian dhe ka rritur kërkesën për përgjegjëshmëri më të lartë nga vëndet e unionit për vendimet që do të marrin për të ardhmen në të mirë të vazhdimësisë së projektit europian.

Pavarësisht sfidave dhe krizave, në këtë studim merret i mirëqenë fakti që BE është një projekt i hapur politik, dhe vënde si Shqipëria janë në proces konstruktimi dhe bashkveprimi politik dhe normativ. Kjo është dhe vlera më e madhe e kësaj marrëdhënie. Ndërkohë që ky process ndodh, Shqipëria ka mundësi të shpalosë dhe të promovojë vlerat e saj në këtë marrëdhënie të hapur. Ajo jo vetëm influencohet politikisht dhe nga ana normative por ka mundësi të influencojë dhe të impresionojë me vlerat dhe traditat kulturore, në një kuadër panoramik multi-kulturor të cilin Europa apo BE e vlerëson dhe kërkon ta zhvillojë akoma më shumë. Në këtë aspekt do të shihen vlerat, disa sfida dhe perspektiva që hasen në kuadër të kësaj marrëdhënie. Rëndësia e promovimit të tyre për ndërtimin e imazhit shqiptar në një realitet të gjerë multi-kulturor.

- ***Rrafshi kombëtar shqiptar***

Ky punim ka në qendër të studimit vlerat etno-kulturore si tipare thelbësore shprehëse të identitetit Shqiptar, që kanë zgjuar here pas here kureshtjen e studiuesve të huaj, të antropologëve, të udhëtarëve që kanë kaluar nga Shqipëria, por që nuk i është bërë jehonë aq sa duhet, për ti promovuar dhe për të krijuar literature të posaçme më të thelluar për këto vlera, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në këtë studim është parë se si rrjedha e këtyre vlerave gjatë shekujve ka qenë e natyrshme dhe e transmetuar brez pas brezi me uljet dhe ngritjet që kanë sjellur rrjedhat historike të ngjarjeve, që kanë prekur kombin shqiptar. Në këtë aspekt është parë e volitshme që të analizoheshin edhe faktorët politikë dhe socialë, në mënyrë që vlerat të shihen si komponentë të pandarë jo vetëm i një kulture të përgjithshme, por edhe të një sistemi vleror që përmban në vetvete kuadrin social-polik-etik-kulturor.

Ajo çfarë vihet re është se vlerat etno-kulturore kombëtare kanë spikatur karakterin shqiptar ndër shekuj, dhe e kanë ruajtur atë karakter dhe shpirt kombëtar deri në ditët e sotme, por në një sistem vleror të përgjithshëm ku ka munguar klima kulturore politike dhe demokratike si dhe çalimi apo ecja shumë e ngadaltë e procesit të reformave nga BE. Përveç kësaj vlerat liberale si progresi social, diskriminimi dhe qeverisja e mirë kanë ende shumë punë për përmirësim dhe kanë një mospërputhje me standartin europian.

Ajo çka e ka penguar rrjedhën sistematike të zhvillimit në përgjithësi të këtij sistemi vleror ka qenë mosfunksionimi në sintoni i komponentëve të sistemit vleror shqiptar, pra i komponentëve që ky studim ka analizuar, ku disa struktura të cilat janë analizuar, kanë çaluar. Për të marrë analizë vlerat kombëtare në rrjedhën e integritetit në BE, u desh të analizohej gjithashtu sistemi vleror i BE-së, si fuqia normative e saj, vlerat e identitetit European sipas qasjes esencialiste dhe vlerat e identitetit europian, në një komunitet të përbërë nga shumë identitete të para sipas qasjes konstruktiviste. Paraqitja e një kuadri të vlerave europiane ose të BE-së

është bërë për të parë mundësitë e integritit të vlerave etno-kulturore kombëtare si trashëgimi të gjalla, jo të lëna në harresë, në trashëgiminë kulturore europiane, dhe për të konstruktuar tek vetja atë çfarë aplikon BE nëpërmjet fuqisë dhe kuadrit normativ, pikërisht atë çfarë Shqipërisë i nevojitet më shumë. Për ti bërë vlerat pjesë të sjelljes bashkvepruese dhe sjelljes konstruktiviste, dhe pjesë të trashëgimisë europiane nevojitet një diplomaci publike aktive, e cila promovon vlerat e spikatura etnokulturore, që kanë ndikuar në ruajtjen e identitetit shqiptar dhe në mbijetësën e kombit Shqiptar.

Këto vlera si gjuha, bashkjetesa fetare në tolerance dhe traditat kulturore janë vlera esenciale në kuadrin e vetëshprehjes në një komunitet multikulturalist që vetëm mund të promovohen dhe të lartësojnë imazhin e shqiptarëve në arenën ndërkombëtare pasi janë vlera të veçanta dhe kontribuese. Edhe pse këto vlera s'kanë arritur të krijojnë atë kohezion social për të cilin ka vuajtur Shqipëria për shekuj me radhë sepse bashkimi në tërësinë e tij si komb ka qenë gjithnjë një detyrë e veshtirë për tu arrituredhe për shkak se vlerat e tjera politiko-sociale dhe etiko-morale, kanë munguar. Gjithsesi qasja konstruktiviste jep dhe identifikon sfera bashkëpunimi gjatë bashkëveprimit që Shqipëria ka me BE-në dhe në këtë prizëm, mund të ecet përpara dhe të shihen mundësitë e zhvillimit, promovimit dhe konstruktimit.

Cilat janë problemet e vlerave kombëtare sot? Sikurse është shqyrtuar edhe në kapitullin që analizon identitetin kombëtar, Shqipëria njihet për një klimë demokratike jo shumë të zhvilluar, me problemet e veta sociale dhe tranzicionet e gjata politike ekonomike, të cilat nuk e kanë ndihmuar aspak për evidentimin e vlerave dhe njëkohësisht për lartësimin e imazhit shqiptar. Shpesh nga mediat e huaja apo studime që janë bërë për Shqipërinë është folur në mënyrë të përgjithësuar duke u nisur nga tranzicioni i gjatë me periudha krizash politiko-sociale. Këto stereo-tipizime kanë ndikuar për një propaganda jo shumë të mire në favor të Shqipërisë, duke errësuar edhe ato vlera që janë dhe duhen promovuar. Një përzierje opinionesh dhe perceptimesh vjen nga vetë koncepti “identitet shqiptar.” Prof. Ass. Dr. Ibrahim Berisha konstaton se identifikimi i identitetit me

kombin në rastin shqiptar është bërë nga metodologjia publicistiko letrare si forma më e shprehur *“ka një qasje dominuese në sqarimin e identitetit shqiptar që është ajo historiografike – ideologjike- lingvistike dhe letrare-publicistike. Kjo qasje nuk prodhon ndonjë të veçantë shkencore. Duke mos qenë as gazetari dhe as shkencë, trajtimet debatet, polemikat kryesisht mbeten pezull duke prodhuar motiv hutues për identitetin, ajo që njihet te latinët si përsëritje e së njëjtës apo përsëritje e së diturës”* (Berisha 2009) Në këtë kënvështrim duhet të kryhen më tepër studime që të paktën në nivel kombëtar të thellohet, sqarohet çështja e identitetit në nivel shkencor, dhe me konsensus të gjerë duke shkuar drejt tendencave apo qasjeve që ekzistojnë sot në botë për përcaktimin e identitetit dhe ndryshimeve që pëson apo kontributeve që mund të japi një identitet i caktuar sipas qasjeve dhe rrymave ndërkombëtare që ka sjellur vetë koha në të cilën jetojmë. Gjithsesi çështjet e debatit dhe të pikpyetjeve që shtrohen në lidhje me identitetin nuk e pengojnë Shqipërinë të vazhdoj rrugën e konstruktimit, bashkveprimit dhe zhvillimit të saj drejt BE-së. Çështjet e debatueshme në nivele të ndryshme përsa i përket identitetit nuk duhet ta kthejnë Shqipërinë mbrapa në kohë, apo të ulin besimin apo reputacionin si të brendshëm apo të jashtëm dhe pritshmëritë për antarësim. Ata gjithashtu mund të shtrohen si debate konstruktive, që të ndihmojnë studimet për avancim të mëtejshëm drejt rrjedhave integrale, jo denigruese.

Etnosi kombëtar shqiptar paraqet vlera të spikatura të shprehura në tradita kulturore të njohura me konsensus të gjerë nga autorë të ndryshëm, të cilat duhen promovuar dhe zhvilluar si pjesë e identitetit dhe kultures shqiptare. Prandaj ky punim ka si qëllim të evidentojë vlerat etno-kulturore të identitetit shqiptar duke ju referuar burimeve të ndryshme dhe jo të dale në të vërteta shkencore historike përsa i përket identitetit shqiptar. Aty ku synon të arrijë Shqipëria, në komunitetin e BE-së ku bëjnë pjesë identitete të shumta, kombet e ndryshme që bëjnë pjesë aty e kanë afirmuar dhe shqyrtuar me kohë çështjen e identitetit të tyre kombëtar, dhe kanë reshtur së bëri debate në lidhje me identitetet e tyre kombëtare. Ata tashmë kanë shkruar historinë dhe vlerat e tyre, kanë ndërtuar kurrikulat kombëtare dhe kanë krijuar një imazh të tyrin në botë të cilin e përditësojnë vazhdimisht sidomos

nëpërmjet praktikave të diplomacisë publike. Përveç çështjes së identitetit shqiptar, akoma të debatueshëm Shqipëria ka nevojë që vlerat e saj etno-kulturore t'i shpalosi dhe t'i bëjë pjesë të një komunikimi apo dialogu ndërkulturor ndërkombëtar. Kështu ajo do të dale nga izolimi dhe reduksionizmi i vetvetes nga përceptimet e huaja. Përveçse të promovohen, këto vlera mund të konstruktohen sipas ideve të përbashkëta në mënyrë që të vihen në shërbim të vetë kombit dhe të ambjentit social ndërkombëtar.

- ***Përfundime dhe rekomandime në lidhje me vlerat etno-kulturore***
- ***(Gjuha)***

Gjuha shqipe bën pjesë në familjen e madhe indeo-europiane të gjuhëve. Ajo ka qenë një pjesë e rëndësishme, shprehëse e identitetit shqiptar, dhe një mjet për të shprehur zakonet traditat kulturore dhe për të përcjellur egzistencën e vetë popullit shqiptar që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Ajo është përbër nga dy dialekte, gegërisht (veriu) dhe toskërisht (jugu) krahina dialektore të cilat ndahen nga njëra tjetra, ay ku shtrihet lumi shkumbin. Megjithatë të dy krahinat kuptohen shumë mire me njëra tjetrën dhe e kanë integruar më së miri gjuhën shqipe. Ajo që paraqitet si sfidë sot për gjuhën shqipe është rigjallërimi dhe pasurimi i saj me fjalë shqipe të reja. Simon Pepa mendon se *“lufta për pastërtinë e gjuhës shqipe është po kaq e gjatë dhe këmbëngulëse sa dhe rruga e përpjekjeve të pareshtura për shkrimin e lëvrimin e saj. Qysh tek autorët tanë të vjetër shohim të shprehet shqetësimi për fjalët e huaja që po hynin në shqipen, por shohim edhe përpjekjet e tyre për të gjallëruar e formuar vetë fjalë të brumit popullor.”*¹⁰¹ Gjallërimi, formimi dhe pasurimi konsiston në zhvillimin e saj nga brumi i saj, dhe mos-përdorimi i fjalëve që kanë hyrë vonë në përdorimet “dialektore e krahinore”¹⁰² Si dhe përdorimi i fjalëve ekzistuese shqipe, në vend që të përdoren fjalë të huja, kur janë fjalët shqipe.

¹⁰¹ Pepa Simon, Për fjalën e bukur shqipe. Lexo më shumë :

<http://www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologji.aspx?id=270> pare me 11.6.2016

¹⁰² (ibid)

Një problem tjetër që vihet re me shqipen është rihapja e saj pas një izolimi të gjatë me rrjedhat integruese ku Shqipëria është përfshirë. Kjo do të thotë “*se shqipja ndodhet prballë nevojës së integrimit të një terminologjie të re që i ka munguar për shkak të izolimit-nacional komunist si dhe gjetjes së rrugëve se si do të bëhet ky integrim*”(Lubonja 1999;7) Pavarësisht faktit që gjuha letrare e njehësuar është mire-integruar si në veri dhe në jug, ka mjaft studiues që shohin gegërishten të lënë krejtësisht mënjanë dhe peshën që duhet të ketë ajo në gjuhën e njesuar apo standartizuar shqipe.

Pra rihapja e “*çështjes së raportit të shqipes standarte me gegërishten*” (Lubonja 1999;8) është një çështje me mjaft rëndësi për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe. Mos shqyrtimi i kësaj çështje “*shtron problemin nëse gegërishtja duhet të shuhet gradualisht në emër të unitetit kombëtar, duke i hapur rrugë forcimit të standartes, apo duhet të mësohet për shkak të asaj pjese të rëndësishme të trashëgimisë kulturore kombëtare që e kemi në gegërisht*” (Lubonja 1999;8)

Këto janë tre probleme dhe sfida që lidhen me gjuhën shqipe sot, që rrjedhimisht ndikojnë dhe në pasurimin, pastrimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Këto janë sfida që i përkasin jo vetëm individëve të thjeshtë, por edhe instancave apo qarqeve të ndryshme që jo detyrimisht merren direkt me gjuhën shqipe. “*Të jesh pjesë e familjes së madhe të gjuhëve indo-europiane-theksonte gjuhëtari ynë i madh E. Çabej-nuk do të thotë të gjunjëzohesh, e aq më keq të asimilohesh prej tyre, sepse gjuha është tipari kryesor i mbijetesës së një kombi*” (Harka 2016). Ndërsa Naim Frashëri thoshte “*kombet mbahen me gjuhët; një komb që humbet gjuhën’ e vet, është’ i humbur’ e i haruarë; që me të humburit të gjuhës së ti është’ i humbur dhe ay vetë.*” (Frashëri 1988; 244)

Rilindasit në përgjithësi si Fan Noli, Ndre Mjeda, Naum Veqilharxhi, Eqrem Çabej, Ernest Koliqi kanë bërë një punë të pandalur për të shkruar gjuhën shqipe, për ta përsosur, pastruar dhe lartësuar, si një gjuhë që duhet të ishte e kulluar dhe e pastër për të pëcjellur idetë, kulturën dhe shpirtin shqiptar. Sot kjo sfidë qëndron akoma edhe më e madhe për ta lartësuar, zhvilluar sipas rrjedhave integruese dhe ruajtur nga rreziku i gërryerjes apo asimilimit nga përdorimi i shprehjeve, formave apo fjalëve të gjuhëve të huaja. Ruajtja nga gërryerja dhe asimilimi s`do

të thotë që atë ta izolosh nga rrjedhat integruese apo ta kthesh tek *“puritanizmi, si dukuri konservatore, që e mbyll atë në vetvete, duke përjashtuar absolutisht huazimet, edhe aty ku nuk ekziston fjala përkatëse shqipe”*; -thotë autori Çabej. Do të ishte marrëzi, thekson më poshtë autori, nëse do të bënim përpjekje për të zëvendësuar edhe fjalë të tilla të huaja si *“qytet”, “shëndet”, “analizë”, “skenë”,* të cilat kanë zënë vend me kohë në leksikon e gjuhës shqipe. Me vlerë për gjuhën e sotme shqipe janë dhe ndërkombëtarizmat dhe fjalët që emërtojnë mjetet dhe dukuritë e reja të elektronikës së sotshme moderne.(Harka 2016) Pra kjo kërkon një punë të kujdeshme, dhe shumë të matur, pasi fjalë shprehje dhe struktura të posaçme shqip ka ose egzistojnë, por edhe që mund të përdoren nga ai brum apo të formësohen nga brumi egzistues, nga te dyja dialektet. Kur të dyja dialektet mund të vijnë në ndihmë, dhe mbajnë potencial për lartësimin dhe zhvillimin e shqipes, atëherë pse mos të nxirret më e mira dhe të integrohen këto risi në përdorim të njehsuar.

Ajo çfarë ndodhi me gjuhën shqipe pas periudhës së gjatë të komunizmit dhe izolacionizmit është se e shfaqti atë të papërgatitur ndaj rrjedhave integruese dhe glabalizuese. Në mënyrë që gjuha shqipe të përpallet denjësisht me këto “proçese jashtëgjuhësore” (Lloshi 2007;26) duhen politika gjuhësore të posaçme shtetërore, dhe “kujdesi shtetëror” (Lloshi 2007;32) Duke qenë se “gjuha është një dukuri thelbësisht shoqërore” duhet “të pranojmë se tashmë ecuria e shqipes së kultivuar varet pandërmjetshëm nga ecuria e kultures, dijeve dhe e përparimit të përgjithshëmshoqëror” (Lloshi 2007; 33) duke e shndërruar punën për lartësimin dhe zhvillimin e saj në një punë gjithpërfshirëse për të gjithë organizmin dhe veprimtarinë shoqërore, me kujdes të veçantë nga aparati shtetëror akademik për politika funksionale gjuhësore integruese.

- ***Toleranca fetare***

Toleranca fetare është një vlerë që i ka rezistuar kohës tek shqiptarët, dhe është karakteristikë e vetë egzistencës, e lirisë së shprehjes, e lirisë së besimit dhe e respektit për besimin e tjetrit.

Toleranca fetare erdhi si e diktuar nga rrethanat historike por u ngulit paqësisht si formë bashkjetese së bashku me traditat dhe kulturat që sollën këto fe, në veprimtarinë kolektive shoqërore të shqiptarëve. Besimet fetare në Shqipëri, me gjithë kritikën që kanë ardhur nga analistë, shkrimtarë apo studiues të shumtë në këtë drejtim, mbeten një karakteristikë e rrallë, që lartëson pikësëpari vetëdijen kombëtare, si ruajtjen e origjinalitetit dhe vlerave shpirtërore duke përcjellur respekt për ‘tjetrin’ me fe të ndryshme, qoftë shqiptar apo i huaj. Shqiptarët janë shembulli i një populli që beson në një zot, pavarësisht se nga çfarë besimesh përcillet ky zot.

Pra e vërteta në lidhje me zbulesën e perëndisë tek shqiptarët ka kuptim sepse ata shohin zotin si emruesin e përbashkët për të gjitha fetë. Përvec elementit të identitetit (gjuhë gjak komb) që i ka kaluar fetë në një plan dytësor për unifikimin e tyre, është dhe besimi në vërtetësinë e një zoti për të gjithë, që ka funksionuar si çelësi i paqes kolektive sociale në lidhje me besimet fetare, jo si një fe civile por si “një ligj moral” (Zeqo 1995;83) i shoqërisë shqiptare, ashtu siç e përshkruan autori Moikom Zeqo tolerancën fetare. “Traditat fetare” (Pannenberg 1994) dhe “ndërveprimi ndërmjet traditave fetare” (Pannenberg 1994) në rastin shqiptar nuk ka qenë një “formë e përkushtimit publik” (Pannenberg 1994), dhe nuk ka egzistuar si “një fe në të drejtën e vet” (Pannenberg 1994) që të krijojnë një fe civile, apo një bazë morali shoqërore, pasi një moral i qëndrueshëm social kërkon një bazë fetare. “Moralin, vetëm i bazuar në arsye, i pavarur nga çdo lidhje fetare, është për të thënë së paku, i pasigurt.

“Pa fe, liria degjeneron” në një lloj “licence dhe detyrimi” (Pannenberg 1999). Shqiptarët kanë ditur ta ndërtojnë tolerancën, dhe moralin e qëndrueshëm social pikërisht duke besuar në një zot, si baza e religjionit, mbi fetë që kanë hyrë në Shqipëri nga pushtuesit. Populli shqiptar nuk ka njohur as dhunë fetare e as lufta fetare, dhe kjo frymë paqësore duhet të vazhdojë të kultivohet si e tillë. Debate të tilla si ka tolerance apo nuk ka tolerance mbas kaq shekujsh që Shqipëria vazhdon dhe e kultivon një traditë të tillë, sjellin hije dhe kaos në përceptimin e drejtë të kësaj dukurie, ashtu siç është mishëruar në popull. Sot më shumë se asnjëherë, ku bota ka dëshmuar raste ekstremizmi, përplasje ideologjish me karakter fetar,

përplasje kulturash, Shqipëria duhet ta zhvillojë dhe ta promovojë këtë traditë, duke shmangur debatet pa bosht dhe pa vlera në lidhje me këtë karakteristikë. Pluralizmi fetar vetëm mund t'i shërbejë komunikimit ndërkulturor ndërmjet popujve apo grupeve sociale të ndryshme, mund të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet qytetërimeve, mundëson lirine e shprehjes dhe të besimit dhe edukon vlera. Ajo çfarë është me rëndësi, është identifikimi dhe sensibilizimi i popullit në vazhdimësi, për vlerat që përmban bashkjetesa fetare. Duhet punuar sistematikisht që kjo vlerë e lidhur pazgjidhshmërisht me historinë dhe rrethanat historike shqiptare, të paraqitet si realitet dhe të edukohet si karakteristikë egzistuese, në mënyrë që të mos propagandohet si mit, dhe të perceptohet e më pas të trajtohet si e tillë.

Në një kohë zhvillimesh marramëndëse jo në favor të bashkjetesës fetare, është e rëndësishme mbikqyrja, moskrijimi i hapësirave për ekstremizëm, fanatizëm, radikalizim, dhe kjo tolerance të shprehet si barazi, respekt i ndërsjellë ndërmjet besimeve që ekzistojnë, dhe mos diskriminimi i asnjërës prej feve që ekzistojnë. Sfidat qëndrojnë tek barazia legjitime që duhet të kenë këto fe për shoqërinë shqiptare, trajtimi i njëjtë nga të gjitha strukturat e shoqërisë, respektimi dhe mosdiskriminimi, në mënyrë që të mos përshkruhet si një tolerance e thjeshtë, por si një koncept që përmban të gjitha vlerat e lartpërmendura si kontrata morale për funksionimin në paqe të mutikonfesionalitetit shqiptar, pasi *“tolerimi është i bazuar në indiferencë, dhe kur indiferenca fetare bëhet një shenjë e kulturës publike, nuk duhet të befasohemi nga rritja e qëndrueshme e licencës së shfrenimit, nga humbja progresive e konsensusit lidhur me vlerat morale dhe kulturore, dhe me shpërbërjen sociale, duke çuar, me shumë gjasa drejt tiranisë dhe humbjes së lirisë”* (Pannenberg 1994). Prandaj këto tradita fetare duhen kultivuar si të tilla, ku në thelb qëndron i njëjti zot, ku për të “vetë-kuptuarit e tij dhe si kusht për autenticitetin” (Pannenberg 1994) e kësaj tradite, “kërkon idenë e tolerances” (Pannenberg 1994) me të gjithë vlerat morale dhe barazinë që duhet të përmbajë kjo tolerancë.

- ***Traditat etno-kulturore***

Trashëgimia etno-kulturore është një muze i gjallë shumë i pasur me elementë të traditës që janë transmetuar në shekuj brez pas brezi tek shqiptarët. Siç janë analizuar edhe tek kapitulli që shqyrton identitetin kombëtar shqiptar, janë pikërisht traditat kulturore që kanë kontinuar në mbajtjen gjallë të folklorit dhe të karakteristikave që kanë të bëjnë me vlerat e etnosit shqiptar. Traditat janë mbartëse të së shkuarës drejt së ardhmes. Drejt rrugës të së ardhmes ato duhet të ndërtohen sipas rrjedhave integruese duke ruajtur të gjallë origjinalitetin në një atmosferë multi-kulturore. Karakteristikat etnografike kanë larmishmëri dhe dallime karakteristike nga veriu në jug, dhe çdo krahinë apo zonë ka veçantitë e veta duke e pasuruar akoma më shumë mozaikun etno-kulturor shqiptar. Këto vlera e karakteristika të shumta e të ndryshme e pasurojnë akoma më shumë realitetin kombëtar, “si shprehje e pasurisë dhe e gjallërisë së njësisë kombëtare” (Jakllari 2002; 20) “Njësia kombëtare në artin popullor nuk mund të egzistojë pa diversitetin” (Jakllari 2002; 20) Kjo vlen edhe për Ballkanin dhe Europën, ku nuk mund të ketë trashëgimi kulturore të përbashkët pa pasur diversitet.

Diversitetet kulturore të shprehura në tradita kulturore mund të përcjellin shije, vlera etike, dhe shpirtin e gjallë të kombeve të ndryshme. Në këtë kuadër vlerat etnografike duhet të promovohen, për të pasuruar larmishmërinë dhe diversitetin më gjerë se sa në nivel kombëtar dhe të dalin gjithmonë e më shumë në pah, në një kohë ku lëvizjet sidomos turistike janë të shumta, në kuadrin e turizmit kulturor, për të ngjallur interes për këtë pjesë origjinale të kultures shqiptare. Përveç kësaj folklori ka mjaft pasuri dhe vlera për të shpalosur që nga lashtësia deri në ditët e sotme ku shumë elementë janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar sipas kohës. “Duke qenë pjesë përbërëse e strukturave vitale të jetës” shqiptare “shpirtërore” (Jakllari 2002;19) “folklori ndihmoi ndjeshëm” në “identifikimin e njeriut shqiptar” (Po aty) “Po kështu ky manifest artistik e vuri publikun e sotëm në relacion estetik, filozofik dhe etik me tërë rrjedhën e jetës historike shqiptare, nga burimi protoilir i saj deri në kufinj të modern.

“Ai e vuri në kontakt shpirtëror e mental me shumë breznitë e stadi kulturor të kombit tonë” (*Ibid* 2012; 19) dhe “ky komunikim i gjerë që është privilegj në radhë të parë i artit oral” që shpreh “në mënyrë të spikatur tiparet esenciale të botëperceptimit” dhe “botëshijimit” (po aty) shqiptar. Të gjitha elementët, temat e këtij mozaiku duhen pasqyruar dhe hedhur nëpër festivale apo evente të ndryshme jo vetëm kombëtare, por edhe shkëmbyese ballkanase dhe europiane. Asnjëherë nuk është vonë për mbledhjen dhe grumbullimin e pasurisë etno-kulturore, dhe shfrytëzimin dhe paraqitjen e saj në evente të dizenuara për shpalosjen e këtyre vlerave për efekt njohje dhe imazhi.

- **Rekomandime**

(vlerat liberale, reformat dhe imazhi)

Ndërtimi i demokracisë është një proces që ecën ngadalë në përgjithësi, ama në Shqipëri siç është vënë re nga të gjitha nivelet e shoqërisë, por edhe nga jashtë, tranzicioni politik ka qenë i gjatë me momente kyçe të vështira për tu kaluar, çka ka dhënë impaktet negative jo vetëm në shoqëri, institucione, por edhe në ekonomi, formimin e një kulture të përgjithshme në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe politiko-institucionale. Kjo ka çuar gjithmonë në vonesa, në shtyrje afatesh për sa i përket asaj çfarë synon të arrijë Shqipëria në raport me BE-në, dhe në mos pasjen e një periudhe apo afati të caktuar kohor për antarësimin e plotë të Shqipërisë në BE.

BE ka vënë një sërë kushtesh dhe kriteresh që Shqipëria duhet të adaptojë që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, progresin social dhe progresin e qëndrueshëm, qeverisjen e mirë ose efikase, luftën ndaj diskriminimit dhe që të përshtase dhe të konstruktojë veten sipas modelit që ofron BE nëpërmjet fuqisë normative. Përmeshja e kushteve dhe kriterëve të vëna nga BE, (pavarësisht kritikave që ka marrë BE në lidhje me formulat që aplikon ajo në raport me vendet e Ballkanit në veçanti) ndoshta nuk nënkupton një adaptim të gjithë sistemit vleror kombëtar me atë të BE-së, ama nënkupton një konstrukt sipas rrjedhave integruese, përse I

përket vlerave të liberal-demokracisë që janë në shërbim të interesave kombëtare për sa i përket ndërtimit politik ekonomik dhe social të Shqipërisë.

Interesi kombëtar ruhet dhe avancohet duke përqafuar vlerat e solidaritetit, qytetërimit, demokracisë dhe drejtësisë, që janë në thelb të fuqisë normative dhe vetem atëherë mundet që interesi kombëtar i një vendi të përkojë me interesat njerëzore, dhe të zhvillojë me ritme më të shpejta mekanizmat për promovimin e vetes në arenën ndërkombëtare.

Për të zhvilluar vlerat e solidaritetit, qytetërimit, klimës demokratike dhe institucionale, Shqipërisë i shërben një marrëdhënie e vazhdueshme me BE-në ku në këtë marrëdhënie mund të zbërthejë edhe vlerat që burojnë nga një themel apo trashëgimi etno- kulturore që ka zhvilluar populli shqiptar gjatë mbijetesës së tij. BE është një projekt politik, dhe fuqia normative të cilën ky projekt politik e dëshmon është aspekti më i rëndësishëm për BE-në. Në këtë këndvështrim konstruktimi dhe përshtatja e Shqipërisë me këtë realitet normative do të ishte me rëndësi jo vetëm për Shqipërinë por edhe për shtetet e tjera që bashkveprojnë, japin e marrin në komunitetin e BE-së.

Arbër Xhaferri në një intervistë për rëndësinë e imazhit pozitiv të shqiptarëve shprehej kështu: - “Në Evropë në përgjithësi mund të funksionojnë shtetet në qoftë se do t’i plotësojnë tre kushte elementare. Kushti i parë është kohezioni i brendshëm në atë shtet” (Xhaferri 2012; 51) Kjo vlen shumë për rastin e Shqipërisë që shteti është distant nga shoqëria civile dhe anasjelltas, ku gjithë trupi shoqëror si i tërë ka nevojë për solidaritet, paqe, harmoni dhe tolerance, duke hequr nga praktika shoqërore kolektive funksionimin dhe veprimin nëpërmjet, grupeve, klaneve, individëve apo klientëve, për të ndërtuar një praktikë të re operimi në favor të ndërtimit të një sistemi apo strukture të forte dhe të qëndrueshme sociale për të sjellur progres të qëndrueshëm. “Kushti i dytë është ekonomia që krijon lehtësira për të gjithë qytetarët, pra mirëqenia ekonomike dhe kushti i tretë është demokracia liberale” (Xhaferri 2012;51), ndërtimi me hapa të shpejtë i të cilës në Shqipëri, do të sillte progress në reforma, në përmirësimin e klimës demokratike dhe të kultures politike në përgjithësi. “Cilësia e Evropës është afirmimi i idesë kombëtare dhe jo shuarja e idesë kombëtare” (Xhaferri

2012; 51) kjo dëshmon që shtetet ndjekin interesin e tyre duke bashkvepruar me njëri tjetrin brenda këtij kuadri politik normative që operon BE. Kjo do të thotë që shtetet ndjekin interesin kombëtar duke vepruar jo si individ të veçantë por në realitetin e një komuniteti ku bëjnë pjesë shumë shtete.

BE ka ndryshuar kriteret dhe kushtet për antarësim nga traktati në traktat dhe nga një vale zgjerimi në tjetrën, por kjo më shumë se superioritet i imponuar siç shihet shpesh here nga vëndet aspirante, do të ishte më mire të shihej dhe të interpretohej si ‘politika kushtëzimi’, ashtu siç i quan vetë BE. Edhe pse këto politika shihen shpesh nga studiues dhe nga njerëz të niveleve të ndryshme si të pafavorshme për vëndet e Ballkanit, pasi nuk po sjellin ndryshimin e duhur, konstruktimi dhe përmirësimi i aspektit politik është shumë i rëndësishëm për interesin kombëtar në radhë të pare, e më pas për kuadrin e BE-së.

Shqipëria duhet të tregohet e aftë për të implementuar normat liberal-demokrate që ndihmojnë në luftimin e diskriminimit, progresin e vazhdueshëm dhe një qeverisje sipas modelit integruar, jo vetëm për të përmbushur aspiratën e saj shumë vjeçare, por edhe për të ndryshuar dhe ndërtuar përceptimet në lidhje me imazhin që buron nga ky aspekt.

Nëpërmjet diskurseve dhe raporteve zyrtare BE nuk imponon ndonjë superioritet vleror kulturor për çështjet e identitetit apo duke vënë në diskutim identitetet kulturore të vëndeve që aspirojnë të bëhen pjesë e BE-së, se sa i mëshon kriterëve politike nëpërmjet fuqisë normative. Duke qenë një projekt politik i hapur ku në themel qëndrojnë vlera dhe norma që rrjedhin nga kjo fuqi, ajo zyrtarisht aplikon dhe i jep identitet vetes nëpërmjet atyre normave që janë të identifikuara në tabelën nga autori Manners, ku flitet për fuqinë normative të Europës, duke përmendur vlerat thelbësore dhe normat e reja.

BE njeh me konsensus të gjerë, vlera kulturore të cilat janë si p.sh arti, arkitektura, muzika, feja, politika, principet filozofike, familja, etj dhe disa periudha të rëndësishme ku këto vlera janë zhvilluar dhe kanë krijuar një lloj qytetërimi europian, nga që mendohet të ketë evoluar që nga antikiteti greko-romak, Krishterimi, Rilindja dhe humanizmi i tij, mendimi politik i Rilindjes, dhe Revolucioni Francez, dhe zhvillimet e modernitetit, duke përfshirë të gjitha llojet

e socializmit. Por këto vlera janë prurje dhe kontribut i gjitha kombeve që ajo mban në komunitetin e saj. Qëllimi i tezës nuk ka qenë të provojë identitetin evropian të shqiptarëve, edhe pse gjatë shtjellimit dhe analizës shfaqen marrëdhëniet e shqiptarëve dhe Shqipërisë me Perëndimin që në lashtësi, pavarësisht periudhave dhe fazave të ndërprerjes nga pushtimet lufrat dhe zhvillimet ndërkombëtare që prekën dhe Shqipërinë.

Kjo tezë ka synuar gjatë shtjellimit të demostrojë që vlerat etno-kulturore nuk ka pse të përputhen me doemos me një realitet të gjerë dhe kompleks evropian, për sa kohë në gjirin e saj ka një shumicë shtetesh me kultura, besime, tradita kulturore dhe gjuhë të ndryshme, me rende të ndryshme politike, të cilat janë të disiplinuar për të jetuar së bashku në një mënyrë ose në një tjetër, duke rrespektuar në parim vlerat e BE-së të sanksionuara tashmë në traktate.

Ajo çfarë i disiplinon dhe i konstrukton këto shtete të jetojnë së bashku është projekti politik i përbashkët dhe fuqia normative që aplikon BE. Ajo çfarë i duhet Shqiptarëve të përshtasin, është pikërisht aspekti normativ, aty ku shfaqet dhe hendeku më i madh, dhe kjo është me interes të madh si për interesin shtetëror ashtu edhe për atë të përbashkët të shteteve. Konstruktimi i ndërsjellë formëson dhe disiplinon bashkjetesën dhe mundëson respektimin dhe të popujve, shteteve dhe kombeve jashtë Europës. Respektimi i popujve kërkon edhe pranimin e tjetrit të njëjtë për nga vlerat politike morale dhe normative, por jo detyrimisht të njëjtë kulturalisht.

Një tjetër faktor i domosdoshëm për bashkjetesë është pranimi i multikulturalizmit, pasi nëse vlerat politike normative kërkojnë pëputhshmëri për një bashkjetesë që të funksionojë, multikulturalizmi është një fenomen që sot ekziston në BE. *“Kontinenti Evropian nuk ka një identitet kulturor dhe qytetar të përcaktuar. Ai përbëhet nga një larmi identitetesh kulturore dhe qytetare kombëtare, nga të cilët asnjëri nuk mund të përfaqësojë identitetin kulturor dhe qytetar të Kontinentit. Edhe në këtë rast, identiteti kulturor dhe qytetar i çdo kombi evropian është në raport me atë që do të ishte identiteti kulturor evropian, si pjesa me të tërën. Shkurt, Evropa si kontinent nuk ka asnjë identitet të mirëfilltë kulturor e qytetar të saj. Nëse nga kjo pikëpamje duhet të flasim për një identitet*

të mirëfilltë kulturor e qytetar evropian, këtë duhet ta kërkojmë tek larmia e identiteteve kulturorë e qytetare të kombeve që jetojnë në gjirin e saj, pra tek mungesa e një identiteti të mirëfilltë evropian” (Frashëri 2006) Në këtë aspekt Shqipëria e ka një identitet etno-kulturor karakteristik që mund ta vejë në bashkveprim me kombet përbërëse të BE-së, ndërsa, përsa i përket aspektit politiko-normativ e ka në konstruktiv e sipër, dhe kjo është sfida më e madhe për të. Sa më shpejt që të përshtatet në këtë drejtim aq më shpejt do t’i hapë rrugë intersit dhe aspiratave kombëtare për zhvillim dhe integrim, aq më shumë do të shpalosë dhe promovojë vlerat etno-kulturore gjatë rrjedhës dhe rrugës së integritit, dhe kur të gjithë këto komponentë të sistemit vleror të jenë të sinkronizuar dhe të zhvilluar në mënyrë paralele, edhe imazhi i saj do jetë përmirësuar ndjeshëm.

Megjithatë politikat për përmirësimin e imazhit duhen zhvilluar më tepër edhe në kushtet që jemi. “Çdo popull në procesin historik has kriza në identitetin e tij për shkak se tradita ndërpritet shpesh here e në mënyrë të dhunshme me luftra, me pushtime,” (Xhaferri 2012;45)apo nga tranzicione të gjata politiko-ekonomike dhe sociale, por kjo s`do të thotë që ai popull nuk ka një identitet apo ka një identitet të pranueshëm apo të pëlqyeshëm për veten dhe të tjerët. Biles, pikërisht periudhat e vështira që ka kaluar Shqipëria në procesin e saj historik, me luftra pushtime dhe tranzicione, dëshmojnë se ajo ka ditur të trashëgojë dhe të ruajë shpirtin dhe etnosin e saj kulturor, dhe ky etnos është shumë i pasur dhe i larmishëm. Pikërisht këtë aspekt duhet të shpalosë dhe të promovojë diplomacia publike shqiptare.

“Cilësia e Evropës,”(Xhaferri 2012; 51) produkti dhe zhvillimi evropian ka ardhur pikërisht nga bashkveprimi kulturor që kanë sjellë kombet në Europë më parë e më pas në BE me njëri tjetrin. Shtetet në BE vazhdojnë afiromojnë idenë kombëtare, dhe kulturën apo identitetin e tyre, në një projekt politik të përbashkët. Shpalosja e vlerave kombëtare nuk vlen vetëm për një realitet të BE-së por duhet të shihet si një projekt apo politikë që fillonqë nga audienca shqiptare, rajonale ballkanike, në BE e më gjerë. Kjo kërkon ndërmarrjen e fushatave të gjera aktive ku shqiptarët, insatancat e përfshira të fillojnë të “analizojnë në mënyrë të mirëfilltë traditën e tyre, historinë e tyre” dhe të mos “bëjnë gabime trashanike

duke ia lënë antiken grekëve, mesjetën sllavëve, periudhën osmane turqëve dhe vetë mbeten pa asnjë identifikim kulturor nga e kaluara” (Xhaferri 2012; 53)

Krishtërimi per shembull “nuk ka qenë vlerë e vetëm sllavëve apo grekëve por ka qenë edhe e shqiptarëve” (Xhaferri 2012; 53) Ata “për 17 shekuj kanë shkuar në këto kisha prandaj nuk mund të jenë vetëm të sllavëve por janë prone e të gjithë popujve të Ballkanit” (Xhaferri 2012; 54) Përveç kësaj shqiptarët kanë arritur të kultivojnë dhe bashkjetesën fetare, si një karakteristikë e veçantë e këtij populli. Në këtë këndvështrim, mbetet shumë punë për tu bërë. Meqënëse Shqipëria nuk ka gëzuar një imazh jo të mirë, “përfaqësuesit tanë të kultures, të shkencës” duhet “të fillojnë të angazhohen në këtë segment të ndërtimit të imazhit të mire të shqiptarëve dhe të kenë plane konkrete se do të korrigjohet ky imazh” (*ibid*) si në plan rajonal, por edhe më gjerë. Shqipëria ka prodhuar gjithmonë personalitete nga fusha e artit dhe kultures të cilët mund të promovohen për role individuale në përmirësimin e imazhit. “Shqiptarët kanë performance të shkëlqyera kulturore, është një popull fisnik që arrin në kushte minimale ekonomike të krijojë kulture” (Xhaferri 2012; 56) Për këtë arsye atyre duhet ti jepet hapsira dhe mundësia e duhur që të përçojnë kulture dhe krijim në favor të përmirësimit të imazhit kudo. Për sa kohë politika dhe demokracia është në fazën e saj të konstruktimit dhe ekonomia është në fazën e saj të zhvillimit, diplomacisë kulturore duhet ti krijohen të gjitha mundësitë dhe të ndërtohen të gjitha strategjitë e nevojshme që ajo të veprojë.

Personalitetet e kulturës, artit dhe shkencës nuk duhet të kthehen në “instrument të partive politike. Ata duhet të ndërtojnë argumentin për një imazh pozitiv dhe të fuqishëm të shqiptarëve” (Xhaferri 2012; 56) Politika ka një detyrë përse i përket dhënies së hapsisës së nevojshme këtyre personaliteteve dhe mbështetjes së tyre si dhe të “ndërtojnë institucione të fuqishme shkencore që ndërtojnë argumentin ekonomik, argumentin historik, argumentet kulturore, gjeostrategjike apo të tjera” (Xhaferri 2012; 57) dhe jo të varen “prej aftësive të tyre retorike” (po aty) kur vjen puna për të mbrojtur veten dhe për të paraqitur sa më mirë imazhin e vetes ndërkombëtarisht. Pra Shqipëria ka nevojë për të ndërtuar politikat dhe strategjitë e duhura, në mënyrë që të zhvillojë dhe të prodhojë diplomaci publike në

përmirësim të imazhit. Kultura dhe vlerat etno-kulturore përbëjnë një fushë me shumë interes dhe një fushë që ka prodhuar dhe vazhdon të prodhojë, prandaj duhen shfrytëzuar, interpretuar dhe promovuar këto asete jo për të dale drejt një adaptimi me kulturën dhe vlerat e qytetërimit europian, sesa për të promovuar vlerat origjinale në një kuadër të gjerë multikulturalizmi.

- ***Roli i diplomacisë publike për përmirësimin e imazhit kombëtar***

Në këtë studim theks të veçantë kanë pasur vlerat etno-kulturore, si vlerat më të spikatura të identitetit shqiptar të cilat kanë shënjuar mbijetesën kombëtare dhe kanë qënë vlera bazë për formimin dhe unifikimin kombëtar shqiptar në periudhat më të vështira historike që ky komb ka kaluar. Këto vlera nuk janë identifikuar vetëm nga autorë shqiptarë por edhe të huaj. Ata u analizuan jo vetëm për ti parë ato nën dritën e identiteteve të ndryshme që përcjellin dhe shkëmbejnë vlera të ndryshme të cilat egzistojnë sot pa pyetur askend dhe në mënyrë gati si të vetëvendosur në BE (pavarasisht divergjencave dhe kondrtaiktave që ka në BE rreth identiteteve të ndryshme që qarkullojnë dhe jetojnë aty) , por për të parë se “zhvillimi dhe mirëmbajtja e çdo kulture kërkon ekzistencën e një “ego” të ndryshëm dhe një “alter” konkures. “Ndërtimi i identitetit për identitetin nuk ka rëndësi” (Said 1978; 324-325) se çfarë lloj identiteti ndërtohet, sepse ajo çfarë ka rëndësi është “një depo e përvojave të ndryshme kolektive duke përfshirë në vetvete ‘vendosjen e të kundërtave’” (Said 1978; 324-325) që ndihmon në shkëmbim dhe pasurim. Pikërisht këtu qendron edhe rëndësia e diplomacisë publike. Si të përcillen dhe të promovohen këto vlera.

Si mund të përmirësohet imazhi i vendit, çfarë roli mund të luajë diplomacia publike jo vetëm në peisazhin rajonal, atë ballkanik dhe europian por edhe më gjerë. Sot imazhi ka një rëndësi shumë të madhe për ndikim të gjerë. Autori Guy Debord, në librin e tij “Shoqëria e Spektakleve” thekson se “Gjithcka çfarë dikur jetoheshe drejtpërdrejtë, është bërë thjesht një përfaqësim”(Debord 1994;5) pasqyrim në imazhe, në një rrjedhë ku ndeshen, takohen dhe krijojnë përceptime. Brenda kuadrit të diplomacisë publike, imazhet e aktorëve (vëndeve) të ndërtuara nga perceptimet mbi identitetet japin e marrin me njëri tjetrin. Duke qënë se

“qeveritë gjithmonë përpiqen për të komunikuar me publikun e huaj” (Smith 2010) dhe jo vetëm por edhe atë vendas pasi sot gjithmone e më shumë po zhduken muret ndarëse ndërmjet publikut vendas dhe atij të huaj; ata nëpërmjet procesit të komunikimit, bindjes, dhe joshjes përpiqen “për të eksportuar idetë e tyre, institucionet dhe kulturën, si dhe synimet kombëtare dhe politikat aktuale”.(Smith 2010)¹⁰³ Në një botë marrëdhëniesh gjithnjë e më të ndërvarura diplomacia publike krijon nevojën dhe domosdoshmërinë për njohje dhe krijim marrëdhëniesh të ndërsjella me aktorin, ose aktorët e tjerë.

Shqipëria, që pas viteve 90-të dhe rënies së komunizmit e ka përzgjedhur rrugën e saj perëndimore. Ajo është anëtare e Nato-s dhe aspiron integrimin në BE. Duke qenë se është në një proces të vazhdueshëm marrëdhëniesh me këto struktura të cilat kanë vendet e tyre anëtare, mund të punojë sistematikisht për prodhimin e kësaj klime të favorshme për të fituar audiencën e huaj duke promovuar vlerat, ashtu siç interpretohen nga autorët e ndryshëm, por edhe agjentë të tjerë në mënyrë sa më të besueshme, nëpërmjet një politike apo fushate të sektorëve dhe agjensive të politikës së jashtme shumë proaktive, që pasqyrojnë në çdo moment ndryshimet apo zhvillimet në vend. Kur flitet për politikë proaktive dhe sistematike të jashtme, duhet pasur parasysh “Diplomacinë Dixhitale” si një Diplomaci publike e re, që “është duke iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin ndërkombëtar dhe vendor, në qendrat kryesore të autoritetit, sidomos shtetet, dhe në karakterin e shoqërive brenda dhe jashtë vendit. Shkalla në të cilën diplomacia e sotme është shndërruar në “një institucion social tani është më e dukshme se kurrë” (Hocking & Melissen 2015; 9) "Risja" në diplomaci sot është se çdo gjë ka të bëjë “me aplikimin e komunikimeve të reja të teknologjive të diplomacisë” (Ibid ;9) Duke pasur parasysh vonesat që ka kaluar vendi ynë në periudhat e

¹⁰³ Diplomacia Publike e formuluar sipas studentëve të diplomacisë publike në London Metropolitan University. The new public diplomacy 2010. Artikulli origjinal i edituar në këtë faqe interneti i marrë nga (Smith, P.H. Public diplomacy, by Minister-Counsellor for Public Affairs, U.S. Embassy, London. Retrieved on 26/04/2010. From: <http://www.diplomact.edu/books/mdiplomacy-book/smith/p.h.%20smith.htm>)
Marrë nga: <http://newdiplomacy2010e.blogspot.al/2010/04/importance-of-public-diplomacy-in.html> parë më 1/6/2016 , parë më 10 korrik 2016

vështira historike ku ka kaluar identiteti shqiptar, të cilat janë përmendur më lart, duhet përshpejtuar me ritmet që përdorin vendet perëndimore për të promovuar imazhin e tyre sot qoftë për hesape të politikës së jashtme, qoftë për zhvillimin e turizmit apo avancimin në të gjitha fushat për përfitime si vetjake ashtu edhe të ndërsjella, duke përdorur mekanizmat e diplomacisë publike.

Marrëdhënia me strukturat euro- atlantike e ndihmon Shqipërinë jo vetëm për të promovuar imazhin në ditët e sotme por edhe për ta konstruktuar këtë imazh nën dritën e vlerave, normave dhe frymës që tenton të përcjellë bota perëndimore, dhe reformave që po ndërmerr Shqipëria në këtë drejtim. Në një mënyrë ato arrijnë të joshin qeverinë dhe audiencën shqiptare se vlera dhe norma të tilla si “pluralizmi, liria, demokracia, qeverisja e mirë etj., janë vlera themelore njerëzore që do të rezonojnë dhe duhet të ndiqen në vende” (Wolf Jr. & Rosen 2004;4) si Shqipëria për të sjellur progres dhe kulturë të përgjithshme institucionale dhe demokratike, nga ana tjetër Shqipëria në kuadrin e multikulturalizmit mund të promovojë jo vetëm progresin që sjell në fushat që i kërkohen nga këto struktura, por edhe vlerat e spikatura të identitetit si vlera të shpirtit popullor shqiptar që janë transmetuar brez pas brezi. Duke ndjekur në mënyrë koherente dhe sistematike zbatimin e reformave mund të zhvillojë më tepër vlerat liberale dhe kulturën demokratike në vend dhe të ndihmojë progresin e demokracisë neoliberale. Sa më të zbatueshme dhe të vërteta të jenë reformat, aq më të matshme do të jenë rezultatet si për publikun vendas ashtu edhe të huaj dhe si rrjedhim komunikimi rezultateve do të ndihmojë përmirësimin e imazhit dhe joshjen e audiencës.

Diplomacia publike është një term dhe një praktikë e futur vonë në përdorim në Shqipëri. Në vitet e para të tranzicionit pavarësisht parullave dhe sloganeve të popullit dhe protestave të aktivistëve që luftonin për demokraci “e duam shqipërinë si gjithë Europa”, “informimi dhe bindja e opinionit publik të huaj nuk kishte të bënte dhe aq me publikimin dhe mbrojtjen e vlerave universale njerëzore, si: liria, demokracia dhe pluralizmi” (Gjuraj 2013) apo vlera të tjera

kulturore, “por më shumë me politikat dhe sjelljen e qeverisë shqiptare gjatë tranzicionit, qëndrimet dhe sjelljen e publikut shqiptar ndaj këtyre vlerave (*ibid*).

Duke marrë në konsideratë eksperiencën relativisht më të shkurtër të shtetformimit shqiptar në raport me vendet e tjera të rajonit, shteti shqiptar ka zhvilluar dhe ka qenë i orientuar deri vonë në diplomacinë tradicionale, duke pasur parasysh që “diplomacia publike është transparente dhe gjerësisht e shpërndarë”(Charles Jr. & Rosen 2004;4), dhe ajo tradicionale ose “zyrtare (përvec rasteve të rrjedhjes) e padepërtueshme me shpërndarje ngushtësisht të kufizuara”(Ibid;4).Duke pasur parasysh eksperiencën e mangët, vonesën në shtetformim, kthesat e vështira, periudhën e gjatë të tranzicionit, Shqipëria ka pasur një imazh jo të mirë ndërkombëtar. Ka një serë arsyesh që lidhen me krijimin e një imazhi jo të mirë që kanë disa vende në përfundim për Shqipërinë. Një pjesë e vëndeve të BE-së dhe më gjerë ose nuk dinë dhe nuk e njohin shumë në plan individual, pavarësisht marrëdhënieve që ka Shqipëria me BE-në dhe përpjekjeve të saj për anëtarësim, ndërsa një pjesë tjetër e kanë krijuar atë imazh nga “një traditë e krijuar prej kohësh” (Alpion 2005;12) dhe një tendencë për ta “përkrahur këtë vend vetëm bardh e zi” (Alpion 2005; 12) deri në kohët më të vona. Kjo vjen edhe si shkak i pozicionit të saj pak të eklipsuar në vetë rajonin e Ballkanit. Duke qenë se pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë u krijuam dy realitete shoqërore si, “Jugosphere” dhe “Albanosphere” (Joannin 2011). Këto dy sfera kanë komunitetet e tyre përkatëse, të cilat lidhen për shkak “të gjuhës, kulturës, interesave të tyre” (Joannin 2011) dhe të vlerave të tjera etno-kulturore që i identifikojnë ato në njërën nga komunitetet apo sferat e lartpërmendura. Ajo çfarë në ditët e sotme është thelbësore për t’u kuptuar, është se “interesi i këtyre dy sferave nuk mund të jetë për shkak se ata janë të kundërta,” (Joannin 2011) apo se duhet vazhdojnë të jenë ashtu, por interesi në favor të dy kaheve do të shihet në këndvështrimin “se ata mund të komunikojnë në mënyrë konstruktive” (Joannin 2011) Dialogu konstruktiv rajonal sidomos ndërmjet këtyre dy sferave, çon në njohje të ndërsjellë, influencim dhe ndërtim imazhi të ndërsjellë. “Bashkëpunimi ndër-rajonal nuk do të kërcënojë karakteristika të veçanta kombëtare, por mund të çojë në pasurim të ndërsjellë.”(Joannin 2011) Në këtë kontekst Shqipëria duhet të

zhvillojë akoma më shumë pozicionin e saj për marrëdhënie paqësore me fqinjët dhe të dijë ta promovoj më së miri këtë rol nëpërmjet dialogut dhe komunikimit konstruktiv. Duke qenë se nuk ka një datë të përcaktuar për asnjë vend të rajonit se kur do të bëhet anëtar me të drejta të plota, pra kur do të arrijë anëtarësimin final në BE, “lidhjet politike, ekonomike dhe kulturore me fqinjët duhet të përmirësohen për të mirën e vetë vendeve.” (AIIS 2012; 26) Sikurse për lidhjet politike edhe ekonomike ka projekte në vazhdim, edhe në kuadër të Proçesit të Berlinit, i cili angazhon vëndet e Ballkanit në nisma politike dhe projekte ekonomike të përbashkëta, mund t’i mësohet edhe planit kulturor, ku diplomacia kulturore si një nga trarët më të rënësishëm të diplomacisë publike, mund të luaj një rol për të promovuar vlerat e përbashkëta, shkëmbimet njerëzore, informacionin e ndërsjellë, programet e përbashkëta në art, arsim, kulturë dhe shkencë.

Në kuadër të informacioneve që qarkullojnë në masmedia, edhe pse nuk mund të mohohet që ka perceptime dhe informacione pozitive më parë duhet filluar të bëhet përshkrimi i mirë dhe i saktë i vetvetes, duke qenë se Shqipëria aspiron të aderojë dhe është në marrëdhënie formësimi me komunitetin e BE-së. Në këtë rast komunikimi me audiencat, me strategji komunikimi, me informacione njohje dhe materiale që promovojnë elementë dhe vlera shqiptare duke dekonstruktuar stereotipet e vjetëruara do të kishte një impakt pozitiv për opinionin publik në vitet që do të vijnë. Diplomacia publike si një diplomaci e tërheqjes dhe e joshjes që vepron në disa aspekte sociale politike është me rëndësi të punojë kundrejt përmirësimit të imazhit në dy drejtime: në kuadër rajonal ballkanik dhe në kuadër të BE-së dhe komunitetit të saj. Rajoni i Ballkani duhet parë si një mjedis i pashmangshëm i saj jo si rasti i Kroacisë apo Sllovenisë pa përmendur Greqinë që ka disa dekada në integrimin euro-atlantik të cilat kërkojnë ta shkëpusin imazhin e tyre nga ky realitet, ndërsa BE-ja si familja dhe komuniteti i madh i kombeve ku finalizohet udhëtimi i saj dhe drejt kësaj udhe konstruktohet imazhi i saj.

Sot, në epokën globale, me evolucionin e mediave dhe të teknologjisë së informacionit, Shqipëria duhet të aftësojë aparatet, strukturat dhe mekanizmat e

diplomacisë publike që të jenë tepër vigjilente në filtrimin, kontrollimin dhe kundërpërgjigjen apo korigjimin që lypset t'i bëhet informacioneve imazh-ndërtues që mund të jenë tendencioze, manipuluese, apo keq-informuese për arsye apo interes personal të disa shteteve të caktuara.

Ajo çfarë ndodh në kudrin e diplomacisë publike sot kur flitet për “politikën e lartë”, është se Ministrinë e Jashtme të shumë vendeve në arenën ndërkombëtare janë shumë aktive në rrjetet sociale, si Twitter, Face Book, Instagram në kohë reale në përcjelljen e vizitave të kryeterëve të shtetit, të personaliteteve të një vendi të huaj, duke shkëmbyer informacion, apo etiketuar ose lakuar njëra – tjetrën, në mënyrë që informacioni të jetë sa më real dhe sa më i prekshëm si për audiencën vëndase ashtu edhe atë të huaj. Kjo vihet re në faqet zyrtare Face Book Twitter të Liderëve të shtetit edhe shqiptar që përcjellin vizita takime me lider të ndryshëm të vendeve të huaja në kohë reale. Ky trend duhet të vazhdojë kështu për të shfaqur nivelin e bashkpunimit dhe miqësisë me vende të ndryshme. Gjithashtu Shqipëria duhet të punojë më shumë me sondazhe për matjen e perceptimeve që ekzistojnë për Shqipërinë në vende të ndryshme, sidomos të BE-së, në mënyrë që të punojë më shumë për ngritjen e imazhet në vendet ku perceptimet shfaqen të ulëta.

Përsa i takon vëndeve të veçanta në BE të cilat janë skeptike rreth Shqipërisë, siç u paraqit Hollanda kundër për marrjen e statusit kandidat të Shqipërisë në 2013, Shqipëria thotë një eksperte e Diplomacisë Publike¹⁰⁴ në Ministrinë e Jashtme Shqiptare, gjatë një interviste të zhvilluar me të në kuadër të këtij studimi doktoral, punon më intensivisht për përmirësimin e imazhit të saj me vëndet që paraqiten më skeptike ndaj saj. “Duke iu referuar opinionit publik holandez, shumë agjenci lajmesh referojnë se 90% e holandezëve nuk dëshironin që Shqipëria të merrte statusin kandidat”¹⁰⁵ pasi sipas “Ambasadorit të Holandës

¹⁰⁴Intervistë me gojë e marrë në kuadër të këtij punimi në ambjentet e Ministrisë së Jashtme me Drejtoreshën e Diplomacisë Publike në Ministrinë e Jashtme, Donika Hoxha, datë 15/6/2016.

¹⁰⁵Gazeta Telegraf (13 Dhjetor 2016) shkruan mbi qendrimin e Holandës në BE për marrjen e statusit kandidat të Shqipërisë. Titulli artikullit: 90% e holandezëve nuk e duan Shqipërinë në BE, marrë nga <http://telegraf.al/bota-rajoni/90-e-holandezeve-nuk-e-duan-shqiperine-ne-be>, pare më 15 qershor 2016

Martin de la Bej në Shqipëri, gjatë një konference kombëtare të antikorrupsionit” u pat shprehur se “Në vendin tim në Holandë, imazhi i Shqipërisë ka shumë punë për të përmirësuar” Pra një politikë konstante nëpërmjet diplomacisë publike për përmirësimin e imazhit Shqiptar në BE dhe më gjerësisht në arenën ndërkombëtare është e nevojshme sidomos me vënde me qëndrim jo pozitiv ose skeptik nevojitet punë më intensive në këtë drejtim.

Diplomacia kulturore duhet të shihet si një shtyllë shumë e rëndësishme e diplomacisë publike, sidomos në rastin e Shqipërisë. Kultura në vetvete përmban shumë karakteristika dhe elementë, dhe sikurse ky punim shqyrton vlerat më të spikatura etno-kulturore të identitetit shqiptar, natyrshëm rrjedh vlera e diplomacisë kulturore dhe aftësisë që ka ajo për të ndërtuar marrëdhënie që i qëndrojnë kohës, nëse investohet sa duhet në këtë fushë. Kultura ‘përfshin studimin e një gjuhe të një vendi tjetër, traditat, stilin e jetës”(Saliu 2013; 179), gjithashtu “edhe letërsinë, artin, veshjet dhe traditat, sjelljen njerëzore, historinë, folklorin, komunikimin joverbal ndërmjet njerëzve të kulturave, gjeste, marrëdhëniet sociale etj...” (Saliu 2013;179) Sot në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe në aspektin e multi-kulturave që gjenden në BE dhe në arenën globale, Shqipëria ka shumë për të ofruar në këtë drejtim, dhe ka shumë të përbashkëta për të identifikuar me rajonin në terësi. Kur njerëzit shkëmbehen dhe ka konstruktiv të ndërsjellë “këto shkëmbime apo ndërveprime ndërmjet popujve (Saliu 2013; 179) duhet të mbulohen gjerësisht dhe të promovohen nën frymën e diplomacisë kulturore. Përveç shkëmbimit të objekteve, mesazheve, vlerave që vetë elementi human-individi, ka forcë t’i japi kuptim gjatë shkëmbimit, një elementi apo produkti kulturor, pasi një fushë me rëndësi është “komunikimi me publikët e huaj nëpërmjet produktit kulturor” (Saliu 2013; 179). Nëpërmjet këtij komunikimi përfshihen dhe angazhohen audiencat e huaja, apo audiencat që një vend do të arrijë për të influencuar apo edhe për influencim të ndërsjellë. Kombet apo “shtetet sot nuk mund të jetojnë individualisht, për këtë arsye komunikimi duhet të bëhet horizontalisht”¹⁰⁶, kjo do të thotë që angazhimi nëpërmjet

¹⁰⁶CD Statement - The Role of Cultural Diplomacy in Today's World

komunikimit është multi-dimensional, i përbërë dhe multi-kulturor, ku procesi i informimit dhe shkëmbit të informacionit është i lidhur ngusht me procesin e të dëgjuarit. Pra diplomacia kulturore duhet të punojë si një kanal i pavarur duke vënë “në shënjestër popullatën” (Mark 2009; 10) në nivel më të zgjeruar nisur dhe nga eksperiencia individuale, pra shkëmbimi individ me individ nga fusha të ndryshme, jo vetëm në nivel politik, shtetëror apo diplomatik.

Ajo çka është vënë re në përgjithësi, është se kur nuk ka pasur marrëdhënie politike, apo ka pasur konflikte apo tensione politike, këto kanë influencuar marrëdhëniet në nivel popullor ndërmjet dy vëndeve a më shumë, duke lënë fushën e kulturës apo marrëdhëniet kulturore si një “terra ingonigta” ndërmjet vëndeve me çështje të tilla të hapura. Kjo mungesë promovimi dhe “kjo mungesë e informacionit perceptohet shpesh si mungesë e kapitalit kulturor per se” (Bubullima 2013; 6). Duke u nisur nga zhvillimi i madh që ka marrë diplomacia kulturore, në një kohë kur kontaktet shtetërore dhe individuale janë gjithmonë e më të ndërvarura Shqipëria mund të mendojë si të shpalosë vlerat e saj kulturore, si të rrisë kredibilitetin dhe rolin e gjithë këtyre aktorëve dhe aktiviteteteve për rritjen e imazhit të saj, bërjen të mundur njohjen e saj nëpërmjet informacionit të përditësuar, rreth fushave të ndryshme.

Këto aktivitete kulturore që Diplomacia Kulturore mbulon sot dhe ka mundësi të shpalosë duke mbuluar fusha gjithnjë e më të gjera si bursat në fushën arsimore, vizita të akademikëve, intelektualëve, akademikë dhe artistë si nga brenda dhe nga jashtë, performancat e grupeve kulturore, shfaqje të artistëve, ekspozita, seminare dhe konferenca, festivale aktivitete sportive etj etj duhet të shihen si fusha për shfrytëzim nëpërmjet aktiviteteteve periodike nga të gjitha instancat shqiptare, dhe të targetohen për jashtë kufinjëve shqiptarë. Për çështjen e imazhit të një vëndi, diplomacia kulturore le hapësirë për shumë aktorë dhe individë,

By Prof. Dr. Vasile Puscas (Former Romanian Minister for European Affairs – ICD Advisory Board Member)

<http://www.culturaldiplomacy.org/academy/index.php?cd-statement-the-role-of-cultural-diplomacy-in-todays-world> , parë më 14/6/2016

mjafton organizimi i duhur, investimi, dhe vullneti i mirë për të filluar ndryshimin e duhur në këtë aspekt.

- **Multikulturalizmi**

“Le të mos jemi të verbër për dallimet tona - por le të drejtojmë vëmendjen drejtë interesave tona të përbashkëta dhe mjeteve me të cilat këto ndryshime mund të zgjidhen. Dhe në qoftë se ne nuk mund ti japim fund tani dallimeve tona, të paktën ne mund të ndihmojmë bëmë botën të sigurt për diversitet” (John F. Kennedy 1963)

Arti dhe kulturat e ndryshme në Europë kanë kontribuar për të pasuruar gjithnjë e më shumë atë. Sot në BE ka kombe të cilat ruajnë, promovojnë si dhe kujdesen që kulturat e tyre të përcillen, të promovohen dhe të lulëzojnë përkrah kulturave të tjera të ndryshme. “Diversiteti kulturor është në qendër të projektit europian. Uniteti në diversitet është motoja” (Vassiliou 2016) e këtij bashkimi. Në këtë aspekt Shqipëria vetë mund të shprehë dhe të shpalosë vlerat e saj dhe trashëgiminë kulturore, pa qenë nevoja të përshtatet medoemos. Pa diversitet nuk ka dialog ndërkulturor, dhe në Traktatin e Mastroitit thuhet qartë se: në Europë “bashkimi do të kontribuojë për lulëzimin e kulturave të shteteve anëtare, duke respektuar diversitetin e tyre kombëtar dhe rajonal dhe në të njëjtën kohë duke e çuar trashëgiminë e përbashkët kulturore në plan të parë” (Vassiliou 2014) Kultura dhe artet janë vektorët transmetues për të tërhequr publikun, përcjellur efekte dhe sensibilizim, ato mund të ndërtojnë ura komunikimi dhe bashkimi ndërmjet kombeve, komuniteteve, grupeve etnike dhe individëve të thjeshtë. Personalitetet e kultures dhe të artit janë njerëzit më të ndjekur dhe më të dashur për audiencat, dhe kush më mirë se ato mund të përcjellin dhe të shprehin mesazhet e duhura në favor të paqes, dialogut dhe mirëkuptimit të përbashkët. Komunikimi ndërkulturor dhe pranimi i diversitetit sjell afërsi dhe konstruktiv

edhe në fusha të tjera. Kultura është parakusht për komunikim dhe bashkveprim, sepse pa komunikim dhe bashkëveprim nuk mund të ketë konstruktivitet dhe zhvillim në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe shtetërore të kombeve dhe shoqërive të ndryshme. Prandaj kur flitet për një identitet të përbashkët europian, çështja bëhet komplekse dhe e vështirë pasi nuk ka një identitet të përbashkët të caktuar europian, por ka histori të përbashkëta, trashëgimi të përbashkët pasi trashëgimia kulturore e një vendi është pasuri ndërkombëtare, ka ndërthurje ngjarjesh historike dhe ndërthurje kulturash. Pra mund të ketë evente dhe ngjarje të përbashkëta, të cilat japin një lloj sens përkatësie në lidhje me identitetin europian, pra identiteti europian kthehet në një mantel mbrojtës dhe promovimi në lidhje me këto vlera të përbashkëta të cilat janë dhe shumë diverse në të njëjtën kohë.

Nuk mund të gjejmë të përbashkëtat apo të arrihet në qendrimet të përbashkëta pa shkëmbyer kulture dhe dialog nga këndvështrime të ndryshme kulturore. “Përtej vlerës së saj të brendshme si pjesë themelore e jetës, kultura kontribuon në kohezionin social, rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, inovacionit dhe konkurrencës.” (Vassiliou 2014) Vëndet e vetme mund ta përdorin kulturën si mekanizëm të politikës së jashtme por gjithmonë duke ftuar për bashkveprim, pasi kultura që të pasurohet kërkon ndërlidhje dhe bashkveprim. Shtetet sot në asnjë fushë nuk mund të operojnë maksimalisht vetëm, prandaj ky punim hedh theksin e bashkëpunimit rajonal në fushën e diplomacisë kulturore si me Ballkanin ashtu edhe më gjerë me BE-në. Kur Andrulla Vassiliou, Komisionere e kulturës, edukimit, multi-linguizmit dhe rinisë në Komisionin Europian shprehej që: *Përsëri, unë nuk besoj se "fuqia e butë" e Europës në shekullin e 21-të duhet të jetë në lidhje me projektimin e një vizioni kulturor të asaj çfarë përfaqëson Europa; një përpjekje për të krijuar një markë unike gjeopolitike të BE-së. As nuk duhet të reduktohet në një pyetje për të ndihmuar artistët e saj dhe promovuesit për të gjetur audienca të reja. Përkundrazi, unë besoj se ajo duhet të jetë në lidhje me ndërmarrjen e një sfide të madhe historike të Europës - se si të menaxhojmë diversitetin tonë - në skenën globale, dhe si të angazhohen partnerët tanë në debat.*

Diplomacia kulturore është një mundësi reale për të treguar pasurinë dhe diversitetin e kulturave të BE-së në rajone të tjera të botës. Por ajo është gjithashtu një mënyrë për të ndarë vlerat europiane, të tilla si liria e shprehjes, liria dhe barazia në informacion, pavarësia e jetës kulturore dhe e shprehjes edhe në një shoqëri gjithëpërfshirëse. Ajo mund të krijojë kushtet e nevojshme për zhvillimin e iniciativave bazë dhe një shoqëri të fortë civile.(Vassiliu 2014)

Në këtë perspektive ky punim hedh tezën e diplomacisë publike dhe në veçanti të asaj kulturore për ndërtimin e marrëdhënieve afat-gjata dhe të qëndrueshme me kombet e rajonet e tjera dhe përmirësimin e imazhit nëpërmjet këtyre marrëdhënieve dhe bashkveprimit që lind nga këto marrëdhënie. Sfidat botërore në të gjithë sektorët dhe fushat thërrasin për bashkëpunim, dhe ky bashkëpunim arrihet me mire kur ka dialog dhe memorie për marrëdhënie kulturore. Edhe Federica Mogherini Zv/Presidentja e Komisionit Europian, në Forumin e Kulturës në Bruksel shprehet kështu për rëndësinë e kulturës në politikën e jashtme të BE-së: *Kur Evropa angazhohet me botën, kultura duhet të jetë në qendër të politikës sonë të jashtme. Kultura mund të na ndihmojë luftimin dhe parandalimin e radikalizmit. Por ajo gjithashtu mund të nxitë rritjen ekonomike. Ajo mund të forcojë marrëdhëniet diplomatike dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. Kjo mund të na ndihmojë të qëndrojmë së bashku për kërcënimet e përbashkëta dhe për të ndërtuar partneritete dhe aleanca mes institucioneve dhe - ajo që ka rëndësi edhe më shumë- në mes edhe njerëzish*” (Mogherini 2016) Pra gjithmonë e më shumë po i kushtohet rëndësi kulturës si mjet apo mekanizëm i rëndësishëm dhe i efektshëm i politikës së jashtme për të gjitha benefitet që sjell të cilat u përmendën më lart.

SHTOJCA¹⁰⁷

INTERVISTA

Roli dhe rëndësia e Diplomacisë Publike Shqiptare për promovimin e vlerave kombëtare dhe imazhit kombëtar

1. Kur mendoni se koncepti i Diplomacisë Publike ka hyrë në Politikën e Jashtme të Shqipërisë. A mendoni se politika e jashtme shqiptare ka filluar ta implementojë këtë diplomaci dhe a ka pasur zhvillime pozitive ndër vite në këtë fushë? Kush janë disa nga aktorët , agjentët apo strukturat e përfshira të cilët merren me diplomacinë publike?
2. A mendoni se ka politika promovuese për trashëgiminë kulturore dhe vlerat e veçanta etno-kulturore në kuadër të Diplomacisë Publike shqiptare dhe sa të prekshme duken rezultatet? Po diplomacia zyrtare (track 1) sa është marrë me promovimin e këtyre vlerave ndër vite?
3. A mendoni se vlerat e mbijetesës, të cilat kanë shënjuar identitetin dhe karakterin shqiptar ndër vite dhe në periudha të vështira historike përbëjnë potencial të rëndësishëm për ti promovuar nëpërmjet mekanizmave dhe programeve të duhura në kuadër të lartësimit të imazhit kombëtar?
4. Cilët do të ishin mekanizmat e duhur dhe mënyrat për t'i promovuar këto vlera si në kuadër rajonal të shkëmbimit të vlerave ashtu edhe në atë të BE-së duke i shfrytëzuar ato nën dritën e multi-kulturalizmit.
5. A ka një diplomaci kulturore shqiptare , si pjesë kyçe e diplomacisë publike, por që vepron në fusha më të gjera dhe më të pavarura nga politika, si p.sh shkembime universitare, shkembime në art, ekspozita, sport, në fusha akademike, në nivel shkrimtarësh, etj.. ku vendi ynë mund të prezantojë veteveten, idetë, shpirtin kombëtar, esencën karakteristike, asetet dhe vlerat?

¹⁰⁷ Sikurse tema shtjellon rolin e diplomacisë publike dhe kyresisht diplomacisë kulturore si një praktikë e diplomacisë publike, u pa e nevojshme një intervistë me Znj. Donika Hoxha, e cila është aktualisht edhe Drejtoreshë në Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë për Diplomacinë Publike. Intervista me të që një ndihmesë e madhe, pasi jo vetëm shprehu vullnetin e mirë për t'ju përgjigjur intervistës, por shtjelloi gjerësisht disa koncepte dhe praktika të DP dhe programeve të Ministrisë së Jashtme për promovimin ndërkombëtar të imazhit të Shqipërisë. Data e intervistës: 15 Qershor 2015, Vendi: Ministria e Jashtme e Shqipërisë, Zyra e Znj. Donika Hoxha, ora 11.00, paradite

6. Në politikat për lartësimin dhe promovimin e imazhit shqiptar a bëhet një ndarje gjatë formulimit dhe komunikimit të këtyre politikave të promovimit ndërmjet audiences së huaj dhe asaj vendase?
7. A duhet të ketë një dallim ndërmjet këtyre audiencave (vendase dhe të huaj) kur flitet për lartësim imazhi në kuader të DP dhe mesazhet që ajo përcjell për promovimin e një vendi? Si duhet të bëhet lidhja ndërmjet këtyre dy audiencave?
8. A duhet që diplomacia publike të ndjekë patjetër atë zyrtare apo mund të funksionojë si një kanal i pavarur në përmbushjen e qëllimeve të saja?

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

(Vepra me karakter të përgjithshëm teorik)

- Bergson H. 2002; Burimet e Moralit dhe të Fesë, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit & Amfioni dhe Zeti, 253 faqe. Te konsultuara kapitulli parë dhe i dyte, 7-166
- Burchill S., Linklater A., Devetak R., Donnelly J., Paterson M., Reus-Smit C., True J. 2012; Teori të Marrëdhnieve Nderkombëtare, AIIS press.
- Derrida J. 2001, Writing and difference, First published in Routledge Classics by Routledge, fq.445, (1-36)
- Durkheim E., 2004, “Leksione Sociologjie”, fq.224, Shtëpia botuese Plejad
- Dunne T., Kurki M., Smith S., Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, disiplina dhe shumëllojshmëria, UET Press 2010, (i konsultuar në të gjithë kapitujt)
- Finnemore M. 1996, “National Interests in International Society”, Cornell University Press, New York,
- Hans Morgenthau and Kenneth Thompson 1985, Politics Among Nations, 6th edition (New York: McGraw-Hill), p.166
- Hobbes Th.,1968, Leviathan, ed.C.B Macpherson (Harmondsworth,Ang. Penguin, pp.13)
- Hopf T. 1998. “The Promise of Constructivism in International Relations Theory”. *International Security* 23 (1). The MIT Press: 171–200. doi:10.2307/2539267.

- Holsti, K. J.. 1997. “America Meets the "english School": State Interests in International Society”. Review of National Interests in International Society; International Society After the Cold War. Merston International Studies Review 41 (2). Wiley: 275–80. doi:10.2307/222671.
- Ikenberry J. November/December 1999 Issue, “Social Theory of International Politics” by Alexander Wend, reviewed by G.John Ikenberry <http://www.foreignaffairs.com/articles/55448/g-john-ikenberry/social-theory-of-international-politics> , parë më 22 Mars 2016
- Kellner D. 2005, “Western Marxism” in Modern Social Theory: An Introduction, edited by Austin Harrington. Oxford, UK: Oxford University Press: 154-174.
- Keohane R. 2000, Ideas part way down, Review of International Studies / Volume 26 / Issue 01 / January 2000, pp 125-130 DOI: <http://dx.doi.org/> ([About DOI](#)), Published online: 08 September 2000 <http://journals.cambridge.org/action/displayAbstract?fromPage=online&id=33421>
- Koçani A. 2013, Hulumtimi i Sistemit të Vlerave në Republikën e Shqipërisë në Periudhën Postkomuniste” Albanian University press, Tiranë 2013, (fq 5- 21), fq.6
- Mingst K. Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Albanian Institute for International Studies, AIIS press, Tiranë 2008, i konsultuar ne disa kapituj)

- Marslow A.H, 1954 Motivation and personality, Copyright 1954 by Harper and Row, Publishers, Inc, chapter 7, higher and lower needs 97-105.
- Mead G. nga George Ritzer dhe Douglas G. Goodman 2008, Teoria Sociologjike, UFO Press fq.365, kapitulli 10 (Ndërveprimi Sociologjik)
- Sorokin P. 2005, nga Lewis Coser dhe Dr. Larry Ridener “Teoritë Sociologjike nga fillimet deri në ditët tona”, Plejad, Tiranë
- Wend A. 1999, Social Theory of International Politics, Cambridge University Press.
- Wendt A. 1992 “Anarchy is What States Make of It: The Social Construction of Power Politics” IO 46 (1992): 391-425 Marrë nga: <http://www.olivialau.org/ir/archive/ëëëen7.pdf> (parë më 16 Shkurt 2016)
- Wendt, Alexander. 1994. “Collective Identity Formation and the International State”. *The American Political Science Review* 88 (2). [American Political Science Association, Cambridge University Press]: 384–96. doi:10.2307/2944711. Marrë nga: http://www.jstor.org/stable/2944711?seq=3#page_scan_tab_contents parë më 19 Shkurt 2016
- Williams M. Jul.29 2008, Constructivism is concerned with norms, but is it normative theory? (e-international relations students) <http://www.e-ir.info/2008/07/29/constructivism-is-concerned-with-norms-but-is-it-normative-theory/>

(Vepra mbi identitetin dhe realitetin europian)

- Anderson B. 2006 (revised edition) *Imagined Communities, Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* , Book published by Verso pp (256)
- Anthony David W. 2007, *The Horse, the Wheel, and Language: How Bronze-Age Riders from the Eurasian Steppes Shaped the Modern World*, Book published by Princetown University Press, 547pg
- Barkl, A. 2013. A theory of comparison and empirical examination of Soft power China and normative power Europe in North Africa and Central Asia, Paper submitted to Central European University, Department of International Relations and European Studies. CEU eTD Collection, Hungary, Budapest.pg.1-65

Marrë nga : www.etd.ceu.hu/2013/barkl_adam.pdf, pare më 10 Qershor 2015

- Berting J., 2006, *Europe: A heritage, A challenge, A promise*, Book published by Euborn Academic Publishers, pp 233 (citations from all chapters)
- Bridier J., 1999 (cited in Berting J. 2007;191) *La citoyennete europeene; un projet de cohabitation culturelle*.Hermes 23-24 Cognition, Communication, Politique. *La cohabitation culturelle en Europe. Regards croises des Quinze, de l'Est et du Sud*. Paris: CNRS Editions, pp 84-87
- Brown, Chris (1992) *International Political Theory: New Normative Approaches* (Oxford: Columbia University Press) p2.

- Cederman Lark-Eriks 2001 Constructing European Identity, The external Dimension, Lynne Reinner Publisher Inc, chapter 1, 2 and 3. Pp 271
- Coffin J. , Stacey R., Cole J. Carol S., 2011, Western Civilization, Seventeenth Edition
W.W Norton Company, Inc; Independent Publishers since 1923, chapter 5
<http://www.wwnorton.com/college/history/westerncivilization17/ch/05/ebook.aspx> pare me 12 Mars 2016
- D'Alema 2016, 21 Mars, (Intervistë nga Sokol Balla) D'Alema në "Top Story" për referendumin e PS, të majtën, refugjatët... internet access
<http://tochannel.tv/lajme/artikull.php?id=322311> , parë më 23 Mars 2016
- Diez Th. 1999, Speaking 'Europe'; The politics of Integration discourse, Journal of European Public Policy, 6:4, Special Issue, pp.598-613
- Diez Th. 2005 Constructing the Self and Changing Others:Reconsidering 'Normative Power Europe. doi: 10.1177/03058298050330031701
Millennium - Journal of International Studies June 2005 vol. 33 no. 3 613-636, Sage Journals
- Delanty G., 1995, Inventing Europe; Idea, Identity, Reality, Book published by Macmillan Press LTD. Pp 183, Chapter I, X.
- Eliot T.S. 1939 Selected T.S. Eliot on Tradition, Poetry, Faith, and Culture
Marrë nga <http://www3.dbu.edu/mitchell/eliotpas.htm> , parë më 30 Mars 2016
- EurActiv, May 9, 2006 (updated: Mar 21, 2011) "European Values and identity" Euroactiv.com
Marrë nga: <http://www.euractiv.com/section/languages-culture/linksdossier/european-values-and-identity/#ea-accordion-issues>
(parë më 10 Shkurt 2016)

- Fornara W. (Charles William), 1983, The nature of History in ancient Greece and Rome, Book published by University of California Press, chapter I, 213 pp.
- Giacalone Ramat A. and Ramat P., 1998 The Indo-European Languages, Book published by Routledge, London and New York , Chapter 1 and 10, total pg.502
- Gaiani M. 2015, interview by Genc Mlloja dhe Denisa Hunci “The Cooperation between Albanians and Italians Is Very Successful” Albanian Daily news
http://www.albaniannews.com/mobile/news_info.php?idm=1285 , parë më 11/6/2016
- Giddens A., 2007, L'Europa nell “eta” globale, Pubblicato da GLF Editori Laterza, pp305
- Manners, I. 2001, Normative Power Europe: The International Role of the EU, European Community Studies Association , Biennial Conference, Madison, Wisconsin , USA. 31 May 2001, pp 1-30. p.10
Marrë nga: http://aei.pitt.edu/7263/1/002188_1.PDF , parë më 7 Mars 2016
- Manners, I. 2002, Normative Power Europe: A contradiction in terms ?* JCMS (Journal of common market studies) 2002 Volume 40. Number 2. pp. 235-58 Marrë nga: <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/1468-5965.00353/pdf> , parë më 7, 3 2016
- Metaxas E., 2014, February 1. Faith rising in East, Setting in West? Europe and Christianity, Marrë nga: <http://www.christianpost.com/news/faith-rising-in-east-setting-in-west-europe-and-christianity-113757/> parë më 26.04.2016

- MIALL, Hugh Shaping the new Europe, London, Royal Institute International Affairs, 1993 MIALL, Hugh (ed.) Redefining Europe: New Patterns of Conflict and Cooperation, London, Pinter, 1994a MIAL, Hugh “Wider Europe, Fortress Europe, Fragmented Europe?”, in MIALL, Hugh (ed.) Redefining Europe: New Patterns of Conflict and Cooperation, London, Pinter, 1994b, pp1-16
- McCrudden C. and Prechal S., 2009, The Concepts of Equality and Non-Discrimination in Europe: A practical approach, European Commission Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities Unit G.2 This publication was commissioned by the European Commission under the framework programme PROGRESS (Decision 1672/2006/EC of the European parliament and the Council, OJ L 315/1 of 15.11.2006). pg. 50. For more information on PROGRESS see: http://ec.europa.eu/employment_social/progress/index_en.htm
- Nardelli A. 2014, 26 Sep. Most Europeans can speak multiple languages. UK and Ireland not so much
Marrë nga: <http://www.theguardian.com/neëëëë/datablog/2014/sep/26/europeans-multiple-languages-uk-ireland>, parë më 6.4.2016
- Pannenberg W. 1994, December, Christianity and the West
Marrë nga <http://www.firstthings.com/article/1994/12/christianity-and-the-westambiguous-past-uncertain-future> parë më 13.4.2016
- Pannenberg, *Christianity in a Secularized World* (New York: Crossroad, 1989), 33
- Patrutiu – Baltes L. 14 Oct. 2013, Europe and Europeans, Question of Identity, One – Europe.info , Marrë nga: <http://one-europe.info/europe-and-europeans-questions-of-identity> (parë më 10 Shkurt 2016)
- Sanders F. 2014, September The Strange Legacy of Theologian Wolfhart Pannenberg
Marrë nga <http://www.christianitytoday.com/ct/2014/september-web-only/strange-legacy-theologian-ëëëolfhart-pannenberg.html>, parë më 13.4.2016

- Schmidt A. 2004, 2001, How Christianity changed the world, Book published by Zondervan. pg 7-8, (Foreword of the book by Paul L. Maier), + pg11
- Stackhouse M. and Jean Bethke Elshtain (interview), 2003, January 27, Sources of Basic Human Rights Ideas: A Christian Perspective, PewResearch Center Religion & Public Life Marrë nga <http://w.pewforum.org/2003/01/27/sources-of-basic-human-rights-ideas-a-christian-perspective/> parë më 26.04. 2016
- Spielvogel Jackson J. 2011, Western Civilization, A brief history, seventh edition , book published by Wadsworth , chapter 8, 732 pg,
- Svitych, A. 2013, Why European Identity Will Never Work: Case Study 'EU Vs. USSR', <http://theglobaljournal.net>, parë më 3 shtator 2015
- Schopflin G. 1999, Natyra e mitit, “Perpjekja”, nr 15-16 (6), fq2-8, total fq.248, shtypshkronja Marin Barleti
- Searle J. 1990, 6 December, The New York Review of Books, December 6, 1990 The Storm Over the University
Marrë nga: <http://www.ditext.com/searle/searle1.html#back2> Parë më 30 Mars 2016
- Stickel. D., May 2006 (interview) Dr, Gerhard Stickel “Europe’s Wealth Consists Essentially in its Variety of Languages” Multilingism and policy,
Copyright: Goethe-Institut e. V., Online-Redaktion Marrë nga:

<http://www.goethe.de/ges/spa/prj/sog/mup/en1399909.htm>, parë më
6.4.2016

- Uniting Europe step by step – the treaties, The founding principles of the Union, (The values of the Union) Europa.eu Marrë nga: http://europa.eu/scadplus/european_convention/objectives_en.htm#TOP
(Parë më 19 Shkurt 2016)
- Violatti Cristian 2014, 05 May “Indo-European Languages”, Ancient History Enciklopedia Marrë nga: http://www.ancient.eu/Indo-European_Languages/, parë më 4 Prill 2016
- Veilleux OCSO A. 1976, Religious in Today's world, Franciscan periodical "La Vie des Communautés Religieuses" Feb '76, Montreal. Marrë nga : http://www.scourmont.be/Armand/writings/religious_today.htm, parë më 18.5.2016
- Zavalani T. 1998 (Botimi i Dytë), (Botimi i parë:1966) “Histori e Shqipërisë”, nga Shtëpia e Librit “Phoenix”, pjesa e parë, fq.17, total:388 fq.
- Welle K. 2013, Secretary General of the European Parliament at the Ecole Nationale d'Administration (ENA) Strasbourg, 16 January 2013 internet access: <http://www.europarl.europa.eu/>, parë më 3.5.2016

(Vepra mbi identitetin dhe realitetin politik kombëtar shqiptar)

- Abazi, E. 2011, Kujdes Hendekun. Shqipëria në Europë. Perspektiva dhe sfida., Politikja, nr.1, fq. 77-91, Edlora

- Albanian Institute for International Studies, Perspektiva europiane e shqiperise, Perceptime dhe realitete 2012, Botues instituti I studimeve nderkombetare
Marre nga http://www.fes-tirana.org/media/publications/pdf-files/2012/pub_Perceptime%20dhe%20realitete%202012.pdf, pare me 5/6/2016
- Alia L. 2012, Kanuni, Kodi i së drejtës zakonore shqiptare, Kategoritë etiko morale te kanunint të Lekë Dugagjinit Marrë nga <http://www.nacionalalbania.al/2012/09/kanuni-kodi-i-se-drejt-es-zakonore-shqiptare/> parë më 19/6/2016
- Alpion, G. 2005. Western Media and the European “Other”: Images of Albania in the British Press in the New Millennium. Albanian Journal of Politics. I (1): 4-25.
- Amery, J. 2002 (First edition in Albania 2002), 1948 (Great Britain) Sons of the Eagle, fq. 1-40, fq. 354, London Macmillan & Co. LTD (1948)
- Balla B. 2012 Përplasjet identitare dhe integrimi evropian i shqiptarëve “The clashes of identity and the european integration of albanians” AKTET ISSN 2073-2244 Journal of Institute Alb-Shkenca www.alb-shkenca.org Reviste Shkencore e Institutit Alb-Shkenca AKTET VI, 5: Fq:491 – 494
Marrë nga http://alpa.maliit.eu/pub/aktet/vol/vol6/Aktet_Vol_VI_Nr_5_pp_491_494.pdf , parë më 14.5.2016
- Balla A., Ejodus F., Llubani M. 2013, Article, Albania and Serbia, Perception and reality AIIS Publication faqe: 1-64, Marrë nga http://www.bezbednost.org/upload/document/albania_and_serbia_-_perceptions_and_reality.pdf parë më 3/6/2016
- Bardhoshi N. 2011, Gurtë e Kufinit, Kanuni, Pronësia, Strukturimi Social, UET Press, (1.3-2.3)
- Beshku, K. 2015 The Albanian relationship with Greece and turkey; Perception and realites in the framework of the foreign policy partnership, Center of Excellence, Ministry of Foreign Affairs
- Beshku K. 2013, Albania and Europe in a political regard, Article: “Albania and Western Balkans in a European context at the beginning of

1990s “How did the normative power of the European Community/Union affect them? Pg 41-63, By Cambridge Scholars publishing

- Bubullima E. 2012 Soft Power and stigma How to ameliorate Albanian image in France. Center of Excellence, Ministry of Foreign Affairs, Albania. Marrë nga <http://excellence.al/sites/default/files/Paper%20Soft%20Power%20and%20Stigma.pdf> parë më 14/6/2016
- Çabej N. 1990, Autoktonia e Shqiptarëve në studimet gjermane, Shtëpia botuese “8-Nëntori” fq.191, referenca nga pothuajse te gjithë kapitujt .
- Demi 2011, Mars 09 Bashkjetesa fetare e shqiptarëve dhe ana tjetër e medaljes. Marrë nga http://dituria.se/index.php?option=com_content&view=article&id=344:fatbardha-demibashkjetesa-fetare-e-shqiptareve-dhe-ana-tjeter-e-medaljes&catid=44:debattartiklar&Itemid=63 , parë më 18. 5.2016
- Dervishi Zh. 2013, Nëpër degzime të kulturës shqiptare, shtëpia botuese Emal, fq.445
- Dojaka A. 1978, “Ceremoniali i dasmës shqiptare”, Tiranë, Etnografia shqiptare, nr. IX, faqe 132
- Durham E. 1991, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Shtëpia Botuese 8 Nëntori 584 Faqe
- Elsie R. 2005 Leksiku i kulturës popullore shqiptare, Besime, mitologji, fe, doke, rite, festa dhe veçori kulturore Skanderbeg Books, Tiranë.
- Fita E. & Kafia E. 2011, Veçoritë dhe dinamikat e Proçesit të tranzicionit shqiptar, Politikja, Revistë Shkencore, nr.2, Eldora Press, 209-214,
- Frashëri K. 2006, Identiteti I shqiptarëve dhe të metat e debatit Qose-Kadare, Gazeta Shqiptare, nr 3617-3624, i butuar në disa pjesë, nga data 27 gusht 2006 – 5 Shtator 2006
<http://www.albasoul.com/vjeter/modules.php?op=modload&name=News&file=article&sid=1970> pare më 2 Prill 2016
- Frashëri S. 1988, Vepra I, Akademia e shkencave të Shqipërisë, botuar nga Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja e re Tirane, 1988, fq. 439

- Gjata R. 2014, 28 Prill (Dr. Rustem Gjata) Kanuni I Lek Dugagjinit dhe rëndësia e tij në Shoqërinë shqiptare.
Marrë nga <http://telegraf.al/drejtesia/dr-rustem-gjata-kanuni-i-leke-dukagjinit-dhe-rendesia-e-tij-ne-shoqerine-shqiptare> , parë më 16.5.2016
- Hajrullahu J. 2013, NINULLAT MONOLOG POETIK, TRASHËGIMI SHPIRTËRORE E RIPËRTËRISHME NË RRETHANA TË NDRYSHME SOCIO-EKONOMIKE, Aktet, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, AKTET VI, 5: 517 - 520, 2013, fq. 518-520
- Harka S. 2016, MBROJTJA E GJUHËS SHQIPE-NJË URGJENCË E KOHËS, Shënime për librin “Urgjenca gjuhësore”, shkruar nga Prof. dr. Gjovalin Shkurtaç, marrë nga <http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=79763> parë më 29.6.2016
- Ibrahimimi 2010, Fjala e dhënë, Telegrafi.com , marre nga <http://www.telegrafi.com/fjala-e-dhene/>, pare me 10.5. 2016
- Ingelheart R. & Baker W. 2000, MODERNIZATION, CULTURAL CHANGE, AND THE PERSISTENCE OF TRADITIONAL VALUES*, article, pg.19-5, American Social Review Feb 2000; 65, 1; ABI/INFORM Global
- Independent 2011, artikull: There’s nothing like European hospitality, <http://www.independent.co.uk/student/study-abroad/theres-nothing-like-european-hospitality-2289243.html>, parë më 20.6.2016
- ISHSHN,28 Tetor 2011, Bie interesi I Shqiptarëve për integrimin në BE,
sondazh
Marrë nga:<http://www.shqiptariitalise.com/itali/itali/shqiperi/ishsn-bie-interesi-i-shqiptareve-per-integrimin-ne-be.html> (parë më 15 Shkurt 2015)
- Jakllari A., 2002, Universet e panjohura, (Shkrime per kulturën dhe letërsinë), Shtëpia botuese Panteon, fq.133, par pjesa qe flet per kulturen.
- Karajgdiu A. 1993, “Me Konicën në Europë”, Shtypshkronja A.Z. çajupi, fq. 227, fq. 132-133

- Karanxha V. 28 Shtator 2013, Rëndësia e vlerave në krijimin e shtetit-komb. Marrë nga: <https://shinasi.wordpress.com/category/valbona-karanxha/> , parë më 25.2.2016
- Keesing R. & Strathern A. 2007, Antropologji kulturore me perspektive bashkohore, UFO pres fq. 550
- Kordinjano F. 2008, Shqipëria, përmes veprës dhe shkrimeve të Misionarit të madh italian At Domeniko Pazi, (1847-1914), vëllimi 2. Botimet Almera, 404 fq. Faqia 11-23.
- Kulla N. 2002, Neoshqiptarizma, Një model I braktisur, fq.123, Trashegimia qe vjen nga vitet 30, Plejad
- Lafe. E. 2007 Drejtshkrimi i shqipes dhe disa probleme të tij. Revista shkencore periodike, Gjuha Jonë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti I Gjuhësisë dhe I Letërsisë, shtypur në shtypshkronjën Kristalina-Kh, fq. 9-16
- László, János (2013). Historical Tales and National Identity: An introduction to narrative social psychology. Routledge. p. 19 17. [ISBN 1134746504](https://doi.org/10.1080/11347465.2013.76504).
- Lubonja F. 1999, Mbi nevojën e dekonstruktimit të miteve, “Perpjekja”, nr 15-16 (6), fq2-8, total fq.248, shtypshkronja Marin Barleti
- McCrone D. & Bechhofer 2015, Understanding National Identity, Cambridge University Press, fq. 220, konsultuar parathënia, kapitulli i I-rë.
- Melucci A.1995 Social Movement and culture, (Chapter I, The process of collective identity by Alberto Melucci) Editors: Hank Johnston and Bert Klandermans, Book, first published by UCL press; Routledge
- Mejdini F. 2015, 03 Nov Albanian Parties split on key Judicial reforms, Balkaninsight
Marrë nga <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-lacks-consensus-over-constitutional-changes-11-02-2015> , parë më 3 Qershor 2015

- Milani M. 2003 Jeta dhe zakonet e shqiptarëve, Shtypshkronja Muza, Tiranë, Qershor 1995, Ribotim 2003, 144 faqe, Te konsultuara pothuajse te gjithë kapitujt
- Milaj J. 1944, Raca Shqiptare, Studim Antropologjik e historik, Ismail Mal1Osmani Botonjës, Tiranë, Shtypshkronja Tirana, faqe 201.
- Misha P. 2008, Arratisja nga Burgjet e Historisë, C`do të thotë të jesh Shqiptar, 377 faqe.
- Murati Sh. 2013 Diplomacia Shqiptare në kërkim të identitetit, Botimet Eneas, 153 faqe, i konsultuar për diplomacinë dhe kryesisht fq 5-7; 7-12; 52-57;
- Muller A. 2005, Concepts of Culture, Arts Politics and Society University of Calgary Press, fq.414, në konsultim për këtë punim nga 1-25
- Moore, S. F.. (1973). Law and Social Change: The Semi-Autonomous Social Field as an Appropriate Subject of Study. *Law & Society Review*, 7(4), 719–746. <http://doi.org/10.2307/3052967> Web: www.jstor.org , parë më 16.5.2016
- Naagarazan R.S, 2006. A text book on professional Ethics and human values, New age international (p) limited, publishers, 1.2: Values, pg. 2-5.
- Nako G. 2013, artikull, Shqipëria, identiteti kombëtar dhe imazhi ndërkombëtar, publikur nga Lente Sociologjike III (2), 369-383
- Nence. M. 2013, Corruption, Albania`s biggest challenge for integration in E.U, PECOB
Marrë nga <http://www.pecob.eu/Corruption-Albania-biggest-challenge-integration-E-U> parë më 2 Qershor 2015
- Ngugi T. (Wa Thiong'o)1986, Decolonising the mind , the politics of languagein African literature. Printed by James Currey Ltd, Oxford, EAEP, (East African Educational Publishers, Nairobi, Hinemann, Portsmouth (NH), first published 1986, reprinted, 1988-1994, 1997- 2006. Pg.111, (pg.16)

- Omari A. 2007, Rreth burimit të emrit shqiptar, Revista shkencore periodike, Gjuha Jonë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti I Gjuhësisë dhe I Letërsisë, shtypur në shtypshkronjën Kristalina-Kh, fq. 139-142
- Petrota 2008, G. Populli, Gjuha dhe Letërsia Shqiptare, Botimet Almera, fq.624, të para dhe të referuara 11-61
- Puto A. 1999 15-16 Janar, “Feja e Shqiptarit çshtë “shqiptaria”, mit apo konstruksion historik”, 32-38, Perpjekja 15-16, Roli I miteve në historinë e Shqipërisë, Viti VI, nr. 15-16, shtypshkronja Marin Barleti
- Puto A., Pojani P, Gjoka S. 2008, Diplomacia përballë politikës. Intervistë në Rubrikën Forum të BBC. Marrë nga <http://www.arkivalajmeve.com/Diplomacia-perballe-politikes.45541/> parë më 2/6/2016
- Pye L. W and Verba S. 1965, Political Culture and Political Development, nga Princeton University press fq.565. I konsultuar kapitulli I konkluzioneve 512-560
- Rama E. 2016, Kryeministri Edi Rama në Asamblenë e NATO-s në Tiranë: Britani! Mos ik nga BE!, Gazeta Koha Jonë Marrë nga <http://www.kohajone.com/2016/05/30/kryeministri-rama-ne-asamblene-e-nato-sbritanimos-ik-nga-be/> parë më 3/6/2016
- Ritzer George, Goodman Douglas J., 2008, Teoria Sociologjike, Ufo Press, Tiranë
- Romaniuk S. 2007 ON THE EDGE OF EUROPE: THE MARGINALISATION OF ALBANIA WITHIN THE EUROPEAN COMMUNITY, New Balkans Politics, Journal of Politics, Marrë nga <http://www.newbalkanpolitics.org.mk/item/ON-THE-EDGE-OF-EUROPE:-THE-MARGINALISATION-OF-ALBANIA-WITHIN-THE-EUROPEAN-COMMUNITY#exp2> , parë më 11/6/2016
- Said E. 1977-78, Orientalism, book published by Penguin Books, Pg. 379
- Sako Z. 1984, Studime per folklorin, Tirane 1984, Kombinati poligrafik, Shtypshkronja e re, Tirane, fq.351

- Sulstarova E. 2006, Arratisje nga lindja, Orientalizmi Shqiptar nga Naimi te Kadareja, Botimet Dudaj
- Sulstarova E. 2011, “Jam Evropë”: Ligjërimi i intelektualëve për Evropën në Shqipërinë e tranzicionit, Revista Politikja, Nr.1, (Shqipëria dhe Evropa në një këndvështrim politik), Edlora press fq 213-231
- Sulstarova E. 2013, Moderniteti i Rilindjes kombëtare, Revista Politikja 2/2013,(Populli dhe Populizmi), Botues Albania, fq 40-53
- Smith, Anthony (1991). *National Identity*. University of Nevada Press. pp. 8– 15. [ISBN 0874172047](https://www.isbn-international.org/product/0874172047)
- Surroi V. 30 Gusht 2015, Intervistë marrë nga Tema online, Veton Surroi: Shoqëritë tona të sulmuara nga Islami Politik. Marrë nga: <http://www.gazetatema.net/ëëëeb/2015/08/30/intervista-veton-surroi-shoqerite-tona-te-sulmuara-nga-islami-politik/> parë më 25.2.2016
- Shkreli. F, 2015, Na ishte dikur Besa e Shqiptarit, botasotinfo.com, marrë nga; <http://botasot.info/opinione/405301/na-ishte-dikure-besa-e-shqiptarit/> pare me 13.5.2016
- Troncota M. 2014, The formation of Juncker Kommission and its impact on the Western Balkans, Europolity, Continuity and Change in European Governance, Vol.8, No.2, 163-177
- Tole. V. 2013, Mbi vajin dhe vajtimin në traditën shqiptare, Agjencioni flori press, Marrë nga <http://floripress.blogspot.al/2013/10/mbi-vajin-dhe-vajtimin-ne-traditen.html> parë më 16. 6. 2016
- Topalli K. 2013, 23 Janar, Formimi gjuhësor, i rëndësishëm për formimin e individit, Gazeta Dita, intervistë nga Anida Lera Marrë nga

<http://www.gazetadita.al/formimi-gjuhesor-i-rendesishem-per-formimin-e-individit/> parë më 18.5. 2016

- Xhaferri A. 2012, 12 Porositë e Arbër Xhaferrit, nga Rudina Xhunga, Botimet Dudaj, fq. 192
- Zotaj E. 2014 TRANZICIONI POLITIK DHE ROLI I TIJ NË MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME BASHKIMIN EVROPIAN, Disertacion i paraqitur nga: Elda ZOTAJ Në kërkim të gradës shkencore: DOKTOR Në “Studime Evropiane dhe Integrim Evropian” pare kreu I trete, 3,7, fq. 142-147 Marrë nga <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf> , parë më 25.5.2016
- (Zaman 2016) Zaman 2016, E përditshmja e grupimit gulenist e shqetësuar nga kritikant mbi neootomanizmin, Marrë nga <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2012/05/06/si-perceptohet-politika-e-jashte-turke-ne-ballkan/> , pare me 5/6/2016
-
- Zeqo, M. 1995 Rexhep Qosja dhe Çështja Kombëtare Shqiptare, fq. 1-280 Shtypshkronja Dyrrah, “Durrës”
- UNDP 2015, Studim: Profili i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara. Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri. Marrë nga, <file:///C:/Users/Erli/Downloads/Profili%20PAK%20shqip%20web.pdf> , parë më 3.12.2016
- Hazizaj, Poni 2016, Studim: DISKRIMINIMI I ADOLESHENTËVE NË SHKOLLË PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR. (Pink Embassy & LGBT Pro Shqipëri), Marrë nga http://www.pinkembassy.al/sites/default/files/uploade/Diskriminimi%20oper%20shkak%20te%20orientimit%20seksual%20ne%20sistemin%20arsimor%20parauniversitar%20ne%20Shqiperi_0.pdf parë më 4.12.2016

(Vepra mbi diplomacinë publike)

- Cull J.N. 2009, Mapping the Miracle: Northern Ireland, Public Diplomacy and Track Two Diplomacy, Figueroa Press, fq:105. Te perdorura 1-5

marrë

nga

<http://uscpublicdiplomacy.org/sites/uscpublicdiplomacy.org/files/legacy/media/Track%20Two%20to%20Peace%20FINAL.pdf> parë me 12/6/2016

- Hocking B. & Melissen J. 2015, Diplomacy in the digital age, Netherlands Institute of International Relations Clingendael. https://www.clingendael.nl/sites/default/files/Digital_Diplomacy_in_the_Digital%20Age_Clingendael_July2015.pdf parë me 18.6.2016
- Melissen, J. 2005. The new public diplomacy. Soft power in international relations, Palgrave MacMillan, pg 221
- Debord G. 1994, . Originally published in France as La société, du spectacle in 1967 by BuchetChastel. Translation by Donald Nicholson-Smith. This edition designed by Bruce Mau with Greg Van Alstyne. Published by Zone Books, 1994. Marrë nga http://www.antiworld.se/project/references/texts/The_Society%20Of%20The%20Spectacle.pdf pare me 16.6.2016
- D`Hooge I. 2014 (copyright 2015),(Netherlands Institute of International Relations “Clingendael” China’s Public Diplomacy, Inprint, Nijhoff, fage:408, I parë kapitulli I konkluzioneve
- European Commission. 2008. Western Balkans: Enhancing the European Perspective. Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, November 2008. http://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2008/november/tradoc_141300.pdf parë me 2 maj 2015
- Duke, S. 2013. The European External Action Service and Public Diplomacy, Discussion Papers in Diplomacy, Netherlands Institute of International Relations ‘Clingendael’ The Hague; <http://www.clingendael.nl/> , pare me 2 maj 2015
- Fitzpatrick R. K. 2011, Paper 6, US Public Diplomacy in a post 9/11 World: From Messaging to Mutuality, CPD Perspectives on Public Diplomacy, FIGUEROA PRESS pg 13 (pp54)

http://uscpublicdiplomacy.org/sites/uscpublicdiplomacy.org/files/legacy/publications/perspectives/CPDPerspectives_Mutuality.pdf

- Gjuraj T. 2013, 28 Dhjetor, Diplomacia publike shqiptare dhe imazhi i vendit.Oranews.tv, marrë nga <http://www.oranews.tv/analize/diplomacia-publike-shqiptare-dhe-imazhi-i-vendit/> parë më 1 Maj 2016
- Joannin P. 2011, EU-Western Balkans Relations: the European Bermuda Triangle? European Issue n.195
<http://www.robert-schuman.eu/en/european-issues/0195-eu-western-balkans-,-relations-the-european-bermuda-triangle>, parë me 10.6.2016
- Kennedy J. F. 1963, Commencement Address at American University, Washington, D.C., June 10, 1963
http://www.jfklibrary.org/Research/Research-Aids/JFK-Speeches/American-University_19630610.aspx, pare me 2 qershor 2016
- Krajnc. K. P. 2005, Public Diplomacy: Basic Concepts and trends, marrë nga <http://www.ifimes.org/en/8020-public-diplomacy-basic-concepts-and-trends> parë më 14/6/2016
- Li, M. 2009 “Introduction; Soft power, nurture not nature” in M.Li (ed.), Soft Power: China`s emerging strategy in International Politics. Lanham, MD: Lexington Books, 1-19, pg.7
- Lucas P. 2014, Why Albanians love America, New York Times, marrë nga http://www.nytimes.com/2007/06/14/opinion/14iht-edlucas.1.6137324.html?_r=0 parë më 12. 6. 2016
- Mark S. 2009, A greater role of public diplomacy, Netherlands Institute of International Relations ‘Clingendael’ Desk top publishing: Ragnhild Drange, fq:51, te para 1-10
- Mogherini F. 2016, Speech of the HR/VP Federica Mogherini at the Culture Forum in Brussels
Putting culture at the heart of Europe's external action
http://eeas.europa.eu/statements-eeas/2016/160420_03_en.htm
- Nielsen, K. 2013. EU Soft power and the capability–expectations gap, Journal of Contemporary European Research, Vol. 09, Issue 5.

Marrë nga: <http://www.jcer.net/>, , pare më 11 Qershor 2015

- Nye J. S. (Jr). 2008. "Public Diplomacy and Soft Power". The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science, 616: 94-109, DOI: 10.1177/0002716207311699

Marrë nga: <http://ann.sagepub.com/content/616/1/94>, pare më 12 Qershor 2015

- Nye, Joseph S. 2011. The Future of Power. New York: Public Affairs. Pg.1-297
- Nye, Joseph S. 2008 "Public Diplomacy and Soft Power." *The Annals of the American Academy of Political and Social Science* 616 (2008): 94-109. <http://www.jstor.org/stable/25097996>.
- Nye, Joseph S. (2011). *The Future of Power*. New York: Public Affairs. p. 84. [ISBN 9781586488925](https://www.amazon.com/dp/9781586488925).
- Papa Françesku 2014 (20.9.2014) Papa bekon Shqipërinë, mesazh Botës: Merrni shembull nga kombi i shqiponjave! Marrë nga <http://botasot.info/shqiperia/328280/papa-bekon-shqiperine-mesazh-botes-merrni-shembull-nga-kombi-i-shqiponjave/> parë më 24.5.2016
- Prodi, R. 2000, Shaping the New Europe, speech held at European Parliament Strasbourg, 15 February 2000, internet access at: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-00-41_en.htm, parë më 2 shtator 2015
- Saliu H. 2013. Komunikimi në Diplomacinë Publike, Teze doktorature, Departamenti I Histori Filologjisë, Departamenti I Gazetarisë, fq. 318, pare kapitulli i diplomacise kulturore 179-206
- USIA Alumni Association 2004 (A Coffey, Jr. Silverman S., Maurer W., Rough W, Kotok A.,) Making Public Diplomacy Effective, Marrë nga <http://www.publicdiplomacy.org/archives/17.htm#authors> parë më 31.5.2016

- Vassiliou 2014, Cultural diversity, global politics and the role of Europe, European Commission, Weatherhead Centre for International Affairs - Seminar on Cultural Politics Harvard University-Boston, 28 February 2014
http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-14-165_en.htm?locale=en
pare me 2 qershor 2016